

TAKVIM
1439-1440

KALENDAR
2018

Boton:

KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Prishtinë, rr. "Bajram Kelmendi" (Ish-Vellusha) nr. 84

Tel & fax: 038 / 224-001

www.bislame.net

e-mail: takvimi@hotmail.com

Për botuesin:

Myftiu, Naim ef. Tërnavë

Kryeredaktor:

Resul Rexhepi -

email: resulr@hotmail.com

Hajrullah Hoxha - *sekretar i redaksisë*

Lektor:

Ilmi Rexhepi

Redaktor teknik &

Realizimi kompjuterik:

Nuhi Simnica

Shtypi:

N.SH. Studio grafike "Haris"

© Copyright:

Të gjitha të drejtat e botimit, ribotimit, fotokopjimit a përkthimit i përkasin Kryesisë së BI-së të Kosovës.

Ndalohet me ligj riprodhimi i plotë apo i pjesshëm pa lejen e botuesit

**TAKVIM
1439-1440
KALENDAR
2018**

Prishtinë



Me Emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Në vend të parathënies

Falënderimet dhe madhështia janë për Krijuesin e Gjithësisë, Allahun xh.sh., i Cili e krijoi njeriun në formën më të mirë e më të bukur dhe e mësoi atë që të shkruajë e të lexojë! Më pastaj, e drejtoi atë për në thellësitë e diturisë dhe ia pëlqeu këtë rrugë, duke e nxitur për t’u ushqyer sa më tepër me dituri dhe duke e veçuar atë që di mbi atë që nuk di!

Selame dhe salate i dërgojmë Pejgamberit tonë, Muhamedit a.s., i cili nxiti për dituri e mësim. Përshtëndetjet dhe salavatet ia dërgojmë edhe familjes së tij të nderhme, shokëve të tij besnikë, dhe gjithë atyre që ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit!

* * *

Lexues të nderuar!

Ndërsa po bëheshin përgatitjet e fundit për “Takvimin” e këtij viti, po bëheshin edhe përgatitjet që, në kuadër të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, të organizohet Tryeza shkencore kushtuar 60-Vjetorit të veprimtarisë botuese islame në gjuhën shqipe në Kosovë. Në këtë Tryezë shkencore, nga studiues kompetentë, natyrisht që do të flitet dhe do të trajtohet edhe “Takvimi” dhe roli e fun-

ksioni i tij, sepse “Takvimi” hynë ndër botimet e para islame në gjuhën shqipe ndër ne, në botimet më jetëgjate dhe me një vazhdimësi që sivjet mbush dyzetetetë vjet nga dalja e tij për herë të parë më 1970. Gjithë këto vite dhe këta dyzetënëntë numra, janë më se të mjaftueshëm për t’u analizuar, vështruar e vlerësuar puna dhe rëndësia e “Takvimit”. Prandaj, mendojmë dhe na mbanë shpresa se në vitin e ardhshëm, me rastin e nxjerrjes së numrit pesëdhjetë dhe jubilarë të “Takvimit”, botuesi do të organizoj një tryezë a konferencë shkencore të veçantë me temë bosht fillet, zhvillimin, sukseset dhe perspektivën e “Takvimit”.

“*Takvimi*” përfundimisht ka vendin e tij të meritueshëm në veprimtarinë botuese islame në gjuhën shqipe në Kosovë dhe jo vetëm.

Sigurisht dhe pa asnjë dyshim, dalja dhe botimi i “*Takvimit*” ndër këto vite është meritë e botuesit, e themeluesve, e drejtuesve dhe sidomos e bashkëpunëtorëve dhe e lexuesve besnikë të tij. Prandaj që të gjithë këta, pa përjashtim, meritojnë një mirënjohje shumë të veçantë nga ne dhe pikërisht këta janë garancia më fortë se “*Takvimi*” do të vazhdoj edhe për shumë vjet e dekada.

Tashmë është në traditën e “*Takvimit*” që për lexuesit e tij të nderuar të bëjë përpjekje për të sjellë sa më shumë punime nga sa më shumë fusha të dijes dhe të shkencës. Natyrisht, pa harruar këtu, në asnjë mënyrë, edhe pjesën kalendarike, e cila e veçon këtë botim nga literatura dhe publicistika tjetër islame shqipe në vendin tonë.

Së këndejmi, edhe “*Takvimi*” i këtij viti përmban tema nga fusha e tefsirit, e akaidit, e fikhut, e ahlakut, e trashëgimisë, nga historia e arsimit, nga e drejta e Sheriatit, etj., fusha këto standarde dhe karakteristike të “*Takvimit*”.

Ky numër, po ashtu, përmban edhe opinione dhe kontribute të dijetarëve të spikatur islamë, e që në gjuhën tonë vijnë përmes përkthimeve të bashkëpunëtorëve të “*Takvimit*”, porse, sikurse e kemi potencuar dhe herë të tjera, redaksia e “*Takvimit*”, jo domosdoshmërisht, pajtohet me opinionet e autorëve të shkrimeve që boton, por, megjithatë, ajo mbetet e hapur dhe përkrah mendimin, pikëpamjet dhe idetë ndryshe.

Në anën tjetër, si të gjithë numrat e tjerë të “*Takvimit*”, edhe ky i sivjetmi, përmban ajete kuranore dhe hadithe të Pejgamberit a.s., prandaj lexuesit e nderuar i lusim që me rastin e përdorimit të tij, të kenë kujdes të shtuar.

Dhe në fund fare, duke qenë të vetëdijshëm për ndonjë lëshim të paqëllimtë, e që është e mundshme dhe njerëzore, e lusim Allahun e Gjithëmëshirshëm që këtë punë tonën të na e pranojë dhe të na e llogaris në punët tonë të hajrit!

Vel hamdulil-lahi l-ledhi bini'metihi tetimus-salihat!

Prishtinë, nëntor 2017

R. Rexhepi

Sabri BAJGORA

KOMENTIMI I KAPTINËS “EL-HUMEZE”

وَيْلٌ لِّكُلِّ هُمَزَةٍ لُّمَزَةٍ ۚ الَّذِي جَمَعَ مَالًا وَعَدَّدَهُ ۚ تَحْسَبُ
أَنَّ مَالَهُ أَخْلَدَهُ ۚ كَلَّا لَيُنْبَذَنَّ فِي الْحُطَمَةِ ۚ وَمَا أَدْرَاكَ مَا
الْحُطَمَةُ ۚ نَارُ اللَّهِ الْمُوقَدَةُ ۚ الَّتِي تَطَّلِعُ عَلَى الْآفَافَةِ ۚ إِنَّهَا
عَلَيْهِمْ مُّؤَصَّدَةٌ ۚ فِي عَمَدٍ مُّمَدَّدَةٍ ۚ

“Mjerë për secilin që ofendon e përqesh (njerëzit). Që ka tubuar pasuri dhe e ruan. E mendon se pasuria e tij do të bëjë të përjetshëm. Jo, të mos mendojë ashtu! Se ai patjetër do të hidhet në Hutame. E çka din ti se ç’është Hutame? Është zjarri i Allahut i ndezur fort. Që depërton deri në loqë të zemrës. Ai do t’i rrethojë ata nga çdo anë, (duke qenë të prangosur) nëpër shtylla të gjata flakëruese. - (El-Humeze, 1-9).

Kaptina “El-Humeze”, sipas mendimit unanim të dijetarëve, është kaptinë mekase. Transmeton Ibn Merduvije nga Ibn Abasi të ketë thënë: “Ka zbritur kaptina “Vejlun li kul-li humezetin lumeze” në Mekë.¹ Ka gjithsej 9 ajete, 33 fjalë e 130 shkronja.² Ka zbritur pas sures “El-Kijame” dhe para sures “El-Murselat”. Në radhitjen e Mushafit mban numrin 104, kurse në radhitjen e zbritjes është e 32-ta.³

Emërtimi i kësaj kaptine

Kjo kaptinë, në mesin e dijetarëve, njihet me disa emërtime:

1. Emërtimi më i njohur i saj, me të cilin është radhitur nëpër Mushafe, nëpër librat e Tefsirit dhe të Hadithit, është **“El-Humeze”**. Arsyeja e këtij emërtimi është fakti se qysh në ajetin e parë të saj përmendet fjala *“humeze”*, e cila nënkupton personin që ofendon dhe përqesh njerëzit duke i nënçmuar haptazi: *“Mjerë për secilin që ofendon përqesh (njerëzit)”*.⁴
2. Emërtimi i dytë i kësaj sureje është: **“Vejlun li kul-li humezetin lumeze”**. Ky emërtim i gjatë është përcjellë nga Ibn Abasi, ashtu siç pamë pak më lart, ndërkohë që me këtë emërtim e kanë radhitur edhe San’ani, Nesaiu, Tabe-

¹ Imam Shevkaniu, *Fethu-l Kadir*, Measure-Egjipt, vëll.V, f. 497

² Fejruzabadi, *Besairu dhevi-t-temjiz*, Kajro, 1996, vëll. I, f. 543.

³ Ibn Ashur, *Et-Tahriru ve-t-Tenviru*, Tunis, 1984, vëll. XXX f. 535.

⁴ Dr. Munire ed-Devserij, *Esmau suveri-l Kurani-l Kerim ve fedailuha*, f. 595-596.

riu dhe Imam Buhariu.⁵ Arsyeja e këtij emërtimi është po ashtu ajeti i parë i kësaj sureje: *“Mjerë për secilin që ofendon e përqesh (njerëzit).”*

3. Emërtimi i tretë i kësaj kaptine është **“El-Hutame”**. Arsyeja e këtij emërtimi është fjala *“Hutame”*, e cila gjendet në ajetet: (4-5) të saj: *“Jo, të mos mendojë ashtu! Se ai patjetër do të hidhet në Hutame. E çka di ti se ç’është Hutame?”* Fjala *“Hutame”*, nënkupton njërën prej greminave të Xhehenemit, e ndezur e tëra me flakë përcëlluese, e cila do të djegë çdo gjë para vetes. Me këtë emërtim e ka cekur Fejruzabadi.⁶
4. Emërtimi i katërt dhe i fundit i kësaj kaptine është **“El-Lumeze”**, emërtim i cili është përmendur aty-këtu nëpër disa Mushafe. Arsyeja e këtij emërtimi është po ashtu ajeti i parë i kësaj kaptine: *“Mjerë për secilin që ofendon e përqesh (njerëzit)”*.⁷

Vlera e kësaj kaptine

- Surja *“El-Humeze”* bën pjesë në grupin e sureve *“El-Mufassal”*, me të cilat Resulullahi s.a.v.s. është nderuar ndaj të dërguarve të tjerë. Në lidhje me këtë, transmetohet nga Vathilete ibnul Eska’ë El-Lejthi të ketë thënë: *“I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: “Më është dhënë, në vend të Tev-*

⁵ Sahihu-l Buhari-Kitabu-t-tefsir, (6/406). Shih: *Esmau suveri-l Kurani-l Kerim*, f. 231.

⁶ Besairu dhevi-t-temjizi, vëll. I, f. 543.

⁷ *Esmau Suveri-l Kuranil kerim*, f. 231; *Esmau suveril Kuranil Kerim ve fedailuha*, f. 596-597.

ratit, shtatëshja (suret nga El-Bekare e deri te El-Enfal ose Et-Tevbe); më janë dhënë, në vend të Zeburit, “El-Miejn” - njëqindëshet, (suret që kanë mbi 100 ajete); më janë dhënë, në vend të Inxhilit, “El-Methani” - (suret që kanë më pak se 100 ajete), ndërsa jam nderuar (ndaj të dërguarve të tjerë) me suret “El-Mufassal” (nga sureja Kaf, është thënë nga El-Huxhurat, e deri te En-Nas). ”⁸

Shkaku i zbritjes së kësaj kaptine

- Sipas Ataut, Kelbiut dhe Suddiut, kjo sure ka zbritur në lidhje me Ahnes bin Sherikun, i cili i ofendonte njerëzit e sidomos të Dërguarin e Allahut.⁹
- Mukatili thotë se kjo sure ka zbritur në lidhje me Velid ib-nul Mugiren, i cili e përqueshte të Dërguarin e Allahut pas shpine, me gjeste të çoroditura, ndërsa e ofendonte rëndë me fjalë edhe para sysh.¹⁰

Po ashtu është transmetuar nga Ibn Mundhiri se edhe Umejje bin Halefi vepronte njësoj ndaj Resulullahit s.a.v.s.¹¹

- Transmetohet nga Muhamed bin Ishaku dhe Suhejli të kenë thënë: Vazhdimisht dëgjonim se kjo sure kishte zbritur

⁸ Transmeton Imam Ahmedi (4/107); Bejhekiu në *Shuabi-l Iman* (2/465); Al-bani ka kategorizuar si hadith hasen në *Sahihu-tergib* (1457); si hadith sahih me të gjitha rrugët e transmetimit në *Silsile-t es-Sahih*a (1480) dhe në *Sahihu-l Xhamiu* (1059).

⁹ Imam Sujutiu, *Lubabu-n-Nukul*, f. 305.

¹⁰ Tefsiri i Mukatil bin Sulejman, Bejrut 2002, vëll. IV; f. 837.

¹¹ Dr. Muhamed Salim Muhajsin, *Fet’hu-r-Rrahmani fi esbab nuzuli-l Kuran*, f. 168. Kajro, 1999.

për Umejje bin Halefîn. Këtë e ka transmetuar edhe Ibn Xheriri nga Othmani e Ibn Omeri r.a.¹²

- Ebu Hajjani, në lidhje me zbritjen e kësaj kaptine, ka thënë: Kjo kaptinë ka zbritur në lidhje me Ahnes ibn Sherikun ose As ibn Vailin ose Xhemil ibn Ma'merin ose për Velid ibnul Mugiren ose për Umejje ibn Halefîn.¹³
- Sipas Zemahsheriut, kjo sure mbase ka zbritur për të gjithë këta dhe mund të ketë edhe shkak specifik për ndonjërin prej tyre, por kërcënimi është i përgjithshëm dhe përfshin të gjithë ata njerëz që kanë cilësi të tilla jonjerëzore.¹⁴

Lidhja e kësaj kaptine me atë paraprake “El-Asr”

Në kaptinën paraprake “*El-Asr*”, është cekur se të gjithë njerëzit janë në humbje dhe shkatërrim të qartë përveç atyre që i ka mbrojtur Allahu me dritën e Imanit, ndërsa tash në këtë sure ceken disa cilësi të të humburve e të devijuarve nga e vërteta, siç janë përgojimi, përqeshja, ofendimi etj.

Një lidhje tjetër e kësaj sureje me atë paraprake qëndron edhe në faktin se kur Allahu xh.sh. në suren “*El-Asr*” thotë: **“Nuk ka dyshim njeriu është në një humbje të sigurt.”**, tash në këtë sure “*El-Humeze*”, na e sqaron gjendjen e këtyre njerëzve të humbur-jobesimtarë.

¹² Po aty.

¹³ Ebu Hajjan El-Endelusi, *El-Bahrul Muhit*, Bejrut, 1993, vëll. VIII. f. 509.


¹⁴ Zemahsheri, *El-Kesh-shaf*, Rijad, 1998, vëll. VI, f. 429.

Përmbajtje e shkurtër e kësaj kaptine

Kjo sure e shkurtër mekase synon të shërojë një prej sindromave më të rrezikshme të një shoqërie, fyerjen dhe ofendimin e njerëzve, qoftë para sysh, qoftë në mosprezencë të tyre.

- *Qysh në ajetin e parë të kësaj sureje shohim kërcënimin e ashpër hyjnor për ata që ofendojnë e përqeshin të tjerët, qoftë për ndonjë të metë fizike, qoftë për varfëri etj. (Shih ajetin 1).*
- *Në vazhdim të sures, Allahu xh.sh. i qorton këta njerëz që nuk kanë mirësjellje e as moral njerëzor, të cilët mendojnë vetëm për grumbullimin e pasurisë, duke pretenduar se kjo pasuri e tyre do t'i bëjë të pavdekshëm. (Shih ajetet 2-3).*
- *Sureja përfundon me përshkrimin e zjarrit të ndezur të Xhehenemit, i cili do t'i djegë këta njerëz të prishur, të cilët ia kthyen shpinën udhëzimit hyjnor. (Shih ajetet 4-9).*

Koment:



1. Mjerë për secilin që ofendon e përqesh (njerëzit),

Kjo kaptinë pasqyron realitetin e hidhur të një dukurie negative sociale në shoqëritë njerëzore, e cila është e përhapur te një kategori e veçantë njerëzish. Ka prej tyre që, kur arrijnë pasurinë, sidomos ata që e arrijnë në mënyrë të pandershme, e humbin arsyen në veprimet e tyre. Ata që kanë më pak pasuri se këta, i shikojnë me përbuzje e nënçmim,

kurse i lajkatojnë atë që janë të ngjashëm me ta, ose që kanë më shumë pasuri se ata. I Lartmadhërishmi sikur dëshiron të na tërheqë vërejtjen që të mos zhytemi në këto gjëra të ulëta, sepse është Allahu Ai që jep e merr pasuri, se pasuria që ne posedojmë nuk është jona, por atë e kemi në shfrytëzim, si një dhunti e mirësi nga ana e Allahut Bujar e Mëshirëgjërë.

Kaptina fillon me fjalën “*vejlun*” që do të thotë: “*mjerë për...*” dhe është një prej fjalëve më të ashpra, që tregon qartë për hidhërimin e Allahut ndaj kësaj kategorie njerëzish të pandershëm, të cilët përpiqen të përqeshin e të etiketojnë të tjerët me shpifje dhe fjalë ofenduese, qoftë para syve, qoftë pas shpine, duke u treguar si arrogantë, të vrazhdët e mendjemëdhenj.¹⁵

Fjala “*vejlun*” në Kuran ka ardhur në 40 ajete dhe nëpërmjet saj, te pjesa më e madhe e ajeteve ku është përdorur, tërhiqet vërejtja në formën më të ashpër të mundshme për veprimet e ulëta të disa njerëzve, siç është përdorur edhe në ajetin e parë të kësaj sureje. Ky kërcënim vjen drejtpërdrejt nga Allahu xh.sh., i Cili edhe mund ta realizojë kërcënimin e Tij kur të dëshirojë. Prandaj edhe ndëshkimi është i një lloji shumë të veçantë, ndëshkim që do t’i kaplojë të gjithë ata ofendues e përqeshës të besimtarëve dhe të dispozitave hyjnore.

Rreth kuptimit të fjalëve “*humezetin*” dhe “*lumezetin*”, dijetarët kanë dhënë disa mendime, por që të gjitha në fund dalin pothuajse me kuptime përafërsisht të njëjta. Sipas Hasanit, Muxhahidit dhe Ataut, fjala “*humeze*” nënkupton nje-


¹⁵ Selman El Avde, *Ishrakat kuranije*, Rijad, 1433 h., vëll. II, f. 261.

riun që ofendon dhe përgojon tjetrin me fjalë të rënda në mosprezencë të tij, ndërsa fjala “*lumeze*” nënkupton njeriun i cili në mënyrë ironike ua shkel syrin të tjerëve, dëfton me kokë dhe bën shenja me anë të vetullave, për ta përqeshur ndonjërin prej të pranishmëve, edhe në prezencë të tij.¹⁶

Ibn Abbasi në lidhje me fjalën “*humeze*” ka thënë: Këta janë ata që merren me thashetheme, me shpifjet e të cilëve i ndajnë njerëzit më të afërt dhe të pastërve u veshin gjëra të turpshme e të paqena.¹⁷

Në përgjithësi, Allahu xh.sh. në këtë ajet kuranor, i mallkon dhe i kërcënon të gjithë ata njerëz që ofendojnë të tjerët, i përqeshin parapa shpine dhe shpifin gjëra që lëndojnë sedrën e të tjerëve dhe që prekin nderin e moralin e njerëzve të pastër e të devotshëm.

Por a thua ç’i shtyn këta njerëz të lig të sillen me aq pacipësi e përbuzje ndaj të tjerëve? Natyrisht, përgjigjja pason në ajetin vijues, është pasuria...



2. *Që ka tubuar pasuri dhe e ruan.*

Ata që ofendojnë njerëzit e tjerë dhe i përqeshin ata vetëm pse janë të varfër, duke u mburrur me pasurinë e tyre, vërtet janë fundërrina e llojit njerëzor. Këta njerëz, të hutuar nga pasuria e tyre, mendojnë se i kanë në dorë të gjitha gjërat në këtë jetë. Ata mendojnë se vetëm grumbullimi i pasurisë i bën të fortë dhe të pathyeshëm. Të tillët nuk kanë ndjenja

¹⁶ Shih më gjerësisht: Tefsiri i Kurtubiut, Kajro, 1950, vëll. XX, f. 181;

¹⁷ Po aty, vëll. XX, f. 181.


njerëzore. Ne zemrat e tyre nuk ka shpirt human, por për ta materialja mbizotëron mbi shpirtëroren. Këso kategorish të njerëzve hasen në çdo kohë dhe në çdo vend të botës. Këta njerëz edhe në ditët tona të sotme, nuk kanë ndërruar strategjinë e kohërave të vjetra. Këta shfrytëzojnë pasurinë e fituar në rrugë të pista për të mbizotëruar ndaj pjesës më të madhe të shoqërisë, duke i shfrytëzuar pamëshirshëm njerëzit e varfër.

Ky ajet flet pikërisht për ata njerëz të pandërgjegjshëm, të cilët grumbullojnë pasurinë dhe e ruajnë duke mos dhënë asgjë në udhë të Zotit.¹⁸ Allahu xh.sh. për të tillët thotë: ***“Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë në rrugën e Allahut, paralajmëroji me një dënim të dhembshëm.. Do të vijë dita kur (pasuria e mbledhur) do të digjen në zjarrin e Xhehenemit dhe me to do t’u damkoset balli, anët dhe shpina e tyre (e do t’u thuhet): “Kjo është ajo që keni grumbulluar për veten tuaj, pra, shijoni atë që grumbulluat!” (Et-Tevbe, 34-35)***

Njerëz të tillë kishte pasur edhe në kohën e Resulullahit s.a.v.s.. Ata e përqeshnin Muhamedin a.s. se ishte i varfër, nuk kishte pasuri e as djem që do ta trashëgonin dhe sillesin në mënyrë të vrazhdë dhe me përbuzje ndaj tij, por, megjithatë, ai që e përkrah Allahu xh.sh. natyrisht që do të jetë gjithmonë ngadhënjyes dhe fitimtar ndaj çdo tirani dhe shpifësi. I tillë ishte Muhamedi a.s., i cili i fuqizuar dhe i përkrahur nga ana e Zotit të Plotfuqishëm, themeloi shtetin e mirëfilltë islam, i cili, pak vjet pas vdekjes së tij, do të çrrënjoste nga

¹⁸ Dr. Aishe bin Abdurrahman-Bintu-sh-Shati’ë, *Et-Tefsiru-l bejani li-l Kur-ani-l Kerim*, Kajro, 1986, vëll. II, f. 170.

themeli dy perandoritë më të mëdha që ndonjëherë i ka mbajtur mend historia: perandorinë romake dhe atë persiane.



3. E mendon se pasuria e tij do ta bëjë të përjetshëm.

Ahnesi, Umejje, Velidi apo Asi, cilido qoftë ai, ka qenë i përhumbur në iluzionin se pasuria e tij do ta bënte të përjetshëm e të pavdekshëm. Këta idhujtarë ishin verbuar duke kujtuar se, meqë ishin të pasur, e kishin në dorë edhe përjetësinë e tyre. Mendonin se me pasurinë e tyre do ta arrinin këtë gjë. Këta, teksa e shihnin veten, të rrethuar nga të gjitha anët me luks e mirëqenie, mendonin se të tjerët ekzistonin në këtë botë vetëm që të ishin robër ose shërbëtorë të tyre.. Mjerisht, pamje dhe raste të tilla ka pasur si në të kaluarën e ka edhe sot e do të ketë deri në përfundim të jetës. Asgjë nuk ndryshon tek kjo kategori njerëzish. Pasuria i ka verbuar përfundimisht dhe ata mendojnë se me anë të saj mund të realizojnë çdo gjë. Por, sa përfundim i keq do të jetë fundi i tyre si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër. Shumica prej tyre qysh në këtë botë e marrin ndëshkimin e merituar. Do të turpërohen për së gjalli, do të vdesin ashtu siç vdiqën idhujtarët, të përbuzur e të nënçmuar, duke marrë më vete hidhësinë e mendjemadhësisë së tyre, ndërsa në botën tjetër ata do t'i pretë zjarri i ndezur flakë i skëterrave të Xhehenemit...

Nga kjo perspektivë, ne mund të imagjinojmë gjendjen shpirtërore të ndonjë miliarderit të pafe në momentet e vdekjes, kur para syve të tij në momentet e dorëzimit të shpirtit, i hapen perdet e “gajbit” dhe i sheh engjëjt e azabit-ndëshkimit duke e tërhequr zvarrë. Po të kishte mundësi të fliste, ai sigu-

risht se do të pendohej për grumbullimin e tërë asaj pasurie, të cilën nuk ka arritur ta shpenzojë ku duhet, në rrugën e Allahut. Tash tërë ajo pasuri do t'i kundërvihet në Ditën e Gjykimit dhe do ta bartë si barrë të rëndë në ndërgjegjen e vet kur të fillojë ndëshkimi i tij me zjarrin e ndezur flakë të Allahut, i cili do ta djegë e do ta përcëllojë.

كَلَّا لَيُنْبَذَنَّ فِي الْحُطَمَةِ ﴿٥٠﴾ وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْحُطَمَةُ ﴿٥١﴾

4. Jo, të mos mendojë ashtu! Se ai patjetër do të hidhet në Hutame.


5. E çka di ti se ç'është Hutame?

Dëshirat joreale të këtyre njerëzve për përjetësinë në këtë botë, i zhदारarit fjala e Allahut në vazhdim, që këta të mos iluzojnë e as të mos mendojnë kështu, sepse këto janë dëshira dhe lakmi të kota, meqë përjetësia dhe amshimi nuk i takon askujt tjetër pos Allahut, Krijuesit të ekzistencës. Përkundrazi, këta njerëz të poshtër, me nënçmimin më të madh do të përbuzen dhe do të hidhen në humnerat e Xhehenemit. Vendqëndrimi i tyre është Xhehenemi i quajtur “*Hutame*”,¹⁹ një prej greminave të skëterrës, e cila do t'i gllabërojë në zjarrin e saj përcëllues të gjithë ata gojëkëqij, shpifës dhe përqeshës.

Në aspektin kuptimor, emërtimi “*Hutame*” rrjedh nga folja: ‘*hatame*’, që do të thotë të thyesh a të copëtosh diçka në thërmija. Është quajtur me këtë emër si një lloj shëmbë-

¹⁹ Një prej emrave të Xhehenemit. Muxhahidi dhe Kushejri kanë thënë se “*Hutame*” është gremina e dytë e Xhehenemit; Dahhaku mendon se është gremina e katërt e tij, kurse Kelbiu është i mendimit se “*Hutame*” është gremina e gjashtë e Xhehenemit. Ndërkohë, Vahidiu mendon se “*Hutame*” është dera e dytë e Xhehenemit.


llimi me thyerjen e zemrave dhe ndereve të njerëzve të pastër nga gojët e intrigantëve dhe shpifësve ofendues. Në fakt, ata në këtë xhehenem, vërtet do të ndëshkohen me tmerre të papara. Por, a thua çfarë në të vërtetë është “*Hutame*”? Çfarë është tmerri i quajtur “*Hutame*”? Përgjigjja hyjnore vjen në ajetin vijues...



6. Është zjarri i Allahut, i ndezur fort.

Kjo greminë e Xhehenemit, në të cilin do të hidhen jobesimtarët, mbase është një specifikim për një kategori të caktuar njerëzish, si f.v. ofenduesit, përqeshësit, nënçmuesit e fjalës hyjnore etj..

Në këtë greminë të skëterrës do të jetë i ndezur fort zjarri përcëllues, të cilin Allahu ia ka atribuuar Vetes sa për të na vënë në dijeni se ky zjarr nuk është sikurse zjarri i kësaj bote, por është zjarr që kur të ndizet me lejen e Allahut, më kurrë nuk fiket, por vetëm djeg dhe përcëllon mëkatarët.




7. Që depërton deri në loçkë të zemrës.

Ky zjarr, që do t'i kaplojë trupat e jobesimtarëve, do të depërtojë deri në loçkën e zemrës së tyre. Flakët e zjarrit do të përpijnë çdo gjë para vetes. Do t'ua djegë lëkurat dhe kjo do të jetë ndëshkim i rëndë, sepse nuk vdesin kurrë, por vetëm se ky proces përsëritet e ripërsëritet në pambarim, duke u shkaktuar dhimbje të padurueshme.

Është veçuar zemra si gjymtyra trupore e cila do ta ndiejë më së shumti ndëshkimin, sepse zemra është burim i atyre

besimeve të kota të tyre, i ideve ndjellakeqe e të mbrapshta dhe i sjelljeve çoroditëse e të ulëta.

Transmeton Halid Ibn Ebi Imran me senedin e tij deri tek Resulullahu s.a.v.s. të ketë thënë: *“Zjarri i ha (djeg) banorët e tij, derisa të depërtojë në zemrat e tyre dhe aty ndalet. Pas-taj sërish ndizet dhe fillon të flakërojë mu nga brendia e zem-rës. Kjo do të përsëritet përjetësisht dhe kjo është ajo për të cilën flet Allahu xh.sh. kur thotë: “Është zjarri i Allahut i ndezur fort, që depërton deri në loçkë të zemrës.”*



8. Ai do t'i rrethojë ata nga çdo anë

Ky zjarr i xhehenemit ua zë frymën. Ata me vështirësi do të marrin frymë. Aty faktikisht nuk do të ketë ajër të pastër, sepse bloza e Xhehenemit e bën atmosferën aty krejtësisht të zymtë e të errët.

Në këtë xhehenem nuk do të ketë as dyer e as dritare të hapura. Zjarri i këtij Xhehenemi, i cili do t'i torturojë pambarrim, i rrethon ata nga çdo anë. Nga aty nuk mund të dalin, edhe po që se tentojnë, sepse Allahu xh.sh. në lidhje me këtë ka dhënë shenjë edhe në disa ajete të tjera kuranore:

“Kundër tyre është zjarri i mbyllur.” - (El-Beled, 20),
dhe

“Sa herë që përpiqen të dalin prej tij nga vuajtjet e padurueshme, kthehen me dhunë në të përsëri (u thuhet): “Vuajeni dënimin me djegie!” - (El-Haxh, 22).

فِي عَمَدٍ مُّمَدَّدَةٍ

**9. (duke qenë të prangosur) nëpër shtylla të gjata flakë-
ruese.**

Çka është me e keqe, jobesimtarët do të jenë aq të përbuzur e të nënçmuar, saqë, përveç këtyre dënimeve e djegieve me zjarr, ata edhe do të prangohen dhe do t'u pamundësohet çdo lëvizje. Ata, faktikisht do të jenë të burgosur e të pranguar brenda burgut të skëterrës.

Në lidhje me fjalët “*fî amedin mumeddedeh*”, dijetarët kanë dhënë disa mendime:

Katadeja thotë se jobesimtarët do të ndëshkohen të lidhur nëpër shtylla, mundim të cilin e ka përzgjedhur Ibn Xherir et-Taberiu.²⁰

Ibn Abasi²¹ mendon se “*fî amedin mumeddedeh*” janë prangat dhe zinxhirët deri në qafë.

Ebu Salihu thotë se fjala është për prangat e vëna në këmbë, ndërkohë që Kushejri²² thotë se fjala “*fî amedin mumeddedeh*”, sipas të gjitha parametrave, nënkupton shtyllat të pllakave (kapakëve) të cilat do të palosen mbi banorët e zjarrit, duke mos lënë as hapësirën më të vogël të dritës, në mënyrë që ndëshkimi të jetë sa më i tmerrshëm. Disa nga mufessirët, këtë ajet e kanë shpjeguar edhe si: kohë të zgjatuar, pa mbarim, por të vërtetën, megjithatë, e di vetëm Allahu xh.sh.

²⁰ Tefsiri i Taberit, Kajro, 2001, vëll XIV, f. 625.

²¹ Po aty, vëll XIV, f. 625.

²² El-Arumij, *Hadaiku-Rrevhi ve-r-Rrejhan*, Bejrut, 2001, vëll. XXX, f. 320,

Porosia e kësaj sureje:

- *Kjo kaptinë mëton të gjejë shërim për cilësitë e urryera të njerëzve mendjemëdhenj e mburraveçë, të cilët i marrin nëpër gojë njerëzit kur ata nuk janë të pranishëm, por i ofendojnë ata edhe në praninë e tyre.*
- *Të urryer tek Allahu janë edhe ata njerëz që grumbullojnë pasuri dhe që pastaj nuk çajnë kokën për të varfrit, por mendojnë se pasuria e tyre do t'i bëjë të pavdekshëm e të përjetshëm Ndëshkimi për të tillët që nuk respektuan ligjet e Allahut do të jetë hedhja në zjarr të ndezur të Xhehenemit.*
- *Urtësia e mospërmendjes së emrave të atyre për të cilët ka zbritur kjo sure, është shumë e madhe, sepse po të përmedeshin emrat e të tillëve, kjo sigurisht se do të lëndonte të afërmit dhe pasardhësit e tyre, shumica prej të cilëve më vonë pranuan islamin.*
- *Allahu xh.sh. nëpërmjet këtyre ajeteve na e ka tërhequr vërejtjen të bëjmë kujdesin ndaj këtyre veseve të shëmtuara: fyerjen dhe ofendimin e njerëzve me fjalë ose me vepër. Na ka bërë me dije që të mos bëhemi rob të pasurisë e të jetojmë për pasuri, sepse kjo botë është kalimtare, pasuria vjen e shkon, kurse njeriu vdes dhe në fund i lë të gjitha. Ai njeri te i cili gjenden këto cilësi dhe nuk pendo het tek Allahu, ai pa dyshim që do të jetë banor i zjarrit, i cili djeg e shkrumbon çdo gjë.*

Doc. dr. Almir FATIĆ

METODA E INTERPRETIMIT KONTEKSTUAL TË KURANIT¹

Hyrje

Komentuesit e Kuranit vërejtën shumë herët se, për një kuptim të duhur të leksikut kuranor, e një rëndësie të madhe është njohja e situatave kontekstuale dhe lidhja në mes të fjalëve, ajeteve dhe sureve. Fjalët kuranore, që kanë kuptim të vendosur apo konvencional, kur përdoren ose gjenden në një kontekst të ri, bartin edhe kuptimin e ri kontekstual. Kështu, e njëjta fjalë paraqitet në “subjektet e reja semantike”. E që kjo të vihet re, semantikët klasikë dhe ata bashkëkohorë të Kuranit arrijnë në përfundimin se është e nevojshme, së pari, të kuptohet konteksti në të cilin një fjalë paraqitet, së dyti, të

¹ Doc. dr. Almir Fatić, “Metod kontekstualnog tumačenja Kur'ana”, **Znakovi vremena**, XII, nr. 43/44, 2009, f. 87-115.

kuptohet marrëdhënia kontekstuale me fjalë të tjera, dhe së treti, të kuptohet struktura formale e kontekstit të saj. Metodologët e shkencës së tefsirit, si një prej rregullave metodologjike hermeneutike, kanë vënë rregullën e kontekstit kuranor. Sipas kësaj rregulle të rëndësishme, komentuesit (mufesirit) nuk i lejohet që fjalët kuranore ose ajetet t'i interpretojë brenda kontekstit të vet, e ka për detyrë t'i perceptojë dhe t'i interpretojë në kontekstin e tekstit kuranor (*fī sijāq en-nassi'l-qur'ānijj*), veçanërisht në qoftë se një fjalë apo ajet ka kuptim polisemik. Në këtë mënyrë, komentuesit e hershëm të Kuranit kanë zhvilluar një lloj të veçantë të metodave kontekstuale të interpretimit të Kuranit dhe kështu themeluan teorinë klasike të kontekstualitetit të Kuranit, e cila është aktuale deri sot.

Teoria klasike rreth kontekstualitetit të Kuranit

Me teorinë klasike të kontekstualitetit të Kuranit kuptojmë parimin klasik tefsiror se Kurani e komenton veten e tij (*el-Qur'an u fessiruhu ba'duhu ba'dan*). Me këtë parim dëshmohet, ndër tjerash, se në shkencën e tefsirit veçanërisht është marrë parasysh e që edhe sot merret parasysh roli dhe rëndësia e kontekstit në analizën semantike të tekstit kuranor. Në veprën e tij *Bedā'i'u'l-fewā'id*, autoriteti i njohur në shkencat islame Ibn Kajjim el-Xhewzijje kështu e shpjegon rolin e kontekstit në përcaktimin e kuptimit: *Konteksti sugjeron një shpjegim të termit të paqartë, përcakton një nga kuptimet e mundshme, pa mëdyshje udhëzon në një kuptim, pa mundësinë e kuptimeve të tjera, e përcakton deklaratën absolute*

dhe e klasifikon kuptimin. Prandaj, konteksti është një nga treguesit më të rëndësishëm që tregon intencën e folësit; kush e lë pas dore, do të gabojë në të menduarit dhe do të shkaktojë një gabim në diskutim. Vëzhgoi (analizoi) fjalët e të Plotfuqishmit: 'Sprovo! Ti je, me të vërtetë, 'i fuqishëm', 'fisnik'' (Ed-Dukhān,), në të cilat do të vini re se konteksti i tyre tregon se i tilli është i përulur dhe i shkretë.²

Këto fjalë të Ibn Kajjimit, Ez-Zerkeshiu i përmend në *El-Burhānu* në pjesën e tij rreth “faktorëve që përcaktojnë kuptimin, semantikën e situatave problematike”, si faktor të katërt e përmend kuptimin kontekstual (*dilāletu's-sijāq*).³ Ez-Zerkeshiu, si shumë të tjerë para dhe pas tij, e konfirmoi parimin klasik tefsiror se *Kurani e komenton vetë Kuranin*, që në fakt nënkupton metodën kontekstuale të interpretimit të Kuranit. Në pjesën e titulluar “Metoda më e mirë në interpretimin e Kuranit - komentimi i Kuranit me Kuran”, ai gjithashtu tregon për metodën e tillë të interpretimit të Kuranit, kur ai thotë: “Ajo që është thënë (në Kuran) në një mënyrë të paqartë, është shpjeguar në një vend tjetër dhe ajo që është thënë në një vend shkurtimisht, në vendin tjetër është thënë më gjerësisht. E nëse mungon, atëherë kthehu në Synet, sepse Syneti është koment dhe shpjegim i Kuranit; i Plotfuqishmi ka thënë: *Ne të shpallim ty Librin, në mënyrë që të shpjegojnë gjithë atë për të cilën ata ndahen, dhe si Udhëzim e Mëshirë për ata që besojnë!* (En-Nahl, 64). Kështu që Pejgamberi

² Ibn Qayyim al-Džawziyya, *Badā'i al-fawā'id*, Maktaba al-bayān, Bayrūt, 1994, 301.

³ Az-Zarkashī, *al-Burhān fī 'ulūm al-Qur'ān*, II, Dār al-xhīl, Bayrūt, 1988, f. 200.

s.a.v.s. ka thënë: "*Me të vërtetë, mua më është dhënë Kurani dhe diçka e ngjashme me të*" (Ahmedi), domethënë Syneti. Nëse nuk gjendet (shpjegimi) në Synet, atëherë u drejtohem fjalëve të sahabëve, sepse ata më së miri e njihnin (Kuranin), sepse ata ishin dëshmitarë të rrethanave (të shpalljes së tij) dhe për shkak se Allahu atyre u dhuroi të kuptuarit e pazakontë. Nëse, megjithatë, shpjegimi nuk gjendet edhe në fjalët e sahabëve, atëherë përdoret shqyrtimi racional dhe deduksioni, nën kushte të përmendura.”⁴

Në këtë drejtim, fjalët e Ibn Kajjimit mund të merren si rregulla të rëndësishme eksegjetike për të kuptuar parimin tefsiror “Kurani e shpjegon vetveten”, ku konteksti ka rëndësinë kyçe. Prandaj, në vazhdim, duke përdorur shembuj nga Kurani, në mënyrë koncize do të ekspozojmë shtjellimin e fjalëve të Ibn Kajjimit për të realizuar implikimet e asaj që ato përmbajnë.

a) Shpjegimi i shprehjeve të paqarta

Kjo rregull nënkupton se asaj që është e paqartë në një vend në tekst, në vendin tjetër i është dhënë shpjegimi.” Shembuj të kësaj rregulle eksegjetike janë të mjaftueshëm në Kuran.”⁵ Es- Sujūtū në *El-Itqānin* e tij në një kapitull të veçantë përmend një numër të shembujve të ajeteve kuranore, në të cilat “gjen shprehjen” kjo rregull. Në fillim të kapitullit, *Es-Sujūtū* përmend nëntë shkaqet gjuhësore të cilat sjellin deri te *ixhmāli* - pasiguria (të tilla si: polisemia, elipticiteti,

⁴ Ibid., f. 175-176.

⁵ Enes Karić, *Kako tumačiti Kur'an*, Tugra, Sarajevë, 2005, f. 22.

përemrat reflektivë, inversioni...)⁶ Këtu do përmenden disa shembuj nga *El-Itqāni* i tij:

Ajeti i parë i sures El-Mā'ide:

أُحِلَّتْ لَكُمْ بَهِيمَةُ الْأَنْعَامِ إِلَّا مَا يُنْتَلَى عَلَيْكُمْ *Ju janë lejuar kafshët, pos atyre kafshëve ndalesa e të cilëve do të përmendet, është shpjeguar me ajetin e tretë të së njëjtës sure: ... حُرِّمَتْ عَلَيْكَ الْمَيْتَةُ ... Ju është ndaluar ngordhësira...*

Ajeti i katërt i sures El-Fatiha: يَوْمَ الدِّينِ *Sunduesit të Ditës së Gjykimit*, shpjegohet në ajetet e sures El-Infitār (17-19):

وَمَا أَدْرَاكَ مَا يَوْمَ الدِّينِ ﴿١﴾ ثُمَّ مَا أَدْرَاكَ مَا يَوْمَ الدِّينِ ﴿٢﴾
يَوْمَ لَا تَمْلِكُ نَفْسٌ لِنَفْسٍ شَيْئًا وَالْأَمْرُ يَوْمَئِذٍ لِلَّهِ

“E ç’të mësoi ty se ç’ është dita e gjykimit? Përsëri, ç’të mësoi ty se ç’ është dita e gjykimit? Është dita kur askush, askujt nuk do të mund t’i ndihmojë asgjë; atë ditë e tërë çështja i takon vetëm Allahut!”

Ajeti në suren el-Bekare (37): فَتَلَقَّى آدَمَ مِنْ رَبِّهِ كَلِمَاتٍ *E Ade-mi pranoi prej Zotit të tij disa fjalë*, shpjegohet në ajetin e njëzetetretë të sures El-E'arāf: رَبَّنَا ظَلَمْنَا أَنْفُسَنَا *Dhe ata thanë: “Zoti ynë, ne i bëmë të padrejtë (e dëmtuam) vetvetes sonë...”*

Ky shpjegim i termit të paqartë - pretendon Selwā el-'Awwā⁷- nganjëherë pjesërisht mund të pasojë nga vetë kon-

⁶ Shih: as-Suyūtī, *al-Itqān fi 'ulūm al-Qur'ān*, I, Dār al-kutub al-'arabī, Bay-rūt, 1999, f. 641-644.

⁷ Salwā Muhammad al-'Awwā punon si ligjëruese e Kuranit dhe Hadithit në Universitetin në Birmingham. Fusha shkencore e interesimit të saj përmbledh: studimet kuranore dhe të hadithit, komentimet klasike dhe moderne

teksti i gjuhës (*es-sijāqu'l-lugawijj*), domethënë që në tekst të përmendet drejtpërsëdrejti fjala që e shpjegon atë, apo, nganjëherë, domethënia mund të kuptohet nga konteksti tematik (*es sijāqu'l-mewdū'ijj*) apo fakte tjera të përfshira në kontekstin e përgjithshëm (*es-sijāqu'l-'ām*) ose kontekstin kulturologjik (*es-sijāqu'th-theqāfijj*) të një teksti. Gjithashtu, nganjëherë në një kontekst tjetër flitet në lidhje me temën e njëjtë ose përmendet e njëjta fjalë diku tjetër në tekst ose në kontekstin e përgjithshëm. Si një shembull i fjalëve të saj, ajo e përmend sintagmën kuranore *we eqīmu's-salāh* (“dhe fal namaz”), ku fjala *iqāmeḥ* është term i paqartë (*muxhmel*), shpjegimi i të cilit nuk përmendet në vende ku përmendet kjo sintagmë, por në vende tjera ku përmendet kjo sintagmë kuranore. Më tej, shpjegime të hollësishme të fjalës *iqāmeḥ* janë në kontekstin e përgjithshëm të tekstit kuranor, domethënë në synetin verbal (hadith i Pejgamberit, s.a.v.s.) dhe zbatimin.⁸

b) Përcaktimi i një kuptimi nga kuptimet e mundshme

Bëhet fjalë për përcaktimin e një kuptimi nga dy ose më shumë kuptime të mundshme leksikore. Duke pasur parasysh se gjuha kuranore është polisemike, ndonjëherë është e nevojshme, me qëllim të eliminimit të pasigurisë dhe dyshimit, që t'i jepet përparësi një kuptimi. Si shembull i kësaj rregulle

të Kuranit dhe analiza linguistike e Kuranit dhe hadithit. Krahas librit të përmendur ajo i botoi edhe këto libra: *al-Xhamā'a al-islāmiyya al-musallaha fī Misr*, Maktaba ash-Shurūq, al-Qāhira, 2006; *Textual Relations in the Qur'an: structure, coherence and relevance*, Routledge-Carson, 2005 (<http://www.theology.bham.ac.uk/staff/el-awa.htm>).

⁸ Al-'Awwā, *al-Wuxhūh wa'n-nadhā'ir*, op. cit., f. 64.

mund të specifikojmë ajetin e shtatëmbëdhjetë të sures Et-Tekwîr: *إِذَا اللَّيْلُ إِذَا عَسْعَسَ*, të cilin Ibn Kethîri në tefsirin e tij, e shpjegon si më poshtë: “Fjalët *عَسْعَسَ* do të thonë *أَقْبَلَ* kur të shfaqet edhe pse është i saktë edhe kuptimi *الْإِذْبَارُ* kur të perëndojë, por këtu është kuptimi më i përshtatshëm *الْإِقْبَالُ* shfaqja (e natës). Sikur i Plotfuqishmi të betohet në natën dhe errësirën e saj kur të shfaqet dhe agimin e të zbardhurit e tij kur agon, siç thotë Ai: *إِذَا يَغْشَىٰ وَالنَّهَارُ إِذَا تَجَلَّىٰ* Betoheh në natën kur të fshihet, dhe ditën kur të shfaqet (El-Lejl, 1-2); *إِذَا سَجَىٰ وَاللَّيْلُ إِذَا سَجَىٰ* Betoheh në mëngjesin, dhe natën kur terrohet e qetësohet (Ed-Duhā, 1-2). Shumë dijetarë të metodologjisë së shariatit (usûl-i fikhut) thonë se fjala *عَسْعَسَ*, duke pasur parasysh se është polisemike, përdoret në të dy kuptimet: *të shfaqet* dhe *të perëndon* (*el-iqbālu we'l-idbār*) dhe është e saktë që të pretendohet se këtu mendohet në të dy kuptimet.”⁹

Komentuesi i Kuranit Et-Taberîu thekson se një nga njohësit e gjuhës arabe pretendon se folja *عَسْعَسَ* është më afër kuptimit të foljes *أَقْبَلَ* shfaqje dhe *أَظْلَمَ* muzg (natë).¹⁰

Është vërejtur se Ibn Kethîri dhe Et-Taberîu i japin përparësi kuptimit *أَقْبَلَ* duke u mbështetur në vende të tjera kontekstuale në Kuran, ose foljet të cilat përdoren me fjalën *لَيْلٌ* natë, errësirë.

⁹ Ibn Kathîr, *Tafsîr al-Qur'ân al-'adhîm*, IV, Xham'iyya ihyâ' at-turâth al-islâmî, al-Kuwayt, 1994, IV, f. 617.

¹⁰ At-Tabarî, *Xhâmi' al-bayân 'an ta'wîl âyi'l-Qur'ân*, XXX, Dâr al-fikr, Bayrût, 1995, f. 99.

c) Referimi jo i dykuptimshëm rreth një kuptimi në pamundësi të kuptimeve tjera

Ndonjëherë ndodh që kuptimi i cili del nga teksti është në kundërshtim me kontekstin e përgjithshëm të njohur, apo fakteve të përgjithshme të mundshme në kontekstin tematik në të cilin gjendet një fjalë e caktuar. Në të gjitha rastet e këtij lloji, konteksti mund të na ndihmojë në përcaktimin e qartë të kuptimit leksikor. Si shembull mund të përmendim ajetet e mëposhtme:

فَوَيْلٌ لِلْمُصَلِّينَ الَّذِينَ هُمْ عَنْ صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ ﴿٧﴾

الَّذِينَ هُمْ يُرَاؤُونَ ﴿٨﴾ وَيَمْنَعُونَ الْمَاعُونَ ﴿٩﴾

Mjerë për ata, të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm (të harrueshëm), e veprojnë, vetëm sa për sy e faqe (para botës) dhe pengojnë dhënien e ndihmës (bamirësisë midis njerëzve)! (El- Mā'ūn, 4-7).

Nëse me analizën leksikore ne duam të kuptojmë ajetet e përmendura më lart, është e nevojshme që të përcaktojmë kuptimin e fjalës *musal-līn* (musal-litë, falësit e namazit). Së pari, konteksti i përgjithshëm na ndihmon për të përcaktuar kuptimin e fjalëve përkatëse, por, gjithashtu, sjell edhe një paqartësi të natyrës gjuhësore. Gjegjësisht, si mund të përdoret fjala *wejl* (që tregon kërcënim dhe frikësim) për *musal-litë* (ata që falen), kur namazi është një nga themelet bazë të fesë, pa të cilin edhe vepra të tjera nuk do të jenë të pranuar?! Kështu që, kuptimi i fjalës *musal-līn* në këtë rast nuk ka të bëjë për secilin falës, ose, thënë me fjalë të tjera, kuptimi këtu kërkon që kjo të jetë e kufizuar në karakteristikën tjetër që dikton konteksti i përgjithshëm për të shmangur rënien në

të kuptuarit jo të drejtë. Prandaj, roli i kontekstit gjuhësor në këtë rast reflektohet në përcaktimin e tipareve të reja të kuptimit.¹¹

Ajeti: ... *të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm (të harrrueshëm)* paraqet një përshkrim të fjalëve përkatëse problematike. Pra, këta *musal-li* janë ata të cilët e falin namazin “në harresë dhe neglizhencë”. Por, parashtrohet pyetja se çfarë do të thotë këtu “harresa dhe neglizhencia”? A nënkupton kjo harresë, harresën dhe neglizhencën ndaj kohës së namazit ose ndaj të kuptuarit të vetë namazit? Konteksti i përgjithshëm kuranor nuk lejon që harresa të jetë arsyeja për kërcënim; këtë kontekst të përgjithshëm - pretendon El-'Awwā e përfshin hadithi: “Ymetit tim do t'i falet ajo që e bën nga gabimi, harresa dhe ajo për të cilën ata detyrohen ta bëjnë”.¹²

Përgjigjet ndaj pyetjeve të bëra mund të gjenden në *El-Burhānin* e Ez-Zerkeshiut, ku ai thotë “Rreth çdo fjale duhet të mendojmë thellë që mos të vijë deri te keqinterpretimi i saj, siç ka ndodhur edhe nga dijetarët e mëdhenj. El-Khattābī transmeton se Ebu'l-'Ālije ishte pyetur për kuptimin e fjalës së të Lartësuarit: *Fewejlun li'l-musallīn elledhīne hum 'an salātihim sāhūn*” dhe ai tha: 'Kjo u referohet atyre që janë aq larg nga namazet e tyre sa nuk e dinë nëse ata i kanë falur rekatet çifte apo teke.' Pastaj El-Haseni tha: 'Ngadalë, Ebu'l-

¹¹ Al-'Awwā, al-Wuxhūh wa'n-nadhā'ir, *op. cit.*, f. 64.

¹² Hadithi është *sahīh* (autentik) “sipas kushteve të Bukhāriut dhe Muslimit” (al-Hākim); si autentik e konsiderojnë edhe: adh-Dhahabīu, Ibn Hibbāni, Ahmad Shākiri dhe al-Albānī; shih: Muhammad Nāsir ad-Dīn al-Albānī, *Irwā' al-galīl fī takhrīxh ahādīth manār as-sabīl*, I, al-Maktaba al-islāmiyya, Bayrūt, 1979, f. 123.

'Ālije, nuk është kështu, por këtu mendohet për ata që e harrojnë kohën e namazit e që ajo u kalon (pa u falur)! A nuk e sheh se i Plotfuqishmi ka thënë: '*an salātihim*?' Kjo do të thotë se Ebu'l-'Ālije këtë ajet nuk e kishte trajtuar me vëmendje të mjaftueshme në mënyrë që nuk e vërejti dallimin në mes të parafjalës *fī* dhe parafjalës *an*, për çka e kishte paralajmëruar El-Haseni. Ajo siç e kishte kuptuar Ebu'l-'Ālije do të ishte: '*fī salātihim*, por është thënë '*an salātihim*, që do të thotë të larguarit nga koha e namazit.'"¹³

Elementi tjetër për të përcaktuar kuptimin e fjalës problematike *musallīn*, - siç përmend El-'Awwā, - janë fjalët e të Lartësuarit: *elledhīne hum jurā 'ūne* ("të cilët vetëm shtiren"), kuptimi i të cilëve është absolut dhe i natyrës së përgjithshme, për shkak se folja *jurā 'ūne* është përmendur pa specifikuar objektin ose shtesën. Kështu që, të gjitha veprat e falësve të tillë të namazit janë mashtruese, hipokrite. Pastaj, përmendet prova praktike e hipokrizisë së tyre: parandalimi i lëmoshës/sadakasë, e që sadakaja është një vepër thelbi i së cilës është sekret.

Në këtë mënyrë - përfundon El-'Awwā - këtu ne vërejmë pasimin e ajeteve të cilat subjektin (*musallīn*) e përshkruajnë si largim nga koha e namazit, pastaj kuptimi specifikohet me termin e hipokrizisë në veprimet e tyre, i cili gjithashtu tregon në kuptimin e fjalës *musallīn*. Prandaj, në mënyrë të qartë tregohet për rëndësinë që pikërisht përcakton konteksti dhe akjo me tri fjali përshkruese në mënyrë që të mos lihet mundësia për kuptime të tjera. Këtij konteksti gjuhësor i bashkën-

¹³ Az-Zarkashī, *al-Burhān*, I, *op. cit.*, f. 294.

gjitet kuptimi i kontekstit të përgjithshëm të tekstit kuranor, i cili nuk lë mundësinë që këtu me fjalën *musallīn* të mendohet për ata që "kujdesen për namazet e tyre," siç tregohet nga kuptimi thelbësor i kësaj fjale.¹⁴

d) Specifikimi i deklaratës së përgjithshme dhe kufizimi i deklaratës absolute

Dijetarët e usul-i fikhut u kanë kushtuar vëmendje të madhe deklaratave *'ām* (të përgjithshme) dhe *khāss* (specifike) në Kuran, si dhe thëniet *mutlak* (absolute) dhe *makajjed* (të kufizuar).¹⁵ Të katër këta terma janë në lidhje me fjalët, dhe kanë të bëjnë, kryesisht, me kuptimin. Duke qenë se tefsiri si shkencë i shqyrton kuptimet kuranore në terma të përgjithshme dhe të veçanta, interpretuesit gjithashtu patën parasysh kuptimin e këtyre katër llojeve të fjalëve. Kuptimin e këtyre fjalëve e kanë radhitur në një nga disiplinat tefsimore.¹⁶ "Fjalët janë të ndara *'ām*, *khāss*, *mutlaq* dhe *muqajjed* në bazë në aspekteve të caktuara të vetë kuptimit të tyre."¹⁷

Ez-Zerkeshīu dhe Es-Sujūtīu, në kapitujt e hyrjeve të tefsireve të tyre që merren në mënyrë specifike me terma të mësipërme, përmendin një numër të madh të shembujve të ajeteve kuranore, në të cilat ndodh specifikimi i deklaratave të përgjithshme, respektivisht kufizimi i deklaratës absolute

¹⁴ Al-'Awwā, *al-Wudžūh wa'n-nazā'ir*, f. 67.

¹⁵ Shih: Fakhr ad-Dīn ar-Rāzī, *al-Mahsūl fī 'ilm usul al-fiqh*, III, Mu'assasa ar-risāla, Bayrūt, 1992, 14; f. 57-75.

¹⁶ Shih: az-Zarkashī, *al-Burhān*, II, 15-16; as-Suyūtī, *al-Itqān*, I, II, f. 631-640, f. 15-16.

¹⁷ Al-'Awwā, *al-Wuxhūh wa'n-nadhā'ir*, op. cit., f. 67.

dhe referimi në shkaqet bazë (ajete, hadithe, konsensus të dijetarëve dhe analogjinë/kijas si faktorë specifikues dhe kufizues) të këtyre fenomeneve gjuhësore. Këtu do të veçojmë dy shembuj të këtyre dy “rregullave ekzegjetikë”:

- ajeti: مَا طَابَ لَكُمْ مِنَ النَّسَاءِ *Atëherë, martohuni me ato femra që ju pëlqejnë* (En-Nisa', 3), është specifikuar me ajetin: حُرِّمَتْ عَلَيْكُمْ أُمَّهَاتُكُمْ *U ndalohet kurorëzimi me nënat tuaja...* (En-Nisa', 23).

- ajeti: وَالْعَامِلِينَ عَلَيْهَا وَالْمُؤَلَّمَةَ قُلُوبُهُمْ ...*dhe atyre që e tubojnë, dhe për të fituar zemrat e njerëzve...* (Et-Tawba, 60), është specifikuar me hadithin: لَا تَحِلُّ الصَّدَقَةُ لِعَيْنٍ وَلَا لِذِي مِرَّةٍ سَوِيٍّ “Sadakaja nuk i është e lejuar atij i cili është i pasur e as atij që është i shëndetshëm”,¹⁸

- në ajetin: وَمَنْ يَكْفُرْ بِالْإِيمَانِ فَقَدْ حَبِطَ عَمَلُهُ *kushdo që mohon besimin (del nga feja), puna e tij është e falimentuar!* (El-Maide, 5), është përdorur termi حَبِطَ *rënie* (falimentim, dëshitim) me të cilin kuptohet edhe koncepti i mohimit të fesë (*ridde*), që nuk kushtëzohet në rast të vdekjes, ndërsa në një tjetër ajet thuhet:

...e, *ata që e mohojnë fenë dhe vdesin si mohues, veprat e (mira) të tyre do të humbasin...* (El-Bakare, 217), ku koncepti i apostazisë (braktisjes së fesë islame) kufizohet në rast të vdekjes në këtë gjendje, dhe vdekja në mosbesim;

- ajeti: أَجِيبْ دَعْوَةَ الدَّاعِ إِذَا دَعَانِ *i përgjigjem lutjes së lutësit, kur ai më lutet Mua!* (El-Bekare, 186), është i lidhur/i kufi-

¹⁸ As-Suyūfī, *al-Itqān*, I, 236, 237. Hadithin e përmendur e citon edhe Tirmidhīu në *Sunanin* e tij (II, Dar al-fikr, Bayrūt, 1983, 82), për të cilin thotë se është hadith “i mirë” (*hasen*).

zuar me ajetin: اُدْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ *Mē thirrni Mua! Unë do t'ju përgjigjem!*¹⁹

Ez-Zerkeshiu në *El-Burhān*in e tij thotë: “Nuk mund të konkludohet në bazë të cilësive universale përveç nëse realizohet kufizimi (i deklaratës), dhe pastaj konkludohet në bazë të kontekstit. Për këtë arsye, Imām-i Shāfiu' r.a., ka thënë: “Vetë fjala e shpjegon intencën e saj, por është e mundur që kjo edhe të mos jetë intenca e saj.”²⁰

e) Klasifikimi i kuptimeve

Si shembuj të këtij roli të kontekstit në përcaktimin e kuptimit, Selwā el-'Awwā përmend ajete të mëposhtme kuratore:

ثَمَانِيَةَ أَزْوَاجٍ مِنَ الضَّأْنِ اثْنَيْنِ وَمِنَ الْمَعْزِ اثْنَيْنِ

“*Ai (krijoi) tetë lloje (nga kafshët shtëpiake), prej deleve dy (dash e dele), prej dhive dy (cjap e dhi)*” (*El-En'-ām*, 143).

فَأَنْشَأْنَا لَكُمْ بِهِ جَنَّاتٍ مِنْ نَحِيلٍ وَأَعْنَابٍ لَكُمْ فِيهَا فَوَاكِهُ كَثِيرَةٌ

“... dhe me anën e tij Ne mundësuaam për ju kopshte hurmash e rrushi, që në to keni shumë pemë dhe hani prej tyre” (*El-Mu'minūn*, 19).

¹⁹ Ibid., f. 15-16.

²⁰ Az-Zarkashī, *al-Burhān*, II, op. cit., f. 18.

وَهُوَ الَّذِي أَنْشَأَ جَنَّاتٍ مَعْرُوشَاتٍ وَغَيْرَ مَعْرُوشَاتٍ وَالنَّخْلَ وَالزَّرْعَ
مُخْتَلِفًا أَلْوَانُهُ وَالزَّيْتُونَ وَالرُّمَانَ مُتَشَابِهًا وَغَيْرَ مُتَشَابِهٍ

**“Ai (Allahu) është që krijoi kopshte (bimët e të cilave)
të ngritura lart (në shtylla) dhe të rrafshta (të shtrira
për tokë), dhe hurmet dhe drithërat me frute (shije) të
ndryshme; (krijoi) ullinj të dhe shegët të ngjashme (nga
forma) e jo të ngjashme (nga shija)” (El-En’ām, 141).**

Llojet e përmendura pas fjalëve të përgjithshme (أَنْوَاعٍ llo-
jet; جَنَّاتٍ vreshtat, kopshtet, زَرْعٍ të lashtat) tregojnë për klasifi-
kimin (tenewwu’) e kuptimit të duhur të fjalës, d.m.th. në
lloje të ndryshme të kafshëve dhe bimëve. Pra, fjala *ezwāxh*,
si fjalë polisemike, tregon në llojet e mëposhtme të bagëtive:
dele, dhi, lopë dhe deve; vreshtat e harkuara nuk janë njëjtë
sikur kopshtet e hurmave; vetë fjala *xhennāt* tregon në llojet
e kopshteve (sipas vendit) në të cilat mbin ajo që mbillet:
palma, rrushi, ullinj, shegë - të lashtat me shijet e ndryshme.

Kjo është - siç pretendon El-'Awwā - një nga aspektet e
klasifikimit të kuptimit në të cilin tregon konteksti, si dhe, se
një fjalë në vete përmban lloje të ndryshme (të kuptimeve),
dhe pastaj, paraqiten dy ose më shumë ajete që i përmbledhin
këto lloje (të kuptimeve) në një aspekt të kuptimit të asaj
fjale; shembull për këtë është ajeti i parë dhe i dytë rreth vre-
shtave, sepse ajeti i parë nuk përmban kuptimin e ullirit dhe
shegës, të cilët janë përmendur në ajetin e dytë.²¹

Intenca e klasifikimit të kuptimit - vazhdon El-'Awwā -
nganjëherë reflektohet në vënien në dukje të kuptimeve të

²¹ Al-'Awwā, *al-Wuxhūh wa'n-nadhā'ir*, op. cit., f. 68.

ndryshme (të një fjale) që në çdo vend nxirren përmes kontekstit, dhe kur, gjatë interpretimit të këtyre fjalëve, mbliidhen këto kontekste të ndryshme, atëherë kuptohen të gjitha aspektet (kuptimet) e fjalës së veçantë dhe intencat e saja të ndryshme në Kuran. Kjo është, - konsideron El-'Awwa, - procesi i mbledhjes (së kontekstit) në disiplinën e tefsirit '*ilmu'l-wuxhūhi we'n-nedhā'ir*'.²²

Prandaj, Ibn Kajimi me të drejtë pretendon se konteksti është një nga indikacionet më të rëndësishme që tregon qëllimin e folësit. Fjala *indikacion* (*qarine-qarā'in*), e përmendur në këto fjalë të Ibn Kajimit, paraqet një arsye të caktuar, e cila lejon që të kuptojmë një fjalë ndryshe nga kuptimi i saj themelor. Indikacionet kontekstuale, janë gjithashtu një nga agjendat më të rëndësishme për stilistikët, në analizat e tyre të fenomeneve gjuhësore. "Pa këtë *indikacion gjuhësor* (el-qarīnetu'l-lugawijje) mufesiri nuk është në gjendje që ta kap domethënien e saktë të kuptimeve kuranore, dhe në përgjithësi teksteve gjuhësore, sepse ndonjëherë konteksti plotësisht e modifikon kuptimin e fjalëve."²³

Na mbetet vetëm për të sqaruar fjalinë e fundit në fjalët e Ibn Kajimit. Gjegjësisht, si shembull që tregon dhe vërteton saktësinë e fjalëve të tij të mëparshme, ai përmend: *Shqyrto fjalët e të Plotfuqishmit: "Shijoje! Se ti je ai i forti, i autoritetshmi!" - në të cilat do të vinim re se konteksti i tyre tregon se i tilli është i përulur dhe i mjerueshëm*. Për të kuptuar kup-

²² Ibid., 69. - '*Ilmu'l-wuxhūhi we'n-nedhā'ir* është shkurtimisht, disiplina e tefsirit e cila shqyrton fjalët me një kuptim dhe me disa kuptime në Kuran, ose, kuptimi i fjalëve në kontekstin kuranor.

²³ Al-'Awwā, *al-Wuxhūh wa'n-nadhā'ir*, op. cit., f. 68.

timin në të cilin aludon Ibn Kajimi, d.m.th. se me metodën e analizës kontekstuale vihet deri te kuptimi i saktë i fjalëve në ajetin e përmendur kuranor, është e nevojshme të përmendet një kontekst më i gjerë nga sureja në të cilën gjendet ky ajet kuranor. Ky kontekst i gjerë është: *“Ndërsa Ne i shpëtuam beni israilët prej vuajtjeve nënçmuese, prej faraonit. Vërtet ai ishte mizor i pakufishëm. (...) (I thuhet): Shijoje! Se ti je ai i forti, i autoritetshmi. E ky është ai (dënimi) për të cilin dyshonit”*. (Ed-Dukhān, 30-50).

Nga ky kontekst më i gjerë, ne shohim se Allahu i shpëtoi bijtë e Israelit nga shtypja e Faraonit, i cili i torturoi në mënyra më mizore, e më pastaj u dhuroi njohuri të mëdha, por ata megjithatë nuk besuan peygamberin e tyre e as që e ndoqën atë. Një nga shenjat e mosbesimit të tyre ishte se ata nuk besonin në ringjallje e as në llogaridhënie. Kjo përmbajtje është treguar në ajetet e para, ose, do të thoshim, në kontekstin e ngushtë. Pastaj, kemi një krahasim konciz mes Israilitëve dhe një populli para tyre, i cili, gjithashtu, i mohoi argumentet e Zotit dhe pyetjen: Kush është më i miri dhe më i forti prej tyre, që të jetë i larguar nga ndëshkimi i Allahut në Ditën, kur ata të mblidhen para Tij? Pastaj, konteksti kalon në planin eskatologjik: Popuj dhe individët e tillë, për shkak të mosbesimit të tyre, do t'i kaplojë ndëshkimi i përçmuar nga i cili nuk do të jenë në gjendje që të shpëtojnë, as nuk do të kenë forcë për ta larguar atë nga vetvetja. As arroganca e as pushteti i faraonit nuk do t'i jenë në dobi atij. Në fund të këtij konteksti më të gjerë, vjen ajeti: *'Shijoje! Se ti je ai i forti, i autoritetshmi!'* Ai, d.m.th., faraoni (dhe çdo tiran tjetër), është i përshkruar me dënim të poshtëruar, dënimi me

të cilin dënoi fëmijët e Israelit, e që i Plotfuqishmi i shpëtoi. Në ajet është përmendur folja *shijo!* (*dhuq*) pa objektin e saj, d.m.th., këtu objekti '*adhabu 'l-muhīn*' ("vuajtja e padurueshme") nënkuptohet. Faraoni u mendua se është i fuqishëm, i fort dhe se atij i përket vendi më fisnik në këtë botë; u bë mendjemadh dhe i ndëshkonte bijtë e Israelit me dënim të përçmuar. Kjo fuqi dhe ky nder janë përmendur tashmë në një kontekst poshtërues: *Se ti je ai i forti, i autoritetshmi!* Ez-Zamakhsharī thotë se "në mënyrë poshtëruese dhe ironike për secilin (mohues), i cili ishte i fuqishëm dhe i nderuar në mesin e popullit të tij."²⁴

Pra, mufesirët me këtë ajet tregojnë mundësinë e qartë të ndryshimit të kuptimit në bazë të fjalës në përputhje me situatën kontekstuale. Në këtë rast, fjala '*azīz*' (i fuqishëm, i madh) dhe '*kerīm*' (fisnik, i nderuar) kanë kuptim krejtësisht të kundërt nga kuptimi i tyre normal leksikor, ato në këtë ajet nënkuptojnë *dhelīl* (i përulur) dhe *haqīr* (i mjerë). Për të ndodhur ky transformim i kuptimit, siç e kemi theksuar tashmë edhe më lart, është i nevojshëm indikacioni (*al-qarīne*); ky indikacion në këtë rast është konteksti (*sijāq*).

Nuk është rastësi që Ibn Kajimi, në mesin e shumë shembujve të tjerë të kuptimeve kontekstuale të leksikut kuranor, e përzgjedhi këtë shembull nga Kurani, si konfirmim i qëndrimit të tij teorik në lidhje me kontekstin. Gjegjësisht, në rastin e këtij shembulli, siç e përmend edhe Selwā el-'Awwā, "*indikacioni* i vetëm që i transformon në kuptime të dhëna

²⁴ Az-Zamakhsharī, *al-Kashshāf*, op. cit., f. 1003.

është konteksti, dhe jo ndonjë element tjetër gjuhësor, të tilla si konstruksionet gramatikore etj.”²⁵

Aspektet kontekstuale të Kuranit - pikëpamjet bashkëkohore

1. Konteksti i përgjithshëm, tematik dhe gjuhësor i Kuranit

Selwā el-'Awwā, analizat e së cilës shfrytëzojmë në masë të madhe në punimin tonë, kur i përmend linguistët e “shkollës së Londrës” dhe vendosjen e tyre të “fqinjësisë së unitetit semantik të njërit dhe tjetrit”, ose, siç thotë ajo, ajo që strukturalistët e quajtën 'karakter gjuhësor' (*le signe linguistique*),²⁶ është në fakt ajo që quhet 'konteksti gjuhësor', në të cilin në masë të madhe mbështetemi gjatë analizave kontekstuale të fjalëve që kanë kuptime të shumta. Gjithashtu, ajo është e mendimit se mufesirët që moti mbështeten në atë “kontekst gjuhësor”, kur fjalëve u atribuojnë më shumë kuptime (*wuxhūhe*) duke favorizuar njërin nga kuptimet e mundshme të fjalëve të caktuara. Ajo konsideron se ata, në kontekste të fjalëve të veçanta, vërejtën fjalën që favorizon një kuptim, ose, nga ana tjetër, shkakton një dykuptimësi semantike në qoftë se i jepet përparësi kuptimit tjetër, dhe atëherë,

²⁵ Al-'Awwā, *al-Wuxhūh wa'n-nadhā'ir*, op. cit., f. 71.

²⁶ Ferdinand de Saussure, (v. 1913.), themelues i linguistikës strukturale, gjitha është “lojë e shenjave” ose “sistem i shenjave”... Më shumë për de Saussurin dhe linguistikën e tij strukturale shih në: Ferdinand de Saussure, *Spisi iz opšte lingvistike*, Novi Sad, 2004; Ranko Bugarski, *Lingvistika o čoveku*, Prosveta, Beograd, 1983.

vazhdimisht hulumtohen kontekste (vende ku është përmendur fjala) për të arritur deri te përcaktimi i njërit prej kuptimeve ose në paaftësi që të jepet përparësia njërit prej tyre.²⁷

Pasi që përmend ndarjen e mësipërme të kontekstit, të lingvistëve Ammera, El-'Awwā kuptimin e “kontekstit kulturologjik” e zgjeron me konceptin e “kontekstit të përgjithshëm”, ndërsa për të kuptuarit e kontekstit “emocional” dhe “të situatës” shton termin e kontekstit “tematik”, të cilat pastaj i aplikon në krahasim me tekstin kuranor, sepse përparësia e një konteksti kuranor ose komentimi (*tefsīri*) i arsyes së përparësisë së kuptimit të caktuar, është bazuar sipas mendimit të El-'Awwāsë, në tri aspekte kontekstuale: gjuhësore, të përgjithshme dhe tematike. Përkufizimet e saj të këtyre aspekteve të rëndësishme kontekstuale janë si më poshtë:

Konteksti i përgjithshëm (es-sijāqu'l-'ām) përfshin konceptimin e përgjithshëm islam, tekstin e tërësishëm të Kuranit dhe shpjegimin e tij në synetin verbal dhe praktik si dhe thënie të sahabëve.

Konteksti tematik (es-sijāqu'l-mewdū'ijj) paraqet një situatë në të cilën ajeti kuranor përmendet me një fjalë të veçantë, të cilën kjo situatë e drejton dhe rrethon dhe ndikon në zgjedhjen e fjalëve ose në zgjedhjet tona të kuptimit të bazuar në një kuptim të plotë të këtij vendi, së bashku me përshkrimin e temës/lëndës së ajetit ose tekstit.

Konteksti gjuhësor (es-sijāqu'l-lugawijj) i paraqet fjalët dhe konstruksione të përfshira në deklaratën e cila është objekt i studimeve duke pasur parasysh se fjalët dhe konstruksi-

²⁷ Al-'Awwā, *al-Wuxhūh wa'n-nadhā'ir*, op. cit., f. 76.

onet janë faktorë themelorë në bazë të së cilëve fillon i kuptuari; interpretimi/tefsiri, nëse nuk ekziston indikacioni, nuk duhet t'i kundërshtohet kuptimeve të këtyre fjalëve dhe konstruksioneve.

Secili prej këtyre tre aspekteve kontekstuale forcohen më tej,-konsideron El-'Awwā,- me aludimet (*ishārāt*) dhe provat (*edille*), të cilat ajo i përcakton si në vijim:

- aludimet (*ishārāt*) janë shenja gjuhësore ose jo-gjuhësore që favorizojnë një interpretim mbi një tjetër, i cili është dominues, por nuk bëhet fjalë rreth kuptimit kategorik, sepse për kuptimin kategorik është e nevojshme dëshmia;

- dëshmia (*edille*) është aludimi të cilin mufesiri e konsideron plotësisht të qartë dhe të fortë, dhe konfirmon se këtu bëhet fjalë për një kuptim e jo për kuptimin tjetër, mirëpo, rrallëherë këtu bëhet fjalë rreth kuptimit kategorik, sepse kuptimi gjuhësor *per se* nuk vjen në formën kategorike; nga njëherë një studiues në kontekst aludimi sheh atë që është në kundërshtim me pikëpamjet e studiuesit tjetër, ose, lexuesi mund të perceptojë diçka tjetër.²⁸

2. Konteksti i ajetit, tekstit, sures dhe i tërë Kuranit

Ebū Safiyye el-Hārithī në nëntitullin e studimit të saj *Di-lāletu's-sijāq* sugjeron se kuptimi kontekstual është metodë e “sigurt/ebesueshme në komentimin e Kuranit“. Kjo autore argumenton se korniza kontekstuale e kuptimeve kuranore nganjëherë i referohet një grupi të ajeteve që flasin rreth një qëllimi primar; nganjëherë kufizohet në një ajet të vetëm;

²⁸ Ibid., f. 76-78.

ndonjëherë, megjithatë, shtrihet në të gjithë suren, e që, ndonjëherë, i referohet tërë Kuranit. Kështu që, El-Hārithī këtu tashmë i prezanton kushtet e mëposhtme: سِيَاقُ آيَةٍ *konteksti i ajetit*, سِيَاقُ النَّصِّ *konteksti i tekstit*, سِيَاقُ السُّورَةِ *konteksti i sures* dhe السِّيَاقُ الْقُرْآنِيُّ *konteksti i Kuranit*. Të gjitha këto kontekste, pra, ndikojnë në kuptimin, dhe "për këtë arsye është detyrë e mufesirit që të mos i injorojë këto lidhje dhe dimensionet (të kuptimit)."²⁹

Konteksti i Kuranit, sipas kësaj autoreje, nënkupton dy gjëra:

- qëllimet themelore dhe intencat për të cilat flasin të gjitha kuptimet kuranore; krahas kompozicioneve të mbinatyrshme dhe përbërjes stilistike, që janë të pranishme në të gjitha deklaratat kuranore, dhe që është e nevojshme të njihen si dhe karakteristikat e tyre, është e nevojshme të njihen edhe qëllimet universale kuranore dhe intencat si dhe tendencat përgjithësisht të konfirmuara të Kuran-kerimit;
- ajetet dhe vendet me tematikë të ngjashme; përveç dallimeve të vogla në mënyrën e citimeve, dhe caktimi i fjalëve kuranore në bazë të situatës së të folurit, ekziston edhe motivi stilistik i cili është i lidhur ngushtë me objektivat e sures së caktuar, në ajetet e saj dhe në tekstin e saj:

a) në ajetet: p.sh. fjalët e të Lartësuarit:

وَجَاءَ رَجُلٌ مِنْ أَقْصَى الْمَدِينَةِ يَسْعَى *Dhe një njeri, erdhi, duke nxituar prej skajit të qytetit...*(El-Qasas, 20) dhe

²⁹ 'Abd al-Wahhāb Abū Safīyya al-Hārithī, *Dilāla as-siyāq - manḥaḥ ma'mūn li tafsīr al-Qur'ān al-karīm*, 'Ammān, 1989, f. 88.

fjalët e Tij: وَجَاءَ مِنْ أَقْصَى الْمَدِينَةِ رَجُلٌ يَسْعَى Dhe, duke nxituar prej skajit të qytetit erdhi një njeri...(Jā Sîn, 20). Në ajetin e dytë, vëmendja është përqendruar në vetë njeriun, ndërsa në ajetin e parë vëmendja është përqendruar në vrapimin e njeriut, duke pasur parasysh se, në ajetin e parë, konteksti është fokusuar në tregimin rreth Musait a.s., e që nxitimi për shkak të vendimit të dënimit për të është i patjetërsueshëm, ndërsa në ajetin e dytë konteksti është fokusuar në njeriun besimtar, për shkak të rëndësisë së pozitës së tij në qytet dhe thirrjes së pejgamberit;

b) në tekst: kjo veçanërisht iu referohet tregimeve kuranore, p.sh. vërehet dallimi në tregimin rreth Musait a.s., faraonit dhe magjistarëve në suren Esh-Shuarā' dhe në suren El-E'arāf. Në suren Esh-Shu'arā' (32-37) tregohet: “Atëherë, (Musai) e hodhi shkopin e vet, i cili u shndërrua në gjarpër të vërtetë. Nxori dorën prej xhepit, kur qe, ajo në sy të shikuesve flakëronte nga bardhësia. (...) Shtyje atë dhe vëllain e tij (çështjen e tyre) për më vonë, e ti dërgo nëpër qytete tubues. Që t'i sjellin të gjithë magjistarët e dijshtëm këtu.”

- ndërsa në suren El-E'arāf (107-112) lexojmë: “Ai (Musai) e hodhi shkopin e vet, kur ja, u shfaq gjarpër i vërtetë. Dhe e nxori dorën e vet, kur qe, për shikuesit dritë e bardhë. Rrethi i parisë nga populli i faraonit tha: “Ky nuk është tjetër pos një magjistar i përsosur”. (...) “Ndale atë dhe vëllain e tij, e dërgo nëpër qytete tubues (të magjistarëve). Të sjellin çdo magjistar të dijshtëm (të aftë)”.

Ne konstatojmë se konteksti në ajetet e sures Esh-Shu'arā' fokusohet në faraonin dhe frikën e tij ballafaqese me fuqinë argumentuese të Musait a.s., e që atij, pothuajse, i duket se ai (Musai) do të del fitues. Në ajetet e sures El-E'arāf, megjithatë, konteksti nuk fokusohet në këtë fakt, veç në mendimin rreth asaj se si të shpëtohet nga Musai a.s.³⁰

Sipas El-Hārithit, është e drejtë që të argumentohet se konteksti kuranor është faktori më i madh që neutralizon animet (*el-xhewāmiḥ*) e mufesirëve, veçanërisht në lidhje me intencat dhe kuptimet kuranore, për shkak se intencat e Kuranit janë të qarta dhe të caktuara. Për më tepër, ky autor, duke absolutizuar rolin e kontekstit, pretendon se kuptimet e gabuara të disa aspekteve të besimit islam - sidomos atyre që lidhen me përcaktimin (kaderin) dhe përkufizimin e vullnetit të njeriut dhe fuqisë në krahasim me veprat e tij, si dhe divergjencën në pikëpamjen e cilësive Hyjnore - si rezultat i mos përkushtimit të vëmendjes në kontekstin kuranor, sepse “konteksti është shenja më e qartë e udhëzimit para të gjitha vendeve muteshabih/të panjohura kuranore.”³¹

3. Konteksti i situatës dhe temës së lëndës në Kuran

Linguisti bashkëkohor egjiptian Ahmed Mukhtar 'Umer, arsyet e deklaratave polisemike kuranore i sheh, para së gjithash, në kontekstet e ndryshme të tija gjuhësore. Këtu do të përmendim disa nga shembujt e tij, prej të cilave vërehet roli i “kontekstit gjuhësor apo kontekstit të situatës dhe lëndës.”

³⁰ Al-Hārithī, *Dilāla as-siyāq...*, f. 89.

³¹ Ibid., f. 90.

Kështu ai përmend se fjala *insān* në Kuran përsëritet në disa vende. Kuptimi i saj themelor është i njohur, por, nga njëherë konteksti gjuhësor apo konteksti i situatës i drejton mufesirët në kuptime shtesë ose relative të lidhura me kuptimin e saj themelor. Në ajetin *خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ صَلْصَالٍ كَالْفَخَّارِ* *Ai e krijoi njeriun prej baltës së thatë, ashtu siç është vorba e pjekur* (Ar-Rahmān, 14). fjala *insān* e paraqet Ademin a.s.; në ajetin *خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ مِنْ نُطْفَةٍ* *Me të vërtetë, Ne e kemi krijuar njeriun nga një farë e përzier (spermës)...* (Al-Insān, 2), me këtë paraqiten pasardhësit e Ademit a.s. Shkaku i zbritjes ose tema e lëndës është ajo që mufesirët, në ajetet e caktuara, i fokuson në personat konkret: *insāni* në ajetin 6 dhe 7 të sures El-'Aleq është Ebū Xhehli; në ajetin 17 të sures 'Abese është 'Utbe b. Ebī Leheb; në ajetin 67 të sures Merjem është Umejje b. Khalefi.

Fjala *el-bātil* në kuptimin e saj themelor nënkupton atë që është në kundërshtim me të vërtetën (*neqīdu'l-haqq*). Në Kuran kjo fjalë merr më shumë kuptime partikulare: kuptimin e shtrembërimit dhe falsifikimit (*et-tahrīfu we't-tezwīr*) në ajetin 188 të sures El-Bekare; kuptimin e mosbesimit dhe humbjes (*el-kufu we'd-dalāle*) në ajetin 8 të sures El-Enfāl, dhe kuptimin e lojës (*el-'abeth*) në ajetin 27 të sures Sād.

Fjala *el-fāhishe* në kuptimin e saj të fjalëpërfjalshëm tregon në vepra dhe fjalë tejet të shëmtuara (të neveritshme). Nga ky kuptim i përgjithshëm formohen disa kuptime kuratore, të cilat i përcakton konteksti gjuhësor apo konteksti i situatës. Me të nganjëherë paraqitet: *homoseksualizmi* (An-Naml, 54); nganjëherë *kurvēria* (An-Nisā', 15.), dhe ndonjëherë *veprime të neveritshme* (Ālu 'Imrān, 135).

Ka shumë shembuj në Kuran, thotë Mukhtār 'Umer, kur një fjalë kuranore ka kuptim të veçantë, dhe atë nëpërmjet lidhjes së saj me një fjalë të veçantë që specifikon. Për shembull, fjala *ehl* ka kuptimin e saj të njohur, por kuptimi i saj specifikohet nëpërmjet fjalëve me kolokacion ashtu që fiton kuptime specifike si në vijim: *gratë e të Dërguarit* (Al-Ahzāb, 33); *pasuesit e librave qiellor* (Al-Mā'idā, 65); *dijetarët e Teuratit dhe Inxhilit* (An-Nahl, 43).³²

4) Gjuha e Kuranit në dritën e linguistikës kontekstuale - pasqyrë

Në studimet e reja linguistike të Kuranit me metodën e analizës kontekstuale të kuptimit janë aktualizuar dhe hulumtuar nivelet e ndryshme kontekstuale (gramatikore, sintaksore, stilistike, semantike) të kuptimeve kuranore.

Muhammed Ahmed Khadīr, në studim të gjerë, hulumton lidhjen e simetrisë/korrespondencës midis numrit gramatikor - njëjësit, dyjësit dhe shumësit - dhe kontekstit në studime gjuhësore dhe kuranore. Mustafā Xhetal dhe 'Alī Xhānsīz shqyrtojnë kontekstin gjuhësor të Kuranit dhe ndikimin e tij në kuptimin e formës kërkimore dhe elementeve të saja (imperativit, prohibitivit, pyetjeve, dëshirave, shpresave dhe kërkesave apo propozimeve). Ahmed Muhammed Quddūr dhe Suzan Mejri kanë shkruar në lidhje me marrëdhëniet kontekstuale në thëniet kuranore. Mehā Bint Sālih b. Abdu'r-Rahmān el-Mejmān shkroi studimin e detajuar linguistik-semantik

³² Ahmad Mukhtār 'Umar, *al-Ishtirāk wa't-tadādd fi'l-Qur'ān al-karīm*, 'Ālam al-kutub, al-Qāhira, 2003, f. 82-83.

rreth partikulares *innemā* në kontekstin e strukturës dhe kuptimit, ku përmend shembuj të shumtë të përdorimit kuranor të këtyre partikulareve. Mustafā Rexheb, duke aplikuar metodën e lingistikës gjeneruese, shqyrton ndryshueshmërinë sufiksale dhe ndikimin e saj në kuptimin e kontekstit kuranor. 'Awde Ebū 'Awde kuptimin semantik të fjalëve *el-kitāb* dhe *el-Kurān* i shqyrtoi në dritën e kontekstit kuranor. Muhammed el-'Abd në librin e tij mbi ironinë kuranore, mes tjerash, diskuton rolin e kontekstit, si një nga faktorët më të rëndësishëm gjuhësor në përcaktimin e kuptimit “ironik-stilistik” të fjalëve kuranore...³³

³³ Për më shumë shih në punimet e tyre: Mustafa Xhatal i 'Alī Khānsīz, “as-Siyāq al-lugawiyy wa atharuh fi'd-dilāla 'alā ma'nā at-talab wa adawātuh,” *Maxhxhalla buhūth Džāmi'a Halab*, No. 31, Aleppo University, 1996, f. 9-27. Po ashtu shih: Muhammad Ahmad Khadīr, “al-'Alāqa bayna al-mutābaqa al-'adadiyya wa's-siyāq fi'd-dirāsāt al-lugawiyya wa'l-qur'āniyya,” *Maxhxhalla kulliyya al-ādāb*, No. 60, Xhāmi'a al-Qāhira, 1993, f. 7-79. Shih edhe: Ahmad Muhammad Qaddūr i Sūzān Mayrī, “al-'Alāqa as-siyāqiyya fil-qissa al-qur'āniyya,” *Maxhxhalla buhūth Xhāmi'a Halab*, No. 34, Aleppo University, 1998, f. 31-43. Gjithashtu: Mahā Bint Sālih b. 'Abd ar-Rahmān al-Maymān, “(Innamā) fi's-siyāq at-tarkīb wa'd-dilāla,” *Maxhxhalla al-dirāsāt al-lugawiyya*, Vol. V, No. 4, Markaz al-Malik Faysal lil buhūth wa'd-dirāsāt al-islāmiyya, ar-Riyād, 2004, f. 115-196. Po ashtu: Mustafā Rexheb, “al-Mugāyara al-i'rābiyya wa atharuhā ad-dilālaliyy fi's-siyāq al-qur'āniyy,” *Manār al-islām*, Vol. XXX, No. 351, Wizāra al-'adl wa'sh-shu'ūn al-islāmiyya wa'l-awqāf, al-Imārāt al-'Arabiyya al-Muttahida, Abū Dabī, 2004, f. 12-15. Gjithashtu: 'Awda Abū 'Awda, “al-Kitāb wa al-Qur'ān, dirāsa dilāliyy fi's-siyāq al-qur'āniyy,” në: Fārūq Badrān (ur.), *Silsila an-nadawāt wa'l-muhādarāt*, Xham'iyya ad-dirāsāt wa'l-buhūth al-islāmiyya wa'l-Ma'had al-'ālamiyy li'l-fikr al-islāmiyy, I, 'Ammān, 2002, f. 119-145. Shih edhe: Muhammad al-'Abd, *al-Mufāraqa al-qur'āniyya*, Maktaba al-ādāb, al-Qāhira, 2006.

Përfundim

Metoda e interpretimit kontekstual të Kuranit konsiderohet metoda më e vjetër e interpretimit të Kuranit dhe ajo qëndron si bazë për të gjitha metodat e tjera. Aktualiteti gjithëkohor i kësaj metode kryesisht rrjedh nga fakti se ajo merr parasysh tërësinë e Kuranit dhe kështu ofron qasjen autoritare intertekstuale në interpretimin e Kuranit. Prandaj, besojmë se mënyra e interpretimit kontekstual të Kuranit, në një kuptim të gjerë të fjalës, në gjurmë të përkufizimeve të fundit të linguistikës kontekstuale, është e nevojshme të mbështetet fuqishëm dhe sërish të afirmohet në ditët e sotme.

Studimet të cilat i kemi përmendur dëshmojnë për rritjen e interesimit të dijetarëve bashkëkohorë myslimanë për të studiuar gjuhën e Kuranit në bazë të rezultateve të linguistikës kontekstuale e gjithashtu edhe analizës tekstuale. Ndoshata ky trend do të vazhdojë edhe në të ardhmen për shkak të korrespondencës me interesimet moderne të linguistikës përrëndimore dhe amerikane, dhe për shkak të llojit të sfidave që kjo metodë padyshim u ofron studiuesve të ardhshëm në këtë fushë. Por ajo që është edhe më e rëndësishme nga këto, është se kjo metodë nga njëra anë është e pandarë me traditën shekullore të komenteve myslimane, në të cilën hulumtimet linguistike si të tilla, kurrë nuk kanë pushuar, e nga ana tjetër, kjo mundëson që të fitohet kuptimi “objektiv” i ajetit dhe ndihmon për t’iu shmangur “ndikimeve të jashtme në interpretimin e Kuranit.”

Përktheu dhe përshtati nga boshnjakishtja:

Azmir Jusufi

Omer NAKIQEVIQ

NJERIU DHE KURANI

Njeriu, në jetë, është i gëzuar kur i shërben së vërtetës, në rastin tonë kur i shërben Zotit të Lartësuar dhe kur mund që të ndjekë Rrugën e Drejtë, për ne myslimanët, rrugës së të dërguarit Muhamed a.s., të ashabëve dhe të atyre që kanë ndjekur mësimet e të Dërguarit a.s., të gjeneratave të hershme dhe të mëvonshme. Islami e vlerëson njeriun sipas sjelljes dhe këmbënguljes së tij në veprat dhe aksionet pozitive. Në bazë të veprave pozitive të bëra, shihet personaliteti i një myslimani dhe vërehet ndikimi që lë në rrethin e vet, në bashkësi (Ymet), dhe jo në bazë të pasurisë së tij, as pozicionit në shoqëri, as titullit të tij të lartë akademik dhe diplomës dhe as të prejardhjes. Pejgamberi a.s., me fjalë të thjeshta, këtë e thotë kështu:

“Kur vdes dikush i ndërpriten të gjitha veprimet përveçse për tri raste:

- nëse ka lënë ndonjë dije dhe nga ajo të tjerët përfitojnë (e përdorin),

- nëse ka lënë ndonjë sadaka të përhershme, ka lënë vakëfe për ne, dhe
- nëse ka lënë fëmijë, trashëgimtarë të mirë (të hairit), të cilët për të i luten Zotit me dua.”

Këto fjalë të të Dërguarit a.s. na kujtojnë obligimet tona që fëmijët duhet t’i edukojmë dhe t’i drejtojmë, sepse njeriu do të jetë përgjegjës për amanetin e besuar, amanetin e edukimit të fëmijëve të vet dhe brezave të asaj periudhe. Për këtë na obligojnë edhe fjalët e tjera të të Dërguarit a.s., që janë kaq të njohura:

“Të gjithë ju jeni barinj dhe secili prej jush do të jetë përgjegjës për tufën e vet.”

Paraqitja e Muhamedit a.s. ka shënuar ndryshim në shoqërinë njerëzore, ka ndryshuar sistemin dhe mënyrën e jetës së njeriut, e ka drejtuar atë në rrugën e drejtë, e ka hequr frymën e jotolerancës fisnore, ndërsa kategorinë e përkushtimit ndaj Zotit (*et-takva*) e ka shënuar si e mira më e madhe.

Muhamedi a.s. thërret njerëzimin në Rrugë të Drejtë, duke e ngritur njeriun në sferat më të lartësuara, i përshkruan atij shtegun jetësor, nëpërmjet të cilit njeriu mund të arrijë deri tek objektivi, për çka i është dhënë bekimi që të jetë më këmbës i Zotit në tokë.

Njerëzimi i përgjigjet thirrjes së të Dërguarit a.s. vetëm pas thirrjes së tij të durueshme dhe këmbëngulëse, të sqarimeve, të xhihadit dhe të përkushtimit të plotë ndaj mësimave të reja, përpjekjeve dhe qëndrueshmërisë, kur thirrja hyjnore jehon gjithandej nëpër botë:

“Thuaj (Muhamed): “O ju njerëz! Unë jam i dërguari i Allahut te të gjithë ju. I Allahut, vetëm i të Cilit është

sundimi i qiejve e i tokës, s'ka të adhuruar të vërtetë pos Tij; Ai jep jetë dhe ai jep vdekje, pra besoni Allahun dhe të dërguarin e Tij, peygamberin e pashkolluar, që beson Allahun dhe shpalljet e Tij, ndiqeni rrugën e tij që ta gjeni të vërtetën.” (Sureja “El-A'raf”, 158)

Toka është ndriçuar me nurin/dritën hyjnore, e pastruar me mëshirën hyjnore, është vendosur ligj i barabartë, janë ndryshuar standardet e kuptimit, janë hequr poshtërimet dhe torturat, fronet e zullumqarëve janë shkatërruar dhe njeriu është liruar nga robërimi i njeriut tjetër, kurse horizontet e jetës së vërtetë janë zgjeruar. Shpejt vjen deri te themelimi i civilizimit më të madh, i cili e ka përfshirë botën me siguri dhe shpëtim, toka ka përjetuar lulëzimin. Kurani për këtë thotë:

“E sikur banorët e këtyre vendbanimeve të kishin besuar dhe të ishin ruajtur, Ne do t’ju hapnim begati nga qielli e toka, por ata përgënjeshtroan, andaj i dënuam me shkatërrim për atë që merituan.” (El-A'raf, 96.)

E tillë ishte situata në botë derisa myslimanët kishin jetuar nën hijet e mësimave të Kuranit, por kur bota islame e ka lenë pas dore atë (*pra Kuranin*), sulmet kanë pasuar nga të gjitha anët. Në momente të tilla e djathta e mbrojtësve dobësohet dhe bie nën pushtimin e kundërshtarit. Feja humb vend në zemrat e tyre dhe ata lëshojnë terren, të dëshpëruar dhe të mundur. Botën islame e përshkojnë elemente negative, dëshmitarë të të cilave jemi edhe ne këtu. Grindje dhe mosmarrëveshje të ndërsjella! Taktikat dhe planifikimi i anës kundërshtare nuk qetësohen! Ndër të tjera, mendohet se si

dhe sa më larg t'i ndajnë myslimanët nga Islami, se si ta ngatërrojnë Islamin në sytë e myslimanëve, se si ta nënvlerësojnë të kaluarën islame. Kjo sjell deri te formimi i qarqeve edukative ndër myslimanë, të frymëzuar me burime të huaja për Islamin dhe mësimet themelore islame. Fillohet të besohet në mënyrë të gabuar. Shoqëria, opinionet e veta për jetën, i formon në bazë të principit të opinioneve të atyre qarqeve të atilla kulturore. Kështu vjen deri te distanca ende më e madhe ndërmjet këtyre opinioneve dhe qëndrimeve të fesë. Ia behin probleme të shumta jetësor, e të cilave njerëzit nuk u japin zgjidhje nëpërmjet fesë, paraqiten fraksione të ndryshme në Islam dhe pikëpamje shpirtërore, vjen deri te ndarja ndërmjet personalitetevembajtëse dhe përgjegjëse për të mirën e përgjithshme të bashkësisë (Ymetit), ndonjëherë duke shkatërruar çdo gjurmë të jetës islame te njeriu. Myslimanët bëjnë të ekspozuar, sikurse përballë erës, nga lëvizjet e ndryshme politike dhe kulturore, ndërsa valët e ateizmit dhe shkatërrimit të indeve të shoqërisë islame marrin pjesën e vet. Myslimanët humbin karakteristikat fundamentale të Islamit, të cilat në disa vende edhe zhduken plotësisht. Familja myslimane po e humb lidhjen që ka mbajtur me Islamin. Ky proces i shtresimit në familje zgjatet edhe në shoqërinë myslimane, bashkësinë (Ymetin), ashtu që sot pyesim: *Pra, çka është feja?* Krejt ajo çka dimë për të, *për fenë*, është një përzierje e së vërtetës dhe bestytisë. Kemi mbetur në qarkun, në të cilën nuk njohim as çka është feja jonë, as burimet e lëvizjeve në jetën tonë dhe parashtrohet pyetja: *A është brezi i sotshëm i privuar nga Islami dhe mësimet islame?*

Shkaku më i madh për mospajtimin ndërmjet myslimanëve dhe për mospasimin e programit islam është mosnjohja e Islamit ose kuptimi i mangët i mësimëve islame. Sot shumë myslimanë nuk kanë konceptim të drejtë mbi Islamin. Te shumica, kuptimi i Islamit sillet deri ndërmjet mohimit dhe besëtytnisë. Shumica e myslimanëve gabimisht e kuptojnë Islamin, duke mos e vërejtur asnjë dallim ndërmjet formës dhe esencës-thelbit. Në masë të madhe, në mjediset tona është përfaqësuar imitimi-simulimi, kurse baza i është, siç është thënë, mosdija dhe besëtytnia.

Shumë punëtorë myslimanë të kulturuar e të civilizuar nuk kanë pasur rast që të studiojnë Islamin nga burimet themelore dhe asnjëherë nuk e kanë kuptuar thelbin e mësimëve islame. Krejt çka dinë, është ajo çka u ka ofruar kundërshtari i Islamit. Ndihet nevoja për diçka që atë botë do ta dridhte si elektroshok dhe do ta shkundte nga vdekja/letargjia dhe do ta drejtonte kah drejtimi pozitiv. Jemi dëshmitarë okularë që në kohën tonë botohen me qindra libra të lidhura tematikisht për Islamin dhe trashëgiminë islame, por të paraqitura në mënyrë jokritike.

Bota islame nuk ka aq nevojë për vepra të cilat i trajtojnë, për shembull, çështjen e demokracisë në Islam, çështjen e marrëdhënieve ndërkombëtare e të ngjashme, sepse këto tashmë janë të zgjidhura, por ajo ka nevojë për vepra të përpiluara me metoda bashkëkohore për parimet themelore të mësimëve islame. Forcat që i kundërvihen imanit-besimit janë gjithmonë e më të ashpra dhe shfrytëzojnë metodat më bashkëkohore. Mbrapa tyre rregullisht qëndrojnë qëllime dhe tendenca të caktuara. Tani parashtrohet pyetja: *A t'ua njohim*

atyre forcave shpjegimin e mësimave islame apo jo, dhe cilën metodë duhet ta zbatojmë?

Të përgjigjemi menjëherë: Metoda jonë duhet të jetë metoda, me të cilën është shërbyer vetë i Dërguari a.s. dhe ajo është metoda e kujdesit për secilin person veç e veç, nga të cilët më pas formohet edhe familja myslimane, përkatësisht rritet bashkësia myslimane (Ymeti). Pikërisht e tillë duhet të jetë metoda jonë.

Është detyrë e njeriut që, si individ dhe mysliman, të jetë i edukuar ashtu që ta stolisin cilësitë e myslimanëve të parë, për të cilët shumica nuk dinë ose dinë shumë pak dhe janë të informuar jomjaftueshëm.

Kur i Dërguari s.a. e thërriste dikë në Islam, asnjëherë nuk e linte në mëdyshje që t'i ngatërronte nocionet për Islam-in dhe fenë e as t'i kuptonte ashtu si mendonte dhe dëshironte ai personalisht, por së pari ia definonte principet bazë të Islamit, në të cilat ngrihet/qëndron personaliteti islam, ia definonte drejtimin dhe zhvillimin e atij personaliteti në parimet e besimit të qartë dhe të ibadetit. Asnjë moment nuk e ka lënë pa ia theksuar dhe sqaruar nga ato cilësi të myslimanit që duhet ta përcjellin gjatë ekzistencës së tij, p.sh.:

“Mysliman është ai njeri i cili nuk i shqetëson myslimanët e tjerë, as me vepra dhe as me fjalë.” (Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi)

Me këtë e ka definuar natyrën e moralit dhe mirësjelljes islame në jetë, kur i Dërguari a.s. thoshte se: *“një besimtar në raport me besimtarin tjetër, duhet të jetë si ndërtesa”,* dmth., *“njëri tjetrin duhet që ta mbështetin dhe forcojnë...”*

(E transmeton Pesa)¹, me këtë ka dashur të tregojë se si forcohen lidhjet vëllazërore dhe ndihma e ndërsjellë.

Është e qartë se në një shkrim si ky nuk është e mundur që në detaje të flasim mbi karakteristikat e personalitetit të myslimanit, por mund të themi një segment, pjesëzën e personalitetit të atillë, duke e bazuar qëndrimin tim në Kuran dhe Hadith dhe në kuptimin e drejtë të frymës islame. Do të tentojmë që këtë ta ekspozojmë në mënyrë që do të ishte e kapshme dhe e kuptueshme për lexuesin tonë të rëndomtë, me shpresë që secili të ketë një ide mbi këtë segment, i cili e zbuluron natyrën e një personaliteti mysliman. Do të flasim për natyrën e personalitetit mysliman, e cila mbështetet në tekstet e Kuranit, si për shembull:

“Ata që lexojnë librin e Allahut, e falin namazin dhe nga begatitë që Ne u kemi dhënë japin fshehurazi e haptazi, ata shpresojnë në një fitim që kurrë nuk humbet. Që Ai (Allahu) do t’u plotësojë shpërblimin e tyre e edhe do t’u shtojë nga mirësia e tij, vërtet Ai është Mëkatfalës i madh dhe shumë Mirënjohës.” (Sure “Fatir”, 29-30.)

Secili mysliman duhet të dijë se Kurani është thelbi i udhëzimit në këtë botë dhe momenti i ndryshimit në historinë njerëzore. Kjo do të thotë se ai duhet të jetë i lidhur fuqishëm me Kuratin, të jetojë me të, sepse Kurani është kabllo e fuqishme dhe drejtim i sigurt i ecjes.

¹ Me fjalën “E transmeton Pesa” do të thotë se hadithin në fjalë e kanë transmetuar përpiluesit e sunneneve: Et-Tirmidhiu, Ebu Davudi, Nesaiu, A. Hanbeli dhe Ibni Maxhe. (Shënim i përkthyesit).

Kurani i është shpallur Muhamedit a.s. nga mëshira ndaj botëve dhe si udhëzim për të gjithë njerëzit, sepse në Kuran burimisht qëndron:

“Elif, Lam, Ra. (ky është) Libër; Ne ta shpallëm ty që me urdhrin e Zotit t’i nxjerrësh njerëzit nga errësira në dritë; (t’i nxjerrësh prej errësirës) në rrugë të Fuqipotit, të Falënderuarit.” (Sure Ibrahim, 1)

Allahu i Lartësuar në Kuran ka tubuar bazat e të gjitha të mirave dhe ka programuar udhëzimet si të rregullohet jeta dhe si të vendosen paqja dhe shpëtimi në tokë, sepse Kurani udhëzon për atë që është më e fortë:

“Është e vërtetë se ky Kuran udhëzon për atë rrugë që është më se e vërteta, e besimtarët që bëjnë vepra të mira i përgëzon se ata pa dyshim do të kenë shpërblim të madh.” (Sure “El-Isra”, 9)

Myslimani duhet të dijë që roli i Kuranit shtrihet në individin, po edhe në shoqëri, që Kurani ofron sistem të plotë të mënyrës së jetës. Ai është ilaç për zemrën e sëmurë dhe zgjidh edhe problemet e njeriut:

“Është e vërtetë se ky Kuran udhëzon për atë rrugë që është më se e vërteta, e besimtarët që bëjnë vepra të mira i përgëzon se ata pa dyshim do të kenë shpërblim të madh”. (Sure “el-Isra”, ajeti 9)

Kurani është rregullorja themelore e Islamit, i cili në vetë i ka përmbledhur rregullat e Islamit, e ka sqaruar besimin islam, i ka definuar rregullat/normat e Sheriatit dhe e ka udhëzuar njeriun se si të sillet dhe si të përvetësojë virtyte pozitive. Kush dëshiron që më shumë të lexojë/mësojë Kuran, ai ka mundësi të pakufizuara. Ajetet e shumta dhe hadithet flasin

mbi vlerat e mësimi të Kuranit dhe udhëzimet që ofron Kurani për lexuesit. I Dërguari a.s. thotë:

“Kush këndon Kuran dhe e mëson përmendsh, pastaj lejon atë që është e lejuar (hallall) dhe ndalon atë që është e ndaluar (haram), për këtë Allahu do ta shpjerë në Xhenet dhe ai do të ndërmjetësojë për dhjetë persona të tij, të cilëve, ndryshe, do t’u takonte Xhenemi.” (Transmeton Tirmidhiu).

Megjithatë, besimi nuk qëndron në lartësi e as nuk shkëlqen shumë nëse njeriu nuk mendon për atë që e ka mësuar dhe lexuar. Kur të mendojë, vetëm atëherë do të lulëzojë bota e imanit dhe do të shfaqet etika kuranore në fjalët dhe veprat e tij. Fryti i Kuranit paraqitet në programin e të jetuarit dhe të sjelljes së tij. Kështu, Kurani rafinon-fisnikëron shpirtin dhe trupin e njeriut, sikurse thotë i Dërguari a.s.:

“Njeriu i cili e lexon-mëson Kuranin është i ngjashëm me portokallin, aroma e të cilit është e këndshme dhe shija e mirë, kurse besimtari i cili nuk lexon-mëson Kuranin, ai është sikurse bima (një lloj i limonit) e cila as nuk ka aromë e as nuk ka shije të mirë.” (E transmeton Pesa)

Leximi dhe mësimi i Kuranit nuk është vetëm ibadet, por edhe dobi për njeriun në jetë. Kurani ia paraqet të vërtetën e gjithçkaje që ekziston, ia sqaron mënyrën e lidhjes dhe komunikimit ndërmjet njerëzve, i mundëson sukses në punë ashtu që të mos endet symbyllazi. Atëherë në rrethin e vet njeriu jeton si vepër e mirë dhe kreative dhe në shoqërinë e vet ndikon pozitivisht.

Sipas kësaj, këndimi i Kuranit është dobi e vërtetë, e cila nuk mund të matet me asnjë dobi tjetër.

I Dërguari a.s. ka sqaruar se leximi dhe mësimi i Kuranit ia kthen lexuesit frytin, i cili e tejkalon secilën ofertë tjetër që do të mund t'i ofronte kjo botë. I Dërguari a.s. thotë:

“...sikur çdo ditë secili prej jush të zgjohej herët dhe të shkonte në xhami dhe të mësonte nga dy ajete nga Kurani, për të do të ishte më mirë dhe më e vlefshme se dy deve, se tri etj.” (Transmeton Muslimi).

Besimtari mysliman nuk duhet ta kuptojë lehtë këtë lidhje, e cila e lidh me leximin e Kuranit. Atë që e ka mësuar, nuk guxon që të mos e përfillë. Kurani është statut që përmban të vërtetën mbi Islamin, kur të ndërpritet lidhja ndërmjet Kuranit dhe një besimtari, ndërpritet edhe burimi i imanit. Për këtë i Dërguari a.s. thotë:

“Ai i cili nuk di asgjë nga Kurani, ai është si shtëpi e demoluar (harabatë)”.

Të harrosh nga Kurani atë që e ke mësuar, është mëkat i madh. Për këtë i Dërguari a.s. thotë:

“Më janë paraqitur mëkatet e Ymetit tim dhe nuk kam vërejtur mëkat më të madh sesa që dikush ta ketë mësuar ndonjë sure/kaptinë të caktuar nga Kurani apo ajet dhe më vonë ta ketë harruar”. (Transmeton Tirmidhiu dhe Ebu Davudi).

Sipas kësaj, qëllimi i leximit të Kuranit është lidhja e zemrës së njeriut me përmbajtjen e asaj që lexon. Ky është ibadet, i cili kërkon edhe zemër të shëndoshë e edhe kuptim/perceptim të drejtë.

Mësimi që nxjerrim nga kjo, nuk është në leximin sa më të shpeshtë të Kuranit, por në leximin dhe meditimin për atë që është lexuar. Për këtë myslimani lexon Kuran me zemër të përlur, i koncentruar duke u munduar që të njohë madhërinë e tij. Kurani thotë:

“Sikur Ne ta zbritnim këtë Kuran mbi ndonjë kodër, do ta shihje atë të strukur e të çarë prej frikës nga Allahu. Këta janë shembuj që ua shkoqisim njerëzve, që ata të mendojnë.”. (Sureja, el-Hashr, 21).

Kjo do të thotë se Kurani nuk mund të reduktohet vetëm në melodi dhe nota, të cilat në këtë rast nuk kanë kuptim të pavarur. Të lexosh Kuranin për zbavitje, mësimet islame nuk e aprovojnë, ky veprim vjen në kundërshtim me madhësinë e fjalëve të Zotit. Nëse zemra nuk është e përgatitur për ta pranuar udhëzimin apo porosinë e Kuranit, atëherë nuk ka nevojë as që ta lexojë atë. Lidhur me këtë i Dërguari a.s. ka thënë:

“Lexoni-mësoni Kuran për atë që do t’ju afrojë e kur t’ju ndajë, lëreni atë! (Transmeton Shejbani).

Me leximin e Kuranit nuk mund të zbavitemi. Kurani vepron në zemër të njeriut duke prekur deri në atë masë sa që edhe tek i Dërguari a.s. do të nxiste lotët. Transmetohet nga Abdullahu se:

“Një ditë i Dërguari a.s. i kishte thënë:

- Më lexo diçka nga Kurani!

- Si te të lexoj ty, kur ty, o i Dërguari i Allahut, të është shpallur ai?!-i qe përgjigjur Abdullahu.

- Dëshiroj të dëgjoj kur e lexojnë të tjerët, i qe përgjigjur i Dërguari a.s..

Dhe Abdullahu kishte lexuar kaptinën “En-Nisa”, deri te ajeti 41:

“Po çdo të bëhet, atëherë, kur të sjellim dëshmitarë nga secili popull e ty do të sjellim dëshmitar kundër tyre?”

Atëherë, i Dërguari a.s. i kishte thënë se kaq mjaftonte dhe i kishin rrjedhur lotët.

“Në krijimin e qiejve dhe të tokës, edhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka me të vërtetë argumente për ata që kanë mend.

Për ata të cilët e përmendin Allahun në këmbë, edhe ulur, edhe ratë dhe mendojnë thellë për krijimin e qiejve dhe të tokës: “O Zoti ynë, Ti nuk e ke krijuar këtë kot; qofsh lartësuar! Dhe ruana prej dënimit të zjarrit”!

O Zoti ynë, atë të cilin Ti do ta futësh në zjarr, atë e ke turpëruar. Për mizorët nuk ka asnjë ndihmës.

O Zoti ynë, ne dëgjuam një profet i cili na thërriste në besim, “Besoni Zotit tuaj!” Dhe ne besuam. O Zoti ynë, na fal mëkatet tona, mbuloji veprat tona të këqija dhe bëna të vdesim me ata të mirët.

O Zoti ynë, na jep atë që na ke premtuar me anë të profetëve dhe mos na poshtëro në Ditën e Kiametit! Ti me të vërtetë e zbaton premtimin Tënd”. (“Ali Imran”, 190-194.)

“Marrë nga: “Zbornik Radova”, nr. 19/2015, Fakulteti i Shkencave Islame - Sarajevë, 2016, f. 9-17”.

Përktheu: **Nail Halimi**

Resul REXHEPI

VLERA DHE RËNDËSIA E DUASË NË DRITËN E KURANIT DHE TË SYNETIT

وَإِذَا سَأَلَكَ عِبَادِي عَنِّي فَإِنِّي قَرِيبٌ أُجِيبُ دَعْوَةَ الدَّاعِ إِذَا دَعَانِ
فَلْيَسْتَجِيبُوا لِي وَلْيُؤْمِنُوا بِي لَعَلَّهُمْ يَرْشُدُونَ

“Kur të të pyesin ty (Muhamed) robtë e Mi për Mua, thua ju se Unë jam afër tyre, i përgjigjem lutjeve të lutësit kur ai më lutet Mua. Prandaj, le të më përgjigjen edhe ata Mua dhe Mua le të më besojnë për të qenë të drejtëudhëzuar”.¹

وَقَالَ رَبُّكُمْ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ

“Zoti juaj ka thënë: Më thirrni Mua (bëni dua), se Unë ju përgjigjem juve”.²

¹ Kuran, El-Bekare, 186.

² Kuran, Gafir, 60.

Duaja-lutja, si në të drejtën e Sheriatit, po ashtu edhe ndër qarqet e myslimanëve, ka një rëndësi të veçantë. Vetë fakti se në Kuranin fësnik ka një numër të ajeteve që bëjnë fjalë për këtë, dëshmon se sa e rëndësishme është duaja. Këtë konstatim e vërtetojnë, përveç të tjerash, edhe shumë vepra të dijetarëve më i eminentë islamë.³

Në të vërtetë, duaja-lutja e ka qëllimin që lutësi ta lut Allahun xh.sh. për ndihmë, për falje mëkatesh, për ta ruajtur nga fatkeqësitë, për t'ia falur Xhenetin, ose për ta ruajtur nga ndëshkimi në botën tjetër. Prandaj, njeriu në këtë botë, duke iu lutur Allahut të Gjithëpushtetshëm, në të vërtetë, e dëshmon se kush është meritori për t'u adhuruar dhe kush meriton që t'i drejtohem i për ndihmë.

Pejgamberi a.s. ndërkaq ka thënë: *“Nuk ka gjë më të ndershme tek Allahu sesa duaja.”*⁴ dhe se *“Duaja është adhurim”*, e më pastaj ka lexuar fjalën e Allahut:

وَقَالَ رَبُّكُمْ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ إِنَّ الَّذِينَ يَسْتَكْبِرُونَ عَنْ عِبَادَتِي
سَيَدْخُلُونَ جَهَنَّمَ دَاخِرِينَ

“Zoti juaj ka thënë: “Lutmëni Mua, se do t’ju përgjigjem! Me të vërtetë, ata që tregohen mendjemëdhenj e nuk duan të Më adhurojnë, do të hyjnë në Xhehenem të poshtëruar”.

Me një rast tjetër, Pejgamberi a.s., ka thënë:

³ Shih: *“Kitâb eddu’âi”* e autorit Imam Ebu el-Kâsim Eshshâmî (vdiq 360 h); *“She’nûd-du’âi”* e Imam El-Busetit (v. 388 h.); *“Ed-D’avât en-Nebevîje”* e Es-Semani; *“En-Nasiha fî el-edijetis-sahîha”* e Imam El-Makdesit etj.

⁴ Transmeton Tirmidhiu.

⁵ Kuran, Gafir, 60.

الدعاء مخ العبادة

“Duaja është thelbi i ibadetit”

Dhe në hadithin tjetër:

الدعاء سلاح المؤمن

“Duaja është arma e besimtarit”.

T’i lutemi Allahut xh.sh. gjithmonë dhe pa ia ndarë, mënjës e mbrëmje, përveç se është nevojë e jona, është edhe urdhër kuranor, është urdhër i vetë Allahut xh.sh., sepse Allahu është Ai i Cili na ka mësuar që t’i lutemi Atij dhe gjithashtu na ka premtuar se Ai është pranë nesh dhe se i përgjigjet lutjeve të lutësit.

Lidhur me këtë, Allahu xh.sh. në Kuran, ka thënë:

وَإِذَا سَأَلَكَ عِبَادِي عَنِّي فَإِنِّي قَرِيبٌ أُجِيبُ دَعْوَةَ الدَّاعِ إِذَا دَعَانِ

“Kur të të pyesin ty (Muhamed) robtë e Mi për Mua, thuaju se Unë jam afër tyre, i përgjigjem lutjeve të lutësit kur ai më lutët Mua”.⁶

Allahu i Madhërishëm, po ashtu, urdhëroi që t’i lutemi Atij me përulje të vërtetë, e sidomos gjatë vështirësive dhe sprovave, dhe na lajmëroi se nevojtarit nuk i vjen në ndihmë për t’ia larguar të keqen, përveç se Allahu:

أَمَّنْ يُجِيبُ الْمُضْطَرَّ إِذَا دَعَاهُ وَيَكْشِفُ السُّوءَ وَيَجْعَلُكُمْ

خُلَفَاءَ الْأَرْضِ أَيْلَهُ مَعَ اللَّهِ قَلِيلًا مَا تَذَكَّرُونَ

“A ka më të mirë se Ai i Cili i vjen në ndihmë nevojtarit të këputur, kur i lutet Atij, që ua largon të keqen dhe ju bënë trashëgimtarë në tokë?!”⁷.

⁶ Kuran, El-Bekare, 186.

⁷ Kuran, En-Neml, 62.

Nga ana tjetër, Allahu xh.sh. i qorton rreptë ata të cilët nuk iu luten Atij, në veçanti kur ballafaqohen me sprova e fatkeqësi. E gjithë kjo vjen nga mëshira dhe bujaria e Tij. Allahu xh.sh. i urdhëron që t'i luten Atij, për arsye se ata kanë nevojë për Të dhe vetëm Ai mund t'ju ndihmoj:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ أَنْتُمُ الْفُقَرَاءُ إِلَى اللَّهِ وَاللَّهُ هُوَ الْغَنِيُّ الْحَمِيدُ

“O njerëz! Ju jeni të varfër e nevojtarë për Allahun, kurse Allahu s’ka nevojë për asgjë dhe është i Denjë për çdo lavd”.⁸

Kurse në një ajet tjetër, thotë:

وَاللَّهُ الْغَنِيُّ وَأَنْتُمُ الْفُقَرَاءُ

“Allahu është i Pasur (s’ka nevojë për asgjë), ndërsa ju jeni të varfër”.⁹

Pejgamberi a.s. ndërkaq, duke përcjellë fjalët e Allahut xh.sh., në një hadithi kudsij, ka thënë: “... O robtë e Mi, ju bëni mëkate natë e ditë, e Unë ua shlyej të gjitha ato, pra kërkoni nga Unë falje dhe Unë do t’ju fali!”

Edhe pejgamberët kanë bërë dua

Ndonëse të zgjedhur të Zotit, edhe pejgamberët a.s. shpeshherë iu kanë drejtuar Allahut duke e lutur Atë për ato që kishin nevojë. Duaja prandaj, është edhe synet i të gjithë pejgambereve a.s.. Sa për ilustrim po përmendim rastin e ha-

⁸ Kuran, Fatir, 15.

⁹ Muhamed, 38.

zreti Adem it a.s., i cili së bashku me të shoqen Havanë, pas një gabimi që kishin bërë, iu drejtuan Allahut me këto fjalë:

قَالَا رَبَّنَا ظَلَمْنَا أَنْفُسَنَا وَإِنْ لَمْ تَغْفِرْ لَنَا وَتَرْحَمْنَا لَنَكُونَنَّ مِنَ الْخَاسِرِينَ
“O Zoti ynë, ne i kemi bërë zullum vetvetes, e nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, me siguri do të jemi të humbur”¹⁰.

Nuhu a.s., edhe pse e kishte ftuar popullin e tij në rrugë të drejt një kohë të gjatë, megjithatë i qe lutur Zotit që ta përdhte popullin e tij.

Ibrahimi a.s. i qe lutur Zotit që ta falte prindin e tij Aze-rin, i cili ishte thelluar aq shumë në besimin e idhujve në vend se ta besonte Zotin e vërtetë.

Luti a.s., po ashtu, iu lut Zotit që ta falte popullin e tij, i cili atëbotë kishte marrë rrugë të gabuar.

Musai a.s. i qe lutur Allahut që atij t’ia shtonte përkrahjen duke ia bërë edhe vëllanë e tij gjithashtu peygamber, lutje të cilën Allahu ia pranoi dhe Haruni u shpall peygamber dhe u bë krah i fortë i Musait kundër faraonit.

Sikurse rastet e peygamberëve të Zotit, në Kuran janë të përmendur edhe njerëzit e devotshëm, evliatë, njerëzit e mirë, të cilët në momente të caktuara kanë bërë dua, si për shembull:

- lutja e As’hâbu’l-Kehfit (“Shokët e Shpellës Kehf”),
- lutja e Merjemes, për të shfaqur ndershmërinë e moralit të saj,

¹⁰ Kuran, El-Araf, 23.

- lutja e Asijes (bashkëshortes së faraonit, e cila kishte kërkuar nga Allahu që ta mbronte nga zullumi i faraonit dhe reprezaljet e tij,
 - lutja e Uzejrit, i cili e kishte lutur Allahun që ta bënte të kuptonte se si Ai i ringjallte të vdekurit
- Raste si këto, në literaturën islame, ka akoma më shumë.

Kushtet e duasë

Për të qenë duaja e pranuar tek Allahu i Gjithëmëshirshëm, dijetarët islamë kanë potencuar se ajo duhet t'i plotësojë disa kushte, ndër të cilat më kryesorët janë:

1. Personi i cili bënë dua, duhet të jetë i sinqertë në përmbajtjen e saj, dhe jo t'i drejtohet Zotit me dua për çështje të rëndomta dhe ato të cilat janë në domenin e mundësisë njerëzore ose të fushës së obligimeve. Gjatë lutjes, duhet kërkuar ato gjëra që janë në përputhje me ligjet e Zotit në gjithësi dhe kurrse si ato që janë të jashtëzakonshme ose ato që janë në përgjegjësi të njeriut. Në Kuran, Allahu xh.sh. ka thënë:

ادْعُوا رَبَّكُمْ تَضَرُّعًا وَخُفْيَةً إِنَّهُ لَا يُحِبُّ الْمُعْتَدِينَ وَلَا تُفْسِدُوا
فِي الْأَرْضِ بَعْدَ إِصْلَاحِهَا وَادْعُوهُ خَوْفًا وَطَمَعًا إِنَّ رَحْمَةَ اللَّهِ
قَرِيبٌ مِّنَ الْمُحْسِنِينَ

“Lutuni Allahut të përulur e në heshtje. Ai nuk i do ata që e teprojnë. Dhe mos bëni çrregullime në tokë pas rregullimit të saj dhe Atij lutuni duke u frikësuar

dhe duke shpresuar. Mëshira e Allahut vërtet është pranë bamirësve.”¹¹

Në një ajet tjetër, Allahu xh. sh. ka thënë:

فَاسْتَجِبْنَا لَهُ وَوَهَبْنَا لَهُ يَحْيَىٰ وَأَصْلَحْنَا لَهُ زَوْجَهُ إِنَّهُمْ كَانُوا

يُسَارِعُونَ فِي الْخَيْرَاتِ وَيَدْعُونَنَا رَغَبًا وَرَهَبًا وَكَانُوا لَنَا خَاشِعِينَ

“...Ata (pejgamberët) nxitonin në punë të mira dhe na luteshin duke shpresuar dhe duke u frikësuar, ndërkohë që ndaj Nesh ishin të përrulur.”¹²

2. Besimtari që i ngre duart kah qielli me qëllim që t’i lutet Allahut, nuk bënë që të jetë prej atyre që ushqehen me haram ose që veshën me haram, që jetën e tyre e përbalton me haram, sepse kjo është në kundërshtim me parimet bazë të duasë. Të tillët, sado që i ngrenë duart për t’u lutur, e kanë të kot, sepse është shumë afërmendsh që Allahu të mos iu përgjigjet në dua.
3. Lënia e urdhërimit për të mirë dhe ndalimi nga e keqja. Pejgamberi a.s. me një rast kishte deklaruar: ”Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, ose do të urdhëroni për të mirë dhe të ndaloni nga e keqja ose ndodhë që Allahu t’ua dërgoj ndonjë ndëshkim e pastaj ju do ta lutni Atë, por Ai nuk iu përgjigjet”¹³.
4. Lutja duhet t’i drejtohet Allahut xh.sh. kur je i lirë dhe në kushte normale, e jo kur ballafaqohesh me vështirësi. Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Kush dëshiron që Zoti t’i përgji-*

¹¹ Kuran, El-Araf, 55-56.

¹² Kuran, El-Enbija, 90.

¹³ Transmeton Tirmidhiu.

*gjet kur është ngushtë dhe në vështirësi, le ta shpreshtojë lutjen kur është i lirë dhe në lumturi”.*¹⁴

5. Duaja e njeriut është jo në rregull sa kohë që ai i cili e bënë atë vazhdon të zhytet në mëkate apo vazhdon t’i shkëput marrëdhëniet ndërfamiljare (silatu-rahmi). Muhammedi a.s ka thënë: *“Robit Tim vazhdon t’i plotësohet duaja përderisa nuk lutet me mëkat apo me shkëputje të marrëdhënieve familjare...”*
6. Lutja e njeriut duke qenë i pakujdesshëm - gafil, e jo me vendosmëri. Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Lutuni Allahut duke qenë të bindur se Allahu iu përgjigjet dhe ta dini se Allahu nuk i përgjigjet duasë (e cila rrjedh nga) zemra e pakujdesshme (gafile)”*.¹⁵
7. Duaja duhet drejtuar vetëm Allahut xh.sh., sepse Ai është meritör për këtë, prandaj nuk lejohet t’i luteni askujt tjetër përveç Allahut: *“...kështu që mos iu lutni askujt krahas Allahut!”*¹⁶. Ata që i luten dikujt tjetër e jo Allahut, apo krahas Allahut i luten edhe tjetërkujt, si f.v. idhujve, varreve, të vdekurve nëpër tyrbe, përmendoreve, etj., kjo nuk lejohet, është haram dhe rrjedhimisht lutjet e tyre nuk janë të pranuar. Për më tepër, të tillët janë vetë meritör që kur të bien në vështirësi dhe t’i drejtohen me lutje Allahut, ato të mos ju pranohen. Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Njihe Zotin tënd në rehati që të të njeh Ai në vështirësi”*.

¹⁴ Transmeton Nesaiu.

¹⁵ Transmeton Tirmidhiu.

¹⁶ Kuran, El- Xhinn, 18.

Me rastin e duasë duhet pasur kujdes edhe këto detaje

Gjithmonë duhet pasur në mendje Krijuesin dhe duhet lutur vetëm Atij. Me rastin e duasë drejtuar Allahut xh.sh., duhet pasur kujdes në veçanti edhe:

Fillimisht duhet të pendohemi shumë sinqerisht për gabimin(et) e bërë duke thënë: *“Estagfirull-llahe ‘l-Adhim”* (tri ose edhe më shumë herë) dhe duke qenë shumë të vendosur që gabimin e njëjtë do ta përsërisim. Ndërkaq, në qoftë se bëhet fjalë për ndonjë dëm që ia kemi shkaktuar tjetër kujt, atëherë duhet t’i kërkojmë falje të njëjtit dhe eventualisht duhet t’ia kompensojmë dëmin e shkaktuar, dhe tek më pas duhet bërë dua për të na falur Allahu i Gjithëmëshirshëm.

Është mirë që gjatë duasë të jemi me abdes, dhe sipas mundësisë edhe të kthehemi në drejtim të Kibles.

Gjatë duasë duhet ngritur duart lartë dhe në fund me to e përshkojmë fytyrën. Dijetarët kanë rekomanduar që duaja të fillohet në këtë mënyrë:

اعوذ بالله من الشيطان الرجيم

بسم الله الرحمن الرحيم

الحمد لله رب العالمين والصلاة والسلام على سيدنا محمد وعلى آله وصحبه أجمعين

*“Kërkojë mbrojtjen e Allahut nga shejtani i mallkuar!
Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!
Falënderimi i takon vetëm Allahut, krijuesit të botëve. Bekimi
dhe përshëndetja qofshin mbi Pejgamberin tonë Muhamedin
dhe mbi familjen dhe shokët e tij”.*

Gjatë duasë duhet qëndruar në mënyrë dinjitoze, duke shprehur frikërespekt dhe përlësi, kurse shprehjet duhet thënë me zë të ulët, sepse Allahu ka urdhëruar:

ادْعُوا رَبَّكُمْ تَضَرُّعًا وَخُفْيَةً إِنَّهُ لَا يُحِبُّ الْمُعْتَدِينَ

“Lutuni Zotit Tuaj me përlësi dhe në heshtje....”¹⁷

Lutësi-optimist

Me rastin e duasë, besimtari duhet të jetë i bindur dhe optimist se duaja e tij do të pranohet tek Allahu i Gjithëmëshirshëm dhe se dëshira do t’i plotësohet. Megjithatë, në rast se ajo vonohet, ai nuk guxon të dëshpërohet, aq ma pak të hidhërohet. Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Kur dikush prej jush kërkon diçka nga Zoti dhe bindet se dëshira iu ka plotësuar, le të thotë: “Falënderimi i qoftë Zotit, me begatitë e të Cilit plotësohen veprat e mira”. Ndërsa, nëse plotësimi i dëshirës i vonohet, atëherë le të thotë: “Falënderimi i takon Allahut në çdo gjendje (kohë)”*.

Në një hadith tjetër, Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Duaja mund të pranohet deri sa të mos ngutet njeriu e të thotë: Po lutem qe sa e sa kohë, e ajo nuk po më pranohet”*.

Kohërat dhe vendet më të preferuara për dua

Përmes duasë, njeriu e mbanë lidhjen e tij me Krijuesin e Gjithësisë. Këtë ai duhet ta bëjë në çdo vend dhe në çdo kohë, sepse kur është në kushte të mira, e falënderon Zotin,

¹⁷ Kuran, El Araf, 55.

kurse kur ballafaqohet me vështirësi të cilat jo rrallë ia ofron jeta, Atij i drejtohet për ndihmë. Megjithëkëtë, disa kohë dhe disa vende janë më të rekomanduara për dua, si në:

- Natën e parë të muajit Rexheb,
- Natën e xhumasë,
- Natën e Fitër-Bajramit,
- Natën e Kurban-Bajramit,
- Duaja e atij që është duke agjëruar gjatë Ramazanit, sidomos në natën e Madhe të Kadrit dhe në prag të iftarit,
- Duaja mes ezanit dhe ikametit,
- Në kohën e namazit të xhumasë dhe pas çdo namazi,
- Në momentet e sulmit në luftë, etj.

Ndërsa, vendet më të preferuara për lutje janë:

- Qabeja në Mekë (dhe Meka në përgjithësi, e sidomos pjesa që konsiderohet “Harem”),
- Xhamia e Pejgamberit a.s. në Medine,
- Mesxhidi Aksaja në Jerusalem,
- Arafati dhe Mesh'ari Haram,
- Xhamitë (në përgjithësi).

Në vazhdim, për shkak të natyrës së punimit dhe hapësirës së kufizuar, po sjellim, në arabisht dhe në shqip, vetëm disa dua të përzgjedhura për raste të caktuara. Duatë në fjalë janë të njohura përgjithësisht dhe janë përdorur tradicionalisht ndër ne. Sipas shembullit të duave të përmendura më poshtë, lexuesi mund të përpilojë një dua tjetër, me të cilën do t'i lutet Allahut xh.sh. për ato që synon ose dëshiron. Duatë e

mëposhtme, janë vetëm një model për një dua të specifikuar për një rast të veçantë.

أعوذ بالله من الشيطان الرجيم ، بسم الله الرحمن الرحيم

رب يسر و لا تعسر، رب تم بالخير ، آمين!

Kërkojë mbrojtjen e Allahut nga shejtani i mallkuar!

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“O Zot, lehtëso e mos rëndo, O Zot, plotësoje me të mirë, amin!”

دعاء الاستغفار

أعوذ بالله من الشيطان الرجيم ، بسم الله الرحمن الرحيم

اَسْتَغْفِرُ اللهَ الْعَظِيمَ أَنْتَ رَبِّي لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ خَلَقْتَنِي وَأَنَا عَبْدُكَ وَأَنَا عَلَى عَهْدِكَ وَوَعْدِكَ مَا اسْتَطَعْتُ، أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا صَنَعْتُ، أَبُوءُ لَكَ بِنِعْمَتِكَ عَلَيَّ، وَأَبُوءُ بِذَنْبِي فَاغْفِرْ لِي فَإِنَّهُ لَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ، وَأَنْتَ أَرْحَمُ الرَّاحِمِينَ إِنَّي كُنْتُ مِنَ الظَّالِمِينَ وَأَنْتَ أَرْحَمُ الرَّاحِمِينَ.

Duaja e pendimit - Sejjidu-l-istigfari

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Kërkoj falje nga Allahu i Madhërishëm. O Allah, Ti je Zoti im, nuk ka zot përveç Teje, Ti më ke krijuar dhe unë jam robi Yt, dhe për sa do të mundem do të zbatoj zotimin dhe premtimin Tënd. Kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja që kam bërë, unë jam mirënjohës për dhuntitë e Tua, i pranoj mëkatet e mia, prandaj më fal mua, sepse mëkatet nuk i fal askush përveç Teje. I Lartësuar qofsh, unë vërtetë kam qenë nga keqbërësit, e Ti je më i Mëshirshmi Mëshirues.

دعاء الاستغفار

أعوذ بالله من الشيطان الرجيم ، بسم الله الرحمن الرحيم
استغفر الله العظيم من كل ذنب اذنبته عمدا أو خطأ أو سرا أو علانية و
اتوب اليه من الذنب الذى اعلم و من الذنب الذى لا اعلم . انك أنت
علام الغيوب.

Duaja e pendimit - 2

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!
Kërkojë falje nga Allahu i Madhërishëm për çdo mëkat të bë-
rë (mëkatuar) me qëllim ose gabimisht, fshehtas ose haptas.
Pendohem tek Ai (Allahu) për çdo mëkat që unë di dhe që
nuk di, sepse vërtet Ti je më i dijsmimi i fshehtësive (sekrete-
ve).

دعاء الاذان

أعوذ بالله من الشيطان الرجيم ، بسم الله الرحمن الرحيم
اللهم رب هذه الدعوة التامة والصلاة القائمة آت محمدا الوسيلة و الفضيلة
والدرجة الرفيعة وابعثه مقاما محمودا الذى وعدته انك لا تخلف الميعاد.

Duaja kur e dëgjon ezanin

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!
Zoti ynë, Zoti i kësaj thirrje të plotë dhe namazit që do të
falët, dhuroji Muhamedit vendin merititor dhe gradë të lartë.
Dërgoje atë në pozitë falënderuese të cilën ia ke premtuar,
sepse Ti nuk e prish premtimin.

دعاء بعد صلاة و خاصة بعد صلاة العصر

أعوذ بالله من الشيطان الرجيم ، بسم الله الرحمن الرحيم
الحمد لله رب العالمين. والصلاة والسلام على خير خلقه محمد وعلى اله
وصحبه اجمعين. اللهم ربنا تقبل منا صلاتنا و صيامنا و قيامنا و قراءتنا
وركوعنا وسجودنا وتسبيحنا وتحميدنا و تهليلنا و تضرعنا ودعاءنا و قم
تقصيرنا ولا تضرب بها وجوهنا يا مولانا برحمتك يا ارحم الراحمين. يا خفي
الالطاف نجنا مما نخاف واجعل لنا من لدنك نصيرا. اللهم ربنا اتنا في الدنيا
حسنة و في الاخرة حسنة وقنا عذاب النار. رب اجعلني مقيم الصلاة و من
ذريتي. ربنا و تقبل دعاء. ربنا اغفرلى و لوالدى و للمؤمنين يوم يقوم
الحساب. سبحان ربك رب العزة عما يصفون وسلام على المرسلين والحمد
لله رب العالمين.(الفاتحة)

Duaja e cila lexohet pas faljes se namazit, në veçanti pas ikindisë

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve. Përsë-
ndetjet dhe selamet i dedikohen krijesës së Tij më të mirë,
Muhamedit, familjes dhe të gjithë shokëve të tij.

O Zoti ynë, pranoje nga ne namazin tonë, agjërimin tonë, që-
ndrimin tonë në këmbë gjatë namazit, leximin e Kuranit gjatë
namazit, përkuljen në ruku, rënien në sexhde, lutjet tona, fa-
lënderimet tona, përkushtimin tonë, plotësoj zbrazëtitë tona
dhe mos na mësho me to në fytyrat tona, o Zoti ynë, për hir
të mëshirës Tënde, o më i Mëshirshmi Mëshirues. O Ti, që

ruan butësinë, na shpëto nga ajo që ne frikësohemi dhe nga Ti na dhuro neve ndihmesë. O Zoti ynë, na dhuro të mira në këtë botë dhe të mira në botën tjetër dhe na mbro nga munda mi me zjarr. O Zot, më bënë mua dhe pasardhësit e mi prej atyre që e falin namazin, pranoje lutjen, o Zot. O Zoti ynë, më fal mua dhe prindërit e mi dhe të gjithë besimtarët atë ditë kur do të jepet llogaria...

دعاء عند دخول المقبرة

أعوذ بالله من الشيطان الرجيم ، بسم الله الرحمن الرحيم
السلام عليكم يا اهل الديار من المسلمين والمؤمنين. رحم الله تعالى
المستقدمين منكم والمستأخرين منا. انتم لنا سلف و نحن لكم تبع و إنا إن شاء الله تعالى بكم لاحقون. نسال الله تعالى لنا و لكم الرحمة. رضاء الله
(الفاحة)

Duaja e cila lexohet kur hynë në varreza ose kur kalon pranë tyre

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Paqja dhe shpëtimi qofshin mbi ju, o banorë myslimanë të varrezave, i mëshiroftë Allahu pararendësit nga ju dhe ata që do vijnë tek ju nga ne. Ju ishit për ne prijës, kurse ne po ju pasojmë, dhe në dashtë Zoti, ne do vijmë tek ju. Lusim Allahun të na mëshirojë neve dhe juve. (*Lil-lahi el-fatiha*)

دعاء ختم القرآن

أعوذ بالله من الشيطان الرجيم ، بسم الله الرحمن الرحيم
الحمد لله رب العالمين. و العاقبة للمتقين. ولا عدوان الا على الظالمين.
والصلاة و السلام على رسولنا محمد و اله و صحبه اجمعين. ربنا تقبل منا
انك انت السميع العليم. و تب علينا يا مولانا انك انت التواب الرحيم.
واهدنا ووفقنا الى الحق و الى طريق مستقيم. ببركة القران العظيم. و بحرمة
من ارسلته رحمة للعالمين. واعف عنا يا كريم. واعف عنا يا رحيم. و اغفر لنا
ذنوبنا بفضلك وكرمك يا اكرم الاكرمين. اللهم زينا بزينة القران. و شرفنا
بشرافة القران. و البسنا بخلعة القران. و ادخلنا الجنة بشفاعة القران. و عافنا
من كل بلاء الدنيا و عذاب الآخرة بحرمة القران. وارحم جميع امة محمد يا
رحيم يا رحمن. اللهم اجعل القران لنا في الدنيا قرينا و في القبر مونسنا و في
القيامة شفيعا وعلى الصراط نورا و الى الجنة رفيقا و من النار سترا و
حجابا. و الى الخيرات كلها دليلا و اماما بفضلك وجودك وكرمك. اللهم
اهدنا بهداية القران و نبخنا من النيران بكرامة القران. وارفع درجاتنا بفضيلة
القران. و كفر عنا سيئاتنا بتلاوة القرآن. يا ذا الفضل والاحسان. اللهم
طهر قلوبنا. واستر عيوبنا. واشفع مرضانا. واقض ديوننا. و بيض وجوهنا.
وارفع درجاتنا. وارحم ابائنا. واغفر امهاتنا. واصلح ديننا و دنيانا. و شت
شمل اعدائنا. واحفظ اهلنا و اموالنا و بلادنا من جميع الافات و الامراض
والبلايا. و ثبت اقدامنا وانصرنا على القوم الكافرين. بحرمة القران العظيم.

اللهم بلغ ثواب ما قرأناه. و نور ما تلوناه هدية واصله الى روح سيدنا محمد صلى الله تعالى عليه و سلم. و الى ارواح جميع الانبياء و المرسلين. صلوات الله و سلامه عليهم اجمعين. و الى ارواح الهم و اولادهم و ازواجهم و اصحابهم و اتباعهم و جميع ذرياتهم رضوان الله تعالى عليهم اجمعين. و الى ارواح آبائنا. و أمهاتنا و إخواننا و أخواتنا و اولادنا. و اقربائنا و احبائنا و اصدقائنا و استاذنا و استاذ استاذنا. و مشايخنا. و لمن له حق علينا. و لجميع المؤمنين والمؤمنات. و المسلمين والمسلمات. الاحياء منهم والاموات يا قاضي الحاجات. و يا مجيب الدعوات. استجب دعائنا برحمتك يا ارحم الراحمين. و سلام على المرسلين. والحمد لله رب العالمين الفاتحة.

Duaja e hatmes së Kuranit

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve. Përfundimi i mirë është për të devotshmit, kurse armiqësia vetëm ndaj tiranëve. Paqja dhe shpëtimi qofshin mbi të dërguarin tonë Muhamedin a.s., mbi familjen e tij dhe mbi shokët në përgjithësi.

O Zoti ynë! Prano lutjet tona, sepse me të vërtetë Ti je që Dëgjon dhe Din. Na falë, o Zoti ynë, sepse vërtetë Ti je Falës dhe Mëshirues. Na udhëzo dhe na ndihmo tek e vërteta dhe në rrugë të drejtë për hir të Kuranit të madhërishëm dhe për hir të atij që e dërgove mëshirë për të gjithë botët. Na falë neve, o Fisnik, na falë neve, o Mëshirues. Na i falë mëkatet tona me mirësinë dhe bujarinë Tënde, o më Bujari i bujarëve.

O Zot! Na zbukuro me bukurinë e Kuranit. Na fisnikëro me fisnikërinë e Kuranit. Na ndero me nderin e Kuranit, na begato me begatitë e Kuranit, na shpjerë në Xhenet me ndërmjetësimin e Kuranit. Na ruaj nga të ligat e kësaj bote dhe nga dënimi në botën tjetër, për hir të Kuranit. Mëshiroje gjithë Ymetin e Muhamedit a.s., o Mëshirues, o Mëshirbërës.

O Zot! Na e bënë Kuranin të afërm në këtë botë, ndihmues dhe ndriçues në varr, ndërmjetësues në Ditën e Gjykimit, dritë në Urën e Siratit, shoqërues për në Xhenet e mburojë nga zjarri, dhe udhëzues e prijës për punë të mira, për hir të fadiletit, mirësisë dhe fisnikërisë Tënde, o Fisnik!

O Zot! Na udhëzo me udhëzimin e Kuranit, na shpëto prej zjarrit, për hir të fisnikërisë së Kuranit, na i ngre gradat tona me mirësinë e Kuranit. Na i mbulo të metat tona me leximin e Kuranit, o Pronar i mirësive.

O Zot! Na i pastro zemrat tona, na i mbulo të metat tona, shëroi të sëmurit tanë, na mundëso t'i kthejmë borxhet tona, na i shndrit fytyrat tona, na i lartëso gradat tona.

O Zot, mëshiroj baballarët tanë, fali nënat tona, na e rregullo fenë tonë dhe dynjanë tonë, shpartalloj armiqtë tonë dhe ruaj familjet tona, pasurinë tonë dhe atdheun tonë nga të gjitha të metat, sëmundjet dhe belatë (fatkeqësitë). Na përforco, O Zot, në fenë tonë dhe na triumfo ndaj armiqve tanë, për hir të Kuranit famëlartë.

O Zot! Sevapin e këtij leximi dhe dritën e këtij këndimi, ia dërgojmë shpirtit të zotrisë tonë Muhamedit (shpëtimi dhe paqja qoftë mbi të!), dhe shpirtrave të të gjithë pejgamberëve (paqja e Allahut dhe shpëtimi i Tij qoftë mbi të gjithë ata!).

Sevapin, gjithashtu, ua dërgojmë familjeve të tyre, fëmijëve të tyre, bashkëshortëve të tyre, shokëve të tyre, pasuesve të

tyre dhe të gjithë trashëgimtarëve të tyre (Allahu qoftë i kënaqur me ta!).

Gjithashtu, shpirtrave të baballarëve dhe nënave tona, vëllezërve, motrave dhe fëmijëve tanë, të afërmve dhe të dashurve tanë, dhe shokëve tanë, dhe mësuesve tanë, dhe mësuesve të mësuesve tanë, dhe hoxhallarëve tanë, dhe mbi shpirtrat e të gjithë atyre që ju kemi hak, të gjithë besimtarëve e besimtarëve, myslimanëve dhe myslimaneve, të gjallë prej tyre dhe të vdekur, o Plotësues i nevojave dhe o Pranues i lutjeve. Të lutemi na i prano lutjet tona me mëshirën Tënde, o më i Mëshirshmi i mëshiruesve.

(Subhane rabbike...)

دعاء السفر

أعوذ بالله من الشيطان الرجيم ، بسم الله الرحمن الرحيم
 أَللّهُمَّ أَنْتَ الصَّاحِبُ فِي السَّفَرِ وَالْخَلِيفَةُ فِي الْأَهْلِ أَطُو لَنَا الْأَرْضَ وَ سَهْلَ
 لَنَا الطَّرِيقَةَ وَ يَسِّرْ لَنَا السَّفَرَ سُبْحَانَ الَّذِي سَخَّرَ لَنَا هَذَا وَ مَا كُنَّا لَهُ
 مُقْرِنِينَ وَ إِنَّا إِلَى رَبِّنَا لَمُنْقَلِبُونَ.

Duaja me rastin e udhëtimit

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

O Zot i ynë, Ti je shoqërues në udhëtim dhe zëvendës në familje, na e afro tokën, na e lehtëso rrugën dhe udhëtimin na e bën të mbarë. Lavdi i qoftë Zotit, i Cili na e ka vënë këtë mjet udhëtimi në shërbimin tonë, sepse ne këtë nuk mund ta bënim dhe se te Zoti ynë ne kemi për t'u kthyer.

دعاء عند دخول العمل

أعوذ بالله من الشيطان الرجيم ، بسم الله الرحمن الرحيم
 اللهم يا مفتاح الأبواب افتح لنا خير الباب. اللهم ارزقنا حالاً و رزقاً واسعاً
 برحمتك يا ارحم الراحمين

Duaja me rastin e hyrjes në vendin e punës

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

O Zot, Ti je Që i hap dyert, prandaj na e hap derën më të mirë. O Zot, na e bënë të mundshme të fitojmë me hallall dhe të kemi begati të gjerë për hir të mëshirës Tënde, o më i Mëshirshmi i Mëshiruesve.

دعاء الافطار

أعوذ بالله من الشيطان الرجيم ، بسم الله الرحمن الرحيم
 اللهم لك صمت وبك آمنت وعليك توكلت وعلى رزقك أفطرت.

Duaja e iftarit

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

O Zoti ynë, për Ty agjërova, Ty të kam besuar, te Ti jam mbështetur dhe nga bereqetet Tua bëj iftar.

دعاء (نية) الاضحية

أعوذ بالله من الشيطان الرجيم ، بسم الله الرحمن الرحيم
 بسم الله الله أكبر اللهم هذا منك ولك ان صلاتي ونسكي ومحياي ومماتي
 لله رب العالمين لا شريك لك وبذلك أمرت وأنا أول المسلمين. اللهم تقبل
 مني كما تقبلت من ابراهيم خليلك و محمد عليه الصلاة و السلام.
 (الفاحة)

Duaja me rastin e therjes së kurbanit

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Me emrin e Allahut, Allahu është më i Madhi! O Zoti ynë,
 ky kurban është nga Ti dhe për Ty. Vërtetë namazi im, kur-
 bani im, jeta ime dhe vdekja ime janë vetëm për Allahun-Zo-
 tin e botëve, Ai nuk ka rival, me këtë jam urdhëruar dhe unë i
 pari i myslimanëve jam.

O Zot, pranoje këtë sakrificë nga unë, ashtu siç e ke pranuar
 nga i dashuri yt Ibrahim dhe nga Muhamedi - paqja dhe
 shpëtimi qoftë mbi të! (*El-Fatiha*)

دعاء ليلة القدر

أعوذ بالله من الشيطان الرجيم ، بسم الله الرحمن الرحيم
 اللهم انك عفو كريم تحب العفو فاعف عنا انك رحيم ودود. (الفاحة)

Duaja që lexohet me rastin e Natës së Kadrit

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

O Zoti ynë, Ti vërtet je falës dhe fisnik, e do faljen, prandaj
 na falë neve, sepse Ti vërtet je i mëshirshëm dhe i dashur!”

دعاء بعد دفن الميت

أعوذ بالله من الشيطان الرجيم ، بسم الله الرحمن الرحيم

الحمد لله الذي قال في كتابه الكريم كل نفس ذائقة الموت ثم الينا ترجعون.
و الصلاة و السلام على رسولنا محمد الذى نزل فى شأنه انك ميت وانهم
ميتون. وعلى اله واصحبه الذين إذا اصابتهم مصيبة قالوا انا لله و انا اليه
راجعون. اللهم انا عبيدك و ابناء عبيدك و ابناء امائك ماض فينا حكمك
عدل فينا قضائك نسئلك اللهم بكل اسم هو لك سميت به نفسك او
علمته احدا من خلقك او انزلته فى شيء من كتبك او استاثرت به فى علم
الغيب عندك ان تبلغ ثواب ما قرانه و نور ما تلونه هدية واصلة الى روح
سيدنا محمد صلى الله عليه و سلم و الى ارواح آله وازواجه واتباعه و اهل
بيته اجمعين. و الى ارواح جميع المؤمنين والمؤمنات و المسلمين والمسلمات
الاحياء منهم والاموات و الى ارواح من دفن فى هذاالجوار رحمة الله عليهم
اجمعين. وخاصة الى عبدك المرحوم الذى (المرحومة التى) نزل (نزلت) بك و
انت خير منزل به جاف الارض عن جنبه (جنبها) وافتح ابواب السماء
لروحه (لروحها) واقبله (اقبلها) منك بقبول حسن ولقه (لقها) منك رضوانا.
اللهم ان هذا عبدك (هذه امتك) انت أعلم به (بها) منا و لا نعلم منه
(منها) الا خيرا اللهم ارحمه (ها) والحقه (الحقها) بنبينا محمد صلى الله عليه
و سلم و لا تضلنا بعده (بعدها) ولا تحرمنا اجره (اجرها). اللهم اجعل قبره
(قبرها) روضة من رياض الجنان ولا تجعل قبره (قبرها) حفرة من حفراتيران.
اللهم لا تجعل له (لها) ذنبا الا غفرته ولا عملا خيرا الا قبلته و لا عيبا الا

سترتة. اللهم اجعل روحه (روحها) مسرورا و ذنوبه (ذنوبها) مغفورة و
اعماله (اعمالها) مقبولة واملا قبره (قبرها) نورا واعط له (لها) كتابه (كتابها)
بيمينه (بيمينها) و حاسبه (حاسبها) حسابا يسيرا ولا تعط له (لها) كتابه
(كتابها) بشماله (بشمالها) ولا من وراء ظهره (ظهرها) ولا تحاسبه
(تحاسبها) حسابا شديدا. اللهم بشره (بشرها) بالروح والريحان والراحة
والايمان والقبر والبستان والعفو والرضوان والفردوس والجنان برحمتك يا ارحم
الراحمين. اللهم ارحمنا اذا ارق الجبين وكثر الانين وبكى علينا الحبيب و يئس
منا الطبيب. اللهم ارحمنا اذا واراننا التراب وودعنا الاحباب و فارقتنا النعيم
وانقطع عنا النسيم. اللهم ارحمنا اذا نسى اسمنا و بلى جسمنا واندرس قبرنا
و اطوى ذكرنا وارحمنا اذا نفخ في الصور و بعثر ما في القبور و حصل ما في
الصدور يوم الحشر و النشور. وارحمنا يوم يبلى السرائر و تبدى الضمائر و
تنشر الدواوين يا حى يا قيوم برحمتك نستعين. اللهم اجعل القرآن لنا فى
الدنيا قرينا و فى القبر مونساً و فى القيامة شفيعاً وعلى الصراط نورا و الى
الجنة رفيقا و من النار سترا و حجابا. اللهم كما جمعتنا فى هذا المقام
فاجمعنا فى دار السلام واغفر لصاحب هذا القبر والمقام. اللهم انله (انلها)
الحسنى و زيادة واجعله (اجعلها) على الصراط من العابرين وعلى حوض
نبيك من الواردين و من اهل شفاعة نبيك الامين. برحمتك يا ارحم
الراحمين. جزى الله عنا سيدنا محمدا صلى الله عليه و سلم بما هو اهلـه .
سبحان ربك رب العزة عما يصفون وسلام على المرسلين والحمد لله رب
العالمين.(الفاتحة)

Duaja pas varrimit

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Falënderimet dhe lavdërimet i takojnë vetëm Allahut xh.sh., I Cili në Kuranin Famëlartë ka thënë: *“Çdo person do ta shijoj vdekjen, pastaj te Ne do të ktheheni”*.

Shpëtimi i Allahut dhe përshëndetjet tona qofshin mbi Pejgamberin tonë, Muhamed Mustafan (a.s.), në lidhje me të cilin është shpallur nga Zoti se: *“Vërtet ti o Muhamed do të vdesësh, por edhe të gjithë ata, (pabesimtarët), do të vdesin”*. Shpëtimi qoftë edhe mbi familjen dhe shokët e tij, të cilët kur u ndodhte ndonjë fatkeqësi thoshin: *“Ne jemi të Allahut dhe tek Ai kemi për t’u rikthyer”*.

O Zoti ynë, ne jemi besimtarë dhe bijtë e besimtarëve Tu, veprimë nën vullnetin Tënd dhe caktimi Yt mbi ne është drejtësi.

O Zoti ynë, për hir të Emrave të bukur, më të cilët e emërtove Vetën Tënde, ose ia mësove ndokujt nga robërit Tu, ose që e ke zbrit në ndonjërin nga Librat Tu dhe për hir të Kuranit që na e dërgove udhëzim, sevabet e këtij leximi dhe dritën e këtij këndimi nga ky tubim, dërgoja dhe dhuroja shpirtit të Pejgamberit tonë (a.s.), e edhe shpirttrave të familjes dhe shokëve të tij, edhe shpirttrave të atyre që e pasojnë rrugën e tij, nga radhët e besimtarëve e besimtareve, myslimanëve e myslimaneve, të gjallë qofshin ose të vdekur, e veçmas mbi këtë të varrosurin në këtë vend, - mëshira Jote i mbuloftë të gjithë. O Zot, të lutemi, që këtij të ndjerit (ndjerës), t’ia zgjerosh varrin nga të dy anët, t’ia hapesh portat e qiellit për shpirtin e tij (saj), t’i bësh pritje të mirë e t’i dhurosh mëshirën Tënde, Ja Errhamerr-Rrahimin.

O Zot, ky është rob i Yti, Ti më së miri e njeh atë, ndërkaq ne e njohim për të mirë, mëshiroje, O Zot, dhe afroje te Pejgamberi jonë (a. s.), mos na dëmto pas tij (saj) dhe mos na përjashto nga shpërblimi tij (saj).

O Zot, të lutemi që varrin e tij (saj), ta bësh kopsht prej kopshteve të Xhenetit dhe të mos e bësh humnerë nga ato të Xhehenemit.

O Zot, të lutemi që këtij të ndjerit (ndjerës) t'ia falësh gjynahet, t'ia pranosh veprat e mira dhe t'ia mbulosh të metat e tij (saj).

O Zot, shpirtin e tij bëre të gëzuar, gjynahet e shlyera, ndriçoja varrin plotë dritë, zbritja librin e veprave nga e djathta dhe gjykoje me llogari të lehtë, dhe mos ja zbrit librin nga e majta dhe as pas shpine dhe mos e gjyko me llogari të rëndë.

O Zot, përgëzoje këtë të ndjerin (ndjerën) me gëzim e rahati, me çlodhje e qetësi, me furnizim e begati, me falje dhe shpërblim me Xhen-neti Firdevs, më Mëshirën Tënde, o Mëshirues i Përgjithshëm...

Subhaneke Rabbike Rabbil izzeti amma jesifune ve selamun alel murselin vel hamdulil-lahi Rabbil alemin (El Fatihah).

Nexhat IBRAHIMI

MEDHHEBET JANË DOMOSDOSHMERË DHE JO BIDAT

I. DISA NGA KUPTIMET E FJALËS *MEDHHEB*

Fjala *medhheb* (مذهب) është nga gjuha arabe dhe ka një spektër të gjerë të kuptimeve, sikurse: lëvizje, doktrinë, opinion, mënyrë veprimi, veprim, mendim, vështrim, pikëpamje, botëkuptim, bindje, perceptim mësim, fe, sekt, teori etj.¹ Kurse Imam Gazaliu mendon se kjo fjalë ka tri kuptime themelore: qëndrim, metodë mësimi dhe besim.² Kjo domethënë që kuptimin e mirëfilltë të fjalës e përcakton konteksti i fjalisë dhe duhet pasur parasysh saktësimi i saj. Por, kjo fjalë, krahas kuptimin gjuhësor, ka edhe kuptimin përmbajtjesor,

¹ Isa Memishi, Fjalor Arabisht-shqip, I, Logos-A, Shkup, 2014, fq. 608-609.

² Imam Gazaliu, Mizan'ul-amel, përgatiti Sulejman Dunja, botimi I, Kajro, 1964, fq. 405-408 ose: Ebu Hamid El-Gazali, Mjerilo djela, Sarajevë, 2005, fq. 207-211.

sikurse një prej shkollave juridike (fikhore) dhe besimore (akaidore) brenda të kuptuarit të fesë nga ehli suneti dhe xhemati, përkatësisht medhheb domethënë drejtimi apo metoda që juristi i kualifikuar – muxhtehidi zgjedh dhe përdor për të arritur deri te njohja dhe nxjerrja e dispozitave të caktuara (el-ahkam).³ Edhe në përdorimin e gjerë shkencor, por edhe të zakonshëm fjala medhheb e ka këtë kuptim.

II. NJË FE, NJË BESIM DHE DISA MEDHHEBE

Islami është një fe monoteiste, besimi në Zotin Një dhe të Vetëm. Të tillë e shpalli Allahu gjatë gjithë historisë, nga Ademi a.s. e deri te Muhammedi a.s. Por, të kuptuarit e fesë nga njerëzit është i llojllojshëm, varësisht nga aftësia njerëzore intelektuale, nga prirja dhe qasja për shkencë apo për drejtime të ndryshme. Kjo ka përcaktuar që perceptimet të jenë disa, natyrisht, në pajtim me shtyllat islame, me parimet e përgjithshme islame. Prandaj, medhhebi është një mënyrë perceptimi, praktikimi dhe shpjegimi të fesë, e nuk është fe e re, besim i ri, dhe si i tillë i papranueshëm, siç pretendohet të thuhet dhe thuhet nga disa qarqe me pikëpamje të ngurta dhe ultra-konservative.⁴ Ky perceptim nuk është i ndryshëm në baza, në shtylla, të cilat janë përcaktuar me Kuran dhe janë shpjeguar me hadith, por është i ndryshëm në hollësi, çështje

³ Nexhat Ibrahim, Fjalor Enciklopedik Islam, Logos-A, Shkup, në proces botimi, zëri “Medhheb”.

⁴ Mustafa Seid El-Xhinn, Ether’ul-ihtilafi fi’l-kavaid’il-usulijeti fi ihtilaf’il-fukahai, botimi IV, Bejrut, 1985.

më pak relevante, siç kemi faljen e namazit në disa mënyra, mënyrën e dhënies së zeqatit etj.⁵

Bota myslimane ka pasur një varg shkollash, medhhebesh qysh në fillim të historisë së vet, madje intelektual i Muhammed Ikbali pohon se në fillim të historisë, si rezultat i dinamikës së zhvillimit të gjithëmbarshtëm mysliman kishte jo më pak se nëntëmbëdhjetë shkollë⁶, por jo të gjitha këto i rezistuan kohës. Ato medhhebe që krijuan identitet të gjithëpranueshëm dhe vazhduan jetën janë katër në çështjet juridike (hanefizmi, malikizmi, shafiizmi dhe hanbelizmi)⁷ dhe dy në çështjet besimore (maturidizmi dhe esh'arizmi).⁸ Të theksojmë se medhhebi hanefi-maturidi është shumicë dërmuese në


⁵ Gjatë jetës së Muhammedit a.s. nuk kemi medhhebe, sepse shpallja ishte në zbritje e sipër dhe çdo nevojë të besimtarëve e plotësonte vetë Muhammedi a.s. me shpjegime meritore. Por, pas vdekjes së tij, nuk kishte autoritet meritues që do të fliste në emër të fesë. Njerëzit të cilët gjatë jetës së Muhammedit a.s. ishin specializuar në njëfarë mënyre, në të ardhmen do të bëhen pikat më referuese të lindjes së shkencave islame, siç është Muadh ibn Xhebeli r.a., Abdullah ibn Mes'udi r.a., Ali ibn Ebi Talibi r.a., Ebu Hurejre r.a., Aishja bint Ebi Bekr r.anha, Ibn Abbasi r.a. etj. Më vonë, natyra e hapur e mësimi islam, pastaj boshllëqet juridike, siguria juridike, polisemia kuranore, perceptimi i ndryshëm i hadithit dhe sunetit e tjera, do të mundësojë zhvillimin e këtyre filizave fillestarë në shkollë të specializuara, e që kohës i mbijetuan vetëm disa sosh. Bazë e besimit islam është ai besim të cilin e kishte pasur Muhammedi a.s. dhe sahabët e tij. Pasuesit e këtij besimi quhen *ehl'us-sunneh dhe xhema'ah* (pasuesit e sunetit dhe mendimit të shumicës). Sipas: Nexhat Ibrahim, Fjalor Enciklopedik Islam, po aty, zëri: Medhhebe.

⁶ Muhammed Ikbali, Ripërtëritja e mendimit fetar në Islam, Logos-A, Shkup, 2006, fq. 191 e tutje.

⁷ Muhammed Ali Es-Sajis, Historia e legjislaturës dhe jurisprudencës islame, Logos-A, Shkup, 2013, fq. 171-202.

⁸ Nexhat Ibrahim, Fjalor Enciklopedik Islam, në proces botimi, zërat: hanefizmi, maturidizmi, esh'arizmi dhe shafi'izmi.

botën myslimane, madje deri në 70% për qind e më shumë. Edhe trojet shqiptare me shekuj kanë kultivuar mehhebin hanefi-maturidi.⁹ Medhhebin hanefi-maturidi e pasojnë edhe Evropa qendrore e juglindore, pastaj shumica e turqve, popujt myslimanë në Azi të mesme, Kaukaz, Afganistan, Pakistan, Indi, por edhe në vende tjera si në Egjipt etj.



III. SHKAQET E FORMIMIT TË MEDHHEBEVE

Të flitet për shkaqet e formimit të medhhebeve në mësimin islam është temë e gjerë, prandaj nevojitet bërë përmbledhje të shkurtër të faktorëve kryesorë. Të gjitha medhhebet nuk janë produkt të rastit as vullnet personal i dikujt, por rezultat i studimeve të thella, të gjithanshme dhe jashtëzakoni-

⁹ Nexhat Ibrahim, Islami dhe muslimanët në tokat shqiptare dhe në Ballkanin mesjetar (shekujt IX-XIV/, Logos-A, Shkup, 2003, fq. 113 e tutje. Gjithashtu: Thomas W. Arnold, Historia e përhapjes së Islamit, Prishtinë, 2004, fq. 182 e tutje.

sht të sakta të Kuranit, pastaj të Sunetit të Muhammedit a.s. dhe burimeve dytësore të sheriatit, e si rezultat e pasojë “*e ballafaqimit të myslimanëve me zakonet, traditat dhe gojëdhënat e nduarnduarta kundërthënëse*”¹⁰ të myslimanëve në vendet ku u shtri Islami brenda shekullit të parë. Pra, medhebet janë rrugë më e shkurtër, më burimore dhe më bindëse në pasimin e Kuranit dhe Sunetit, të cilat i prezantuan muxtehidët e mëdhenj të bashkësisë myslimane: Ebu Hanife (vd. 150/767), Malik ibn Enesi (vd. 179/796), Shafi'u (vd. 204/819) dhe Ahmed ibn Hanbeli (vd. 241/856), dhe nxënësit e tyre.

III. 1. Zbrazëtitë juridike

Kurani dhe Suneti i rregullojnë gjerat në parim, kurse hollësitë u përkasin dijetarëve që në bazë të themeleve të qarta t'i detajizojnë gjerat sipas vendit dhe kohës, kushteve klimatike, kulturologjike, politike etj. Një varg çështjesh nuk kanë ekzistuar në kohën e zbritjes së Kuranit, ndaj edhe nuk kanë mundur të rregullohen me Kuran dhe Sunet. Këto zbrazëti juridike janë plotësuar në frymën e bazave sheriatike, Kuranit dhe Sunetit. Në këtë çështje vjen edhe divergjenca mes dijetarëve se cila është rruga më e mirë për plotësimin e zbrazëtimeve juridike. Dallimet e tilla i gjejmë qysh në kohën e as'habëve, duke arritur deri në ditët tona. Sot janë aktuale temat që nuk kanë rregullim të drejtpërdrejtë nga bazat sheriatike, siç janë transplantimi i organeve trupore, mbarësimi

¹⁰ Abdulkerim Zejdan, El-Med'halu li diraset'ish-sheriat'il-islamijeh, botimi IV, Aleksandri, Egjipt, pa vit botimi, fq. 142.

artificial, klonimi, eutanazia, agjërimi, namazi dhe kiblja në kozmos jashtë orbitës së tokës e tjera, dhe, kërkojnë përgjigje përkatëse. Disa nga këto tema kanë marrë përgjigje e disa më të reja janë në pritje e sipër. Dallimi në përgjigje nuk do të duhej ta ndante bashkësinë myslimane, por do të duhej të shërbejë si pasuri mendimesh, në kërkim të zgjidhjes më të mirë.

III. 2. Siguria juridike

Shekulli i dytë hixhri solli një zhvillim dinamik të politikës, ekonomisë, shoqërisë myslimane. Zhvillimi krahas rritjes së mirëqenies hapi edhe shumë çështje të diskutueshme, problematike, që duheshin zgjidhur, e të cilat duhej të ishin në pajtim me Kuranin dhe Hadithin, por edhe të hapnin zgjidhje në mjediset dhe kohët e reja. Dijetarët myslimanë ofruan mendimet e tyre rreth temave të reja, por, për shkak të numrit të tyre të madh, lindi problemi i rrëmujës, konfuzionit rreth përcaktimit të rrugës së drejtë. Për ta kapërcyer këtë kohë të rëndë, dijetarët i hynë sistematizimit të mendimeve juridike, por edhe besimore. Sistematizimi i tyre dhe verifikimi sipas një apo më shumë metodave, rezultoi edhe me shkollat e para myslimane në çështjet juridike dhe besimore, si ajo e Imam Ebu Hanifes, por rezultoi edhe me sektet e shumta.¹¹

¹¹ Nexhat Ibrahim, Zhvillimi i sekteve në historinë e mendimit islam, Tetovë, 2006.

III. 3. Polisemia e Kuranit

Ndër shkaqet tjera të formimit të medhhebeve është polisemia, përkatësisht shumëkuptimësia e fjalorit kuranor, ajeteve dhe sureve të tij. Polisemia kuranore ka ndikuar në shpjegimet e shumta dhe në përcaktimin e dijetarëve për njërin apo për tjetrin kuptim.¹² Polisemia kuranore nuk është dobësi, por mëshirë e Zotit për njerëzit, sepse mundëson zbatimin e Kuranit në vende dhe kohë të ndryshme e nga ana tjetër, mundëson përgjigje dhe zgjidhje për të gjithë brezat e myslimanëve deri në Ditën e Fundit, nëse këtë myslimanët do të dëshirojnë dhe do ta kërkojnë në Kuran apo në shpjegimin e Tij autentik, Hadith e Sunet.¹³

III. 4. Të kuptuarit e Sunetit

Shkak tjetër në formimin e medhhebeve është edhe perceptimi i ndryshëm i Hadithit apo Sunetit të Pejgamberit a.s. për shkak të autenticitetit të diskutueshëm të disa haditheve.¹⁴ Disa hadithe kanë besueshmëri më të madhe e disa më pak.

¹² Për shembull, fjala *kuru* sipas një kuptimi domethënë pastërti, e sipas kuptimit tjetër domethënë *hajd* (hajz, menstruacionet etj.).

¹³ Nexhat Ibrahim, Shkolla juridike hanefite dhe karakteristikat themelore të doktrinës së saj, Prizren, 2000, fq. 23 e tutje dhe 55-60.

¹⁴ Për dallim nga Kurani, i cili është përcjellë me zinxhir të vazhdueshëm nga njerëz me kredibilitet të plotë dhe është shkruar nga shumë shkruer, kurse është verifikuar nga Muhammedi a.s., Hadithi nuk e pati këtë fat, sepse ai është shkruar me vonësë, kurse është përcjellë nga njerëz jo gjithnjë të denjë për t'u besuar. Prandaj, kemi një shumësi hadithesh të trilluara, të cilat kritika shkencore e shkencës së hadithit i ka cekur. Shih: Subhi Salih, Mebahithu fi ulum'il-Kuran, botimi V, Bejrut, 1968 dhe Subhi Salih, Ulum'ul-hadith dhe mustalehu, botimi XIII, Bejrut, 1981.

Një numër dijetarësh, për shkak të kriterëve të ndryshme, kanë pranuar disa hadithe, kurse disa të tjera i kanë refuzuar, gjë që ka ndikuar që disa hadithe të shërbejnë për të vendosur disa gjera pozitivisht apo e kundërta. Nuk duhet harruar se në fazën e paraqitjes së medhhebeve nuk kishte përmbledhje të kodifikuara të haditheve, kështu që dyshimi ishte më i madh karshi disa haditheve apo disa përcjellësve të hadithit. Kjo gjendje e shtyri Ebu Hanifen që të vendoste rregulla të rrepta për pranimin e hadithit në mënyrë që të mos jepte mendime juridike apo besimore në mbështetje të haditheve të dobëta.¹⁵ Kjo është e qartë, sepse hanefijtë nuk i merrnin si bazë hadithet *ahad* (por vetëm për konsulencë), kur duhej vendosur për një çështje të caktuar. Për më tepër që në atë kohë Kufa ishte qendër shkencore, por edhe e zhvillimeve të shumta politike e sektare dhe mjedis i përshtatshëm për manipulime.¹⁶

III. 5. Mëshirë për umetin

Medhhebet nuk janë dëshirë e ndonjë intelektualit apo ndonjë grupi, por rezultat i perceptimit dhe praktikimit të Islamit në mjedis dhe rrethana të caktuara. Islami edhe pse është një, perceptimet tona janë më shumë, të cilat nuk duhet dhe nuk bën të dalin nga suaza e natyrshme. Medhhebi, siç e thotë metaforikisht një mik, është një kokërr gruri nga e cila

¹⁵ Shibli Nu'mani, Ebu Hanifja, jeta dhe vepra, Logos-A, Shkup, 20153, fq. 133 e tutje, dhe Pasthënie e të njëjtit libër: Nexhat Ibrahim, po aty, fq. 283 e tutje.

¹⁶ Ibrahim Džananović, Idžtihad u prva četiri stoljeća islama, Sarajevo, 1995, fq. 63.

kanë mbirë katër medhhebe (shkolla).¹⁷ Të gjitha janë legjitime, korrekte dhe të nevojshme. Ndryshimet dhe mospajtimet mes tyre janë pasojë e rrethanave dhe nevojave specifike të popujve myslimanë, në kohën dhe hapësirat gjeografike ku jetonin e të cilat kërkonin zgjidhje diç më ndryshe nga tjetra, por jo jashtë kornizës, jo jashtë tringut të përbashkët. Njëmendësia dhe ngurtësia brenda një medhhebi është e paqëndrueshme ndaj porosive universale. Kjo porosi e tillë ndikoi që të paraqitet një shpërthim intelektual në shekujt e parë myslimanë, për t'i ofruar botës një sistem juridik, i cili i jep njeriut qetësi, zhvillim, perspektivë për të dy botët, këtë dhe atë. Për t'i ofruar botës një sistem juridik që nuk e kishte më herët, hyjnor nga burimi e njerëzor nga zbatimi, i quajtur shariat, kurse i prezantuar nëpërmjet katër medhhebeve të gjithëpranura dhe disa medhhebeve tjera që nuk i rezistuan kohës, por që lanë gjurmë në histori. Liderët e medhhebeve kundërshtoheshin me fjalë, por respektonin kundërshtarin. Imam Shafi'u madje, kur e vizitonte Bagdadin, për respekt ndaj Ebu Hanifes, falej sipas mësimave të Ebu Hanifes.¹⁸ Aktualisht, disa dijetarë myslimanë kanë harruar këtë të kaluar, duke shtrirë fanatizmin e injorancën dhe duke përçarë botën myslimane. Secili imam i medhhebit pohonte se ai ishte mendimi i tij, por nëse dikush tjetër vjen me mendim më të mirë, mendimin e vet parashpallte të tërhequr. Në këtë klimë, mendimi

¹⁷ Almir Fatić, Zašto Mezhebi?, në: <https://hanefijskimezheb.wixsite.com/bosna/single-post/ZASTO-MEZHEBI-Fatic/Islam-kao-vjera-je-jedan-ali-razumijevanje-practiciranje-i-tumacenje-vjere-moze-bit-i-razlicito..>

¹⁸ Almir Fatić, po aty.

ndryshe është begati e pasuri, jo ndarje e përçarje, pikërisht siç porosin hadithi i njohur i Muhamedit a.s. se “*mospajtimet në mesin e umetit tim janë mëshirë*”¹⁹, dhe hadithi tjetër se “*shumica e umetit të Muhammedit a.s. nuk do të pajtohet me mashtrimin*”.²⁰

IV. IMAMI MË I MADH (IMAM`UL-A`DHAMI) DHE MEDHHEBI I TIJ

Imam Ebu Hanifë mban titullin *Imam`ul-a`dham*, që do të thotë *Imami më i madh*, jo në kuptimin e forcës, madhësisë, pasurisë, pushtetit, por në kuptimin se ai ishte mësuesi më i madh në zinxhirin e shumë mësuesve. Prandaj, është gabim që Imam Ebu Hanifë të quhet themelues i medhhebit hanefi, sepse ai nuk e themeloi medhhebin, por e gjeti si të tillë dhe e ndërtoi në lartësitë më të larta, duke i dhënë strukturë, fizionomi, metodologji të përkryer.

Pjesën më të madhe të jetës e kaloi në Kufë, qytetin e lindjes, por për nevoja shkencore udhëtoi edhe në Basrë, Mekë, Medinë, Bagdad etj. udhëtimet e tij nuk ishin shëtitje rasti apo humbje kohe, por studime të mirëfillta. Ai takohej me dijetarë të profileve të ndryshme, diskutonte, polemizonte, mësonte etj.²¹

¹⁹ Sipas: Sujuti, El-Xhami'u'l-kebir, pjesa 1, fq. 1164, sipas: Almir Fatic, po aty.

²⁰ Tirmidhi, Xhami'us-sahih, hadithi nr. 2093, sipas: Almir Fatic, po aty.

²¹ Gjerësisht për Imam Ebu Hanifen shih: Shibli Nu'mani, Ebu Hanifja - jeta dhe vepra, Shkup, 2013; Vehbi Sulejman Gavoçi, Ebu Hanife - Nu'man bin Thabit, juristi i juristëve islamë, pa vend botimi, 2013.

V. THELLËSIA DHE RACIONALITETI I DISPOZITAVE

Imam Ebu Hanife dallon nga shumë juristë tjerë edhe për shkak të thellësisë së tij në shqyrtimin e çështjeve të caktuara. Ai nga tekstet fetare nxori mendimet e tij, por në mungesë të tyre, ai përdori arsyen në mënyrë të baraspeshuar në frymën e teksteve (nususeve). Kështu veproi edhe në të kuptuarit e drejtë të dispozitave të caktuara, sikurse është mendimi që zeqati në kafshët shtëpiake dhe në sadekat'ul-fitr mund të jepet edhe në para, sepse synimi i vërtetë i zeqatit dhe sadakës është ndihmesa të varfërve. Sot kjo dispozitë është e pazëvendësueshme dhe mjaft praktike.²²

VI. PËRPARËSIA E JURISTËVE KARSHI MUHADITHËVE NË FIKH

Varësisht nga shkolla juridike, ashtu janë edhe dijetarët në aspekt të përdorimit të burimeve shariatike në çështjet e ndryshme. Këtë çështje do ta kuptojmë më mirë nëse i lexojmë fjalët e tij: “Ai që tubon hadithin por nuk e njeh fikhun i ngjan farmacistit, i cili tubon ilaçe por nuk di çka mjekojnë ato derisa nuk vjen mjeku. Kështu është edhe me tubuesin e hadithit: nuk e di thelbin e tij derisa nuk vjen fekih.”²³

Ja një shembull se si arsyetohet Ebu Hanife në vërejtjen e Imam Evzaiut lidhur me mosngritjen e duarve gjatë namazit pos në fillim. Evzaiu, imami sirian dhe themelues i një shkolle juridike, e cila ndër shekuj është zhdukur, kur u takua me

²² Almir Fatić, po aty.

²³ Almir Fatić, po aty.

Ebu Hanifen në Mekë, i tha: “Është e habitshme se njerëzit e Irakut nuk i ngrenë duart gjatë rukusë, as kur ngriheni lart pas kësaj, edhe pse kam dëgjuar nga Zuhriu, i cili ka dëgjuar nga Salim ibn Abdullah ibn Omeri se Pejgamberi a.s. e ka pasur zakon ta bëjë këtë. Ebu Hanife e përcolli këtë deri te përcjellja e cila kthehet deri te Abdullah ibn Mes’udi²⁴, nëpërmjet Hammadit, Ibrahim Nah’iut dhe Alkames, sipas të cilës Pejgamberi a.s. nuk e ka pasur zakon t’i ngrejë duart në rastet e cekura. “Lavdia i qoftë Allahut” bërtiti Evzaiu: unë po cek përcjelljen të cilën e përcjellin Zuhriu, Salimi dhe Abdullahu e ti ia kundërvë përcjelljen të cilën e përcjellin Hammadi, Neha’iu dhe Alkame.” Ebu Hanife u përgjigj: “Përcjellësit e mi ishin juristë më të mëdhenj sesa përcjellësit e tu. Sa i përket Abdullah ibn Mes’udit, ti shumë mirë e di pozitën e tij. Përcjellja e tij duhet të ketë përparësi.” Përkatësisht, Abdullah ibn Mes’udi, si e përcjellin përcjelljet, e ka arritur pjekurinë qysh gjatë kohës së jetës së Pejgamberit a.s., ndërsa Abdullah ibn Omeri r.a. atëherë ka qenë djalosh. Për këtë shkak Abdullah ibn Mes’udi ka pasur rast t’i vështrojë shprehitë e Pejgamberit në kontakt të drejtpërdrejtë, derisa Abdullah ibn Omeri nuk ka mundur ta bëjë këtë.²⁵

²⁴ Shibli Nu’mani, po aty, fq. Abdurrahman ibn Jusuf, Provat kyçe të fikhut hanefi, Logos-A, Shkup, 2016, fq. 57-65.

²⁵ Shibli Nu’mani, Ebu Hanifja, fq. 33. Krhs.: Abdurrahman ibn Jusuf, po aty, fq. 131 e tutje.

VII. INTERESI INDIVIDUAL

Imam Ebu Hanife dallon prej rivalëve të tij edhe në këmbëgjatësinë e tij në zhvillimin e interesit personal. Për arsye joshërie nuk mund të hiqet e drejta personale dhe liria individuale, liria e drejtimit të pasurisë dhe e marrjes vendim për vetveten. Ai thuhet se është i vetmi nga dijetarët e mëdhenj që jep leje për femrën madhore e të mençur që të vendosë për martesën e saj, pa pajtimin e prindërve, me kusht të jenë plotësuar kushtet shëritake për martesë.²⁶ Largpamësia e Ebu Hanifes shihet qartë dhe mund të shërbejë si shembull edhe për kohën tonë, ndër myslimanë e jomyslimanë.

VIII. NJERËZIT E KIBLES JANË BESIMTARË

Çështja e perceptimit të besimit (imanit) meriton kujdes. Ebu Hanife raportin besim (iman) dhe vepër (amel) e kupton drejt. Këtë mendim ia shtrembëruan kundërshtarët deri në ditët e sotme. Ai thotë: *“Pohoj se të gjithë njerëzit e Kibles janë besimtarë (mu'min) dhe se asnjë prej tyre nuk bëhet jobesimtar për shkak se ka neglizhuar veprën”*²⁷, dhe ky pohim i tij u bë parim i ehli sunetit dhe xhematit.²⁸

²⁶ Ibrahim Džananović, po aty, fq. 71.

²⁷ Imam Ebu Hanife, El-Fikh'ul-ekber - Thelbi i besimit islam, Prizren, 2005.

²⁸ Shibli Nu'mani, Ebu Hanifja, po aty, fq. 115.

IX. NË VEND TË PËRFUNDIMIT

Kur dëgjojmë debate apo kur lexojmë shkrime rreth ekzistimit apo rreth mosekzistimit të medhhebeve në historinë myslimane, nuk mund të qëndrojmë indiferent karshi porositë të dëmshme dhe kërcënuese që bartin individët e tillë. Nuk mendojmë se mjetet efikase për t'u përgjigjur janë antiporositë në mënyrë euforike dhe të pamatura, por angazhimi serioz intelektual, i bazuar në shkencë dhe mendje të shëndoshë, në frymën e bazave të fesë islame. Porositë e tilla vijnë nga qarqe të skajshme dhe fanatikët e tyre, ndaj dhe të tillët duhen izoluar, me mjete intelektuale. Publikimi i veprave klasike myslimane dhe interpretimi i tyre bashkëkohor është një mjet mjaft efikas, qoftë nëpërmjet ligjëratave të drejtpërdrejta, qoftë nëpërmjet shkrimeve në revista, vepra të veçanta apo në mjetet elektronike.²⁹

Kritika është e shëndoshë dhe ajo duhet të ekzistojë, por kritikizmi është rezultat i emocioneve dhe subjektivitetit, me synim të denigrohet autoriteti i caktuar intelektual e njerëzor, dhe jo mendimi i tij. Ixhtihadi i nënshtrohet revidimit nëse edhe ixhtihadi i ri, sikurse edhe ai i vjetri, është rezultat i punës së palodhshme nga ekspertët, nëse ekziston bashkëpunimi me ekspertë të tjerë të fushës dhe synimi i pastër për të arritur deri te zgjidhjet e nevojshme për kohën dhe mjedisin e caktuar.

²⁹ Një vepër e mirë si të bashkëpunohet ndërmjet grupeve të ndryshme është: Kutb Mustafa Sano, Parimet e bashkëpunimit ndërmjet medhhebeve islame, Logos-A, Shkup, 2014.

X. Literatura

1. Abdulkerim Zejdan, El-Med'halu li diraset'ish-sheriat'il-islamij-jeh, botimi IV, Aleksandri, Egjipt, pa vit botimi.
2. Abdurrahman ibn Jusuf, Provat kyçe të fikhut hanefi, Logos-A, Shkup, 2016.
3. Almir Fatić, Zašto Mezhebi?, në:
<https://hanefijskimezheb.wixsite.com/bosna/single-post/2017/05/04/ZASTO-MEZHEBI-Fatic-Islam-kao-vjera-jed-an-ali-razumijevanje-practiciranje-i-tumacenje-vjere-moze-biti-razlicito>.
4. Ebu Hamid El-gazali, Mjerilo djela, Sarajevë, 2005.
5. Ibrahim Džananović, Idžtiħad u prva četiri stoljeća islama, Sarajevo, 1995.
6. Imam Ebu Hanife, El-Fikh'ul-ekber - Thelbi i besimit islam, Prizren, 2005.
7. Imam Gazaliu, Mizan'ul-amel, përgatiti Sulejman Dunja, botimi I, Kajro, 1964.
8. Isa Memishi, Fjalor Arabisht-shqip, I, Logos-A, Shkup, 2014.
9. Kutb Mustafa Sano, Parimet e bashkëpunimit ndërmjet medhhebeve islame, Logos-A, Shkup, 2014.
10. Muhammed Ali Es-Sajis, Historia e legjislaturës dhe jurisprudencës islame, Logos-A, Shkup, 2013.
11. Muhammed Ikbali, Ripërtëritja e mendimit fetar në Islam, Logos-A, Shkup, 2006.
12. Mustafa Seid El-Xhinn, Ether'ul-ihtilafı fi'l-kavaid'il-usulijjeti fi ihtilaf'il-fukahai, botimi IV, Bejrut, 1985.
13. Nexhat Ibrahim, Fjalor Enciklopedik Islam, Logos-A, Shkup, në proces botimi, zëri "Medhheb".

14. Nexhat Ibrahim, Islami dhe myslimanët në tokat shqiptare dhe në Ballkanin mesjetar (shekujt IX-XIV), Logos-A, Shkup, 2003.
15. Nexhat Ibrahim, Shkolla juridike hanefite dhe karakteristikat themelore të doktrinës së saj, Prizren, 2000.
16. Nexhat Ibrahim, Zhvillimi i sekteve në historinë e mendimit islam, Tetovë, 2006.
17. Subhi Salih, Mebahithu fi ulum'il-Kur'an, botimi V, Bejrut, 1968.
18. Subhi Salih, Ulum'ul-hadith dhe mustalehuhu, botimi XIII, Bejrut, 1981.
19. Shibli Nu'mani, Ebu Hanifja, - jeta dhe vepra, Logos-A, Shkup, 2015
20. Thomas W. Arnold, Historia e përhapjes së Islamit, Prishtinë, 2004.
21. Vehbi Sulejman Gavoçi, Ebu Hanife - Nu'man bin Thabit, juristi i juristëve islamë, pa vend botimi, 2013.

Dr. Ajni SINANI

KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË SË DREJTËS ISLAME

Njeriu është uniteti i trupit dhe i shpirtit. Zhvillimi i jo-ekuilibruar i trupit dhe i mendjes çon në çrregullim të ekuilibrit, pasojat e të cilit mund të jenë fatale për qytetërimin. E drejta islame i vuri theksin kreativitetit të të drejtave dhe të detyrimeve: jo vetëm të marrëdhënieve ndërmjet njerëzve, por edhe raportit të njeriut me Krijuesin e tij. Të flitet ekskluzivisht për “të drejtat e njeriut” pa theksuar njëkohësisht edhe detyrat e tij, prej tij mund të bëhej vetëm një kafshë e egër, një ujë ose një djall.¹

Karakteristikat themelore të së drejtës së sheriatit janë: sakraliteti (shenjtëria), përsosja dhe universaliteti.

Sakraliteti vërehet në burimet dhe sanksionet e tij. E drejta islame është me origjinë hyjnore. Sanksionet nënkuptojnë

¹ **Hamidullah, Muhammed**, *Uvod u islam*, op. cit., f. 132.

ndëshkimin në këtë botë dhe në botën e ardhshme. Nga kjo, është nxjerrë një përfundim i qartë se në Islam praktikisht nuk ka dallim mes fesë dhe ligjit. Prandaj, parimi i sakralitetit mund të korrigjohet me parimin e plotësisë, duke pasur parasysh se realizohet gjithëpërfshirja maksimale e të drejtave nga ana e fesë.

Përsosmëria shihet në origjinën e saj hyjnore, gjë që e bën atë të pagabueshme dhe të drejtë të vetme. Përveç kësaj, e drejta islame synon mënyrën e detajizuar të rregullimit të marrëdhënieve, gjë që çon në faktin se ka pak gjëra në shoqëri që nuk mund t'i nënshtrohen Sheriatit.²

Universaliteti nënkupton që e drejta e Sheriatit me buri-
met e saj është aq e konceptuar saqë nuk ka kurrfarë penge-
sash për t'u zbatuar edhe për jomyslimanët dhe jo vetëm për
myslimanët. Ajo është e vlefshme përgjithmonë, në çdo kohë
dhe hapësirë.

Dallimi midis së drejtës islame dhe asaj prejnjerezore

E drejta islame bazohet në shpalljen e Zotit, ndërsa të drejtat njerëzore janë të rrënjosura në jetën dhe vetëdijen njerëzore. Juristi Mevlana Islahi rendit ndryshimet midis këtyre dy të drejtave. E para, sipas së cilës dallohet Sheriati nga të gjitha ligjet prejnjerezore është se ai është hyjnor. Kur e the-

² **Begović, Mehmed**, op. citatum, f. 23-25, shih: **Andrić, Milan**, *Osnovi šerijatskog prava*,
http://www.ceir.co.rs/images/stories/rit_06/rit_6_osnovi_serijatskog_prava.pdf

mi këtë, atëherë ne kuptojmë dy gjëra: origjinën hyjnore³ dhe qëllimin hyjnor të tij.⁴

1. Statusi ligjor i së drejtës njerëzore varet nga fakti nëse ajo gëzon apo jo sanksionimin e shoqërisë njerëzore të organizuar. Nëse nuk ka sanksionim, një tërësi e tillë normash nuk e gëzon statusin e ligjit. Statusi ligjor i së drejtës islame nuk varet nga ky faktor. Sheriati është Ligji që vjen nga Zoti. Dhe nëse disa pjesë të shoqërisë njerëzore nuk e zbatojnë atë, me këtë nuk e dëmtojnë statusin e së drejtës islame, por i sjellin dëm vetes së tyre: ***“Edhe pasuesit e Inxhilit le të gjykojnë siaps asaj që ka shpallur Allahu në të. Ata që nuk gjykuan sipas asaj që ka shpallur Allahu, ata janë njëmend gjynahqarë.”*** (El Maide: 47)
2. E drejta njerëzore nuk është e lidhur me fenë dhe nuk ka ndonjë karakteristikë të shenjtërisë. Ndërsa e drejta islame është pjesë themelore e besimit të çdo myslimani dhe konsiderohet e shenjtë. Myslmani e di se Sheriati vjen

³ Origjina hyjnore kuptohet në mënyrë të tillë që rregullat dhe parimet e Sheriatit nuk janë produkt i një njeriu, i cili është subjekt i defekteve dhe dobësive, faktorëve ndikues të kohës dhe mjedisit, situatave dhe kulturës, ndikimeve të trashëgimisë, temperamentit, pasionit dhe sentimentalizmit. Jo, themeluesi i tij, Ligjvënësi është Ai që krijon dhe të Cilit i bindet gjithçka në kozmos - Zot i gjithçkaje që bën kozmosi dhe çfarë është në të. Ai që krijoi njerëzit dhe që e di më së miri se çfarë është e dobishme dhe e përparimtare për ta, çfarë është e mirë për ta dhe çfarë i bën ata të mirë: *“A nuk e di Ai i cili e ka krijuar dhe që njeh cdo send me hollësi!?”* (El Mulk, 14). Shih: **El Kardavi, Jusuf, Islamsko pravo**, Sarajevo, 1989, f. 16.

⁴ Qëllimi hyjnor do të thotë se qëllimi i të gjitha normave të tij është arritja e lumturisë së njeriut. Dispozitat e këtij ligji hyjnor janë ngulitur thellë në zemrat e myslimanëve. Të gjitha dispozitat, parimet dhe orientimi i tij përshkrohen dhe frymëzohen nga humanizmi universal, sepse ai është mirësi e Zotit ndaj botëve dhe të gjithë njerëzve. **Ibid, f. 16.**

nga Allahu i Lartësuar dhe se kënaqësia e Tij nuk mund të arrihet pa zbatimin e Ligjit të Tij.

3. Roli i së drejtës njerëzore është i vendosur në mënyrë negative: ajo duhet të parandalojë agresionin dhe tiraninë e njeriut mbi njeriun. Qëllimi i së drejtës islame është të udhëheqë dhe ta ndriçojë njeriun në jetën e tij. Prandaj, ajo përmban forma të respektit për Zotit, norma të nevojshme për të arritur pastrimin njerëzor.
4. E drejta njerëzore e ka burim në zakonet dhe konventat shoqërore. Nuk ka lidhje midis së kaluarës dhe të ardhmes. Ndryshe nga kjo, e drejta islame bazohet në shpalljen e Zotit dhe universalitetin e natyrës njerëzore. Zakonet dhe konventat luajnë një rol të kufizuar, kurse marrëdhëniet midis së kaluarës dhe të tashmes janë të ruajtura.⁵

Shumë herë, Sheriatit i jepet një kuptim i ngushtë, kështu që përdoret për ato dispozita që rregullojnë marrëdhëniet në bashkësinë islame dhe shtrihen në veprat dhe veprimet e njerëzve dhe jo në anën shpirtërore dhe në besimin e tyre. Prandaj, Sheriati nënkupton tërë sistemin ligjor, i cili, është vendosur me besimin islam.⁶

M. Islahi e ekspozon natyrën e ndryshimeve në strukturën e së drejtës islame. E drejta njerëzore ndryshon bashkë

⁵ **Islahi, Amin Ahsan**, shih: *Šerijat, bilješke uz jedno novo djelo o islamskom pravu*, Karčić, Fikret, Islamska misao, Godina IV, broj 44, Avgust, 1982, Sarajevo, f. 49.

⁶ Shih: Parathënien e librit H. Muradbegović, *Tumač šerijatskih propisa*, sipas **Latić, Džemalutin** i **Seid Smajkić**, *Šerijat i njegov današnji značaj za Bošnjake*, Glasnik Rijaseta Islamske zajednice u Bosni i Hercegovini, broj 1-2, Januar-februar, 1997, Sarajevo, f. 50.

me ndryshimet shoqërore. Nga ana tjetër, e drejta islame nuk u nënshtrohet tërësisht ndryshimeve të rrethanave sociale.

Në Islam, ndryshimet shoqërore i nënshtrohen së drejtës, edhe pse ka elemente të së drejtës që ndryshojnë me ndryshimin e vendit dhe të kohës. Kjo natyrë unike e bën të drejtën islame njëkohësisht statike dhe dinamike, konservatore dhe progresive. Ajo inkurajon përparimin në shoqëri, por në të njëjtën kohë vepron si kujdestarja e saj.⁷

Dallimi midis së drejtës islame dhe asaj romake

E drejta romake rrjedh nga kultura pagane, ndërsa e drejta islame buron nga Kurani fisnik.⁸ Ekspertët e së drejtës kur krahasojnë Sheriatin dhe të drejtën romake nxjerrin në pah se e drejta romake “filloi nga zakonet dhe u zhvillua nëpërmjet procedurave gjyqësore dhe procedurale”. Kurse, Sheriati “fillon nga burimet e tij bazike, Kuranin dhe Synetin dhe zhvillohet nëpërmjet analogjisë logjike dhe dispozitave objektive.”⁹

E drejta te romakët është shprehje e vullnetit të popullit, vullnetit të njeriut, ndërsa e drejta islame bazohet në vullnetin e Zotit, që i është shpallur Pejgamberit a.s.. Duhet theksuar se dallimi thelbësor midis sistemit juridik islam dhe atij romak rrjedh nga fakti që baza e fikhut është besimi në Zotin. Një e të Vetëm, kurse e drejta romake bazohet në besimin

⁷ **Islahi, Amin Ahsan**, shih: *Šerijat, bilješke uz jedno novo djelo o islamskom pravu*, Karčić, Fikret, Islamska misao, op. cit., f. 49.

⁸ **Ebu Zehra, Muhammed**, *Marrëdhëniet ndërkombëtare në Islam*, Shkup, 2013, f. 16.

⁹ **El Kardavi, Jusuf**, *Islamsko pravo*, op. cit., f. 82.

dhe fenë poligamiste. Nga kjo bazë, dalin dhe rezultojnë dallimet në çështje të shumta midis këtyre dy sistemeve.¹⁰

Pra, ekzistojnë dallime thelbësore midis së drejtës islame dhe asaj romake. Sa i përket kuptimit të së drejtës: romakët e quajnë të drejtën e tyre *ius*, që do të thotë “e drejtë”, ndërsa myslimanët e quajnë të drejtën e tyre *fikh*, që do të thotë “njohuri, mirëkuptim” (dija për të drejtat dhe obligimet e një personi, siç e ka definuar Imam Ebu Hanife).

Në paraqitjen e dispozitave praktike në koleksionet juridike: romakët i ndajnë librat e tyre në tri pjesë: persona, gjëra dhe padi, ndërkohë që avokatët myslimanë i ndanë veprat e tyre në kapitujt e ibadetit (ritualet-adhurimet), muamelat (marrëdhëniet shoqërore) dhe ukubat (ndëshkimet).¹¹

Lidhur me mundësinë e ndikimit të së drejtës romake mbi fikhun, nuk përmendet ekzistenca e njohësve të së drejtës romake në mesin e bashkëkohësve dhe pasuesve të Pejgamberit

¹⁰ **Hamidullah, Muhammed**, *Uticaj rimskog prava na fikh*, Islamska misao, godina V, broj 57, Septembar 1983, Zul-ka'de – Zul-hidždže, 1403, Sarajevo, str. 15.

¹¹ Dispozitat të cilat përcaktohen me emrin e drejta romake nuk janë vetëm me prejardhje romake. Autori anglez (Post) në hyrje të veprës *Institucionet e Gajit* (f. 24-25) thotë: "E drejta romake edhe më do të ishte në thjeshtësi e pazhvilluar, sikur të mos vinte në kontakt me viset lindore". (Po aty, f. 15.) E drejta romake ka pësuar ndikim të Afrikës Veriore, Sirisë dhe Azisë së Vogël. Shkëncëtari francez Collinet dhe të tjerë, pas verifikimit të mundimshëm, arritën në përfundim se e drejta e cila quhet romake, në fakt, ka qenë nën ndikimin e vendeve lindore. Përveç kësaj edhe Gaj, juristi më i madh romak, ka qenë me prejardhje nga Lindja-Azia e Vogël. Shih: **Hamidullah, Muhammed**, *Uticaj rimskog prava na fikh*, Islamska misao, Ibid str. 15; Karçiç, Fikret, Studime për të drejtën e Sheriatit dhe institucionet, shih: Muhammed Hamidullah, Ndikimi i së drejtës romake mbi fikhun, Logos Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2015, f. 361

a.s.. Në bazë të kësaj, thënë më së buti, hedhim poshtë pohimin se një pjesë e fikhut e nxjerrë nga Kurani dhe Hadithi ka pasur çfarëdolloj ndikimi nga e drejta romake.¹²

Fikhu dhe kanuni

Fikhu është e drejtë që zbatohet ndaj myslimanëve pa kufizime hapësinore dhe kohore. Kanunet nuk duhet të jenë në kundërshtim me fikhun, ato kanë karakter lokal. Kanunet i lëshojnë sundimtarët myslimanë që mund t'i ndryshojnë sipas kushteve, duke pasur parasysh dinamizmin e zhvillimit të marrëdhënieve dhe rendit shoqëror midis njerëzve.

Për këtë arsye nuk mund të identifikojmë fikhun dhe kanunin, sepse kanuni është i përkohshëm dhe i karakterit lokal, do të thotë që zbatohet vetëm në territorin e një shteti apo province që e ka lëshuar. Kanuni mund të quhet e drejtë profane, kurse fikhu e drejtë sakrale/fetare.¹³

E drejta që mund të gjendet në veprat klasike nga sfera e fikhut, që në dekadat e mëparshme është zhvilluan pavarësisht, pa ndërhyrjen e shtetit, është quajtur *e drejtë e sheriatit*, kurse ajo që është formuar me urdhrat e sulltanit dhe të fermanëve, është emërtuar *e drejta zakonore*. Kështu që e drejta osmane në bazë përbehet nga sheriatit dhe zakonet. E drejta

¹² *Uticaj rimskog prava na fikh*, Islamska misao, Ibid, f. 13.

¹³ **Mehmed Begović**, *Šerijatsko bračno pravo (sa kratkim uvodom u izučavanje šerijatskog prava)*, Beograd, Izdavačko i knjižarsko preduzeće "Geca Kon" A.D., 1936, str. 4, shih: **Džananović, Ibrahim**, *Idžtihad u prva četiri stoljeća islama*, Sarajevo, 1986, f. 11.

zakonore është zhvilluar gjatë kohës krahas me të drejtën e Sheriatit.¹⁴

Ndryshe nga e drejta e sheriatit që u zhvillua me anë të interpretimit juridik të burimeve të Sheriatit, e drejta zakonore u formua në një mënyrë krejt ndryshe.

Shteti nuk ka pasur një rol të madh në zhvillimin e doktrinës të së drejtës sheriatike, për dallim nga e drejta zakonore e njohur si *urfosmani*, e cila u bë me anë të sjelljes së dekretëve të ndryshme nga ana e sulltanëve osmanë.

Miratimi i ligjeve të bazuara në të drejtën zakonore rrjedh nga fakti se e drejta e Sheriatit ia njeh të drejtën sundimtarit që me anë të *sijasei-šer'ijes* të rregullojë ato çështje që nuk janë rregulluar me dispozitat e Sheriatit.¹⁵

E drejta zakonore është formuar sipas ligjeve të cilat i sollën sulltanët dhe jo nëpërmjet interpretimeve shkencore të juristëve. Zakonet që ka sjellë sulltani, në parim, ishin të vlefshme aqsa ishte ai sulltan në pushtet.

Gjatë zhvillimit të tyre, janë marrë parasysh traditat dhe zakonet ekzistuese, si dhe kushtet lokale, veçanërisht në lidhje me të drejtën e tokës dhe të taksave.

Arsyeja kryesore që sulltani të sjellë zakone dhe që ato të përmbliidhen përgjithësisht në *kanunname*, ishte që të pengohet dhënia me dashje (subjektive) e dënimeve nga ana e ushtarakëve dhe e administratorëve të tyre, si dhe vendosja e

¹⁴ *Historija Osmanske države i civilizacije I*, pergatiti: **Ihsanoglu, E.** (Ekmeledin), Orijentalni institut u Sarajevu, Sarajevo, 2004, f. 516.

¹⁵ **Kazanović, Husein**, *Dvije kodifikacije šerijatskog porodičnog prava*, El Kalem, Sarajevo, 2012/1433, f. 55.

taksave dhe grumbullimi i dënimeve me para, sipas hamendjes vetanake dhe sjelljeve të ngjashme.¹⁶

Kanunnama (*kanunname*) është një shprehje që, në përdorimin osman, nënkuptonte në përgjithësi urdhrin e sulltanit, i cili përmbante dispozita ligjore për një çështje të caktuar. Kanunnama i ngjante çdo kanuni normal në kuptimin që urdhri i Sulltanit mund t'i jepte asaj forcën e ligjit.¹⁷

Kanunnamet, dekretet e sulltanit, mbulonin fushën e së drejtës publike, organizatat dhe administratën shtetërore, sistemin tatimor të së drejtës penale dhe *hisben*. Aktet ligjore që përmbanin dispozita për veprimet politike quheshin *sijaset-name*, kurse ato që rregullonin mbledhjen e taksave, organizimin qeveritar, të drejtat e statusit dhe të ngjashme, u quajtën *kanunname*.¹⁸

E drejta zakonore nuk është një e drejtë për traditën dhe zakonet. Normat e së drejtës zakonore janë vendosur në mënyrë të tillë që të marrin parasysht, më së paku, traditën dhe zakonet, shprehitë ekzistuese në lidhje me disa fusha të caktuara të së drejtës.

Ajo që i ka transformuar të gjitha këto parime ligjore në norma që duhen zbatuar në gjykata, nuk ishte të bazuarit e tyre mbi traditën dhe zakonet, por mbi vullnetin e sulltanit dhe të fermanëve të tij.¹⁹

¹⁶ *Historija Osmanske države i civilizacije I*, op. cit., str. 520-521.

¹⁷ **Smailagić, Nerkez**, *Leksikon islama*, op. cit., str. 12.

¹⁸ **Kazanović, Husein**, Dvije kodifikacije šerijatskog porodičnog prava, op. cit., str. 56.

¹⁹ *Historija Osmanske države i civilizacije I*, op. cit., str. 517.

Ejup HAZIRI

KARAKTERSTIKAT E SHKOLLËS HANEFITE

Hyrje

Në këtë punim do të hedhim dritë rreth karakteristikave kryesore të shkollës hanefite, që e karakterizojnë këtë shkollë nga shkollat e tjera. Ndonëse ka shumë karakteristika dhe është e pamundur të përfshihen të tëra ato brenda një punimi të tillë, mirëpo, jam mjaftuar me shpjegimin e disa prej tyre që i kam parë më të arsyeshme dhe më të rëndësishme. Për shkak se kjo shkollë është keqkuptuar, shpeshherë edhe qëllimshëm nga individë kundërshtarë të saj, ndonëse edhe është organizuar një betejë e gjatë kundër saj, është e natyrshme që të hedhim dritë më tepër rreth saj për të parë se çfarë na tregon realiteti për këtë shkollë, e cila përgjatë shumë shekujve ishte pjesë e zbatimit dhe aplikimit nga vetë shteti islam ku ai dominonte.

Themeluesi i saj takoi gjeneratën e sahabëve

Ndonëse Ebu Hanife njihet si themelues i shkollës hanefite, atributi u përket nxënësve të tij, sepse ata bartën mësimet e tij dhe ndikuan që të themelohet shkolla juridike hanefite.

Ebu Hanife i takon gjeneratës së sahabëve, ngase ai arriti kohën e tyre. Polemika në këtë aspekt nuk është se a takoi ndonjë sahab apo jo, mirëpo polemika është se sa sahabë i takoi. Përfundimisht, ai arriti kohën e tyre dhe në këtë kontekst ai është një hap para tre imamëve të njohur, që më vonë do të njihen si themelues të medhhebeve. Ka mendime se ai takoi më tepër se një nga shokët e të Dërguarit të Allahut, mirëpo, në bazë të hulumtimeve dhe shkrimeve që janë bërë në këtë kontekst, del se Ebu Hanife takoi sahabiun e shquar Enes ibn Malik,¹ me se edhe përfundimisht i takon gjeneratës së tabiinëve.²

Ebu Jusufi përcjell fjalët e Ebu Hanifes: “Kam dëgjuar Enes ibn Malikun duke thënë: “Treguesi për mirësi është si-kurse vepruesi i saj””. Thuhet se Ebu Hanife me Enes ibn

¹ Sujutiu, Mekkiu dhe Kerderiu të cilët konsiderohen si njohës të mirë të biografisë së jetës së Ebu Hanifes, me ç’rast kanë shkruar edhe monografi për të, kanë përmendur transmetime se ai ka takuar më tepër se një sahabij. Ata kanë përmendur edhe emra të sahabijve të cilët i ka takuar Ebu Hanife, si p.sh.: Enes ibn Malik, Abdullah ibn el-Harith ibn Xhez’i Ez-zubejdi, Vathileh ibn el-Eska’, Aisheh bintu Ixhred, Abdullah ibn ebi Evfa, Amër ibn Harith, Ebu-t Tufejl Amir ibn Vathileh, Sehl ibn Sa’d. Shih edhe: Ahmed Seid Havva, *El-Med’hal ila Medhhebil imam Ebi Hanifeh En-Numan*, bot. I-rë, Dar el-Endelus el-Hadra, Xhide-Arabia Saudite, 2002, f. 35.

² Tabii sipas muhadithologëve është ai person që takoi ndonjërin prej sahabijve, pa marrë parasysh a e shoqëroi atë dhe a dëgjoi (transmetoi) prej tij. Sujuti, *Tedribu-rr-Rravi*, v.II, f.206.

Malikun ishte takuar në vitin 95 (apo para tij) dhe kishte dëgjuar prej tij.³ Enes ibn Maliku ishte shërbyesi i të Dërguarit të Allahut dhe një sahab i shquar. Dhehebiu në këtë kontekst thotë: “Enes ibn Maliku, ai është imami, myftiu, lexuesi i Kuranit, muhaddithi, transmetues i Islamit, shërbëtor i të Dërguarit të Allahut...sahabi i fundit që vdiq”.⁴ Ai ishte pjesëmarrës i Bedrit, ndonëse ishte fëmijë i vogël. Ai nuk mori pjesë direkte në betejë, por ai i ndihmonte të Dërguarit të Allahut. Që nga koha kur i Dërguari i Allahut bëri hixhretin, Enesi e shoqëroi atë pandërprerë. Ai shprehet: “Erdhi i Dërguari i Allahut në Medinë e unë kisha dhjetë vjet, vdiq i Dërguari i Allahut e unë kisha njëzet vjet. U inkurajova të jem në shërbim të të Dërguarit të Allahut.” Sulejman et-Temimi kishte thënë: “E dëgjova Enes ibn Malikun tek thoshte: “Nuk ka mbetur askush prej atyre që u falën në drejtim të dy kibleve përveç meje!” Ndërsa el-Muthla ibn Seidi rrëfen ta ketë dëgjuar Enesin duke thënë: “Nuk kalon asnjë natë pa e parë në ëndërr të dashurin tim (Pejgamberin a.s.).”⁵

Nga kjo mund të konkludohet se Ebu Hanife u takoi gjeneratave të hershme dhe ka lidhshmëri me shokët e të Dërguarit të Allahut, sepse një apo më shumë prej tyre pati fatin t’i takonte dhe të dëgjonte prej tyre, qoftë edhe fjalë të pakta.

³ Sajmerij, *Ahbar Ebi Hanife ve Ashabuhu*, f. 18.

⁴ Dhehebiu, *Sijer A’lamun Nubela*, bot.III-të, Muessesetu Rrisaletu, 1985, v. III, f. 396.

⁵ Dhehebiu, *Sijer A’lamun Nubela*, v. III, f. 398-400.

Shkollë e nxënësve të sahabëve

Është gabim i madh të thuhet se Ebu Hanife solli një shkollë të re me mendime krejtësisht të reja e të panjohura më parë në atë shoqëri. Ebu Hanife u bazua kryesisht në opinionet e sahabëve dhe tabiinëve të njohur që ishin juristë të dëshmuar. Ai dha opinione personale vetëm në mungesë të tyre nga ulemaja e mëhershme. Ai që bazuar kryesisht në opinionet e sahabëve të përzgjedhur siç ishin: Omeri, Aliu, Abdullah ibn Mesudi dhe Abdullah ibn Abasi. Këta janë sahabët e hershëm që ishin pranë të Dërguarit të Allahut në çdo çast e rast dhe po këta e njihnin shumë mirë Islamin, sepse kishin hyrë herët në Islam dhe ishin protagonistë të shumë ngjarjeve që e karakterizuan Islamin që nga ditët e hershme të tij.

E kur që pyetur Ebu Hanife se nga i mori këto mësimë, ai që përgjigjur shkurt: “E mora fikhun e Omerit, fikhun e Abdullah ibn Mesudit dhe fikhun e Abdullah ibn Abasit përmes nxënësve të tyre.”⁶ Këta tre ishin prej sahabëve të shquar, duke shtuar edhe Aliun e që të gjithë e përbëjnë katrën e fuqishme të opinioneve të jashtëzakonshme. Që të gjithë këta ishin nga plejada e njohur e sahabëve dhe të mirënjohur në opinione e mendime personale e kolektive. Të tjerët, jepnin opinione vetëm në mungesë të tyre. Prandaj, nuk është e çuditshme aspak se përse Ebu Hanife bazohej në opinionet e tyre, ngase ata përfaqësonin më së miri shkollën dhe mendimet e vetë të Dërguarit të Allahut, sepse ishin protagonistë në shumicën e ngjarjeve të dy dekadave të shpalljes dhe misionit të të Dërguarit Muhamed a.s..

⁶ El-Haxheh Nexhah el-Halebij, Fikhu-l Ibadat ale-l medhhebi-l hanefij, f.6.

Gjatë kohës së Omerit, përderisa ishte udhëheqës i besimtarëve dhe shumë vende të reja i ishin bashkangjitur shtetit islam, saqë ummeti islam kishte përjetuar një ekspansion të gjerë dhe të papërshkruar, ai në Kufë do ta dërgonte njeriun që kishte mbushur shtresat e tokës me dije. Omeri e dërgoi pikërisht Abdullah ibn Mes'udin në Kufë, në mënyrë që ai t'ua mësonte njerëzve fenë, ndonëse ashtu siç kishte deklaruar vetë Omeri, kishte nevojë për një dijetar të kalibrit të Abdullah ibn Mesudit që ta kishte pranë vetes. Në momentin kur Omeri e dërgoi Abdullah ibn Mes'udin mësues (mual-lim) dhe ministër (vezir) dhe Ammar ibn Jasirin guvernator (emir), popullit të Kufës u shkroi: “Unë kam dërguar tek ju Ammar ibn Jasirin guvernator dhe Abdullah ibn Mes'udin mësues dhe ministër, ata dy janë nga elita e zgjedhur e shokëve të të Dërguarit të Allahut dhe nga ata që dëshmuuan në Bedër, andaj pasoni ata, bindjuni atyre dhe dëgjoni fjalët e tyre...”⁷

Abdullah ibn Mesudi ishte në dhjetën e parë që pranuan Islamin, madje ai vetë ishte shprehur: “...jam i gjashti në renditje nga ata që pranuan Islamin, në kohën kur mbi sipërfaqen e tokës nuk kishte myslimanë përveç nesh.”⁸

U edukua në shtëpinë e Pejgamberit a.s., u udhëzua sipas udhëzimit profetik, ndjeku dhe pasoi të gjitha veprimet dhe veçoritë e të Dërguarit gjersa për të u tha: “Njeriu më i afërt me Pejgamberin për nga udhëzimi dhe vlerat morale.” Ai u edukua në shkollën profetike, ndaj ishte njëri nga njohësit më

⁷ Ibn Sa'd në Tabekat, 6/7-8; Hakimi në Mustedrek, v. III, f. 438, nr. 5663, i cili thotë se është autentik e që është pajtuar plotësisht edhe Dhehebiu.

⁸ Dhehebiu, *Sijer A'lamun Nubela*, bot.III-të, Muessesetu Rrisaletu,1985,v. I, f. 464.

të mëdhenj të Kuranit, më i dituri për kuptimet e tij dhe më i njohuri për ligjin e Zotit.⁹ Ishte recitues i njohur i Kuranit, saqë i Dërguari i Allahut dëgjoi Kuran prej tij, gjë që ishte e pazakontë për të Dërguarin e Allahut të dëgjonte Kuran nga të tjerët, madje përderisa dëgjonte Kuran prej tij, lotët e përshkonin fytyrën e tij të bukur. I Dërguari i Allahut për të qe shprehur: “Ai që dëshiron të lexojë Kuran ashtu siç është zbritur, le të lexojë sikur leximi i Abdullah ibn Mesudit.”¹⁰ Për dituritë e tij rreth Kuranit, protagonistin në fjalë qe shprehur: “Pasha Allahun përveç të Cilit tjetër s’ka, nuk ka zbritur ndonjë ajet nga libri i Allahut e që unë mos ta di ku ka zbritur dhe për çfarë ka zbritur, sikur ta dija se ndokush është më i ditur se unë rreth librit të Zotit, po të jetë e mundur arritja tek ai, do të shkoja.” Kjo tregon më së miri se Abdullah ibn Mesudi ishte njohës i mirë i fesë. E si të mos ishte kur ai thuajse krejt rrugëtimin e kishte bërë pranë dhe me të Dërguarin e Allahut, gjegjësisht pranë shpalljes.

Një ditë Omeri po e shikonte atë nga vinte dhe i tha: “Er-dhi i stërmbushuri me dituri.”¹¹ Imam Aliu kur qe pyetur për Abdullah ibn Mes’udin, qe përgjigjur: “Njohësi i Kur’anit dhe sunetit.”¹²

Abdullah ibn Mes’udi me të shkuar në Kufe, ia filloi misionit të tij në kultivimin e shkencës së mirëfilltë Islame dhe

⁹ Abdurrahman Rafet el-Basha, *Suver min Hajati-s Sahabeh*, bot.I-rë, Dar el-edebul Islami, 1997, f.101-102.

¹⁰ Taberaniu në *Mu’xhemul Kebir*, nr. 8338; Ibën Huzejme në *Sahih*, nr. 1156; Tahaviu në *Mushkilul Athar*, nr. 5593.

¹¹ Zerkelij, *El-A’lam*, daru- l-ilm lil melajine, bot.XV-të, 2002, v.IV, f.137-138.

¹² Ibnul Xhevzi, *Sifetu-s-Safvetu*, v.I, f.401.

përreth tij tuboheshin grupe të shumta nxënësish që merrnin dituritë nga njëri prej shokëve më të shquar të të Dërguarit të Allahut e i cili ishte thujasë gjithnjë pranë të Dërguarit. Abdullah ibn Mes'udi konsiderohet njëri ndër personalitetet më të mëdha në edukim dhe njëri prej atyre që ka lënë gjurmë të pashlyera në edukimin e brezave të rinj dhe në përhapjen e traditës profetike. Ai qëndroi një kohë aty para se të kthehej përsëri në Medinë. Por, para se të largohet nga Kufa, ai la pas vete plejadë dijetarësh që u edukuan prej tij, të cilët morën mësimet të rëndësishme nga libri i Allahut, suneti i Resulullahut dhe thellimi në fe. Këta morën flamurin e dijes, fikhut dhe fetvave në Kufe.¹³

Banorët e Kufës në veçanti dhe ata të Irakut në përgjithësi, patën fatin që të jenë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në tubimet e dijes nga Abdullah ibn Mes'udi. Numri i atyre që prezantonin në tubimet e tij të dijes ka qenë jashtëzakonisht i madh dhe sipas disa transmetimeve ai numër kalon shifrën prej 4000 nxënës.

Nga nxënësit më të shquar dhe më të dalluar të Abdullah ibn Mes'udit ishte Alkame ibn Kajs Nehaiu, Harithi, Mesruk ibn Exhda', Amër ibn Shurahbil el-Hemdani (Ebu Mejsere), El-Esved, Abideh, Harith ibn Kajs, Shurejh el-Kadi dhe shumë të tjerë, por, i pari prej tyre ishte më i njohuri dhe mori dituri të shumta në fikh dhe hadith dhe nga ai dolën shumë juristë.¹⁴

¹³ Hatib, *Te'rihu Bagdad*, v. XII, f. 299; Dhehebiu, *Sijer A'lamun Nubela*, v. IV, f. 56.

¹⁴ Ibn Haxher, *Tehdhibu-t Tehdhib*, v. IV, f. 168; Dhehebiu, *Sijer A'lamu-n Nubela*, v. IV, f. 64-57.

Shkollë e bazuar në Kuran dhe sunet

Janë përhapur informata të gabuara, sa të qëllimta e sa nga smira apo injoranca, se shkolla hanefite është shkollë e cila nuk bazohet në argumente nga Kurani dhe në sunetin e të Dërguarit të Allahut. Madje, zëra të tillë nuk ndalen me kaq, por guxojnë të provojnë edhe një hap tjetër e që, sipas tyre, kjo shkollë nuk qenka e bazuar në mendimet dhe opinionet e sahabëve.

Realiteti është krejtësisht i kundërt, ngase shkolla hanefite bazohet në rend të parë në librin e Allahut, Kuranin, e nëse aty nuk gjejmë argumente për filan çështjen, atëherë në rend të dytë vjen suneti i të Dërguarit të Allahut. Pas kësaj, në mungesë të teksteve kuranore dhe atyre profetike, Ebu Hanife dhe pasuesit e tij u drejtohen opinioneve të sahabëve. Madje, vetëm në mungesë të tyre u drejtohen opinioneve të tabiinëve.

E për këtë më së miri shprehet protagonistin në fjalë, Ebu Hanife, i cili ka thënë: “Marr nga libri i Zotit; nëse nuk gjej, atëherë nga suneti i Pejgamberit a.s.; nëse nuk gjej as në libër të Zotit e as në sunetin e Pejgamberit, marr nga opinionet (mendimet) e sahabëve nga cilido prej tyre dhe lë opinionin e cilitdo prej tyre e nuk dal jashtë opinioneve të tyre; nëse çështja përfundon tek Ibrahim Nehaiu, Ibn Sirini, Haseni, Atau, Ibn Musejebi, -përmendi edhe tjerë,- ata janë njerëz që kanë bërë ixhtihad, prandaj edhe unë bëj ixhtihad ashtu siç ata bënë ixhtihad.”¹⁵

¹⁵ Ebu Bekër Hatib el-Bagdadi, *Te'rihu Bagdad*, v.XV, f.504; Mustafa Sibai, *Es-Sunetu ve mekanetuha fit-teshriil Islamij*, Dar el-Verrak-el-Mektebul Islamij, pa vit botimi, f.438.

Kjo tregon më së miri bazat ku Ebu Hanife dhe shkolla e tij mbështeten dhe tregon edhe për nivelin e lartë të Ebu Hanifes në njohjen dhe diturinë e tij, sepse përderisa çështja përfundon tek tabiinët, atëherë Ebu Hanife ose e përzgjedh mendimin e ndonjërit prej tyre, ose vetë bën ixhtihad, ngase ishte i po të njëjtës kategori, përndryshe po të mos ishte në të njëjtën kategori nuk do të angazhohej për opinion personal, por do të merrte të gatshme opinionet e tjera.

Ebu Hanife e njihte mirë traditën profetike, madje kishte njohuri të mëdha edhe rreth klasifikimit të haditheve dhe përdorimit të tyre. Ngjarja në vijim do ta demonstrojë më së miri atë që e thamë sipër: Muhamed ibn el-Haseni thotë: “E kam dëgjuar Ebu Jusufin duke thënë: “Me Ebu Hanifen i diskutonim gjërat që kishin të bënin me kapituj të ndryshëm të diturisë. Kur ai e thoshte mendimin me të cilin pajtoheshim, unë dilja dhe i vizitoja dijetarët e Kufës që të gjeja ndonjë hadith apo thënie që do ta përforconte thënien e tij. Ndoshta gjeja dy apo tri hadithe dhe vija tek ai. Ndonjërin e pranonte e ndonjërin e refuzonte dhe thoshte: “Ky nuk është i vërtetë (sahih) apo nuk është i njohur (ma’ruf), edhe pse i përshtatej mendimit të tij. Kurse unë i thosha: “Prej nga e di këtë? Ai thoshte: “Unë jam i ditur falë diturisë së dijetarëve të Kufës.”¹⁶ Kjo tregon më së miri për kualifikimin e tij dhe njohjen e hadithit, përndryshe si do t’i dallonte se cili është i vërtetë e cili jo? Sigurisht se kishte njohuri të thella, përndryshe nuk do të kishte me mijëra nxënës që përcillnin me vëmendje të

¹⁶ Shibli Nu'man, *Ebu Hanifja-Jeta dhe vepra*, Logos-A, Shkup, 2013, f.284-285.

madhe se çfarë shpjegonte dhe si argumentone imami. Në këtë kontekst, përderisa Ebu Hanife shpjegonte meselet dhe i argumentonte ato me argumente nga Kurani, suneti dhe nga opinionet e sahabëve, Ebu Jusufi në fillet e tij si nxënës i Ebu Hanifes, dëgjonte me kujdes të duhur, ai regjistronte opinionet e Ebu Hanifes dhe mënyrën e argumentimit dhe shkante tek imami Ibn ebi Lejla dhe pyeste për të njëjtën çështje. Pastaj dëgjonte çështjen e elaboruar dhe të argumentuar nga vetë Ibn ebi Lejla. Ky i fundit kishte krijuar një emër dhe ishte një personalitet gjithnjë në rritje. Prandaj, Ebu Jusufi nuk e kishite të lehtë të përzgjidhte njërin prej tyre, mirëpo forca e argumentimit dhe mënyra e trajtimit të çështjeve nga Ebu Hanife do ta qetësonin zemrën e Ebu Jusufit dhe ky i fundit pa dyshim që e përzgjedhi Ebu Hanifen, jo për shkak se kishte afërsi më tepër nga ligjëratat, por Ebu Hanife ishte më argumentues dhe më i ditur.

Madje ai i ka dhënë prioritet hadithit të dobët para analogjisë (kijasit). E për këtë, Ebu Hanife, kishte deklaruar: “Pa-sha Allahun, po gënjejnë! Po na shpifin të gjithë ata që thonë se po e preferojmë analogjinë mbi sunnetin! A thua vallë është e nevojshme të merret dhe përdoret analogjia kur kemi tekste të qarta të hadithit?!¹⁷ Me këtë shpalos platformën e tij rreth sunetit, që nënkupton se ai parapëlqen sunetin para analogjisë, gjë për të kundërtën e së cilës ishte akuzuar nga armiqtë e tij dhe për këtë ende disa që nuk e njohin atë si duhet dhe nuk kanë lexuar sa duhet, e akuzojnë. Madje, siç

¹⁷ Ebu Zehre, f.273; cituar sipas Shefik Kurdiç, Ebu Hanife dhe namazi në medhehbin hanefi, f.67.

shprehet ai, përdorimi i analogjisë vlen vetëm atëherë kur ishte një gjë e tillë e domosdoshme: “Ne e kemi përdorur analogjinë vetëmse në domosdoshmëri edhe kjo në qoftë se nuk kemi gjetur asnjë argument nga Kurani, suneti dhe praktika e sahabëve.”

Ebu Hanife gjatë jetës së tij ka shqyrtuar çështje-mesele të shumta, saqë thuhet se numri i *meseleve* të shqyrtuara nga ai është 1 milion e dyqind e shtatëdhjetë mijë.¹⁸ Pra, për secilën çështje të re që dilte në shesh e nuk kishte tekst, qoftë nga Kurani apo suneti. Andaj, është e logjikshme që në shumë prej këtyre çështjeve-meseleve, në mungesë të argumenteve kuranore apo profetike, të ketë bërë *ixhtihad* për të arritur deri tek një vendim juridik, gjithnjë duke u bazuar në argumente apo duke bërë krahasime. Këtë e bënte vetëm atëherë kur mungonin tekstet për sfidat e reja, përndryshe përcillte *etheret* dhe opinionet e pararendësve të tij.

Në këtë kontekst, Ebu Zehre shprehet: “Opinionet e Ebu Hanifes, të cilat i bartën nxënësit e tij, pa argumente, ato s’mund të jenë ndryshe pos *ethere* të bartura gjeneratë pas gjenerate, opinione të njohura në shoqëri, bazimi në fetva të ndonjë sahabiu apo animi dhe përqafimi i mendimit të tabiinit e shumë pak përmendet kijasi (analogjia) dhe istihsani...”¹⁹

Ai përveçse e njihte mirë hadithin ai e dinte se ku ta përdorte atë dhe si të nxirrte prej tij dispozita të ndryshme. Kjo mund të ilustruhet më mirë edhe me shembullin në vijim:

¹⁸ Mustafa Sibai, *Es-Sunetu ve mekanetuha fit-teshriil Islamij*, Dar el-Verrak-el-Mektebul Islamij, pa vit botimi, f.440.

¹⁹ Ebu Zehre, Ebu Hanife –hajatuhu ve asruhu, arauhu ve fikuhu-, f.217.

Ubejdullah ibn Amër thotë: “Isha në shoqëri me el-A’meshin, kur i erdhi atij një njeri dhe e pyeti për një çështje juridike, e ai nuk mundi t’i përgjigjej. A’meshi shikoi, kur ja që ishte Ebu Hanifë, prandaj edhe i tha: “O Nu’man thuaj diçka për këtë çështje?! Ebu Hanife tha: “Kjo çështje është kështu (e tregoi).” A’meshi i tha: “Nga e nxore ti këtë përgjigje?” “Nga ky hadith, të cilin ti na ke treguar.”-, iu përgjigj Ebu Hanife. Atëherë A’meshi i tha: “Ne (hadithologët) jemi sikurse farmacistët, kurse ju fekihët jeni sikurse mjekët.”²⁰

Dhënia përparësi sahabëve muxhtehidë

Shkolla hanefite përveçse mbështetet në opinionet e sahabëve, ajo si e tillë karakterizohet edhe nga opinionet e sahabëve që ishin më të shquar në fe dhe të cilët kishin njohuri të thella në fe, siç ishin Omeri, Aliu, Abdullah ibn Mesudi dhe të tjerët. Kjo shkollë u jep përparësi më tepër sahabëve që ishin muxhtehidë, sikur ata që i kam cekur më herët e të cilët zotëronin dije të madhe, megjithëse në transmetime ata mund të jenë në numër më të vogël.

Për të qenë më objektiv dhe më të kapshëm për lexuesit, duhet të marrim ca shembuj në mënyrë që kjo çështje të kuptohet drejt. Ebu Hanife dhe juristët e shkollës juridike hanefite në çështje të cilat ka më shumë se një mendim, atëherë para vetes kanë vendosur rregulla, dy prej të cilave janë më të rëndësishme.

E para: Preferimi dhe zgjedhja e mendimeve nga sahabët të cilët ishin *muxhtehidë* (njohës të mirë të fesë), duke u

²⁰ Ibën AbdulBerr, *Xhami bejanu-l ilmi ve fadluhu*, v.I, f.131.

dhënë atyre përparësi para tjerëve që nuk ishin *muxhtehidë*. Sahabët e njohur si Enes ibn Maliku dhe Ebu Hurejre tek hanefitë nuk konsiderohen *muxhtehidë*.²¹ Prandaj, në transmetimet e përcjella prej tyre, hanefitë shikojnë gjithnjë mos ka ndonjë transmetim tjetër nga ndonjë sahabij *muxhtehid* dhe nëse ka, atëherë këtyre të fundit u japin përparësi. Për këtë arsye rasti konkret ngritja e duarve apo edhe çështjet e tjera, hanefitë nuk bazohen në transmetimet e Ebu Hurejres, Enes ibn Malikut dhe të tjerëve që ishin në të njëjtën kategori.

Këtë do ta ilustrojmë edhe me tregimin e njohur e të popullarizuar mes imam Evzaiut dhe imam Ebu Hanifes që ishin takuar në Mekë, të cilin e përcjell ibn Ujejne dhe thotë: “Evzaiu e pyeti Ebu Hanifen: “Çfarë keni ju që nuk i ngrini duart gjatë shkuarjes në ruku dhe ngritjes prej saj?” “Sepse një gjë e tillë nuk është vërtetuar nga i Dërguari i Allahut!”-, iu përgjigj Ebu Hanife. Evzaiu shtoi: “Si nuk është vërtetuar, kur më ka treguar mua Zuhriu nga Salimi e ky nga babai i tij se i Dërguari i Allahut i ngrinte duart e tij kur ia fillonte namazit gjatë rukusë dhe ngritjes prej saj.”

Atëherë Ebu Hanife i tha: “Na ka treguar Hamadi nga Ibrahim, ky nga Alkame dhe Esvedi e këta nga Abdullah ibn Mes’udi se i Dërguari i Allahut i ngrinte duart vetëm gjatë tekbitit fillestar dhe nuk e ka përsëritur këtë më në asnjë vend.”

Evzaiu i tha: “Unë po të përcjell (transmetimin) nga Zuhriu, nga Salimi e nga babai i tij e ti po më përcjell mua nga

²¹Kemal ibën el-Humam, *Zadu-l Fekir*, me recensurë nga Said Bekdash, Daru-s Siraxh, El-Medine, 1435h-2013m, f.45.

Hamadi dhe Ibrahim. Ebu Hanife iu përgjigj: “Hamadi ishte më i ditur në fikh se Zuhriu. Ibrahim ishte më i ditur në fikh se Salimi. Alkame nuk ishte më pak (në dije) se ibn Omeri, ndonëse ky i fundit ishte sahabij dhe ai ka vlera, sikurse që ka vlera edhe Esvedi. Ndërsa Abdullahu (ibn Mes’udi) është Abdullah²².” Evzaiu heshti dhe nuk pati përgjigje. Këtu shihet qartë se Ebu Hanife preferon dhe përzgjedh transmetuesit që kishin dije të thellë në dispozitat fetare (fekihë), ndërsa Evzaiu preferon senedin e lartë.²³

Kjo është edhe arsyeja se përse Ebu Hanife i parapëlqen transmetimet nga sahabët e njohur si Abdullah ibn Mesudi, Ali ibn ebi Talib dhe nga Omer ibn Hatabi, sepse këta ishin nga sahabët më të dalluar dhe që të tre ishin njohës të mirë të dispozitave fetare. Prandaj, nuk është e rastësishme përzgjedhja e argumenteve nga Ebu Hanife dhe juristët e tjerë në këtë çështje.

Për të njëjten çështje, pra, kemi dy grupe të sahabëve që përcillnin transmetime rreth ngritjes së duarve: në njërën anë kemi sahabiun e madh Abdullah ibn Mesudin dhe veprimin e Aliut, ndërsa në anën tjetër kemi Ebu Hurejren, Abdullah ibn Omerin, apo edhe Vailin. Kuantiteti i transmetuesve është pa dyshim në grupin e dytë, ndërsa në grupin e parë janë sahabët më kualitativë dhe më të njohur që i përkasin fushës së ixhtihadit, gjegjësisht më të përgatitur se të parët. Sipas hane-

²² Sinjalizon për vlerat e larta të Abdullah ibn Mes’udit i cili ishte thujse gjithnjë në shoqërim të Resulullahit a.s., prandaj edhe nuk e krahasoi me të tjerët, gjë që është shumë e arsyeshme.

²³ Ibën Nuxhejm, *el-Bahru-rr Rraik Sherh Kenzu-d Dekaik*, bot.II-të, Daru-l Kitab el-Islamij, v.III, f.289.

five, Ebu Hurejre e as Vaili nuk i takojnë kategorisë së sahabëve *muxhte hidë*, andaj për çështjen në fjalë u japin përparësi sahabëve më të përgatitur dhe më të njohur, ndonëse lënë grupin tjetër që numerikisht janë më të shumtë dhe më të zëshëm, por që me përgatitje më të vogël.

Sikur në këtë rast, hanefitë u japin përparësi sahabëve të dalluar në dije, atyre të cilët ishin muxhte hidë dhe realisht i njihnin mirë dispozitat fetare. Kjo nuk nënkupton që ne po bëjmë dallime mes tyre, assesi, mirëpo vlera e një sahabiu dallon nga e tjetrit, ashtu siç disa ishin më të ditur nga të tjerët, si në këtë rast Aliu dhe Abdullah ibn Mesudi ishin më të ditur se Vaili dhe Abdullah ibn Omeri.

Konsultimi dhe toleranca në mendime

Nga veçoritë e ndritshme të shkollës së Ebu Hanifes është konsultimi, që e veçon këtë shkollë nga tjerat, sepse shkollat e tjera janë më tepër të përbëra nga mendimet e themeluesve të tyre. Në shkollën hanefite, përveç mendimeve të Ebu Hanifes kemi mendime të shumta nga vetë nxënësit e tij dhe nëse flasim për këtë çështje, atëherë domosdo do ta kuptojmë një element shumë të rëndësishëm e që ka të bëjë me tolerancën në të menduar: askush nuk privohet nga mendimi ndryshe, përkundrazi inkurajohet të paraqesë opinionin e tij personal për çështje të caktuar. Kjo karakteristikë, përveçqë dallon nga të gjitha shkollat juridike, ajo si e tillë sfidon edhe kohën aktuale, sidomos në disa vende të botës islame, ku mendimi ndryshe luftohet dhe pengohet me çdo kusht.

Për konsultimin në shkollën hanefite tregon Esed ibn Furati, i cili thotë: “Më ka thënë Esed ibn Amri: “Ata (nxënësit e Ebu Hanifes) nuk pajtoheshin me të në përgjigjen rreth ndonjë çështjeje, secili vinte me ndonjë përgjigje, pastaj ato ngriheshin tek imami dhe ata e pyesnin atë, përgjigjja nuk mungonte prej tij. Shpeshherë rreth një çështjeje diskutonin tri ditë, më pas e shënonin në divan.”²⁴

Ebu Hanife nuk i detyronte nxënësit e tij ta pranojnë vetëm mendimin e tij, përkundrazi ai i nxiste ata që të japin mendimet e tyre personale dhe ta kuptojnë çështjen. I nxiste ata që të mendojnë, hulumtojnë dhe ta japin mendimin e tyre se si e shohin çështjen në fjalë. Vetëm në fund, pas një diskuti-mi të gjatë, vinte përgjigja vendimtare. Madje, Ebu Jusufi në disa raste e kishte përshkruar klimën e konsultimit, debatit dhe mendimit ndryshe, saqë nganjëherë ata polemizonin një muaj për një çështje të caktuar.

Mësimet e Ebu Hanifes ishin të kësaj natyre. Ato nuk ishin të formës së diktatit që njëri dikton e tjetri shkruan, por ishin tubime konsultative, mësimet me debat për çështje të caktuara, secilit i vinte rendi dhe kontribuonte për çështjen e ngritur. Ebu Hanife në këtë kontekst ishte prijatari dhe ndër të paktët që organizonin mësimet të tilla, prandaj edhe i gjen shokët dhe nxënësit e tij që nuk mungonin asnjëherë nga tubimet e dijes së tij. Ebu Jusufi kur i kishte vdekur një anëtar i familjes së tij të ngushtë, ai caktoi dikë që të merrej me qefinoshjen dhe varrimin e tij që ky mos t'i humbte tubimet e dijes së Ebu Hanifes.

²⁴ Muhamed Zahid Kevtherij, *Fikhu Ehlul Iraki ve Hadithuhum*, f.55.

Konsulta dhe mendimet ndryshe patën një rol kyç në shqyrtimin e meseleve dhe në ixhtihadin rreth tyre. Ebu Hanife i jepte rëndësi të madhe konsultës, saqë raportohet se kur nuk prezantonte Afijeh dhe shqyrtoheshin meselet e caktuara, Ebu Hanife vetëm shqyrtonte meselet me nxënësit e tjerë, por nuk pranonte t'i shënonte si mesele të përfunduara para se Afijeh ibn Jezidi ta jepte edhe mendimin e tij personal.²⁵

Nganjeherë ngriheshin zërat e tyre duke shqyrtuar mesele të caktuara, por imami nuk ndërhynte në qetësimin e tyre. Ai i linte në atë mënyrë të debatonin. I linte të lirë, pa ua imponuar mendimin. Por, kur ai fillonte të fliste, situata qetësohej dhe sikur në atë mes më nuk ekzistonte askush.²⁶ Kur Sufjan ibn Ujejne kaloi pranë tubimeve të tij dhe pa situatën, iu drejtua Ebu Hanifes në formë të qortimit: “A nuk po i ndal ata nga ngritja e zërit të tyre në xhami?” Por, përgjigjja e Ebu Hanifes ishte tjetër nga ajo që priste imami: “Lëri ata, sepse ata fikhun e mësojnë në këtë mënyrë.”²⁷

Metodologjia e Ebu Hanifes ishte konsultative dhe kaq dobiprurëse, secili jepte mendimin personal dhe kjo ndikonte në studimin e thellë të meseleve dhe mënyrën e veçantë të të argumentuarit. Ai kishte një stil pedagogjik që kryesisht përdoret në shkolla të veçanta dhe të njohura si ato të Finlandës apo Singaporit, ku studenti është në qendër të vëmendjes, ndryshe nga mësimi që bëhet te ne, ku profesori ende vazhdon të jetë në qendër të vëmendjes. Ai kishte mundësi të

²⁵ Sajmerij, *Ahbar Ebi Hanife ve ashabuhu*, f.149.

²⁶ Mekij, *Menakib Ebi Hanife*, f.418-419.

²⁷ Dhehebiu, *Menakib Ebi Hanife ve sahibejhi*, f.35; Iben Abdulberr, *Xhami' Bejanu-l ilmi ve fadlihi*. V.I, f.68-69; Kerderij, *Menakib Ebi Hanife*, f.346.

bënte diktat dhe në njëfarë mënyre t'ua impononte atyre mendimin e tij personal, thuajse ashtu siç veproi Shafi'u dhe imamët e tjerë që mendimi i imamat shihej si i pakonkurrencë dhe i pakundërshtueshëm brenda medhhebit (shkollës).

Mekiu, teksa flet për këtë çështje, shprehet: “Ebu Hanife shkollën e tij e vendosi të jetë konsultim i përbashkët, duke përjashtuar kështu të jetë vetëm mendimi i tij e jo edhe mendimet e të tjerëve...ai shtronte meselet, njërën pas tjetrës dhe dëgjonte prej të tjerëve (nxënësve). Secili thoshte atë që dinte (dhe që mendonte se ishte e drejtë). Ai polemizonte me ta ndoshta për një mesele të vetme një muaj, nganjëherë disa muaj, derisa të bëhej i qartë opinioni vendimtar për të, pastaj ai shkruhej dhe evidentohej.” Kjo padyshim që ishte më e drejtë, më reale dhe më e afërt me të vërtetën. Në anën tjetër, një metodë e tillë qetësonte zemrat dhe në fund secili bindej se është përzgjedhur mendimi më i mirë i mundshëm, pasi që meseleja ishte analizuar deri në detajet më të vogla dhe realisht është përzgjedhur mendimi më i mirë i mundshëm, pasi që çështja ishte analizuar nga një grup ekspertësh që i takonin grupit të muxhtehidëve në fushat e tyre përkatëse.

Shkollë me më së shumti pasues

Shkolla hanefite, përveçse është shkolla e parë nga katër shkollat e njohura juridike, ajo edhe për nga përfaqësimi, përfaqësohet më së shumti nga myslimanët, në të katër anët e botës. Shumica e myslimanëve të botës i përkasin kësaj shkolle dhe ajo si e tillë, brenda një periudhe të shkurtër kohore, tejkaloi Kufën dhe Irakun dhe mësimet e saj u përhapën

në të katër anët. Në këtë kontekst Abdullah ibn Zubejr el-Humejdi thotë: “E kam dëgjuar Sufjan ibn Ujejnen të ketë thënë: “Dy gjëra nuk kam menduar se do të kalojnë jashtë Kufës, ndonëse ato dyja kaluan horizontet: leximi i Hamzës dhe opinionet (mendimet) e Ebu Hanifes.”²⁸

Fillimi i shekullit të tretë ishte thuajse vendimtar për përhapjen e mendimeve dhe opinioneve të shkollës hanefite. Nga shekulli i tretë e deri te shekulli i shtatë kemi një ekspansion të vërtetë të opinioneve dhe mendimeve të shkollës hanefite dhe një vrull të madh të juristëve që përfaqësonin shkollën hanefite. Këtu shkolla hanefite thuajse la mbrapa të gjitha shkollat e tjera dhe thuajse ishte gjithnjë një hap para shkollave të tjera. Gjatë kësaj periudhe kur shkolla hanefite pati një rritje dhe shtrirje të madhe, ishte shumë e nevojshme që juristët e njohur të bënin ixhtihad për kërkesat e reja si imperativ i kohës së tyre. Këtu duhet përmendur që si pasojë e ixhtihadit të tyre u përtërinë edhe shumë opinione dhe mendime të mëhershme. Po ashtu duhet përmendur se gjatë kësaj periudhe u shkruan dhe u shpjeguan shumë libra të rëndësishme nga autorë të ndryshëm, si Tahaviu, Kerhi, Kudu-riu, Merginani, Serhasiu, Samerkandiu, Kasani dhe shumë të tjerë, që lanë gjurmë të mëdha në shkollën hanefite.

Kjo shkollë pati një aplikim shumëshekullor, duke filluar nga sundimi abasit, të cilët e aplikuan shkollën hanefite në sistemin e tyre dhe vepruan sipas mësimave të saj, duke vazhduar tutje edhe nëpër sundime të tjera e deri te perandoria

²⁸ Ebu Bekër Hatib el-Bagdadi, *Te'rihu Bagdad*, v.XV, f.475. Senedi i këtij transmetimi është i vërtetë dhe nuk ka ndonjë vërejtje.

osmane, në thuajse tërë sipërfaqen e së cilës aplikohet dhe punohet sipas shkollës hanefite. Madje, ajo që është edhe më interesante dhe që dëshmon për mësimet dhe opinionet në praktikë është fakti se disa nga shtetet arabo-islame kur kishin filluar të aplikonin segmente nga sheriatu islam, siç bëri Egjipti modern kur filloi të aplikonte sheriatin në sferën e kodit familjar, mblodhi dijetarët dhe ata vendosën që të punojnë sipas shkollës hanefite, ndonëse i përkitnin shkollës shafite.

Ky shembulli i fundit në Egjipt dhe shembuj të tjerë të ngjashëm rrëzojnë hipotezat e disave që mendojnë se pushtetet e ndryshme ndihmuan përhapjen e hanefizmit, kur ato aplikuan në sistemet e tyre në gjykatë mësimet dhe opinionet hanefite. Është fakt se pushteti që nga koha e abasitëve e deri tek osmanët, ndikuan në ruajtjen e shkollës hanefite dhe në zgjerimin e saj, mirëpo mësimet e shkollës hanefite për shekuj ishin më të aplikueshme në praktikë sesa mësimet dhe opinionet e shkollave të tjera juridike.

Përfundim

Faktikisht një temë e tillë është e gjerë dhe është e pamundur të elaborohet siç duhet brenda këtyre faqeve. Mirëpo, besoj se, sa u dha këtu, është një pasqyrë e mjaftueshme, së paku për t'i kuptuar disa gjëra të rëndësishme që kanë të bëjnë me karakteristikat e shkollës juridike hanefite, shkollë e cilës i përket shoqëria jonë dhe e cila përgjatë gjithë këtyre shekujve pati një shtrirje në shumicën e vendeve myslimane.

Prof. dr. Qazim QAZIMI

MUHAMEDI A.S. PRIJATARI MË ME NDIKIM NË UDHËZIMIN E NJERËZIMIT

لَقَدْ مَنَّ اللَّهُ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ إِذْ بَعَثَ فِيهِمْ رَسُولًا مِّنْ أَنفُسِهِمْ
يَتْلُو عَلَيْهِمْ آيَاتِهِ وَيُزَكِّيهِمْ وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَإِن
كَانُوا مِن قَبْلُ لَفِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ ﴿١٦٤﴾ آل عمران

“Vërtet All-llahu u ka dhënë besimtarëve një dhuratë të madhe kur u solli një të dërguar nga mesi i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson librin (Kur'anin) e urtësinë edhe pse më parë ata ishin në rrugë të gabuar”.¹

Nga ky ligjërimit kuranor kuptojmë se dhuratën e madhe që u bëri Krijuesi i Gjithësisë besimtarëve ishte dërgimi i

¹ Kurani, sureja "Al Imran", ajeti 164.

Pejgamberit të fundit, si një prijatar që nuk ishte i panjohur për rrethin ku jetonte.

Në historinë e lavdishme të islamit është i njohur për-kushtimi, nderi e respekti që kanë shprehur besimtarët ndaj pejgamberëve në përgjithësi e ndaj Muhammedit a.s. në veçanti. Mënyra e shfaqjes së dashurisë ndaj Pejgamberit a.s. ndër breza është bërë në forma e trajta të ndryshme. Kronistët shprehën dhe regjistruan me respekt dhe dashuri jetën dhe biografinë e Pejgamberit Muhamed a.s.. Mjeshtrit e penës, poetët, thurën vargje në prozë e poezi. Letrarët shkruan poema, ode e tregime. Ulemaja ligjëruan po edhe varguan kaside, ilahi e mevlude kushtuar jetës dhe veprës të ndritshme të Pejgamberit tonë të fundit, Muhamedit a.s..

Është Allahu xh. sh. që përmes Kuranit foli e vlerësoi virtytet, atributet dhe muxhizet (mrekullitë) e Pejgamberit, duke e ngritur në piedestalin më të lartë personalitetin e Muhammedit a.s.. Madje, ligjërimi kuranor do të bëhet burimi kryesor dhe pikë rrëfimi për gjithë ata që patën vullnet e dëshirë që, përmes fjalës së bukur artistike, të shprehin lavdërime për vlerat universale me premisa hyjnore të Pejgamberit Muhamed a.s..

Çfarë thuhet në Kuran për Pejgamberin Muhamed a.s.

Duhet ditur se për lindjen dhe pejgamberinë e Muhammedit a.s. ka pasur paralajmërime edhe në librat e shenjta të mëparme, ardhja e Pejgambrit a.s. është pranim dhe realizim i duasë së Ibrahimit, a.s., nga gjenealogji-lozë e të cilit lindën, erdhën dhe u shpallën tre pejgamberët e feve monoteiste:

Musai, të cilit i zbriti Tevrati (Tora), Isai të cilit i zbriti Inxhili (Bibla) dhe Muhammedit a.s. të cilit i zbriti Kurani, në të cilin gjejmë edhe duanë e Ibrahimit a.s kur kishte thënë:

رَبَّنَا وَابْعَثْ فِيهِمْ رَسُولًا مِّنْهُمْ يَتْلُو عَلَيْهِمْ آيَاتِكَ وَيُعَلِّمُهُمُ
الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَيُزَكِّيهِمْ ﴿البقرة/١٢٩﴾

“Zoti ynë, dërgo ndër ta, nga gjiu i tyre një të dërguar që t’u lexojë atyre ajetet e Tua, t’u mësojë atyre librin dhe urtësinë”.²

Paralajmërimet për ardhjen e Pejgamberit ka pasur edhe në "Inxhil"-(Bibël), por edhe arabët idhujtarë kanë pasur parandjenja për ardhjen e një Pejgamberi nga mesi i tyre.³ Në Kuran decidivisht thuhet:

وَإِذْ قَالَ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ يَا بَنِي إِسْرَائِيلَ إِنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ
مُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيَّ مِنَ التَّوْرَةِ وَمُبَشِّرًا بِرَسُولٍ يَأْتِي مِنْ بَعْدِي
اسْمُهُ أَحْمَدُ...

“Dhe, (kujto) kur tha Isai, biri i Mejremes : O izraelitë, vërtet unë jam i dërguari i Allahut tek ju për ta vërtetuar Tevratin që ka ardhur para meje dhe për të ju përgëzuar për një pejgamber, që do të vijë pas meje, emri i të cilit do të jetë Ahmed (Muhammed)”.⁴

² Kurani, sureja El-Bekaretu, ajet 129.

³ Shakir El-Bedrj, “Edh-dhikra El-Halidetu li En-Nebijji El-Halidi”, shtyp. “Daru El-Basri”, Bagdad, 1969 m. (1388 h.), f 11.

⁴ Kurani, sureja Es-Saf, ajeti 6.

Kështu përgëzoi Isai a. s. në “Inxhil”- (Bibël) për ardhjen e Muhammedit a.s.. Dhe, thënia e Isait u vërtetua me lindjen e Pejgamberit të fundit.

Muhammedi a.s. ishte njeriu që kishte lindur, ishte rritur e edukuar në mesin e arabëve idhujtarë. Dhe s'do mend se kjo që po ndodhte kështu (lindja e pejgamberit të fundit) nuk ishte rastësi por një realitet që po bëhej dhe po vinte nga mëshira e të Gjithëmëshirëmshtit:

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ

“Dhe Ne nuk të dërguam ty (Muhammed ndryshe) veçse mëshirë për të gjithë botët”.⁵

Mrekullia e lindjes së Muhammedit a.s.

Muhammedi, a. s., është i lindur në mëngjesin e së hënës së 12-të (dymbëdhjetë Rebiu El-Evvelit), të vitit të Elefantit, apo më (20 prill të vitit 571 m).

Hasan ibni Thabiti, (poet i pranuar po dhe i licensuar nga vetë Muhammedi a.s.), në ditën kur lindi Mahamedi a.s. pas-kësh dëgjuar një hebre-jahudi duke u thënë kurejshitëve-(fisit nga rrjedh Muhamedi a.s.):

“...Dëgjoni mirë o Kurejshitë! “Sonte te ju ka lindur Pejgamberi i fundit në Botë... Në mes të shpatullave të tij ka një shenjë të zezë e ajo është vula e tij pejgamberike. Verifikoni, se me të vërtetë në këtë natë ka lindur i dërguari i fundit i këtij ummeti.”⁶

⁵ Kurani, sureja, El- Enbija, ajti 106

⁶ Transmeton. Hakimi dhe Jakub ibni Suffani, me sened të mirë (Hadithi ha-sen)

Komentatori i Kur'anit, Ibni Kethiri, në veprën e tij kapitale *“El-Bidaje ve En-Nihaje”* ka shkruar një kapitull të veçantë mbi fenomenet, çudirat dhe mrekullitë, të cilat ndodhën në natën kur po lindte Muhamedi, a.s. e ndër të tjera ai ka përmendur:

- Pozita e ulët e yjeve gjatë asaj nate (yjet iu afruan Tokës).
- Dridhja e pallatit të Kirasë dhe rrënimi i 14 shtyllave të tij.
- Shuarja e zjarrit që adhurohej në Persi. Zjarr, që ishte ndezur 1000 (një mijë) vjet më parë e që asnjëherë nuk ishte shuar gjer me lindjen Muhamedit a.s..
- U thyen idhujt që ishin në brendësi të Qabes e që adhuroheshin nga arabët.
- U shterua e u tha liqeni i quajtur Sava, të cilin e besonin si të shenjtëruar.
- U shfaq “Nurë” (një dritë e madhe) të cilën e pa Amineja, e ëma e Muhamedit - *(dritë që i ka ndriçuar edhe pallatet e Shamit). ”*⁷.
- Të rënë të të porsalindurit (Muhamedit a.s.) më fytyrë për toke (në sexhde).

E, poeti shqiptar Tahir ef. Popova nga Vushtrria e Kosovës, në Mevludin e tij ketë ndodhi-lindjen e Muhammedit e shpreh kështu:

*Prej Mashrikut deri n'magrib gjithë Dunjasë
I dha hjeshe lemja e k'tij Mustfasë!*⁸

⁷ Transmetim i El-Bizzarit dhe Taberanisë ; Hafiz ibni Haxheri ka thënë se ky hadith është sahih. Këtë e pohojnë edhe te Hibbani dhe Hakimi.

⁸ Tahir ef. Popova, Mevludin e tij të titulluar *”Mendhumetu El-Mevludi fi Ef-dali El-Mevxhudi bi Lisani El-Arnauti”* në origjial f 8, të cilin e shkroi më 1890 dhe e botoi me lejen e Ministrisë së Arsimit të Turqisë me nr. 109, në Stamboll.

Në “Musnedin” e Imam Ahmedit, transmetohet të këtë thënë Ibni Abbasi: *“I Dërguari i Allahut, a.s. në ditën e hënë ka lindur, në ditën e hënë është dërguar si pejgamber, në ditën e hënë është shpërngulur nga Meka, në ditën e hënë ka hyrë në Medinë dhe në ditën e hënë e ka vendosur Haxheru-El-esvedin në vendin e tij me rastin e renovimit të Qabesë.”* Po më këtë datë, më 12 Rebiu El-Evvel, në paraditen e së hënës, Muhamedi a.s. ka ndërruar jetë.

Nga kjo që u tha gjer më tani mësohet se lindja e Muhamedit a.s. ndodhi më 12 Rebiu El-Evvel. Babai i tij quhej Abdullah, ndërsa nëna e tij ishte znj. Emine.

Muhamedi a.s. kishte mbetur jetim ende pa lindur. Babai-Abdullahu i kishte vdekur disa muaj para lindjes. Për rritjen, zhvillimin dhe edukimin e tij do të kujdesen e ëma-Emineja, mendorja - (gjdhënëseja)-Halimja, gjyshi-Abdumuttalibi, xhaxhai-Ebu Talibi dhe ndonjë tjetër prej të afërmve të tij. Si fëmijë, Muhamedi a.s. nuk pati rast të shkollohej edhe pse në atë kohë në Mekë kishte njerëz të ditur dhe të tillë që dinin shkrim-lexim.

Që në rininë e hershme, Muhamedi a.s. dallohet shumë nga moshatarët e tij për shumëçka. Si i ri u veçua nga të tjerët me karakter, moral e virtyte të larta. Ai i tërhoqi vëmendjen shumëkujt për të mirë. Të përmendim se kur ai po shoqëronte xhaxhanë e tij, Ebu Talibin, për tregti në Sham në moshën 12 vjeçare,⁹ Muhamedin a.s. e kishte parë një autoritet-prift i devotshëm i quajtur Behira, i cili ka thënë *“Nga ky*

⁹ Ebu El-Fidai Ismail bin Umer bin Kethir El-Kurejshij, “El-Fusulu fi Sireti Er-Resuli”, përpunuar dhe korrektuar nga Ebu Usamete Selim, bot. i parë, libri 1, f 49, Kuvajt, 2003 (1424 h.)

djalosh pritet një punë-mrekulli e madhe, saqë do të përme-ndet në Lindje dhe në Perëndim".¹⁰ Muhamedi a.s., një kohë ka qenë edhe bari delesh, por edhe pjesëmarrës në beteja të ndryshme me xhaxhallarët e tij.¹¹

Duhet veçuar edhe martesë e Muhamedit a.s. me Hatixhenë, të bijën e Huvejlidit, që me njëfarë mënyre, kjo bashkëshortësi rregulloi edhe siguroi mirëqenie sociale. Ajo ishte gruaja e parë dhe, derisa që ajo gjallë, Pejgamberi a.s. nuk ka pasur grua tjetër.¹² Të gjithë fëmijët, Muhamedi a.s. i pati me Hatixhenë, me përjashtim të Ibrahimit. Fëmijët e këtij çifti ishin: Kasimi, Tahiri, Tajjibi, Zejnebeja, Rukija, Ummy Kulthumi dhe Fatimja.

Duhet veçuar edhe zgjidhja e problemit të vënies së gurthemelit gjatë rindërtimit të Qabes. Muhamedi a.s. ofroi zgjidhjen më të mirë. Propozoi që të gjitha fiset gurin e zi të bartnin me një çarçaf deri të vendi i duhur e pastaj, ai me duart e tij, e lëshoi në themel të Qabesë. Ndodhi kjo më 12 Rebiul-Evvel, kur Muhamedi kishte 35 vjet dhe prej atij çasti i dhanë ofiqin "EI-Emin" (Besnik).¹³

¹⁰ Grup autorësh, "Es-Siretu En-Nebevijetu Li-Ibni Hisham", pjesa e parë, bot. i tretë, f 191-194, Bejrut, 1391 h. (1971). Shih edhe: Safijurrahman El-Mubarekfuri, libri i cituar, f 21.

¹¹ Es-Siretu En-Nebevijetu Li-Ibni Hisham, f 195-196.

¹² Grup autorësh, "Es-Siretu En-Nebevijetu" burimi i cituar f 201, Bejrut, 1391 h. (19710).

- Shih edhe Safijurrahman El-Mubarekfuri, Nektari i Xhennetit, f 61. përkthim nga boshnjakishtja, Urtësia-Shkup, 1997.

¹³ Po aty, f 204, 209.

Pejgamberia e Muhamedit a.s.

E tëra sa u tha deri tash në lidhje me Muhamedin a. s., jep të kuptohet se kishim të bënim me një njeri jo të rëndomtë, po jo edhe të mbinatyrshëm. Por, kur Muhamedi a.s. mbushi 40 vjet, fillon t'i shpallet Vahji dhe që nga atëherë ai është Pejgamber i shpallur.¹⁴

Akti i Vahjit-(frymëzimit), që vjen nga jashtë, është një dhunti hyjnore e Allahut xh. sh. që i fal pejgamberit të Tij.

Muhamedi a. s. nuk dinte shkrim-lexim, prandaj edhe me rastin e shpalljes, kur Xhibrili kërkoi nga ai që të lexonte, por, përgjigjja e Pejgamberit ishte se nuk dinte të lexonte.¹⁵ Mirëpo, pas një trysnie të fortë të Xhibrilit mbi Muhamedin dhe pas përgatitjes së tij fizike e psikike, iu shpallën ajetet e para të Kuranit dhe më këtë akt Muhamedi a. s. u bë Pejgamber i shpallur.¹⁶

اقْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ * خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ عَلَقٍ * اقْرَأْ وَرَبُّكَ
الْأَكْرَمُ * الَّذِي عَلَّمَ بِالْقَلَمِ * عَلَّمَ الْإِنْسَانَ مَا لَمْ يَعْلَمْ *

“Lexo në emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrin e nënës). Lexo, se Zoti yt është më bujari! I Cili e mësoi njeriun (të përdorë) lapsin. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte...”¹⁷

Ndodhi ky akt natën e Kadrit: më 1 shkurt të vitit 610.

¹⁴ Ebu Abdil-lah Ez-Zinxhanij, Terihu El-Ku'rani, Bejrut, 1969 (1388), f 21,

¹⁵ Safijurrahman El-Mubarekfuri, vepra e cituar, f 65

¹⁶ Muhammed Alij Es-Sabunij, vepra e cituar, botimi dytë f 12.

¹⁷ Sureja El-Alek, ajeti 1-2.

Shëmbëlltyra e Pejgamberit në çdo fushë e në çdo aspekt të jetës, vlerat universale njerëzore, virtytet sublime, janë ato që e bëjnë të dashur e që e karakterizojnë personalitetin e Pejgamberit a.s.. Aisheja- grua e Muhammedit a.s. është dëgjuar të ketë thënë se: “*Karakterimi-morali i tij ka qenë Kurani i madhërueshëm*” e që do të thotë se çdo fjalë e vepër e tij ka qenë në harmoni e përputhshmëri të plotë me Kuranin famë-lartë, në të cilin i thuhet:

وَإِنَّكَ لَعَلَىٰ خُلُقٍ عَظِيمٍ

“Vërtet ti (Muhammed) je në pedaistalin më të lartë të moralit”.¹⁸

Dymbëdhjetë vitet e qëndruara në Mekë gjatë pejgamberllëkut ishin mjaft të rënda, por tani e tutje, jeta në Mekë ishte e padurueshme. Kështu që më 20. 9. 622 edhe vetë Pejgamberi, së bashku me Ebu Bekrin u detyrua ta lëshonte Mekën dhe të emigronte në Jethrib (Medinë).

Do theksuar se kur Pejgamberi Muhamed a.s. me refugjatët myslimanë të përndjekur nga Meka (vendlindja e tij) arritën në Jethrib-Medinë, themeluan një shoqëri multifetare, multikulturore, multietnike (me tri fe monoteiste dhe katër bashkësi etnesh).

Nisur nga këtu, nuk ka dyshim se në rrafshin burimor islam, “*koekzistenca*”, respektimi i vlerave të ndërsjella, toleranca ndërfetare dhe multinacionaleteti janë bazament i pakapërcyeshëm për të ndërtuar një shoqëri pluraliste dhe shërben si arketip për rregullimin fetar, shoqëror, kulturor, ekonomik,

¹⁸ Sureja El-Kalem ajeti i 4-të.

po pse jo edhe politik e të tjera, të shoqërive bashkëkohore-moderne.

Për personalitetin e Pejgamberit a.s. si drejtues shpirtëror-fetar, si prijatar, si njeri i qytetëruar me karakter e moral të lartë, si strateg ushtarak, si udhëheqës politik e si burrë shteti që mund të shërbejë si shembull përgjithmonë dhe kudo, kanë folur Kurani, shumë hadithe, por edhe personalitete myslimane dhe jomyslimane me renome ndërkombëtare e ndër ta edhe Majkëll Hart, i cili është prononcuar: *“Muhamedi është personalitet prijatar si nga aspekti religjioz, ashtu edhe nga ai politiko-shoqëror, respektivisht, si forcë lëvizëse e çlirimeve arabe. Më të drejtë ai mund të mbajë vendin e parë si udhëheqës politik më me ndikim në histori”*.¹⁹

Muhamedi a.s., poetët dhe poezia

Është i pakontestushëm fakti se Muhamedi a.s. ndaj poezisë, e cila me të drejtë llogaritet si mbretëresha e arteve, pati qëndrim afirmativ. Muhamedi a.s. dëgjonte poezi nga poeti Nabiga Dhubjanu. Edhe nga Kaëb ibni Zuhejr e dëgjoi me vëmendje *“Kasidetu El-Burde”*²⁰ dhe kur arriti te vargjet:

*“Pejgamberi është dritë, me të cilën ndriçohemi,
Luan, nga shpatat e zhveshura të Indisë.*

¹⁹ Majkëll Hart, “100 personalitete më me ndikim në histori”, f 13, Tetovë, 1997.

²⁰ Ibni El-Kajjem El-Xhevziyyetu, “Medariku Es_Salikinë” pjesa e I-rë, botoi “Daru Ihjai Et-turathi El-Arabij”, Bejrut-Liban, 1999 m. (1419 h.) ,f 370

Pejgamberi ndërhyri duke e korrigjuar poetin dhe i tha: *”nga shpatat e Allahut”*, e Kaëbi e përmirësoi vargun në fjalë.²¹

Muhamedi a. s. për hir të fjalës së bukur artistike, Kaëb ibni Zuhejrit, lëre që i fali jetën atij, ngase ishte i dënuar me vdekje, por edhe e nderoi duke ia hedhur mbi supet e tij Burden e vet (një lloj manteli luksoz) në vlerë prej 20 mijë dhërmësh dhe që atëherë kjo poemë është emërtuar *“Kasidetu El-Burdetu”*.²²

Për poezinë Pejgamberi a.s. që atëherë thoshte: *“Poezia është një gjë që të bukurën e bën më të bukur dhe të keqen e bën më të keqe”* (transmetim i Buhariu).

H. Abbasi r.a., i biri Abdu El-Muttalibit, xhaxhai i Pejgamberit a. s. me një rast i është drejtuar Pejgamberit a.s. me këto vargje:

E, kur ti linde u shndrit toka,	و انت لما ولدت أشرقت الأرض
Me nurin tënd u ndriçuan horizontet	و ضاءت بنورك الأفق
E ne, me atë ndriçim	فنحن على ذلك الضياء
Rrugës së drejtë po ecim. ²³	و في سبيل الرشاد نخترق

Nga hadithet e sipërcituara, kuptohet se të thurësh poezi e ta lavdërosh Pejgamberin a.s. është një vazhdim i një tradite të mirë dhe gjithsesi se ka bazë dhe mbështetje në literaturën

²¹ Transmetuar edhe në historinë e Ibni Hishamit.

²² Dr. Shevki Dajf, *“El-Asru El-Islamij”*, botimi i 13-të, Kairo, 1963, f 83,

²³ Shakir El-Bedrij, *“Edh-dhikra El-Halidetu li-En-Nebijji El-Halidi”*, shtyp. *“Daru El-Basrij”*, fq 16-17. Bagdad, 1969 m. (1388 h.).

burimore islame, madje është edhe miratim i Pejgamberit a.s..

Fenomeni i Mevludit dhe këndimi i tij

Pejgamberin a.s e kanë lavdëruar dhe vazhdojnë ta lavdërojnë fetarët e devotshëm, dijetarët, por edhe shkrimtarët, me shkrimet e me këndimet e tyre artistike. Në forma të ndryshme, kanë shprehur devotshmëri dhe respekt të nevojshëm për Pejgamberin a.s.

Shejh Ebu El-Hattab bin Dihjete, në fillim të shek. VII hixhri, shkroi një poemë (Mevludin e parë) për Sulltan Mu-dhaffer Kevkeburin, mbi lindjen e Pejgamberit, a.s., të titulluar *“Et-Tenviru fi Mevlidi El-Beshiri En-Nedhiri”*,²⁴

Te turqit, prej mevludeve më i njohuri dhe më i përdorur është *“Vesiletu En-Nexhat”* (Mjeti për shpëtim) që e përpiloi poeti turk Sulejman Çelebiu në qytetin Bursa në vitin 1409m. pastaj pason mevludi i autorit kurd-Mulla Hasan Ertushi.²⁵

Edhe shkrimtarët shqiptarë të letërsisë islame kanë shkruar mevlude origjinale apo përkthime që nga shek. XIX. Të theksojmë se te shqiptarët shumica e këtyre mevludeve janë shkruar në periudhën e Rilindjes Kombëtare nga personalitete dhe dijetarë të shquar e të dëshmuar si në rrafshin fetar po ashtu edhe në rrafshin kombëtar. Duhet theksuar se deri sot njihen mbi 30 mevlude të shkruara nga personalitete të njo-

²⁴ El-Imam El-Hafidh Ebu Ismail bin Kethir Ed-Dimshkij “El-Bidajetu ve En-Nihajetu” pjesa e XIII-të bot. “Mektebetu El-Iman” f 131-132,

²⁵ Shih Feridudin Aydin “Festimi i mevludit dhe kultura e imitimit” AlbIslam, i botuar më 1 Mars 2009.

hura në fusha të ndryshme të fesë dhe të letërsisë, të cilat, me mjeshtërinë e tyre dhe në mënyrë artistike e shembullore thurën lavde e konsiderata, si për askënd tjetër, për të Dërguarin e Zotit, Muhamedin a.s..

Mevludi i parë te shqiptarët besohet të jetë ai i poetit të madh Hasan Zyko Kamberi, por mevlude kanë shkruar edhe Muhamed Çami, Ismail Flloqi, Hafiz Ali Ulqinaku, Hafiz Ali Korça, Hafiz Ibrahim Dalliu, Tahir efendi Popova etj.. Mevlude shkrimtarët shqiptarët kanë vazhduar të shkruajnë edhe gjatë shekullit XX.

Është realitet i pamohueshëm se festimi i mevludit (ditëlindjes së Pejgamberit a.s.) nuk ndodhi në kohën e Pejgamberit a.s.. Bile, ky festim nuk është bërë as në kohën e Sehabëve as të Tabiinëve por as në kohën e Tebi-tabinëve nuk ndodhi festimi i mevludit në format të cilat i gjejmë dhe i praktikojnë sot myslimanët anekënd botës.

Tani, duke ditur se lavdërimi dhe përshëndetja e Pejgamberit a.s. (çarja salavat dhe selam) është porosi e Kuranit, Sunnetit (traditës pejgamberike) dhe detyrim fetar, jemi të bindur se edhe festimi i Mevludit është “bid’atun haseneh” një fenomen- novatorizëm (një risi e mirë me premisa fetare) dhe ky është një realitet që e jetësojmë edhe në trevat tona, gjithandej ku jetojnë shqiptarët myslimanë.

Në këtë rast, patjetër duhet përmendur thënia e Abdullah ibni Mesudit: *“Atë punë që myslimanët e vlersojnë se është vepër e mirë e që duhet të bëhet, edhe Allahu xh.sh e llogarit për të mirë. Atë që myslimanët e shohin si të keqe që të mos veprohet, edhe Allahu xh.sh. e konsideron si të keqe”*. (transmetim i Ahmedit)

Bazuar në këtë thënie të Sehabiut të respektuar, del se një veprim, punë, fenomen i ri, po qoftë edhe “Bid'atun” risi-(novatorizëm) që nuk bie ndesh me burimet kryesore të Islamit: Kuranin, Hadithin e të tjerat...dhe që është i pranueshëm, i mirë e i dobishëm për shumicën e myslimanëve, atëherë ajo është një "Bid'atun haseneh" (Risi e mirë) novatorizëm i dobishëm për myslimanët, lejohet dhe duhet të aplikohet.

Ibni Tejmiiu qartë është prononcuar në favor të manifestimit e Ditëlindjes së Pejgamberit a.s. kur thotë: *“Madhëro Mevludin dhe prano atë si festë! Këtë e bëjnë disa njerëz dhe për këtë punë ka shpërblim të madh, duke pasur parasysh qëllimin e mirë të tyre dhe duke parë se këtë punë e bëjnë për të nderuar Pejgamberin Allahut xh.sh.”*²⁶

Ulemaja thonë se në këtë natë është e pëlqyeshme të madhërohet Allahu, të këndohen salavate, të jepet sadaka, të bëhen punë të mira etj.. Nëse bëhen këto punë për hir të Allahut xh.sh. është sevap i madh.

Dihet mirëfilli se nga praktika, por edhe nga tradita shumëshekullore, mevludi është festë fetare e gjithë myslimanëve, që kremtohet e festohet në çdo përvjetor të Lindjes së Muhamedit a. s..

Te turqit, Dita e Mevludit për të parën herë u festua në periudhën e Sulltan Muratit të tretë (sundoi nga 1574-1595m.). Ishte ky sulltani i dymbëdhjetë me radhë nga sulltanët osmanë, për të cilin thuhet se bënte shpenzime marramendëse për

²⁶ Ahmed bin Abdu Es-Selam Ibni Et-Tejmijjeti, *“Iktidau Es Sirati El-Mustekim”*, pjesa e II-të, botoi “Daru El-Asimeti”, botimi i VII-të, Rijad, 1998 m. (1419 h.) f. 1 26.

këso festimesh.²⁷ Në Turqi edhe sot, që të gjithë; turq, arabë, kurdë, çerkezë, shqiptarë e boshnjakë, e këndojnë mevludin në gjuhët e tyre.

Te shqiptarët, siç dihet, Lindja e Muhammedit a.s. kremtohet e festohet në forma dhe organizime të ndryshme. Natyrisht, këndimi i mevludit nis me leximin e disa ajeteve të Kuranit e më pastaj këndohet ndonjëri prej mevludeve të shkruar apo të adaptuara në gjuhën shqipe apo disa pjesë të tij. Kjo punë bëhet nëpër shtëpi private, xhami, por edhe në institucione kulturore e fetare, etj, duke u shoqëruar edhe me ndonjë ligjëratë rasti.

Do theksuar se në Mbretërinë Saudite, për herë të parë vitin e kaluar 2016 (1438 h.), zyrtarisht u festua Ditëlindja e Muhammedit a.s. me bekimin e personaliteteve më të larta fetare e shtetërore.

Nga gjithë ajo që u tha deri me tash në lidhje me manifestimin e mevludit, bazuar në argumente, duhet ditur se manifestimi i mevludit nuk është detyrim i patjetërsueshëm, por është pjesë e traditës dhe kulturës sonë fetare-shpirtërore, është një mirësi (mustehab) që myslimanët, kudo ku janë e në veçanti në këto troje tona duhet ta shënojnë ditëlindjen e Pejgamberit a.s., ngase praktika po tregon se në mungesë të festimeve islame dhe nevojës së begatisë shpirtërore, te myslimanët, e në veçanti rinia, po orientohet në festa krejtësisht të huaja e që nuk kanë asgjë të përbashkët me identitetin e tyre fetar e kombëtar. Mesazhi qiellor porosit:

²⁷ Këto të dhëna janë marrë nga numri më i ri i revistës AlbIslam, i botuar më 1 Mars 2009).

إِنَّ اللَّهَ وَمَلَائِكَتَهُ يُصَلُّونَ عَلَى النَّبِيِّ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا صَلُّوا
عَلَيْهِ وَسَلِّمُوا تَسْلِيمًا ﴿سورة الأحزاب / ٥٦﴾

***“Vërtet All-llahu xh. sh. dhe melekët e Tij bien salavat
(lavdërojnë) për pejgamberin. O ju të cilët keni besuar,
lavdërojeni dhe ju atë (duke rënë salavat) dhe përshë-
ndetni me selam (Pejgamberin a.s.)”***²⁸

Është imperativ i kohës që t’u përkushtohemi fesë tonë, burimeve themelore të saj, Kuranit, haditheve të Muhamedit a. s., por edhe traditës sonë të lavdishme derisa ajo nuk bie ndesh me principet substanciale Islame, ngase këtu është shpëtimi jonë nga tjetërsimi. Falë islamit shqiptarët e ruajtën identitetin, gjuhën, kulturën lëndore dhe shpirtërore, në etnosin e tyre dhe masa dërmuese e tyre shpëtuan pa u sllavizuar, pa u greqizuar, pa u latinizuar dhe pa u turqizuar.

²⁸ Kur’ani, El -Ah’zab, ajeti 56.

Mr. Orhan BISLIMAJ

“ISTIDRAXHI”- MIRËSITË FATKEQE! (Shpjegim akaidologjik i hadithit të Pejgamberit a.s.)

1. Hyrje

Në këtë punim, do të flasim për çështjen e “istidraxhit” dhe për referencë bazike do ta kemi hadithin e saktë, si në vijim:

عن عقبة بن عامر رضي الله عنه عن النبي صلى الله عليه وسلم
قال: إِذَا رَأَيْتَ اللَّهَ يُعْطِي الْعَبْدَ مِنَ الدُّنْيَا عَلَى مَعْصِيَةٍ مَا يُحِبُّ
فَإِنَّمَا هُوَ اسْتِزْجَاجٌ، ثُمَّ تَلَا رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَلَمَّا
نَسُوا مَا ذُكِّرُوا بِهِ فَتَحْنَا عَلَيْهِمْ أَبْوَابَ كُلِّ شَيْءٍ حَتَّى إِذَا فَرِحُوا
بِمَا أُوتُوا أَخَذْنَاهُمْ بَغْتَةً فَإِذَا هُمْ مُبْلِسُونَ.

Transmeton Ukbete bin Amir r.a., se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Nëse e sheh se Allahu po ia plotëson njeriut atë çfarë dëshiron prej mirësive të dynjasë, ndërkohë që i njëjti vazh-

don të jetojë i zhytur në mëkate të mëdha, atëherë gjendja e këtillë është ‘istidraxh’ - futje graduale në kurthin tragjik”, pastaj (Pejgamberi a.s.) e lexoi ajetin e Kuranit: ***“Meqë e injoruan atë (shpalljen) me të cilën u këshilluan (t’i binden vetëm Zotit), Ne ua hapëm dyert e çdo gjëje (begatie), derisa kur u gëzuan për atë që u ishte dhënë, i kapëm befas e ata mbetën të pashpresë për asgjë.”*** (Hadith Sahih).

2. Konteksti i hadithit

- 1) Populli thotë *“harami trashet e trashet dhe në fund këputet, ndërsa hallalli hollohet e hollohet, por nuk këputet”*. Kjo fjali mjaft domethënëse është e vërtetë dhe e drejtë. Gjatë jetës së përditshme, shohim individë të ndryshëm, që disponojnë shumë mirësi të kësaj bote, në anën tjetër, i njohim mirë se janë njerëz të brishtë. Si është e mundur që Allahu t’ua plotësojë apetitet e tyre, gjersa dihet se nuk është i kënaqur me njerëzit zullumqarë, e për më shumë, në dorën e Tij, është mirësia, pasuria, autoriteti, fama dhe çdo gjë tjetër!? Por, ç’e do që, për këtë problematikë besimore e që konsiderohet prej atyre delikatesave akaidologjike, ka folur Kurani famëlartë dhe Pejgamberi a.s. në këtë hadith. Po ashtu, kanë folur edhe ulematë e ymetit, prej tyre si gjithmonë imam Ebu Hanife r.h.¹
- 2) Hadithi i sipërpërmendur, në fakt e potencon një princip prej urtësive të Allahut e që është “istidraxhi”- ndëshkimi

¹ “Istidraxhi”, edhe pse ka bazë në Kuran dhe Hadith, megjithatë shumë pak është trajtuar nga ulematë. E, kjo ka shkaktuar vështirësi shtesë, me rastin e parashtrimit, për shkak të mungesës së literaturës.

specifik i zullumqarëve nëpërmjet mirësive të dhuruara. Bile, dijetarët, e kanë cilësuar edhe si “kurth” (mekrun) e Allahut. Sepse, duke ua përmbushur zullumqarëve dëshirat relative, ata pasionohen akoma më shumë në tutelën e devijimit që vetë e kanë zgjedhur. E, pikërisht kjo gjendje, pra, kohëgjatësia dhe sasia e të këqijave, shndërrohen në depozitë fatkeqe, që determinojnë “istidraxhin” shkaktërrimtar kundër tyre, si një drejtësi e Allahut.

- 3) Njerëzit, që janë objekt i “istidraxhit”, janë modeli më i keq në shoqëri. Ata, krekosen me fuqinë e mirësive që disponojnë dhe janë të dhënë shumë pas dynjasë. Të gjitha meritat ia atribuojnë vetvetes, pra jo Allahut. Për më keq janë zullumqarë dhe përgënjeshtres aktivë kundër fesë (xhamisë) me arsyen se askush nuk ia ka parë hairin!? Si dhe shumë anomali të tjera!
- 4) Mbi të gjitha, hadithi implikon intencën e *edukimit* dhe *vetëdijësisimit* të besimtarëve të sinqertë, në mënyrë që mos t’i lakmojnë njerëzit zullumqarë, pavarësisht mirësive që i gëzojnë, sepse ato mund të jenë fatkeqe e që askush nuk do t’i dëshironte.

3. Domethënia dhe përmbajtja e “istidraxhit”

3.1. Domethënia e fjalës “istidraxh”

Para se të kalojmë në shqyrtimin kryesor të çështjes, është e rrugës që të sqarojmë domethënien gjuhësore të fjalës “istidraxh”. Nocioni “istidraxh”, në aspektin gjuhësor është

infinitiv i llojit të 10-të të foljeve të mbishtuara të gjuhës arabe dhe rrjedh prej fjalës “ed-derexhetu” - shkallë, afat kohor, etj. Si i tillë, ka disa domethënie:

- a) “Ngritje ose rënie graduale, shkallë-shkallë”
(الاستعداد أو الاستنزال، درجة بعد درجة);
- b) “Rrokullisje”, dmth, “përmbysja e një gjëje dhe palosja e saj pjesë-pjesë” (وهو لف الشيء وطيه جزأً فجزأً);
- c) “Periudhë kohore, afat i caktuar. Për shembull, kur thuhet: Allahu i ka bërë istidraxh robët (إستدرج الله العبد), kjo do të thotë: “e ka kapluar pak nga pak, dhe jo menjëherë, pra ia ka shtyrë dënimin dhe nuk ia ka përshpejtuar”
(أخذه قليلاً قليلاً ولم يباغته، أمهله ولم يعجل عذابه).² Me këto kuptime, nocioni “istidraxh”, ka ardhur në Kuran (shih: El-A’raf, 182).

3.2. Përmbajtja e “istidraxhit”

Në rastin më kuptimplotë, “istidraxhi” nënvizon ata individë, që kanë dëgjuar për shpalljen e Allahut dhe pejegamberin e Tij, por e përgënjeshtrojnë atë, po qoftë edhe një normë të saj, si dhe janë njerëz vepërkëqij e zullumqarë”. **Ky është pragu besimor në këtë çështje.** Në konvergjencë me këtë, imam Ebu Hanife r.h., kur flet për “istidraxhin”, e ndërlidh me krijesat më të brishta, siç është shejtani, Faraoni dhe Dëxhali, e që janë të ditur për armiqtësinë e tyre. Ndërsa, në

² Shih: Er-Rrazi, *Mefatihu'l gajbi - et-tefsiru'l kebir*, komentimi i ajetit El-A’raf, 182; Fjalori: “El-Mu’xhemu’l-lugatu’l arabij-jetu’l muasireh”, fjala “istedrexhe”, sipas: <https://www.almaany.com/ar/dict/ar-ar/إستدرج> / data e citimit: 26.09.2017.

kuptimin e përgjithshëm, “istidraxhi” i përfshin të gjithë ata njerëz që e pranojnë “haramin” po aq sa “hallallin”.

Personat që i kanë këto tipare, në parim janë objekt i “istidraxhit” të Allahut. Në atë mënyrë që Allahu, me urtësinë e Tij, ua plotëson nevojat, duke u dhënë mirësi të shumta e të ndryshme të kësaj bote, natyrisht sipas angazhimit dhe shkaktësisë. Veçse, këto mirësi, kanë diskurs të kurthit tragjik, duke i futur thellë e më thellë në tutelën e mashtrimit dhe brishtësisë që vetë e kanë zgjedhur. Bile, sa herë që bëjnë ndonjë të keqe të madhe, Allahu u hap një derë prej mirësive të dynjasë, që i katandi akoma më shumë në të këqija dhe mëkate, derisa u bëhen pjesë e pandashme e jetës. Nga ekzaltimi kulminant, shndërrohen në robër të mirësive, të cilat i adhurojnë në vend të Zotit të vërtetë (shih: El-Xhathijeh, 23). E harrojnë totalisht Krijuesin dhe, bëjnë një jetë, siç thotë Allahu, “të shfrenuar” (shih: El-Kehf, 28). Shpirti, zemra dhe gjymtyrët e tyre, nuk kanë asnjë gram yndyrë të mirënjohjes për Allahun fuqplotë (shih: El-Furkan, 43). Duke përbrendësuar thellësisht këtë mënyrë të jetesës, vetvetiu rivendosen në kundërshtarë (anti teistë) dhe armiq të fesë së Allahut. Për më keq, e pëlqejnë vetveten dhe krenohen me veprimet e tyre zullumqare, gjersa besojnë se veprimet e tyre janë “keramet” - nderim prej Krijuesit!³ Në të vërtetë, këtu fillon dhe mbaron ngjizja e vërtetë e “istidraxhit” me përmbajtjen faktike të individit, ku verbëria e tij shpirtërore, ka shkuar aq larg sa nuk e kupton brishtësinë e vetvetes. Në këtë pikë, “istidraxhi” interferon me “hidhlanin”, që konsiston lënien e

³ Ibni Kethiri, *Tefsiru'l Kurani'l Kerim*, komentimi i ajetit El-Kalem, 44.

njeriut në humbje të thellë dhe pafuqishmërinë e tij për të ardhur deri te udhëzimi (hidajeti).⁴ Të gjetur në këtë gjendje të mykur shpirtërore, pason “istidraxhi” i Allahut si reaksion kundër tyre. E, kjo do të thotë se zullumqarët, dalëngadalë përfundojnë në kurthin shkatërrimtar, që u vjen prej kah nuk e kujtojnë (shih: El-A’raf, 182).⁵ Ajeti në vijim, e sqaron më së miri atë që dëshirojmë ta themi: ***“Meqë e injoruan atë (shpalljen) me të cilën u këshilluan (t’i binden vetëm Zotit), Ne ua hapëm dyert e çdo gjëje (begatie), derisa kur u gëzuan për atë që u ishte dhënë, i kapëm befás, e ata mbetën të pashpresë për asgjë (mublisune).”*** (El-En’am, 44).

Pas goditjes nga Allahu, zullumqarët mbesin në një gjendje të mjerë e për keqardhje. Bile, populli shpesh herë thotë, *“e ka zënë haku”*, duke aluduar në zullumin ndaj njerëzve dhe armiqësinë kundër fesë! Sipas ulemave, ky lloj i dënimit është më i rëndi, sepse fjala *“mublisune - të zhgënjyer”*, që ka ardhur në ajet, do të thotë gjuhëzohen përfundimisht dhe mbeten të pashpresë për rimëkëmbje.⁶ Përveç kësaj, dënimi i befasishëm në gjendje të mirësive është dënimi më i rëndë, për shkak të kontrastit të thellë, në mes kënaqësisë dhe vuajtjes. E, përtej kësaj, ajo kënaqësia e mirësive, do të mbetet si predispozitë për hakmarrje kapitale në botën tjetër (موجبة لنقمتهم الآخروية).⁷

⁴ Më gjerësisht, për problematikën e “hidhlanit”, shih: Orhan Bislimaj, *Akaidi Hanefij*, Prizren, 2008, fq. 511 e tutje.

⁵ Er-Rrazi, *Mefatihu’l gajbi - et-tefsiru’l- kebir*, komentimi i ajetit El-A’raf, 182.

⁶ El-Begavij, *Mealimu’t-tenzil*, komentimi i ajetit: El-En’am, 44.

⁷ Shih: Aliju’l-Kari El-Hanefij, *“Sherhu Kitabi’l fikhi’l ekber”*, darul kutubi’l ilmijeh’, botimi i parë, Bejrut-Liban, 1995/1416, fq. 134.

4. Mirësitë si predispozitë e “istidraxhit”

4.1. Allahu është Krijues i mirësive

Në hadithin që e kemi vendosur në ballë të këtij punimi, Pejgamberi a.s. “istidraxhin” e ka ndërlidhur me mirësitë që njeriu i posedon. Mendoj se duhet të sqarojmë çështjen e mirësive, në mënyrë që ta kuptojmë drejt çështjen e “istidraxhit”. Me fjalën “mirësi - ni’met (النِّعْمَةُ)” nënkuptojmë atë që Allahu ia dhuron njerëzve prej rrizkut, pasurisë, etj. (ما وهبه الله من رزق ومالٍ وغيرهما).⁸ Me një fjalë, Allahu është Krijuesi, Furnizuesi dhe Pronari i vërtetë i të gjithë mirësive (En-Nahl, 53) që njerëzit i posedojnë, ndërsa njeriu është vetëm shfrytëzues i tyre dhe assesi krijues (shih: Ibrahim, 34).⁹ Asgjë nuk ndodh rastësisht dhe pa lejen e Tij. Besoj se kjo është e qartë dhe, në këtë pikë, nuk kemi nevojë të zgjatemi më shumë.

4.2. Implikimi i mirësive në procesin e “istidraxhit”

Në diskutimet e hershme akaidologjike, “istidraxhi”, më shumë është përdorur si koncept fetar, që ka pasur për identifikim ekskluzivisht “mirësitë e jashtëzakonshme”, që i kanë zotëruar disa prej armiqve të hapur të Allahut. Bëhet fjalë për disa mirësi, t’i quaj favore, siç i ka pasur, për shembull, Fara-

⁸ “*El-Mu’xhemu’l-lugatu’l arabij-jetu’l muasireh*”, fjala “en-ni’metu”, sipas: <https://www.almaany.com/ar/dict/ar-ar/نعمة/> data e citimit: 26.09.2017.

⁹ Më gjerësisht rreth emrave të Allahut “El-Vehhab - Dhuruesi absolut” dhe “Er-Rrezak- furnizuesi absolut”, shih: Taha Abdur-Reuf Sa’d, *Sherhu Es-mai’l-Lahi’l husna Li’r-Rrazi*, el-mektebetu’l ez’herijjetu li’t-turath, pa vend të botimit, 1420/2000, fq.219-221.

oni, i cili ka pasur mundësi që ta ndërrojë rrjedhën e rëndomtë të lumit Nil, dhe ngjarja e tij është përmendur në Kuran. Apo, veprimet e magjistarëve, duke realizuar veprime çuditëbërëse, etj. Këto mirësi, u konsideruan si “istidraxh”, sepse vetë protagonistët e tyre kanë qenë zullumqarë të spikatur. Natyrisht, kjo problematikë u bë temë diskutimi në mesin e dijetarëve të hershëm. Sepse, thënë të drejtën, sikurse sot, edhe në të kaluarën, njerëzit kanë pasur bindje se nuk mund të bëjë askush veprime të natyrës “çuditëbërëse”, përveç pejgamberëve. Prandaj, posedimi i tyre, nga zullumqarët, ka krijuar amulli besimore në mesin e besimtarëve.

Në këtë kontekst, gjersa disa fraksione islame e mohuan mundësinë që armiqtë e Allahut të disponojnë veprime çuditëbërëse, në anën tjetër, dijetarët e “ehlus-sunneti vel xhematit” e pranojnë faktin se edhe armiqtë e Allahut mund të posedojnë mirësi të këtilla, por ato mirësi i cilësuan si plotësim i synimeve me diskurs të “istidraxhit”¹⁰, bazuar në ajetet e Kuranit dhe hadithet e Pejgamberit a.s.. Imam Ebu Hanife r.h. thotë: “Ne nuk i quajmë ato “mu’xhize” (mrekulli) dhe as “keramete” (e të cilat janë veçori vetëm për evlijatë – të dashurit e Allahut), mirëpo ne i quajmë ato **plotësim i nevojave** (synimeve) të tyre dhe kjo për faktin se Allahu xh.sh. ua plotëson nevojat armiqve të Tij me qëllim të shkatërrimit gradual (në këtë botë) dhe dënimit (në botën tjetër), ashtu që ata duke u mashtruar i shtojnë mëkatet ose mosbesimin. Të

¹⁰ Shih: Tetan dhe El-Kilani, *Avnu'l muridi lish-sherhi xhevheret'it-tevhidi fi akideti Ehli Sunneti ve'l xhemaati*, Darul Beshair, botimi i dytë, pa vend botimi. 1999/1419, vëll.II, fq.944.

gjitha këto janë të lejuara nga Allahu për të ndodhur dhe janë të mundshme (nga aspekti i arsyes).¹¹

Duke e pranuar për të mirëqenë këtë që u tha më sipër, vërtetojmë se mirësitë që gjenden në duart e zullumqarëve, janë fatkeqe dhe “istidraxh” i Allahut kundër tyre.

4.3. Tjetërsimi i mirësive nga vetë njeriu

E kuptojmë se është pak kontraverse gjersa themi se zullumqari do t’ua shohë sherrin mirësive!? Apo kur themi se Allahu do ta ndëshkojë zullumqarin nëpërmjet mirësive të dhuruara!? Por, kur e shikojmë çështjen pak më thellë, e vërtetojmë se kjo është e justifikueshme dhe e arsyeshme. Në fakt, e gjithë problematika ka të bëjë me keqpërdorimin e mirësive të dhuruara nga Allahu dhe jo me vetë mirësitë. Sepse, në parim, të gjitha mirësitë që njerëzit i posedojnë, qofshin në duart e mëkatarëve apo vepërmirëve, janë prej Allahut dhe përmbajnë elementin e dobisë. Mirëpo, njerëzit janë ata që e ndërrojnë efektshmërinë e mirësisë dhe, pikërisht këtu ndërtohet filozofia e “istidraxhit”. Për shembull: “dija” është mirësi, “pasuria” është mirësi, “bukuria”, “fuqia” etj, janë mirësi. Mirëpo, nëse njeriu dijen e përdor për zbulime shkatërruese, ajo shndërrohet në mirësi fatkeqe për vetë atë, apo pasurinë për veprime kriminale. Njësoj është edhe për të gjitha mirësitë e tjera. Vetë njeriu, është faktori që i shndërron mirësitë e mirëfillta (en-nimetu), në mirësi të dënueshme (en-nikmetu). Ulematë e sjellin si shembull flakërimën ndaj jetimit, në shenjë edukimi (تأديبا) dhe në shenjë lëndimi apo

¹¹ El-Magnisavi, *Sherhul fikhil ekber*, Daru Nil, Stamboll, 2007, fq. 49-50.

fyerjeje (إيذاء). Edhe pse bëhet fjalë për të njëjtin akt, megjithatë në rastin e parë është sevap, ndërsa në rastin e dytë është mëkat.¹² Më lart e përmendëm Faraonin. Allahu i pati dhënë mirësi, por i pati dërguar dhe pejgamberë për ta mësuar rreth shfrytëzimit të mirësive për çështje të dobishme. Në analogji me këtë, Allahu u jep mirësi njerëzve të kohës tonë, por u ka thënë që të jenë falënderues ndaj Allahut dhe jo mohues e keqbërës. Prandaj, për këtë “shndërrim të mirësive”, njeriu bart barrën e përgjegjësisë para Krijuesit që manifestohet nëpërmjet “istidraxhit”: ***”...E kush e ndërron të mirën e Allahut pasi që t’i ka ardhur ajo, s’ka dyshim se ndëshkimi i Allahut është i ashpër.”*** (El-Bekare, 211).

Domethënë, mirësitë për nga aspekti i efektshmërisë, janë dy sosh: a) Mirësitë fatlume - lumturuese (en-ni’metu), që nuk janë objekt i “istidraxhit”; dhe b) Mirësitë fatkeqe - ndëshkuese (en-nikmetu), që janë drejtpërdrejt objekt i “istidraxhit”¹³

4.4. Mirësitë fatlume - lumturuese (النعمة)

Mirësitë fatlume apo lumturuese janë ato që i mundësojnë shfrytëzuesit të tyre lumturi të përhershme, në dy botët, sepse është i denjë, dhe atë për dy arsye: a) është falënderues ndaj Allahut për ni’metet e dhëna; dhe b) i kujdesshëm për

¹² Shih: Vehbi Sulejman Gavoxhi, *Er-Revdul ez’her fi sherhi’l-fikhi’l-ekber*, darul beshairil islamijeti, botimi i parë, 1997, fq. 160.

¹³ Shih:

<http://fatwa.islamweb.net/fatwa/index.php?page=showfatwa&Option=FatwaId&Id=291913>, data e publikimit 09.04.2015, data e citimit: 15.09.2017.

shfrytëzimin e tyre në mënyrë korrekte. Me rastin e fitimit të pasurisë, shfrytëzuesi i mirësive fatlume, kujdeset që ta fitojë “hallall”, dhe jo “haram”. Kjo është ajo, që populli ynë, gjatë marrëdhënieve ndërnjerëzore, i thonë njëri-tjerit: “ma bëj hallall!”. Domethënë, e kanë brengë arritjen e mirësive “hallall” dhe ky akt tregon mendësinë falënderuese ndaj Allahut. Prandaj, ky lloj i mirësive nuk implikon elemente të “istidraxhit”. Veçse, shfrytëzuesi i tyre nuk është imun ndaj sprovave të dynjasë e të cilat u ndodhin njerëzve, pa dallim.

4.5. Mirësitë fatkeqe - ndëshkuese (البَقْمَة)

Ndërsa, mirësitë fatkeqe janë ato që shfrytëzuesit të tyre i mundësojnë mashtrim dhe afrim gradual drejt fundosjes së sigurt, nëpërmjet procesit të “istidraxhit”. Kjo ndodh, atëherë kur njeriu i arrin mirësitë që i do, një pas një, ndërkohë që është i përfshirë në mëkate dhe të këqija nga të gjitha anët, sipas hadithit të Pejgamberit a.s.: *“Nëse e sheh se Allahu po ia plotëson njeriut atë çfarë dëshiron prej mirësive të dynjasë, ndërkohë që i njëjti vazhdon të jetojë i zhytur në mëkate të mëdha, atëherë gjendja e këtillë është ‘istidraxh’ - futje graduale në kurthin tragjik”*

Në të vërtetë, në ajetin e mëposhtëm, Allahu e sqaron se mirësitë ndaj mëkatarëve, përfshirë edhe fëmijët, nuk janë fare mirësi me plotë kuptimin e fjalës, por mjet specifik i ndëshkimit ndaj tyre: *“Andaj, ti (Muhamed) lëri ata edhe një kohë në atë mashtrimin e tyre. A mos mendojnë ata se me atë që jemi duke u dhënë atyre nga pasuria dhe fëmijët, Nxitojmë*

t'u ofrojmë atyre të mirat? Jo, kurrësi, por ata nuk janë kah e kuptojnë.” (El-Muminun, 54-56).

4.6. Mirësitë nuk përcaktojnë dashurinë e Allahut xh.sh.

Me vetë faktin se Allahu u jep mirësi edhe armiqve të Tij, është treguesi i qartë se mirësitë nuk përcaktojnë dashurinë e Allahut ndaj akëcilit person. Disa njerëz mendojnë se të varfrin nuk e do Allahu, ndërsa të pasurin po, duke e marrë si justifikim elementin e mirësive. Ky perceptim nuk është i saktë. Ngase, Allahu nuk e ndalon rrizkun për pabesimtarët, për shkak të mosbesimit të tyre, e as për mëkatarët për shkak të mëkatit të tyre. Por, Allahu ua jep edhe atyre dhe i furnizon, është i butë ndaj tyre dhe i durueshëm, ashtu siç ka thënë i Dërguari i Allahut:

ما أحد أصبر على أذى يسمعه من الله تعالى؛ إنهم يجعلون له نداءً،

ويجعلون له ولدًا، وهو مع ذلك يرزقهم ويُعافيهم ويُعطيهم

“Allahu është durimtar i pa krahasueshëm për ofendimet që vetë i dëgjon: ata i bëjnë ortak Allahut dhe i atribuojnë fëmijë, ndërsa krahas këtyre, Ai (Allahu) i furnizon me mirësi, i falë dhe u jep mirësi” (Hadith sahih).¹⁴

¹⁴ Shih: Ismail Esh-Sherkavij, *En-Nasu bejne istidraxhi'l halimi ve hubil kerimi subhanehu*, sipas: <http://www.alukah.net/sharia/0/38665/>, data e publikimit: 25.02.2012, data e citimit: 15.09.2017.

5. Shkaqet e "istidraxhit"

a) Përgënjeshtrimi i shpalljes së Allahut xh.sh.

Gjersa, mohimi i shpalljes së Allahut (Kuranit), apo i pejgamberisë së Muhamedit a.s. është prej veprave më të këqija, në anën tjetër, përgënjeshtrimi i tyre është më shumë se mohim dhe injorim i fesë. Ai, interferon urrejtjen dhe tendencën arrogante të individit për ta shkatërruar çdo kulturë me bazë fetare. Thjesht, është armiqësi kundër fesë. Në analogjinë njerëzore, kjo i bie, kur njeriu ia kthen me armiqësi, dikujt që ka përfituar të mira prej tij. Natyrisht, kjo krijon nervozizëm. Në këtë rast, Allahu i ka dhënë mirësi njeriut, ndërsa ky ia kthen me përgënjeshttrim. Allahu kur ka folur për popullin e pejgamberit Salih a.s., nuk thotë se mohuan pejgamberin e tyre, por e përgënjeshtroan (tekdhëb), domethënë akoma më keq (shih: Esh-Shems, 11). E, për të tillët, Allahu ka thënë: *"E, ata që i përgënjeshtrojnë argumentet Tona, Na, dalngadalë, do t'i shpiem kah shkatërrimi pa e kuptuar ata."* (El-A'raf, 182).

b) Zhytja në mëkate dhe të këqija

Gjersa përgënjeshtrimi ka të bëjë me aspektin teorik të fesë, në relacionin e njeriut me Krijuesin, në anën tjetër, kaplimi në mëkate dhe të këqija, është refleksion i të keqes së individit në relacionet ndërs shoqërore. Këtu bëjnë pjesë, të gjitha ato që konsiderohet si zullum ndaj vetvetes dhe shoqërisë, siç janë: vetitë dhe veset e këqija, keqbërja, padrejtësia dhe keqpërdorimi i tjetrit, përvetësimi i pasurisë së huaj, vrasja e padrejtë, dezertimi nga fronti i luftës, si dhe shumë të tjera. Në kaptinën El-En'am, Allahu i Madhërishëm, pasi që

përmend se gjeneratave të kaluara u ka dhënë mirësi dhe komoditet në tokë, çfarë nuk i kishte dhënë brezit të Pejgamberit a.s., në përmbyllje të këtij konteksti e thotë frazën që neve po na intereson: ***“Por, për shkak të mëkateve të tyre i shkatërruam dhe pas tyre sollëm (breza) tjerë.”*** (El-En’am, 6).

c) Injorimi i mirësive të Allahut

Natyrisht, Allahu hidhërohet me atë njeri, që nuk e falënderon Krijuesin për mirësitë e dhuruara, por që meritat ia atribuon vetvetes. Sufjan Eth-Thevriu, duke shpjeguar ajetin e “istidraxhit”: ***“dalngadalë do t’i shpiem kah shkatërrimi, pa e kuptuar ata.”*** (El-A’raf, 182), thotë: “do t’ua përmbushim mirësitë, veçse do t’i bëjmë që të harrojnë falënderimin ndaj Krijuesit”. Ndërsa, Ebu Revk, thotë: “...do t’i bëjmë ta harrojnë kërkimfaljen tek Allahu.”¹⁵ Domethënë, injorimi i mirësive është shkak për “istidraxhin”.

6. Istidraxhi është gjithëpërfshirës

Askush nuk mund t’i shmanget “istidraxhit”, pavarësisht bindjen fetare, gjersa është pjesë e njerit prej shkaktarëve të lartpërmendur. Natyrisht, një njeriu nuk mund t’i shkruhet se është i keq për një rrëshqitje të rastit, por, atëherë, kur mizorinë e ka tipar individual dhe substrat të orientimit personal. Populli thotë: “filani ish’ i dalët fare”, kur dëshmon për të keqën e dikujt.

¹⁵ Shih: El-Kurtubij, *El-Xhamiu li ahkami’l kur’an*, komentimi ajetit, El-Kalem, 44.

Hazreti Omeri, r.a., edhe pse ishte njeri shumë i devotshëm, megjithatë, kur e mbizotëroi thesarin e madh të Kiswa bin Hurmuzit, kishte thënë: “O Allahu im, kërkoj mbrojtjen Tënde, që kjo të mos jetë “istidraxh”, se unë e kam lexuar në Kuran atë që e ke thënë:

“...Na, dalngadalë, do t'i shpiem kah shkatërrimi, pa e kuptuar ata.”

اللهم إني أعوذ بك أن أكون مستدرجاً فإني سمعتك تقول
سَسْتَدْرِجُهُمْ مِّنْ حَيْثُ لَا يَعْلَمُونَ¹⁶.

Veçse, kur jemi këtu, duhet bërë dallim në mes të “istidraxhit” dhe “sprovave”. Çdo fatkeqësi që i vjen njeriut, në gjendjen e tij si përgënjeshtues i shpalljes, atëherë ajo është në diskurs të “istidraxhit”, ndërsa çdo fatkeqësi (sprovë) që i vjen njeriut, në gjendjen e tij si njeri i devotshëm dhe falënderues ndaj Allahut, ajo është sprovë, me të cilat janë goditur edhe pejgamberët.¹⁷ Për më shumë, këto sprova, mbase janë pastrim prej Allahut nga mëkatet dhe mundësi reale për pendim. Transmeton Termidhiu se Pejgamberi a.s. ka thënë:

إِذَا أَرَادَ اللَّهُ بِعَبْدِهِ الْخَيْرَ عَجَّلَ لَهُ الْعُقُوبَةَ فِي الدُّنْيَا وَإِذَا أَرَادَ اللَّهُ
بِعَبْدِهِ الشَّرَّ أَمْسَكَ عَنْهُ بِذَنْبِهِ حَتَّى يُؤَافِي بِهِ يَوْمَ الْقِيَامَةِ
*“Me të vërtetë, kur Allahu ia do të mirën një njeriut,
ia përshpejton dënimin në këtë botë, ndërsa kur nuk*

¹⁶ Er-Rrazi, *Mefatihul gajbi – et-tefsiru'l kebir*, komenti i ajetit El-A'raf, 182.

¹⁷ Shih: Et-Taftazani, “*Sherhu'l akaidi'n-neseftijjeti*”, Daru'l bejruni, pa vend dhe vit botimi, fq.221; Tetan dhe El-Kilani, *Avnu'l muridi...*, po aty, vëll.II, fq.798.

*ia do të mirën, e kap me mëkate, e pastaj i shpague
ato në ditën e kiametit.” (Hadith sahih).*

7. Manifestimi i “istidraxhit”

Natyrisht, kandari i Allahut është i saktë dhe peshon në hollësi çdo detaj të veprave të njeriut. Me këtë dëshirojmë të themi se “istidraxhi” i Allahut ndaj njerëzve, nuk është i njëjtë për të gjithë. Ai shfaqet në proporcion me nivelin e brishtësisë së individit dhe kjo për Allahun është fare e lehtë. Manifestimi i “istidraxhit” në jetën e njerëzve, shfaqet në disa mënyra:

a) Kasaveti i zemrës dhe trazimet shpirtërore

Ne shohim përditë se si njerëzit kanë shqetësime të vazhdueshme shpirtërore. Ose, më mirë të themi, vuajnë për mungesën e lumturisë, pavarësisht se i kanë kushtet e mira të jetesës. Karakterizohen me trazime të njëpasnjëshme shpirtërore, e të cilat shtrihen në sipërfaqen e gjithë trupit. Sepse, lumturisë së tyre u mungojnë rrënjët e mirëfillta. Ajo përngjason me njeriun që është vjerrur në një litar e që ndonjëherë me njëren këmbë prek në tokë, sa për të mbijetuar. Me këtë gjendje, përballen të gjithë ata që ushqejnë koncepte të brishta në jetën e tyre, siç është përgënjeshtrimi i shpalljes, involvimi në të këqija apo injorimi i mirësive të Allahut. Sepse, qetësia shpirtërore i ka rrënjët në çiltërsinë e bindjeve që burojnë nga zemra e shëndoshë: “*...pra ta dini se me të përmendur Allahun zemrat stabilizohen.*” (Er-Rra’d, 28). Logjika e përgjithshme e Kuranit është që sa më afër xhamisë aq më

afër lumturisë dhe e kundërta, sa më larg xhamisë aq më larg lumturisë. Në këtë rast, xhamia është në pyetje si nocion emblematic i orientimit të shëndoshë dhe largimit nga anomalitë njerëzore.

Prandaj, dijetarët, duke folur për pasojat e “istidraxhit”, thonë se dënimi më i ashpër është ngurtësimi apo siç thotë populli “kasaveti i zemrës” (قَسْوَةُ الْقَلْبِ), si një paradigmë e fshehur, që e pengon robin nga udhëzimi i Allahut.¹⁸ Imam Kurtubiu, r.h., përmend një person nga populli Beni Israil, i cili, me inercion i drejtohet Allahut: *“O Zot, sa e sa mëkate po i bëj, por Ti nuk po më dënon. E, Allahu ia shpalli pejgamberit të asaj kohe, duke i thënë: Thuaj atij: sa e sa dënime t’i kam lëshuar, por nuk je duke i vërejtur, shtangitja e syve dhe kasaveti i zemrës, janë “istidraxh” dhe dënim nga ana ime, nëse e kupton!?”*

(يا رب، كم أعصيك وأنت لا تُعاقبني، قال: فأوحى الله إلى نبيِّ

زمانهم أن قلْ له: كم من عقوبةٍ لي عليك وأنت لا تشعر، إنَّ

جمود عَيْنِكَ وقساوة قلبك، استدراجٌ مني وعقوبةٌ لو عَقَلْتَ).¹⁹

b) Përfundimi në “kurthin” e Allahut

Vetë përmbajtja e “istidraxhit” i përngjason kurthit trajgjik. Në lidhje me istidraxhin ndaj njerëzve meritore, Allahu I lartësuar thotë: ***“Dhe, do t’i lëmë të jetojnë deri në një afat kohor. Me të vërtetë dënimi Im është i fortë.”*** (El-A’raf, 182). Në këtë ajet të shkurtër, i Madhi Allah ka përdorur dy sintagma: *“afatin kohor”*, që nënvizon neglizhimin e ndëshkimit

¹⁸ Ismail Esh-Sherkavij, *En-Nasu bejne istidraxhi’l halimi...*, po aty.

¹⁹ El-Kurtubij, *El-Xhamiu li ahkami’l kur’an*, komentimi ajetit, El-Kalem, 44.

me qëllim të paramenduar, si dhe e ka përmendur “*dënimin ndaj tyre*”, e të cilin e ka nënvizuar si “kejdun” - kurth, ngase i vjen njerëzve pa e hetuar fare. Zaten, këtë rol e ka kurthi, që të arrij dëmtimin apo shkatërrimin e armikut nëpërmjet meto-dave të fshehura, pa e hetuar ai një gjë të tillë.²⁰ Në Kuran, kudo që është përmendur fjala “kurth”, ka ardhur si një kundërvënie ndaj kurtheve të zullumqarëve si një “istidraxh” i Allahut, kundër tyre.²¹

Pa dyshim, kjo formë e “istidraxhit”, pra përmes “afatit kohor” bart një urtësi të madhe, ani pse, palët e dëmtuar, du-an që ta shohin ndëshkimin e zullumqarëve, menjëherë pas zullumit. Këtë, Allahu e sqaron në Kuran: **“Të mos mendojnë ata që nuk besuan se afatin që u dhamë Ne atyre të jetojnë, është në dobi të tyre. Ne, me të vërtetë, i lamë të jetojnë vetëm që të shtojnë edhe më shumë mëkate, se ata i pret një dënim nënçmues.”** (Ali Imran, 178). Duke i lënë në humbjen e tyre, zullumqarët akumulojnë sa më shumë padëgjueshmëri, e për të cilat po për aq do të ndëshkohen.²² Kështu, ia ka plotësuar nevojat Faraonit, e ai qëndroi në sundim 400 vjet pa iu thyer asnjë gjë më e vogël,²³ mirëpo, erdhi momenti i rënies në kurth. Por, kurthi i Allahut vepron vazhdimisht dhe e godet secilin që është zullumqarë e përgënjeshtues. Ne jemi dësh-

²⁰ Shih: *FJALOR i shqipes së sotme*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i gjuhësisë dhe letërsisë, botimet toena, Tiranë, 2002, fq.637.

²¹ Shih: El-Bejhekiu, *El-Esmau ves-sifat*, Daru Ibni Rexheb, botimi i parë, pa vend dhe vit të botimit, fq.606.

²² Vehbi Sulejman Gavoxhi, *Er-Revdul ez’her...*, po aty. fq.241.

²³ El-Bejadij El-Hanefij, *Isharatu’l meram min ibarati’l imam*, botimi i parë, 1368/1949, Kajro, fq. 339.

mitar të përçmimit të personave, në një mënyrë apo tjetër, e që ngelin në një gjendje për keqardhje. Sot, njerëzit, bëjnë me gisht në drejtim të tyre, për shkak të zullumit dhe armiqësisë që dikur e kanë promovuar kundër udhëzimit të Allahut. E, Allahu, ka premtuar se ai që e përgënjeshtroi udhëzimin e Tij, do të ketë jetë të vështirë (Taha, 124). Ky është vendim i prerë, që implementohet në momentin e caktuar, sikurse thotë Pejgamberi a.s.:

إِنَّ اللَّهَ لَيَمْلِكُ لِلظَّالِمِ حَتَّى إِذَا أَخَذَهُ لَمْ يُفْلِتْهُ

“Me të vërtetë Allahu e lë zullumqarin të jetojë në mirësi, veçse kur e kap me ndëshkim, atëherë nuk e lëshon deri në fund.” Pastaj e lexoi ajetin vijues: “Ja, kështu është ndëshkimi i Zotit tënd, kur dënon vendet që janë zullumqare. Vërtet, ndëshkimi i Tij është i dhimbshëm e i ashpër.” (Hud, 102).

c) Dënimi i befasishëm

Në kuadër të “istidraxhit”, dënimi i befasishëm nënkupton shkatërrimin përfundimtar të zullumqarëve dhe përgënjeshtresve, gjersa janë në kulmin e kënaqësisë. Të tillët nuk kanë hapësirë për përmirësim apo shpagim të zullumit të tyre gjatë kësaj jete. Kurani përmend shumë shembuj të shkatërrimit të befasishëm, e njëri prej tyre është ai i Karunit. Allahu tregon se i pati dhënë aq pasuri sa çelësat e pallatit të tij me vështirësi i kanë bartur disa vetë të fortë. Populli e këshillonte, që të jetë bamirës, ashtu siç Allahu i ka bërë mirë atij, duke i thënë që ta fitojë botën e tjetër dhe mos të bëjë të këqija në tokë, ngase All-llahu nuk i do çrregulluesit. Të gjitha këto kanë ardhur në Kuran në kaptinën El-Kasas, ajetet

76-82. Mirëpo, Karuni, në vend se të përmirësohej dhe të bëhej falënderues ndaj Allahut, ai e bëri të kundërtën. Doli para popullit me stolinë marramendëse e tha: ***“Më është dhënë në vetëm në saje të dijes sime!”*** Ngjashmërisht me njerëzit e kohës tonë, që ia atribuojnë vetës meritat dhe jo Allahut. Pas kësaj, Allahu thotë në Kuran: ***“Po, Ne atë dhe pallatin e tij i shafuam në tokë dhe, veç Allahut nuk pati që ta mbrojtë e as vetë nuk pati mundësi të mbrohet.”***

8. Konkludim

Në bazë të asaj që u tha më lart, mund të konkludojmë si në vijim:

- 1) “Istidraxhi” i Allahut ndaj njerëzve meritore, gjatë jetës së kësaj bote, është i vërtetë dhe ka mbështetje në Kuran dhe Hadith;
- 2) Shkaktarët kryesorë të “istidraxhit” janë: përgënjeshtrimi i shpalljes, zullumi çfarëdo qoftë ai dhe injorimi i mirësive të Allahut;
- 3) “Istidraxhi”, në parim i përfshin të gjithë njerëzit meritore, pavarësisht orientimin e tyre fetar dhe, manifestohet nëpërmjet trazimeve shpirtërore, përfundimit tragjik në kurthin e Allahut apo nëpërmjet shkatërrimit të befasishëm, varësisht prej intensitetit të brishtësisë së individit;
- 4) Shpëtimi nga kurthi i “istidraxhit” mund të arrihet vetëm duke braktisur shkaktarët e “istidraxhit”, si dhe duke përvetësuar udhëzimin e Allahut, gjatë jetës së përditshme, si një mëshirë e zbritur për gjithë njerëzimin.

HISTORI E ARSIMIT

Dr. Sadik MEHMETI

SHKOLLAT E MESME TË LARTA (MEKTEBET IDÂDIJE) NË KOSOVË 1885-1912

Vështrim i përgjithshëm

Në vitin 1869 në kuadër të reformave të përgjithshme në sistemin arsimor osman dhe të avancimit të tij me plane mësimore laike, Rregullorja për Arsimin e Përgjithshëm (*Maârif-i Umûmiye Nizâmnamesi*) e Perandorisë Osmane, pas shkollave fillore (mektebeve) dhe shkollave të mesme të ulëta (rushdijeve) parashihte themelimin edhe të shkollave *idâdije*.

Në të vërtetë, *idâdijet janë shkolla të periudhës së fundit në Perandorinë Osmane, dhe ato ishin në një shkallë të njëjtë me shkollat e mesme të sotme-gjimnazet.*

Sipas nenit 34 të Rregullores... së sipërpërmendur, shkollat *idâdije*, parashiheshin të hapeshin në të gjitha vendbanimet që kishin më shumë se 1.000 shtëpi. Por, pavarësisht

kësaj, kjo politikë nuk arriti të vihej në praktikë, përveç të tjerash, edhe për mungesë të vështirësive financiare dhe buxhetit të limituar, i cili, në periudha të ndryshme, nuk lejonte të hapeshin shkolla idâdije.¹

Gjatë zhvillimit të tyre historik, shkollat idâdije, kanë njohur disa ndryshime, për sa u takon ciklit arsimor, kohë-zgjatjes dhe planeve mësimore.

Neni 38 i Rregullores... së përmendur, parashihte që kohëzgjatja e shkollave idâdije të ishte 3 vjeçare. Në vitin 1887 idâdijet u bënë 4 vjeçare². Këtë vit u ndërtuan edhe shkollat e para idâdije me konvikt. Një e tillë u ndërtua edhe në *Manastir*³.

Një reformë mjaft e përqendruar e shkollave idâdije ndodhi në vitin 1892, kur idâdijet jo të plota u bënë 5 vjeçare, kurse ato të plota 7 vjeçare. Dhe meqë kufizimet financiare nuk lejonin që në çdo sanxhak dhe në qendër të vilajetit të hapeshin idâdije të plota, sepse shpenzimet e idâdijeve të plota (me konvikt) paraqiteshin si barrë e rëndë për qeverinë, dhe ngaqë shpenzimet e tyre ishin 5-6 fish më të mëdha se ato jo të plota; u vendos që në sanxhaqe të hapeshin idâdije jo të plota, kurse në qendra të vilajeteve të hapeshin idâdije të plota⁴. Kështu idâdijet jo të plota në sanxhaqe, në kuadër të

¹ Më gjerësisht, shih: Ekmeleddin Ihsanoğlu, *Institucionet studimore-shkenço-re dhe arsimore osmane*, në: Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman, vëll. II, AIITC, Tiranë, 2009, f. 462-463.

² Derya Demirel, *Osmanli devleti'nde sultaniler ve idâdiler*, Samsun 2007, f. 108.

³ Ekmeleddin Ihsanoğlu, *Institucionet studimore...*, po aty, f. 464.

⁴ Bayram Kodaman, *Abdulhamit Devri Eğitim Sistemi*, Ankara, 1994, f. 122-124.

tyre, nënkuptonin: 3 vjet të shkollës rushdije dhe 2 vjet të idâdijes (siç ishte shembulli me idâdijet e Kosovës) dhe 2 vitet e tjera që duhej të plotësoheshin në ndonjë idâdije në qendra të vilajeteve (siç ishte idâdija e Shkupit, Manastirit, Selanikut, Shkodrës etj.).

Në vitin 1902 shkollat idâdije kanë njohur edhe një ndryshim, qoftë për sa i përket kohëzgjatjes, qoftë për sa i përket planin mësimor. Në idâdijet jo të plota, përveç planit bazë, u shtuan edhe disa lëndë tjera, si agronomia, ekonomia dhe artet, kurse u reduktuan mësimet fetare. Mirëpo meqë programi ekzistues rezultoi si shumë i ngarkuar për nxënësit, atëherë kohëzgjatja në shkollat idâdije jo të plota u bë 6 vjeçare, kurse ato të plota dhe me drejtimet e përmendura, u bënë 8 vjeçare. Kjo zgjati deri në vitin 1909, kur përfundimisht idâdijet jo të plota u bënë 5 vjeçare, kurse ato të plota 7 vjeçare⁵.

Idâdijet e para në Perandorinë Osmane u hapën në Stamboll më 1875, po këtë vit u hapen edhe në saxhakun e Jeni-shehirit dhe në More⁶. Në vitin 1884 hapet idâdija në Bursa, *Janinë*, Edrene dhe Çanakala⁷, kurse më 1885 në *Prishtinë* dhe 1888 në *Shkup*⁸, dhe më pastaj edhe në Jeni Pazar, Taslixhe (sot: Plevle) që i takonin Vilajetit të Kosovës, dhe në *Korçë*⁹.

Shkollat idâdije ishin të hapura si ndaj studentëve myslimanë ashtu edhe jomyslimanë, që ishin të diplomuar në rushdije dhe me kusht që “të ishin qytetarë të shtetit osman”¹⁰.

⁵ Derya Demirel, *Osmanli devleti'nde* ..., po aty, f. 103.

⁶ Ekmeleddin Ihsanoğlu, *Institucionet studimore*..., po aty, f. 463.

⁷ Derya Demirel, *Osmanli devleti'nde*..., po aty, f. 98.

⁸ Derya Demirel, *Osmanli devleti'nde*..., po aty, f. 88-89.

⁹ Bayram Kodaman, *Abdulhamit Devri*..., po aty, f. 119.

¹⁰ Derya Demirel, *Osmanli devleti'nde*..., po aty, f. 97.

Këto shkolla kishin për qëllim përgatitjen e punonjësve civilë të kualifikuar që do të punonin në administratë.

Në Rregulloren..., tashmë të zënë në gojë për të satën herë, përveç të tjerash, kanë ekzistuar edhe shumë dispozita ligjore që kishin të bënin me shkollat idâdije.¹¹

Nxënësit të cilët me sukses i kryenin të gjitha provimet, merrnin diplomën mbi kryerjen e kësaj shkolle, kurse atyre të cilët nuk e kishin kryer, u lejohej edhe një vit që të vijonin mësimin në këtë shkollë¹².

Sistemi i vlerësimit të nxënësve mbështetej në shkallëzin një (1) deri në dhjetë (10), si më poshtë:

1-2 = ulët (*sıfır*); 3 = dobët (*zayıf*); 4 = mjaftueshëm (*karîb-i vasat*), 5 = arritje mesatare (*vasat*), 6 = afër arritjes së lartë (*karîb-i âlâ*), 7-8 = arritje e lartë (*âlâ*) dhe 9-10 = shkëlqyeshëm (*‘aliyyü’l-âlâ*)¹³.

Në shkollat idâdije mbaheshin dy lloje të provimeve: *provimi i veçantë* (husûsî) që mbahej çdo tre muaj, dhe *provimi i përgjithshëm* (umûmî) që mbahej në fund të vitit, ku nxënësi tregonte aftësitë e tij në lëndët përkatëse¹⁴.

Nxënësit që tregonin suksese më të mira shpërbleheshin me nga një libër, ndërsa atyre që vinin menjëherë pas këtyre, u ndahej nga një mirënjohje¹⁵.

¹¹ *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova, 1318 (1900-1901)*, f. 267-276.

¹² *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova, 1318 (1900-1901)*, f. 267-276.

¹³ Bayram Kodaman, *II.Abdülhamit Hakkında Bazı Düşünceler*, Osmanlı. C. 2. Ankara, 1999, f. 127.

¹⁴ *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova, 1318 (1900-1901)*, f. 272-273. Derya Demirel, *Osmanlı devleti’nde...*, po aty, f. 111-112.

¹⁵ *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova, 1318 (1900-1901)*, Derya Demirel, *Osmanlı devleti’nde...*, po aty, 112-113.

Disiplina theksohej në mënyrë të veçantë në rregulloret e shkollave me konvikt. Nxënësit konviktorë, kishin edhe uniformën e tyre të veçantë, e cila në rregulloren e shkollave idâdije shpjegohet në hollësi¹⁶.

Nxënësi që diplomonte në ndonjë idâdije të sanaxhakut (d.m.th. në idâdijen 5 vjeçare) i lëshohej *shehâdetnâmeja*, kurse atyre në qendra të vilajeteve (7 vjeçare) u lëshohej *tas-dîknâmeja*¹⁷. Me rastin e diplomimit, përveç mësuesve të idâdijes, merrnin pjesë edhe njerëz të shquar dhe personalitetet të vendit. Diploma më pastaj firmosej nga anëtarët e komisionit vlerësues dhe, në fund, konfirmohej edhe nga Këshilli arsimor i vilajetit.

Kishte edhe shkolla idâdije ushtarake që përgatisnin kua-dro të oficerëve. Në Kosovë nuk ka pasur idâdije ushtarake. Një shkollë e tillë më 1848 është hapur në Manastir.¹⁸

Shkollat idâdije në Kosovë

Në Kosovë shkolla idâdije janë hapur në Prishtinë (1885), Prizren (1903) dhe në Pejë (1908), por këto kanë qenë të paplota, d.m.th. 5 vjeçare (nehârî). Dhe ndonëse ajo e

¹⁶ Të dhëna për uniformën dhe programin e konviktorëve në idâdije, jepen në mënyrë të hollësishme në: *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova, 1318 (1900-1901)*, f. 273-274.

¹⁷ Halil Aytekin, *İttihâd ve Terakkî Devri Eğitim Teşkilatı (1913-1918)*, Yayınlanmamış Doktora Tezi. Ankara: Ankara Üniversitesi, 1987, f. 102.

¹⁸ Mehmet Tefvik, *Kratka istorija Bitolskog vilajeta*, (përkthim nga osmanishtja nga. G. Elezoviç), Beograd, 1933, f. 27. Për shkollat në vilajetin e Manastirit, shih po ashtu: Jašar Redžepagić, *Razvoj prosvete i školstva albanske narodnosti na teritoriji današnje Jugoslavije do 1918 godine*, Priština, 1968, 158-159; Nexhat Abazi, *Zhvillimi i arsimit, i shkollave dhe i mendimit pedagogjik shqiptar në Maqedoni (1830-1912)*, Tetovë, 1997, f. 152-153.

Prishtinës dhe e Prizrenit kishin një jetë më të gjatë, ajo e Pejës punoi vetëm tri vjet (1908-1912) dhe nuk arriti të nxirrte diplomantët e parë. Nxënësit pasi kryenin idâdijen e Prishtinës dhe të Prizrenit, dy vjet të tjera i vazhdonin, i plotësonin në idâdijen e Shkupit, Manastirit apo të Selanikut, që ishin idâdije të plota.

Idâdijet, sikurse edhe shkollat e tjera osmane në Kosovë, kanë pushuar së vepruari në vitin 1912 kur edhe nisi Lufta e Parë Ballkanike.

Në asnjërën prej sâlnâmeve të vilajetit të Kosovës të botuara deri në vitin 1900-1901, nuk përmendet idâdija e Prishtinës dhe as idâdija e Prizrenit, sa kohë që për idâdijen e Shkupit, bie fjala, ka të dhënë të bollshme në këta vjetarë¹⁹. Mirëpo, për idâdijet e Kosovës, gjejmë të dhëna në burime arkivore dhe në literaturën tjetër, që e kemi dhënë në referenca.

Shkolla idâdije e Prishtinës

Idâdija e Prishtinës është themeluar në vitin 1885²⁰. Në vitin 1888, ishte paraparë, sipas Rregullores, edhe ndërtimi i godinës së kësaj shkolle, mirëpo për shkak se qendra e vilajetit kaloi nga Prishtina në Shkup, kjo punë mbeti pa u realizuar²¹.

Vështirësitë financiare që i përcollën këto shkolla, po edhe buxheti i limituar i qeverisë osmane të asaj kohe, nuk mundësuan që idâdija e Prishtinës të punonte normalisht deri pas vitit 1902-1903. Kjo mbase ka bërë që disa studiues të kenë mendime të ndryshme dhe jo të sakta për sa i takon the-

¹⁹ *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova, 1318 (1900-1901)*, f. 258-266.

²⁰ Derya Demirel, *Osmanlı devleti'nde...*, po aty, f. 88-89.

²¹ Branislav Nušić, *Kosovo II*, Novi Sad, f. 14.

melimit të kësaj shkolle. Kështu N. Demiri mendon se idâdija e Prishtinës është hapur më 1905²², kurse J. Rexhepagiqi mendon se është themeluar “menjëherë pas revolucionit të turqve të rinj”²³, d.m.th. në vitin 1908-1909.

Në punën normale të këtyre shkollave kanë ndikuar mbase edhe ndryshimet e shpeshta që i bënte Ministria Osmane e Arsimit, qoftë për sa i takon kohëzgjatjes së mësimin në këto shkolla, qoftë ndryshimeve në planin mësimor. Këto ndryshime, sikurse u tha më lart, ndodhnin aq shpesh sa që akoma pa arritur dhe pa u vënë në zbatim ndryshimi i parë në sanxhaqe, ndodhte ndryshimi tjetër.

Pas vitit 1908, kur edhe lëvizja atdhetare shqiptare merr hove të reja, idâdija në Prishtinë do të punonte normalisht dhe kishte edhe internatin e vet²⁴.

Nxënësit e idâdijes së Prishtinës i dhanë një mbështetje të fuqishme përpjekjeve të patriotëve për të futur mësimin e shqipes në shkollat shtetërore. Sapo qe përhapur lajmi se qeveria e Stambollit (më 1908) do të lejonte mësimin e shqipes në shkollat fillore mektebe dhe rushdije, të parët lëvizën *nxënësit e idâdijes së Prishtinës*, të cilët i dërguan një telegram Ministrisë Osmane të Arsimit dhe i kërkuan se *nëse nuk do të futej gjuha shqipe edhe në idâdije, nuk do të vazhdonin më shkollat turqisht*. Si përgjigje qeveria xhonturke u detyrua të shpallte se lejonte që edhe në idâdije të futej gjuha shqipe²⁵.

²² Necati Demir, *Education in Kosovo among 1877-1912 according to the Prime Ministry Ottoman Archives*, në; “Zeitschrift für die Welt der Türken”, vëll. 2., nr. 3 (2010), f. 17.

²³ Jašar Redžepagić, *Razvoj prosvete...*, po aty, f. 153.

²⁴ Jašar Redžepagić, *Školstvo i prosveta...*, po aty, f. 26.

²⁵ “Kombi”, nr. 107, Boston, 11 nëntor 1908, f. 4; “Lirija”, nr. 10 Selanik, 4 Vjeshtë e II 1908, f. 3.

Ngjashëm, si nxënësit e idâdijes së Prishtinës, vepruan edhe nxënësit e idâdijes së Manastirit, si dhe nxënësit e gjimnazeve të tjera e deri të nxënësit shqiptarë të idâdijes në Selanik, dhe e shpejtuan futjen e mësimi të shqipes në shkollat e tyre²⁶.

Më 1909 në idâdijen e Prishtinës për lëndët histori dhe gjeografi u emërua mësues patrioti dhe një nga rilindësit e fundit - *Profesor Ahmet Gashi*²⁷, i cili, *hapi e parë* që ndër-mori në këtë institucion edukativo arsimor, ishte futja e gjuhës shqipe si gjuhë e dytë. *Hapi i dytë* që organizimi i kurseve për shkrim leximin e gjuhës shqipe²⁸.

Në idâdijen e Prishtinës ka pasur edhe bursistë shtetërorë, ndër të cilët edhe një numër i vogël nxënësish të kombësisë serbe. Nga sanxhaku i Prishtinës më 1910 në këtë shkollë

²⁶ Raport i konsullit austro-hungarez të Manastirit, nr. 75, sekret, datë 30 nëntor 1908, Cituar sipas, Hysni Myzyri, *Arsimi kombëtar shqiptar (1908-1912)*, Prishtinë, 1996, f. 70.

²⁷ *Ahmet Gashi (1888-1977)*. I takon plejadës së fundit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Njëzet e pesë vjet punoi në procesin mësimor, në shumë institucione të arsimit fillor dhe të mesëm në Kosovë dhe në Shqipëri. Ishte pjesëmarrës i tri kongreseve arsimore; më 1920 në Lushnjë, më 1922 dhe më 1924 në Tiranë, sekretar i klubit patriotik të Prishtinës, sekretar i Komisionit Letrar dhe nënkryetar i Lidhjes së Përgjithshme të Arsimitarëve të Shqipërisë. Ishte pjesëmarrës në Kuvendin e Vlorës, ku firmosi aktin e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. U lind në Prishtinë. Shkollën fillore (mejtëpin) dhe rushdijen i kreu në Prishtinë. Mbaroi idâdijen në Shkup dhe më pastaj edhe Shkollën Normale (Dârul-muallimîn) po në Shkup. Studimet i vazhdoi në Shkollën e Lartë të Stambollit. Pas përfundimit të studimeve në Stamboll më 1909 kthehet në vendlindje në Prishtinë dhe ishte emëruar profesor në shkollën idâdije të Prishtinës për lëndët histori dhe gjeografi. Ishte bashkëpunëtor dhe përkrahës i patriotit të shquar Nazmi Gafurrit. Më gjerësisht: Abdullah Vokri, *Mësues në Kosovë e në Shqipëri (personalitete të shquara të arsimit tonë kombëtar)*, Prishtinë, 2008, f. 27-40. Gani Demir Ratkoceri, *Prof. Ahmet Gashi, Rilindasi i fundit*, Tiranë, 2005, f. 12-14.

²⁸ Po aty.

kanë mësuar 16 nxënës serbë, kurse gjithë të tjerët (afër 250) kanë qenë shqiptarë dhe turq²⁹.

Në shkollën idâdije të Prishtinës në vitin 1903 ka dhënë mësim edhe Tefvik Halili, kurse drejtor ishte Hysen Hysniu³⁰.

Idâdija e Prishtinës ndodhej në periferi të qytetit të Prishtinës, dhe ishte vendosur në godinën e spitalit ushtarak turk të ndërtuar në fund të shek. XIX. Objekti i idâdijes së Prishtinës, ndryshe nga objektet e tjera të stilit oriental, ka një teknik tjetër dhe me prirje të arkitekturës evropiane të stilit neoklasik³¹. Kjo godinë për disa vjet ka shërbyer si spital i mushkërive. Sot në godinën e ish-idâdijes së Prishtinës është e vendosur Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës.

Shkolla idâdije e Prizrenit

Shkolla idâdije e Prizrenit është hapur me vendimin e sulltan Abdylhamidit II më 24 gusht 1903 (11 Ağustos sene 1319), në ditën e përvjetorit të 27 të uljes së tij në fron. Në këtë kohë qe marrë vendimi edhe për hapjen e 511 shkollave iptidâije, rushdije dhe idâdije gjithandej Perandorisë, e edhe në vilajetin e Kosovës³². Vetëm në vilajetin e Kosovës ishin

²⁹ Jašar Redžepagić, *Razvoj prosvete i školstva...*, po aty, 154.

³⁰ *Arkivi i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës-Prishtinës*, kutia nr. 12, dosja nr. 13, diploma e Jusuf ef. Bajramit nga Prishtina. Jusuf efendiu nga viti 1908-1912 ka qenë mësues në shkollën fillore në Bërnice të Ulët, kurse nga viti 1914-1945 ka qenë imam në xhaminë “Unpazar mesxhidi”, në Prishtinë. Ka vdekur më 1945.

³¹ Vlora Navakazi, (2009), *Zhvillimi i qytetit të Prishtinës gjatë viteve 1878-1912 (Qendër e Vilajetiti të Kosovës)*, punim i pabotuar.

³² *Başbakanlık Osmanlı Arşivi, Yıldız Mütenevvi Maruzat (Y. MTV), 250/1; Osmanlı Arşiv Belgelerinde Kosova Vilayeti*, Stamboll, 2007, f. 318-320.

paraparë të hapeshin 161 shkolla iptidâije dhe një idâdije, pra ajo e Prizrenit. Këtë vit u vendos që të hapeshin idâdije edhe në *Elbasan* dhe në *Durrës*³³.

Përderisa për shkollat e tjera nuk është e sigurt nëse kishin arritur të hapeshin, hapjen e idâdijes së Prizrenit në këtë vit e dëshmojnë edhe dokumentet e tjera arkivore të lëshuara nga idâdija e Prizrenit. Sipas këtyre dokumenteve³⁴, mësojmë se kjo shkollë në vitin 1902-1903 punonte me profesorë të gjithë të laureuar e me përgatitje përkatëse dhe me ndonjë përjashtim, të gjithë ishin vendorë.

Meqë këto dokumente kanë rëndësi burimore, përmbajtjen e tyre, po e japim po thuajse në tërësi. Duke iu referuar këtyre dokumenteve të rralla që bëjnë fjalë për funksionimin e kësaj shkolle, mësojmë se nxënësi Zekerijai i biri i Beharit ka ndjekur mësimet e rregullta në këtë shkollë, nga viti i parë e deri në vitin e pestë. Në bazë të vlerësimit të Komisionit provues të emëruar sipas Rregullores për Arsimin e Përgjithshëm të shkollave osmane, kandidati pasi u është nënshtruar provimeve të rregullta, ka treguar shkathtësi në provimet me gojë dhe me shkrim dhe është vlerësuar me notën “*shumë mirë*”, në lëndët si më poshtë:

1. Mësime fetare (‘ulûm-i dîniye) -shkëlqyeshëm
2. Etikë (ahlâq)-shkëlqyeshëm
3. Gjuhë arabe (‘Arabi: sarf-nahv) - shumë mirë
4. Gjuhë turke (Türkçe: sarf-nahv) - mirë

³³ Po aty.

³⁴ Kopje të diplomave të Zekerijait të birit Behairit, nga fshati Restelicë, i lindur në vitin 1891/2, ruhen në: *Arkivi i Kosovës, Fondi, Bashkësia e Fesë Islame, Prishtinë*, 015-30.4/kutia 1, dok. nr. 85, viti 1924.

5. Gjuhë persiane (Fârisi) -shumë mirë
6. Gjuhë frënge (Fransızça) - mirë
7. Histori islame dhe histori osmane (Târîh: islâm ve osmâni)
- sh. mirë
8. Stilistikë (Kitabet) - sh. mirë
9. Gjeografi e përgjithshme (Cografiya'ye 'umûmi)- sh. mirë
10. Agronomi (Zirâ'at)- sh. mirë
11. Matematikë (Hisâb: 'ameli ve nazari) - mirë
12. Gjeometri (Hendese: hatiye ve sat'hiye) - mirë
13. Kaligrafi (Hüsn-i hatt) - shkëlqyeshëm
14. Vizatim (Resem) - shkëlqyeshëm
15. Ruajtje e shëndetit dhe gjimnastikë (Hüsn-i hâl ve hareket) - shkëlqyeshëm

Shehâdetnâmeja është dhënë më 19 tetorin-i evvel 1324, që korrespondon me datën 1 nëntor 1908 dhe është vërtetuar nga mësuesit dhe anëtarët e tjerë të komisionit:

- Mehmed Qamil Sylejmani, arkëtar i Drejtorisë arsimor,
- Musa Qazimi, sekretar i Drejtorisë arsimor,
- Shaban Shefkiu,
- Ali Rexhaiu, mualim në Dârul-muallimîn,
- Shejh Sejfudin Fevziu,
- Mustafa Tevfik Abdylhalimi (Gjergjizi), myderriz,
- Mehmed Hafizi, myderriz,
- Sejid Ahmed Nesim Azizi, Drejtor i regjistrimeve i sanxhakut,
- Abdylaziz Hifzi efendiu, myderriz,
- Hafiz Fethiu, mësuesi i kaligrafisë,
- Ibrahim Hakiu, mësuesi i turqishtes,
- Sylejman Faiku, mësuesi i gjeometrisë dhe i ortografisë,
- Hasan Hysniu i biri i Halilit, mësues i vizatimit,
- Hasan Raxhiu, mësuesi i lëndëve fetare, etikës dhe turqishtes,

- Musa Qazimi, mësuesi i arabishtes dhe persishtes,
- Ismail Hakiu, nëntoger,
- Ahmed Hilmiu, nëntoger,
- Ali Nuridini, nëntoger, Hysejn Hysniu, nëntoger,
- Rifat Sirri, kapiten,
- Dr. Hilmi Osmani,
- Mehmed Salih Talati (nën major),
- Nexhib Nexhatiu, Drejtor i shkollës idâdije.
- Vërtetuar nga mytesarifi i Prizrenit, Ibrahim Sirri.

Sipas disa dokumenteve arkivore osmane, dëshmohet se në vitin 1911 ishte paraqitur nevoja që shteti të intervenonte për ndërtimin e një idâdijeje të plotë (lice) në sanxhakun e Prizrenit dhe në sanxhakun e Pejës. Por kjo si duket, për arsye financiare dhe, siç theksohet në dokumente, për shkak të mungesës së ndërmarrjeve ndërtimore dhe kohës së shkurtër³⁵ si dhe fillimit të Luftës së Parë Ballkanike, mbeti pa u realizuar.

Shkolla idâdije e Pejës

Në vitin shkollor 1908-1909 filloi punën edhe idâdija në Pejë³⁶. Për idâdijen e Pejës dihet se ka pasur dy drejtorë; të përgjithshmin dhe të brendshmin. Drejtori i brendshëm merrej me problemet e mësimit dhe të edukimit të fëmijëve të shkollës. Disa nga mësime dhënësit e idâdijes së Pejës kanë qenë.

1. Adem efendiu, mësime dhënësit i gjuhës arabe, i Kuranit dhe i mësimit të fesë,

³⁵ *Başbakanlık Osmanlı Arşivi, İrade-Mecelis-i Vâlâ (I. MV), 154/75; Osmanlı Arşiv Belgelerinde Kosova Vilayeti*, Stamboll, 2007, f. 322-323.

³⁶ Jašar Redžepagić, *Razvoj prosvete...*, po aty, f. 153-154.

2. Haxhi Shabani, mësimdhënës i matematikës dhe i gjuhës turke,
3. Shefqet efendiu, mësimdhënës i gjuhës frënge,
4. Hysen efendiu, mësimdhënës i gjeografisë dhe historisë,
5. Ismail Hakiu, drejtor i brendshëm, mësimdhënës i edukatës qytetare (medeniye-i ma'lumâti).
6. Mulla Shaban Riza, mësimdhënës i bukurshkrimit
7. Ihsan efendiu, mësimdhënës i gjimnastikës, etj.

Idâdija e Pejës punoi vetëm tri vjet, d.m.th. deri më 1912, veprimtarinë e saj e ndërpreu fillimi i Luftës së Parë Ballkanike.³⁷ Në vitin 1911 ishte paraparë që edhe në Pejë, sikurse edhe në Prizren, që të ndërtohej edhe një idâdije e plotë (lice), por kjo për arsye të u përmenden më lart, nuk u arrit të bëhej³⁸.

Programi mësimor dhe lëndët në shkollat idâdije

Programi i shkollave idâdije, sikurse u tha, ka pësuar ndryshime dhe këtë e impononin ndryshimet që bëheshin në kohëzgjatjen dhe në reformat e përgjithshme të shkollave idâdije, po edhe të atyre rushdije. Rregullorja për Arsimin e Përgjithshëm e vitit 1869 parashihte që në shkollat idâdije (që asokohe ishin tre vjeçare) të mësoheshin këto lëndë: drejtshkrimi dhe "*belles lettres*" turke, frëngjisht, juridik, ekonomik, gjeografi, histori botërore, shkenca natyrore, algjebër, kontabilitet, gjeometri dhe planimetri, logjik, kimi dhe viza-

³⁷ Jašar Redžepagić, *Razvoj prosvete...*, po aty, f. 153-154.

³⁸ *Başbakanlık Osmanlı Arşivi, I.MV,154/75; Osmanlı Arşiv Belgelerinde Kosova Vilayeti*, Stamboll, 2007, f. 322-323.

tim³⁹. Më vonë, ky program ka pësuar ndryshime dhe disa lëndë janë hequr dhe janë zëvendësuar me lëndë të tjera, p.sh. është hequr logjika dhe janë futur gjuha arabe, gjuha frënge, trigonometria etj⁴⁰.

Më 1896 është ndërruar programi dhe u shtuan lënda e etikës (ahlak) dhe e jurisprudencës islame (fikh). Me urdhrin e Abdylhamdit II në të gjitha shkollat e Perandorisë u fut lënda e fesë, dhe një rëndësi iu kushtua edhe arteve. Më 1908 shkolla idâdije ka pësuar ndryshime në programet mësimore, në kohëzgjatje etj.⁴¹

Më 1892 shkollat idâdije u ndanë në dy grupe: 5 vjeçare ato pa konvikt (nehârî) dhe 7 vjeçare ato me konvikt (leylî), kjo edhe paraqiti nevojën për hartimin e një programi të ri për secilin cikël të idâdijeve. Një Komision brenda Ministrisë Osmane të Arsimit, i ngritur enkas për këtë çështje, hartoi një program për secilin cikël të idâdijes veç e veç⁴².

Një ndryshim tjetër në planin mësimor për shkollat idâdije u bë në vitin 1900. Në salnâmenë e vilajetit të Kosovës për vitin 1318 (1900-1901), përveç të dhënave të bollshme për rregulloren dhe kushtet për regjistrim në shkollat idâdije, për rregullat dhe kushtet e nxënësve konviktorë, për provimet në fund të vitit etj., janë dhënë edhe programi mësimor, lënd-

³⁹ Bajram Kodaman-Abdullah Saydam, *Tanzimat Devri Eğitim Sistemi*, 150. Yılında Tanzimat, Ankara, 1992, f. 486; Ekmeleddin Ihsanoğlu, *Institucio-net...*, po aty, f. 462.

⁴⁰ Bajram Kodaman- Abdullah Saydam, *Tanzimat Devri Eğitim Sistemi...*, po aty, f. 486.

⁴¹ Derya Demirel, *Osmanli devleti'nde...*, po aty, f. 100.

⁴² Bayram Kodaman, *II. Abdülhamit Hakkında...*, po aty, f. 130-132; Derya Demirel, *Osmanli devleti'nde...*, po aty, f. 101.

ët, orët në javë si dhe tekstet shkollore të idâdijes, së bashku me autorët dhe çmimet e tyre. Ky planprogram ishte hartuar duke marrë për bazë planin mësimor që aplikohet në shkollat idâdije 5 vjeçare, përkatësisht 7 vjeçare të Stambollit dhe Ys-kidarit⁴³ dhe, paraqitur në formë tabelare, duket kështu:

	Emri i lëndëve	Vitet						
		I	II	III	IV	V	VI	VII
		Orë në javë						
1.	Kur'ani Kerim-Texhvîd-mësime feje (Kur'ani kerîm me'a texhvîd ve 'Ilmi dîniyye)	3	2	2	2	2	1	2
2.	Gjuhë turke (Türkçe)	7	6	4	3	2	-	-
3.	Letërsi dhe etikë (Edebiyât ve ahlâk)	-	-	-	-	-	2	1
4.	Stilistikë zyrtar/diplomatika (Kitâbet-i resmiye)	-	-	-	-	-	1	1
5.	Gjuhë arabe ('arabî)	1	2	2	2	2	1	1
6.	Gjuhë perse (farisî)	-	1	2	1	-	-	-
7.	Gjuhë frënge (fransizça)	-	-	3	3	4	4	5
8.	Legjislacioni (Kavânîn)	-	-	-	-	-	2	2
9.	Matematikë (Hesâb)	2	2	2	2	1	-	-
10.	Kontabilitet (Usûl-i defterî)	-	-	-	1	1		-
11.	Algjebër (Cebr)	-	-	-	-	2	2	-
12.	Gjeometri (Hendese)	-	-	1	2	2	2	-
13.	Trinometri (Müsellesât)	-	-	-	-	-	-	1
14.	Kosmografi (Kozmografi)	-	-	-	-	-	-	1
15.	Makineri (Mâkîne)	-	-	-	-	-	-	1
16.	Fizikë dhe kimi (Hikmet-i tabî'îye ve Kimyâ)	-	-	-	-	-	3	3
17.	Mësim natyre (Mevâlîd)	-	-	-	-	-	2	2
18.	Gjeografi (Cogrâfya)	2	2	2	2	2	2	1

⁴³ *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova, 1318 (1900-1901)*, f. 256-257.

19.	Histori (Târîh)	-	2	2	2	2	1	1
20.	Ekonomi ('Ilmi servet)	-	-	-	-	-	-	2
21.	Dituri shoqërore dhe higjienë (Ma'lumât-i nâfia' ve Hivz-üs-siha)	1	1	1	1	1	-	-
22.	Kaligrafi (Hüsn-i hatt)	1	1	1	1	1	-	-
23.	Vizatim (Resm)	1	1	1	1	1	-	-
	Gjithsej	18	20	23	23	23	23	24
24.	Gjuhët (Elsine)	-	-	-	2	2	2	1

Edhe në vitin 1902, u bënë disa ndryshime në planin mësimor të shkollave idâdije, u shtuan lëndët agronomi, ekonomi dhe artet dhe, sikurse e kemi shpjeguar më lartë. Por kjo nuk zgjati shumë, kështu në vitin 1904 u hoqën lëndët agronomi, ekonomi dhe artet, u zvogëlua mësimi i orëve të fesë dhe kohëzgjatja e idâdijeve jo të plota u bë 5 vjeçare, përkatësisht 7 vjeçare ato të plota.

Më 4 qershor 1906 u ndie nevoja për mësimin sa më të madh të fesë dhe etikës, prandaj dhe këto lëndë u futën në planin mësimor, kurse u hoqën disa lëndë të tjera që u panë si të panevojshme.

Ndryshimi i fundit në planin mësimor dhe në kohëzgjatjen e ciklit të shkollimit në idâdije u bë në vitin 1908 dhe këto shkolla u ndanë në tri nivele dhe me këto lëndë:

I. Niveli i rushdijeve (viti I, II, III) mësoheshin këto lëndë:

1. Kuran dhe mësimet feje, 2. histori. 3. gjuhë turke, 4. gjuhë arabe, 5. gjuhë perse, 6. gjuhë frënge, 7. gjeometri, 8. gjeografi, 9. kaligrafi, 10. vizatim, 11. etikë dhe 12. matematikë⁴⁴.

⁴⁴ Atilla Çetin, *Bursa'da Bir Eğitim-Öğretim Kurumu: Bursa idâdisi (1883) ve Sosyo-Kültürel Önemi*. XIII. Türk Tarih Kongresi. C. 3. II. Kısım. Ankara 2002, 791-792; Derya Demirel, *Osmanlı devleti'nde...*, po aty, f. 103.

II. Niveli i idâdijeve jo të plota (viti IV dhe V)

1. Kuran dhe mësimë feje, 2. etikë, 3. gjuhë turke, 4. gjuhë frënge, 5. gjuhë arabe, 6. matematikë, 7. gjuhë perse, 8. gjeometri, 9. stilistikë, 10. histori, 11. gjeografi, 12. kaligrafi, 13. agronomi⁴⁵.

III. Niveli i idâdijeve të plota (viti VI dhe VII)

1. mësimë feje, 2. histori, 3. letërsi, 4. kaligrafi, 5. gjuhë arabe, 6. etikë, 7. legjislacion dhe kontabilitet, 8. algjebër, 9. trigonometri, 10. gjeometri, 11. kozmografi, 12. mekanikë, 13. mësim natyre, 14. kimi, 15. gjeografi, 16. ruajtje e shëndetit, 17. ekonomi, 18 vizatim⁴⁶.

Sikurse shihet, në planet mësimore të këtyre niveleve lëndët nuk janë mësuar në mënyrë proporcionale. Dhe po të vështrojmë konkretisht, bie në sy fakti se doktrina fetare në planin mësimor të idâdijes zinte fare pak vend. Lënda e matematikës dhe e gjeografisë kanë qenë të pandryshueshme dhe janë mësuar në të gjitha vitet dhe në të gjitha nivelet.

Gjuha frënge ka qenë e domosdoshme dhe që nga fillimi e deri në fund e detyrueshme, dhe kjo për tri arsye kryesore:

- *e para*, për shkak të marrëdhënieve që kishte Perandoria Osmane me Francën,
- *e dyta*, nxënësit duhej të përgatiteshin dhe të ishin të aftë të komunikojnin në një gjuhë të huaj, dhe

⁴⁵ Atilla Çetin, *Bursa'da Bir Eğitim-Öğretim Kurumu...*, po aty, f. 791-792.

⁴⁶ Atilla Çetin, *Bursa'da Bir Eğitim...*, po aty, f. 785-193; Derya Demirel, *Osmanlı...*, po aty, f. 104.

- *e treta*, meqë kërkohej të merrej një model për mësim, u zgjodh modeli i Francës, e rrjedhimisht edhe gjuha frënge⁴⁷.

Duhet shtuar këtu edhe faktin se institucionet e Francës të shek. XIX ishin institucione centralizuese të mbetura nga epoka e Francës mbretërore. Prandaj, ishte e natyrshme që edhe administrata osmane që po kalonte një ndryshim evolucionar, të ndiqte traditën centralizuese dhe një model të përshtatshëm me të. Për këtë arsye, dashje pa dashje, Franca u bë modeli kryesor i Perandorisë Osmane në organizimin e institucioneve administrative gjatë periudhës së Tanzimatit. Vetëm se kjo “nuk do të thotë se modeli francez u zbatua pa gabime, pra në mënyrë të përpiktë”⁴⁸.

Preferenca e gjuhës dhe arsimit francez pati rezultate pozitive në shoqërinë e asaj kohe. Këtë gjë e tregon përhapja e një botëkuptimi intelektual që do të ndikonte me anët e tij të ndryshme në opinionin publik që ekzistonte t mësuësit dhe nxënësit e shkollave rushdije dhe idâdije⁴⁹, pra edhe në ato në trojet shqiptare. Mësimi i gjuhës dhe i kulturës frënge që mësohej në shkollat rushdije dhe idâdije në viset shqiptare, pati ndikime pozitive në krijimin gradual të elitës shqiptare dhe inteligjencës “*alla franga*” që luajti rol vendimtar në momentet më të vështira të vendit dhe të kombit.

Një kujdes i veçantë në shkollat idâdije i është kushtuar lëndës së historisë që është mësuar në të gjitha vitet. Në vitet e

⁴⁷ Derya Demirel, *Osmanlı devleti'nde...*, po aty, f. 100.

⁴⁸ Ilber Ortajllë, *Shekulli më i gjatë i Perandorisë*, përktheu: Altin Qefalia, Logos-A, Shkup, 2010, f. 187-189.

⁴⁹ Ilber Ortajllë, *Shekulli më i gjatë...*, po aty, f. 294.

para është mësuar Historia e profetëve (*kisas-i enbiyâ*), në vitet e dyta Historia e Perandorisë Osmane (*târîh-i osmani*) dhe në vitet e fundit Historia e përgjithshme (*târîh-i 'umûmi*).

Një lëndë shumë e rëndësishme dhe kryesore në të gjitha shkollat osmane, pra edhe në të gjitha shkollat idâdije, ka qenë lënda e gjeografisë, ku janë mësuar njohuri të përgjithshme nga gjeografia, më pastaj gjeografia e Evropës dhe Azisë, gjeografia ekonomike dhe gjeografia e Perandorisë Osmane. Por edhe lëndët e tjera si matematika, gjeometria, persishtja etj. shihet se janë mësuar dhe nuk janë lënë pas dore.

Mësimi në shkollat idâdije zhvillohej në gjuhën turke, e cila ka qenë një lëndë e përhershme dhe e rëndësishme, dhe krahasuar me gjuhën frënge, gjuha turke ka qenë pothuajse barabar e përfaqësuar. Dhe, megjithëse pas revolucionit të xhonturqve në shkollat idâdije, nxënësit në mesin e gjuhëve mund të zgjidhnin edhe një gjuhë ndihmëse, kjo për shqiptarët, sikurse u tha, nuk do të ishte e lehtë për t'u bërë.

Tekstet në shkollat idâdije

Tekstet që janë përdorur në shkollat idâdije, në përgjithësi, janë:

Në vitin e parë janë mësuar këto tekste të këtyre autorëve:

Mësim feje: “*Mus’haflî Şerîf*”, “*Birinci ‘Ilmihâlî* dhe “*Tecvîd*” i autorit hâfiz Ferîd efendiut; për lëndën e Etikës: “*Musehah vezâif-i atfâl*” nga Mustafâ Hamî pasha; Gjuhë arabe: “*el-Muşezzeb*” nga Hacı Zihnî efendi dhe “*Binâ*”; Gjuhë osmane: “*Yenî sarf-i osmânî*” dhe “*Kirâ-et*” nga Reşâd beu; Matematikë: “*Yenî hesâb kitâbî*” nga

Tâhir beu; Gjeografi: “Ceografya” nga Hikmet Beu; Pikturë: *‘Ilmi eşyâ*” (pjesa e parë) nga Ismâ’îl Cenânî beu⁵⁰.

Në vitin e dytë:

“*Mus’haflî Şerîf*”, “*Ni’met-i islâm*” nga Haxhi Zihnî efendiu, “*Tecvîd*” nga Hâfiz Ferîd efendiu; Etikë: “*Rehberi ahlâk*” nga ‘Ali Irfân efendiu; Gjuhë arabe: “*el-Muşezzeb*” (pjesa e sintaksës) nga Hacı Zihnî efendiu dhe “*Maksûd*”; Gjuhë osmane (si në vitin e parë); persisht: “*T’alîmî fârisî*” dhe “*Rehberi fârisî*” nga Habîb efendiu; Matematikë: “*Hesâb ‘amelî*” nga Celâl beu; Gjeografi: “*Fezleke-i fenn-i cografyâ*” nga ‘Ali Cevâd Beu; Histori: “*Târîh-i Islâm*” nga Mahmûd Es’ad efendiu, Pikturë: *‘Ilmi eşyâ*” (pjesa e dytë) nga Ismâ’îl Cenânî beu⁵¹.

Viti i tretë:

Mësim feje: “*Mushaflî şerîf*” dhe “*Musahhah durriyetkâ*” nga Imâm Zâde merhûm Es’ad efendiu; Gjuhë arabe: “*el-Muşezzeb*” (sintaksa) nga haxhi Zihnî efendiu dhe “*‘Avâmil*”; Higjienë: “*Hifz-üs-sihati*” nga Ahmed Râsim beu; Gjuhë osmane: “*Yenî nahv osmânî*” dhe “*Kirâet*” nga Reshâd beu; Gjuhë perse: “*Hulasa-i ruhnimâye-i farisî*” nga Habîb efendiu dhe “*Muntehabât-i Gülistân*” nga Ne’îm beu; Gjuhë frënge: “*Elifbâ*” nga Terziyân efendiu dhe “*Tes’hîl-i lisân*” nga Vîzintal efendiu (pjesa e parë); Matematikë: “*Hesâb-i ‘amelî*” (pjesa e parë) nga Celâl beu; Gjeometri: “*‘Amel-i hendese*” nga Hasan Fuâd beu;

⁵⁰ *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova, 1318 (1900-1901)*, f. 258-266.

⁵¹ *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova, 1318 (1900-1901)*, f. 258-266.

Gjeografi: “*Muhtasar Urubbâ ve memâlik-i osmâniye*” nga Tâhir beu; Histori: “*Fezleke-i târîh-i Devleti ‘Aliyye-i Osmaniye*” nga Abdurrahmân efendiu; “*Ilmi eşyâ*” (pjesa e tretë) nga Ismâ’îl Cenâbi beu⁵².

Viti i katërt:

Mësim feje: “*Durriyektâ şerh-i*” nga Esad efendiu dhe “*Berkizâr-i ahlâk*” nga Ahmed Rif’at efendiu; Gjuhë arabe: “*El-muşezeb*” (pjesa e gramatikës) nga Haxhi Zihnî efendiu dhe “*Metni izhâr*”; Gjuhë osmane: “*Tertîb-i ced-îd-i kavâ’idi osmâniye*” nga Xhevdet Pasha dhe “*Kirâet*” nga Reshad efendiu; Gjuhë perse: “*Gülistân*”; Gjuhë frënge: “*Teshîli l-lisân*” (pjesa e dytë) nga Vizintal efendiu dhe “*Lektyra (Lecture)*” nga Hristoforid efendiu; Matematikë: “*‘Ameli ve nazari ‘ilmi hesâb*” nga Ahmed Shukrî pasha; Gjeometri: “*Ta’lîm-i hendese*” (pjesa e parë) nga ‘Abdi pasha; Gjeografi: “*Cografya-yi umûmî*” nga Celal beu; Histori: “*Muhtasar-i târîhi ‘umûmî ve zubdetu l-kisas*” nga Abdurrahmân efendiu; Ruajtja e shëndetit: “*Hifz-üs-siha*” nga Halîl ‘Izet beu⁵³.

Viti i pestë:

Mësimi feje: “*Duriyektâ şerhi*” nga Es’ad efendiu dhe “*Mexhmu’a-i zuhdiye*” (vëllimi i parë); Gjuhë arabe: “*El-muşezeb*” (gramatika) nga Haxhi Zihnî efendiu dhe “*Metn-i izhâr*”; Etikë: “*Ahlâk-i hamîde*” nga Se’îd efendiu; Gjuhë osmane: “*Kirâet*” nga Reshâd efendiu; Gju-

⁵² *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova, 1318 (1900-1901)*, f. 258-266.

⁵³ *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova, 1318 (1900-1901)*, f. 258-266.

hë perse: “*Gülistân*” nga Shejh Sa’adiu; Gjuhë frënge: “*Teshîlu l-lisân*” (pjesa e tretë) nga Vizintal efendiu dhe “*Lecture*” nga Hristoforid efendiu; Matematikë: “*’Amel-i ve nazari il’mi hesâb*” nga Ahmed Shukrî pasha; Diplomatika: “*Usûl-i defterî*” nga Hikmet beu; Algjebër: “*’Ilm-i cebr*” nga ‘Izzet beu; Gjeometri: “*Ta’lîm-i hendese*” (pjesa e dytë) nga ‘Abdi beu; Gjeografi: “*Cografya-yi ‘umûmî*”, nga ‘Abdurrahmân efendiu; Histori: “*Muhtasar târîh-i ‘umûmî ve zubdetul-kisasi*” (vëllimi i parë) nga ‘Abdurrahman efendiu; “*’Ilmi eşyâ*”; “*Ma’lûmât sanaiye ve ticâriye*” nga Xhelâl beu⁵⁴.

Viti i gjashtë:

Mësimet feje: “*Hulâsa-i ‘ilmi kelâm ve şerh-i ‘akâid*” dhe “*Mecmûa-i zuhdiye*” (vëllimi i parë); Gjuhë osmane: “*Osmanli edebiyâtî*” nga Tâhir beu; Etikë: “*’Ilm-i ahlâk*” nga ‘Abdurrahmân beu; Gjuhë arabe: “*Mugni et-tulâb*”, Gjuhë frënge: “*Grammaire*” nga Lariveet Fleury dhe “*Livre d’or*” nga Terziyân efendiu; Ekonomi: “*Muhtasar-i ilmi servet*” nga Nâil efendiu; Legjislacion: “*Telhîsi hukûki mevzûa*” nga Kâzim efendiu; Gjeometri: “*Ta’lîmi hendese*” (pjesa e tretë) nga Abdi Beu; Dituri natyre: “*Muhtasar hikmet-i tabî’iye*” (vëllimi i parë) nga Sâlih Zekî beu; Kimi: “*Kimyâ gayr-i ‘adviy*” nga Nishân efendiu; Gjeografi: “*Cografya-yi osmânî*” nga ‘Ali Tevfik beu; Histori: “*Târîh-i Devlet-i Aliye-i Osmaniye*” (vëllimi i parë) nga ‘Abdurrahmân beu; Trigonometri: “*Müsellesât-i musteviye*” nga Rif’at beu⁵⁵.

⁵⁴ *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova, 1318 (1900-1901)*, f. 258-266.

⁵⁵ *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova, 1318 (1900-1901)*, f. 258-266.

Në vitin e shtatë:

Mësim feje: “*Hulâsa-i ‘ilmi kelâm ve şerh-i akâidi*” dhe “*Mecmûa’i zuhdiye*” (vëllimi i dytë); Gjuhë osmane (si në vitin e gjashtë); Arabisht (si në vitin e gjashtë); Osmanishte: “*Osmanli edebiyâtî*” nga Tâhir beu; Gjuhë frënge (si në vitin e gjashtë); Ekonomi (si në vitin e gjashtë); Kosmografi: “*Kozmografyâ*” nga Mustafa Reshîd efendiu; Mësim natyre (si në klasën e gjashtë, vëllimi i dytë); Kimi (si në klasën e gjashtë); Mësime natyre: tri shken-cat: “*‘Ilm-i hayvânât*” (Zoologji) nga Mahmûd Es’ad efendiu, “*‘Ilm-i nebâtât*” (Botanikë) nga Hysejn Remzi efendiu dhe “*‘Ilm-i tabâkât*” (Gjeologji) nga Halîl beu; Gjeografi: “*Cografya imrânî*” nga Hikmet beu; Histori (si në klasë të gjashtë, vëllimi i dytë); Ruajtje e shëndetit: “*Hifz-üs-sihati*” nga Besîm Ümer Beu⁵⁶.

Disa nga këto tekste janë mësuar edhe në shkollat rush-dije. Tekstet janë shtypur në shtypshkronjat e Stambollit, Manastirit, Selanikut etj. Në Sâlnâmenë e vilâjetit të Kosovës, për vitin 1318 (1900-1901), është shënuar edhe emri i shtypshkronjës ku janë shtypur këto tekste, si dhe çmimi i tyre⁵⁷. Në bazë të çmimeve që janë dhënë këtu, mund të përfundojmë se ato kanë qenë të përbalueshme për nxënësit shqiptarë që kanë ndjekur këto shkolla. Në favor të këtij konstatimi është edhe fakti se në Bibliotekën e Arkivit të Kosovës, në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe në Bibliotekën e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Koso-

⁵⁶ *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova, 1318 (1900-1901)*, f. 256-257 dhe 258-266.

⁵⁷ *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova, 1318 (1900-1901)*, f. 258-266.

vës, po edhe në biblioteka private të ulemave të mëhershëm, ku i kemi kryer hulumtimet tona, kemi parë se ruhen ekzemplarë të shumtë të teksteve të këtyre shkollave.

Përfundim

Nga sa më sipër, mund të përfundojmë se shkollat idâdije, në përgjithësi ishin shkolla të kompletuara, me personel dhe mësimdhënës të përgatitur për lëndët përkatëse, me rregullore dhe me plane mësimore të avancuara.

Shkollat idâdije në Kosovë, sikur në gjithë Perandorinë Osmane, njohën disa ndryshime si në kohëzgjatjen e mësimi, po ashtu edhe në planin mësimor.

Në Kosovë vepruan tri idâdije jo të plota, ajo e Prishtinës, që ishte më e vjetra, e Prizrenit dhe ajo e Pejës, që punoi vetëm tri vjet.

Me largimin e osmanëve nga Kosova dhe me fillimin e Luftës së Parë Ballkanike, sikurse edhe shkollat tjera osmane, edhe idâdijet, pushuan se funksionuari.

Gjatë periudhës 1909-1912, shkollat osmane në Kosovë, pra edhe idâdijet, morën edhe një karakter më kombëtar, sepse patriotët e shquar filluan ta përdornin, herë fshehtazi dhe herë haptazi me mësues dhe nxënës të besueshëm, gjuhën shqipe në këto shkolla.

Nxënësit që kanë mbaruar shkollat idâdije, më vonë do t'i gjejmë si bartës kryesorë të arsimit kombëtar dhe si ushtrues të funksioneve të ndryshme dhe nëpunës në administratë.

Dr. Jusuf EL-KARDAVI

SHOQËRIA NUK NDËRTOHET VETËM NGA LEGJISLACIONI

Islami nuk është thjesht vetëm legjislacion dhe ligj, ai është doktrinë e interpretimit të ekzistencës, adhurim që e edukon shpirtin, etikë që e pastron, koncepte që e saktësojnë perceptimin, vlera që e lartësojnë qenien njerëzore, mirësjellje që e rregullojnë jetën, ajete të dispozitave legjislative që nuk arrijnë 10 ajete të Kuranit, të cilat janë të përziera me përzierje të doktrinës me ndërgjegjen, të shoqëruara me premtim dhe frikësim, të lidhura organikisht edhe me direktivat e tjera të Kuranit.

Të lexojmë, për shembull, në dispozitat e familjes, Allahu i Plotfuqishëm thotë:

“Lëshuarja mund të bëhet dy herë: pra, ose të mbahet me arsye, ose të ndahen me të mirë. E juve, nuk ju lejohet të merrni çfarëdo nga ato që u keni dhuruar, përpos nëse këta të dy frikësohen se nuk do t’i zbatojnë

dispozitat e Allahut. E, nëse, ju të dy frikësoheni se nuk do të mund t'i kryeni dispozitat e Allahut, atëherë nuk është mëkat për asnjërin për atë që ia jep gruaja. Këto janë dispozitat (kufijtë) e Allahut, andaj mos i rrënoni ato! E, ata që i rrënojnë dispozitat e Allahut, janë mëkatarë të mëdhenj.” (el-Bekare, 229) Ky nuk është një legjislacion i thatë si nenet e ligjit, por është legjislacion, thirrje, udhëzim, edukim, inkurajim dhe kërcënim, njëherësh.

Ejani të lexojmë në dispozitat e ndëshkimit të së drejtës islame, ku Allahu i Plotfuqishëm thotë:

“Vjedhësit dhe vjedhëses këputni duart e tyre, për ndëshkim të asaj që kanë punuar - dënim nga ana e Allahut, se Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm. E, kushdo që të pendohet pas të këqijave të tij dhe përmirëson punën e tij, Allahu ia pranon pendimin, se Allahu, me të vërtetë, është falës dhe mëshirues. Ti (o Muhamed!), e di, me siguri, se të Allahut janë pushteti mbi qiejt dhe Tokën. Ai dënon kë të dojë dhe fal kë të dojë. Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.” (el-Maide, 38-40)

Këtu, gjithashtu e gjejmë një legjislacion të ndërgjegjshëm, të shoqëruar me kërcënime dhe premtime, që bart frikësim dhe shpresë, që inkurajon për pendim dhe reformim, që rikujton emrat e Allahut: **El-Aziz** (Fuqiploti) kur urdhëron dhe ndalon, **El-Hakim** (Gjykuesi) në atë që gjykon, **El-Gaffur** (Gjithëfalësi) **Err-Rrahim** (Mëshirëploti) për atë që pendohet dhe reformohet, **Malikul-Kevni** (Pushtetmbajtësi) i universit, dhe pronari i krijimit dhe komandës, dhe Ai është i

Aftë për çdo gjë. Ky është konteksti i legjislacionit në Kuran, i ngjashëm me këtë është edhe në Sunnet, sepse shoqëria myslimane nuk ndërtohet vetëm me legjislacion, por ajo duhet t'i ketë edhe dy komponentë tjerë: thirrjen dhe ndërgjegjësimin, pastaj edukimin dhe arsimimin, krahas legjislacionit dhe ligjit, madje para legjislacionit dhe kodifikimit.

Për këtë shkak Islami filloi me periudhën e Mekës, me periudhën e thirrjes dhe edukimit para periudhës së Medinës që është periudha e legjislacionit dhe organizimit. Në këtë periudhë e shohim legjislacionin të përzier me edukimin, si kurse përzierja e trupit me shpirtin. Vetëm ndryshimi i thjeshtë i ligjeve nuk e ndërton bashkësinë myslimane. Në të vërtetë ndryshimi i shpirtave është themeli.

Ndihmësi më i madh në ndryshimin e shpirtave është besimi, i cili e ngrit njeriun në një krijesë tjetër, duke i vendosur qëllime, duke i dhuruar impulse dhe norma, pastaj duke paraparë shpërblim apo ndëshkim për veprat e tij në këtë botë dhe në botën tjetër, sepse Islami është një tërësi e pandashme. Nëse duam ta luftojmë një krim për të cilin është i përcaktuar ndëshkimi (i sheriatit), ai nuk luftohet vetëm duke e ekzekutuar dënimin, as vetëm me legjislacion, sepse ndëshkimi është hapi i fundit që duhet të ndërmerret në rrugën e reformimit.

Ndëshkimet janë për njerëzit e devijuar, të cilët nuk janë shumicë, as nuk janë rregull, por janë përjashtim nga rregulli, kurse Islami nuk ka ardhur vetëm për trajtimin e të devijuarve, por për drejtimin e të moderuarve dhe parandalimin e tyre nga devijimi, ndërsa ndëshkimi nuk është faktori më i madh në luftimin e krimit sipas Islamit. Faktori më i madh është

mbrojtja prej tij duke i parandaluar shkaqet. Parandalimi gjithmonë është më i mirë se mjekimi.

Nëse shikojmë në krimin e prostitucionit, do të shohim se Kurani famëlartë në lidhje me ndëshkimin (e sheriatit) për të, ka sjellë vetëm një ajet në fillim të sures en-Nur, ku thotë:

“(Dispozitë obliguese është që) Laviren dhe lavirin t’i rrihni, secilit prej tyre me nga 100 të rëna, dhe në zbatimin e dispozitave të Allahut mos u tregoni zemërbutë ndaj atyre dyve, nëse jeni që i besoni Allahut dhe botës tjetër.” (en-Nur, 2)

Megjithatë, vetë surja ka përfshirë dhjetëra ajete të tjera të cilat udhëzojnë për parandalimin e krimit. Na mjafton ky ajet: ***“Ata që duan t’i përhapin lajmet e turpshme për besimtarët, i pret dënimi i dhembshëm në këtë botë dhe në tjetrën, Allahu i di të gjitha, e ju nuk i dini.” (en-Nur, 19)***

Në lidhje me organizimin e shkëmbimit të vizitave dhe me mirësjelljen gjatë tyre, pastaj për respektin e shtëpive dhe mbrojtjen e shenjtërisë së tyre, Allahu i Plotfuqishëm thotë:

“O besimtarë! Mos hyni në shtëpitë e huaja përderisa të mos paraqiteni e të mos i përshëndetni banuesit e saj. Kjo është më mirë, që ju të këshilloheni! (en-Nur, 27)

Këtu hyjnë rregullat e autorizimit për shërbyesit dhe fëmijët që nuk kanë arritur moshën e pjekurisë:

“O besimtarë! Le të kërkojnë leje ata që janë nën pushtetin tuaj (në familje) dhe ata nga ju që nuk e kanë arritur moshën e pjekurisë në tri raste: para namazit të sabahut dhe kur i zhvishni rrobat tuaja në mesditë dhe pas namazit të jacisë. Këto janë tri kohë kontestuese (jo të përshtatshme).” (en-Nur, 58)

Më e rëndësishme se kjo është edukimi i besimtarëve dhe besimtareve për moralin e dëlirësisë dhe nderit, duke i ulur shikimet dhe duke i ruajtur pjesët e turpshme. Kjo është theksuar në ajetet vijuese: ***“Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haramit), të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre se kjo është më e mirë për ta. Me të vërtetë, Allahu është i dijshtëm për atë që punojnë ata. Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme, le të vënë shamitë mbi kraharor...”*** (en-Nur, 30-31)

Këtu shfaqet një element i ri për parandalim nga prostitucioni dhe krimet seksuale, gjë që është ndalimi i grave për t’u shfaqur në publik me pamje joshëse dhe tunduese për burrat, për të mos nxitur instinktët dhe imagjinatën e tyre. Kjo është ligjësuar me ajetin vijues:

“...Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për të mos zbuluar fshehtësinë nga stolitë e tyre...” (en-Nur, 31) Ajeti përfundon duke thënë i Plotfuqishmi: ***“Pendohuni të gjithë te Allahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim.”***

Kjo do të thotë se duhet pastruar shoqëria nga shkaqet e tundimit dhe joshjes, duke i penguar pretekstet ndaj fesadit, kurse më i rëndësishmi nga të gjitha këto është urdhri për martesë i burrave dhe grave, pastaj adresimi i mbarë komunitetit në lidhje me këtë duke e konsideruar bashkëpërgjegjës me përgjegjësi solidare:

“Dhe martoni të pamartuarat (të pamartuarit) edhe robërit e robërshat tuaja që janë të ndershëm e të ndershme. Nëse janë të varfër, Allahu i begaton nga

mirësitë e Tij, Allahu është bujar i madh, i gjithëdijshëm.” (en-Nur, 31)

Përgjegjësia e komunitetit, pikësëpari e pushtetarëve, pasqyrohet në lehtësimin e shkaqeve të angazhimit hallall, krahas mbylljes së dyerve të haramit, duke ua hequr barrierat fizike dhe sociale atyre që duan të martohen, siç janë: kostoja e lartë e mehrit, shpenzimet e tepuara për dhurata, për bankete, për mobilim dhe për çështje të tjera lidhur me të, pastaj duke u ndihmuar atyre, materialisht dhe moralisht, që të formojnë shtëpi myslimane. Prandaj, ekzekutimi i ndëshkimit nuk është ai që zgjidh problemin. Në realitet, ky ndëshkim edhe nuk mund të zbatohet sipas kushteve të tij legjislativë, përveçse në rastet e pranimit para Këshillit Gjyqësor katër herë, sipas mendimit të disa imamëve të medhhebeve, ose dëshmisë së katër dëshmitarëve të drejtë se ata e kanë parë aktin e krimit drejtpërdrejt gjatë ndodhjes së tij. Kjo është vështirë të realizohet. Këtu, sikur është për qëllim parandalimi i shfaqjes së krimit, ndërsa ai që është sprovuar me këtë krim në mënyrë të fshehur, ai nuk i nënshtrohet dënimit të kësaj bote dhe çështja e tij i mbetet Allahut të Plotfuqishëm në botën tjetër.

Burimi: <http://www.al-qaradawi.net/new/Articles-12466>;

Shkëputur nga libri i dijetarit të madh

“Komuniteti mysliman që duam”.

Përktheu nga arabishtja:

Miftar Ajdini

KONTRIBUTE

Dr. Nuridin AHMETI

KONTRIBUTI I DISA YLEMAVE SHQIPTARË GJATË VITIT 1908 (Sipas disa raporteve austrohungareze)

Hyrje

Nga vitet më të rëndësishme në historinë shqiptare llogaritet të jetë edhe viti 1908, sepse pikërisht në këtë vit fillon revolucionin Xhonturk, i cili, sikurse dihet, kishte përkrahjen edhe të inteligjencës shqiptare të kohës, dhe po këtë vit ndodh edhe një ngjarje tjetër me shumë rëndësi për shqiptarët - Kongresi i Manastirit.

Janë shkruar mjaft kontribute shkrimore për Kongresin e Manastirit ndër vite të shqiptarët, posaçërisht pas Luftës së Dytë Botërore e deri me sot për këtë ngjarje në shtetin amë në Shqipëri, në Kosovë dhe Diasporë, janë botuar shkrime, monografi dhe janë mbajtur konferenca të ndryshme shkencore etj..

E, me gjithë këtë, historiografia shqiptare, ka anashkaluar rolin e një shtrese të shoqërisë shqiptare dhënë në këtë Kongres, posaçërisht ka anashkaluar rolin e tyre në unisimin/unifikimin e alfabetit të gjuhës shqipe më 1908. Pra, është fjala për kontributin dhe rolin e padiskutueshëm të disa ulemave që kanë luajtur para, gjatë dhe pas mbajtjes së Kongresit të Manastirit,¹ kontributi i të cilëve u vu në dukje edhe nga diplomatët e huaj që shërbyen në vilajetet shqiptare në raportet e tyre që i dërguan në qendrat e tyre respektive,² në mesin e të cilëve raporte hynë edhe këto që do t'i paraqesim si më poshtë.

Për ta përforcuar mendimin e lartëthenë ne po citojmë librin: “Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare”, në të cilin, kur flitet për këto vite, shkruhet (përzgjedhje e shkrimeve të shtypit të rilindjes) në tërësi me tone negative për krerët fetarë në përgjithësi, por edhe për ata krerë fetarë myslimanë në veçanti.³

Përkitazi me këtë, për lexuesit e “Takvim”-it do t'i sjellim dy raporte të vitit 1908 të dërguara nga konsullatat austrohungareze të akredituara në vilajetet shqiptare, të cilat i kanë dërguar në Ministrinë e Punëve të Jashtme austrohungareze në lidhje me veprimtarinë kombëtare të disa ulemave tanë gjatë vitit 1908. Këto raporte i kemi marrë nga Arkivi i

¹ Zihni Haskaj, “Roli reaksionar i klerit ndaj problemeve të alfabetit(1879-1912)”, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, UT-IH-IGJL, Tiranë, 1972, f. 119-126.

² Memli Krasniqi-Armend Mehmeti, *Dokumente të Shoqërisë Biblike dhe Britanike dhe për të huajt (1816-1912)*, IAP, Prishtinë, 2016, f. 97-119.

³ *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare (1908-1910)*, Vëll. II, SSHSH-IH, Tiranë, 1976, f. 7, 493-553.

Institutit të Historisë në Tiranë dhe ruhen me numrat e signaturave; Vj. 18- 2- 245 dhe Vj. 18-7-751.

Për hir të korrektësisë, këto raporte do t'i paraqesim edhe të plota pa bërë asnjë ndërhyrje.

U kemi bërë një vështrim këtyre raporteve për disa arsye, por ne do t'i përmendim tri:

E para-nuk na ka renë që këto raporte t'i shohim deri me sot të botuara në tërësinë e tyre.

E dyta-në këto raporte behët fjalë për veprimtarinë e ulemave: Hoxhë Ismail Hakiut⁴ dhe Hoxhë Vildan Dibra,⁵ por

⁴ **Ismail Haki ef. Manastiri (1846-1912).** Dijetar i shquar, profesor universitar, publicist, autor i shumë veprave. U lind në Manastir, prandaj dhe u bë i njohur sipas vendlindjes. Botoi shumë shkrime në gazetën “Sirât-i müstakîm”, të cilën e drejtonte vetë ai, si dhe në gazetën “Sebîl’ur-reşâd” me kryeredaktor Mehmet Akif Pejani. Ishte autor i dhjetëra veprave nga fusha e shkencave islame. Vdiq më 22 nëntor 1912 dhe u varros në oborrin e xhamisë “Fatih” në Stamboll. Shih: Sülejman Baki, *Manastırlı İsmâîl Hakkı ve Telhîsu'l-Kelâm Eseri*, Logos-A, Shkup, 2006.

⁵ **Vildan Faik Dibra (?-1925)-** u lindi në Rimnicë të Rekës së Dibrës. Shkolimin fillor dhe të mesëm i mbaroi në Dibrë. Studimet i vazhdoi në Stamboll, ku i përfundoi me rezultate shumë të mira. Pas përfundimit të studimeve shërbeu si Profesorë në medresenë e Yskudarit në Stamboll. Po aty për nxënësit refugjatë shqiptarë hap edhe një shkollë shqipe me emrin “Kosova”. U bë pjesë e Lëvizjes Kombëtare të fillimit të shek. XX. U bë pjesë e Klubit “Bashkimi” në Stamboll dhe përfaqësoj këtë klub në Kongresin e Manastirit më 1908. Si i dërguar i Komitetit Stambollit në hapësirat shqiptare, mbajti një varg ligjërata. Janë me interes ligjëratat rreth shkrimit të shqipes me alfabet latin, të cilën ky e mbronte. Shkroi në gjuhët e lindjes një mori shkrimesh e librash nga fusha teologjike, filozofike dhe e drejtësisë. Vdiq në Stamboll më 1925. Ramiz Zekaj, *Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët gjatë shekullit XX*, ISHMQI, Tiranë, 2002, f. 278-280; *100 personalitete shqiptare të kulturës islame shekulli XIX-XX*, KMSH, Tiranë, 2012, f. 280; Ruzhdi Lata, “Kontributi i ulemave dibranë për çështjen kombëtare”, *Kontributi i prijësve myslimanë në formimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar*, (Konferencë shkencore 28-29 shtator 2012), BIK-KMSH-BFIRM, Tiranë, 2013, f. 45-48.

tërthorazi përmendet edhe veprimtaria e ulemave të tjerë, si Rexhep Vokës së Tetovës, qe raporti e përmend si Rexhep Hoxha etj., të cilët kishin të njëjtin mision si Ismail Hakiu dhe Hoxhë Vildan Dibra.

E treta- raportet nxjerrin në pah personalitetin e ulemave dhe kontributin e tyre gjatë këtij viti dhe në këto ngjarje, por edhe në angazhimin e tyre në aspekte të tjera kombëtare.

Klubet shqiptare dhe Komitetet e fshehta

Në muajin korrik të vitit 1908, si rezultat i kryengritjeve që ndodhën në hapësirat shqiptare, lëvizja xhonturke dhe bashkëpunëtorët e tyre e detyruan sulltan Abdyl Hamitin që ta shpallte Kushtetutën e vitit 1876, e cila ngjarje u prit me entuziazëm në hapësirat shqiptare. Si rezultat i kësaj, disa shqiptarë duke i shfrytëzuar mundësit e krijuara, iu përveshën punës për ngritjen dhe organizimin e mëtejme kulturor e politikë të popullit shqiptarë. Si forma më të përshtatshme për t'i mbështetur organizimet dhe qëllimet e tyre, intelektualët shqiptare formuan klubet me karakter kombëtar, të cilat u shtrinë në të gjitha fshatrat e qytetet shqiptare, duke filluar nga Manastiri dhe më pastaj vazhduan në hapësirat e tjera shqiptare.⁶

Këto klube përfshin në radhët e tyre njerëz të shtresave të ndryshme të shoqërisë, kurse udhëheqja e tyre u besohej intelektualëve të kohës.⁷ Pa dyshim, në këto organizime, nga ajo

⁶ *Historia e popullit shqiptar II*, ASHSH-IH, Toena, Tiranë, 2000, f. 377-381.

⁷ *Historia e popullit shqiptar II*, ETMMKSAK, Prishtinë, 1979, f. 282-283.

që shihet edhe në këto raporte, rol kyç kishin edhe ulemaja shqiptare.

Ajo çfarë kuptohet nga këto raporte, po edhe nga literatura, është fakti se në fillimet e organizimit të tyre, këto klube vepruan haptazi dhe proklamnin se duke punuar në vijën kombëtare ata i ndihmonin gjoja edhe vetë pushtetit të kohës. Me kalimin e kohës, organet xhonturke bënë përpjekje që t'i kontrollonin në masë të theksueshme këto organizime dhe si formë më të përshtatshme zgjodhën formën duke infiltruar njerëzit e tyre në këto klube, përmes të cilëve shkaktonin tensione në mbarëvajtjen e punës së tyre, prandaj, kjo gjë u vërejte nga intelektualët shqiptarë të kohës dhe këto organizime filluan së vepruari në mënyrë të fshehtë. Kjo formë e organizimit, vazhdoi punën e tyre pavarësishturvejimeve të pushtetit.⁸ Veprimet në fshehtësi të këtyre klubeve nuk e humben karakterin e vetë, atë të luftës për avancimin e më shumë të drejtave nacionale për shqiptarët dhe tani e shoqëruar edhe me propagandë anti xhonturke.

Rrjedhimisht, edhe dy raportet e marr në shqyrtim, në mes tjerash, bëjnë fjalë për këto forma të organizimit. Për dallim nga ajo çfarë na është prezantuar në librat tona në lidhje me këto ngjarje, raportet na vërtetojnë bindshëm të kundërtën, pra, se në këto organizime rol vendimtarë kishin edhe ulemaja jonë, të cilët direktivat për këto organizime i kishin marrë nga Komiteti Shqiptar i Stambollit.

⁸ *Historia e popullit shqiptar për shkollat e mesme*, ShB, Libri Shkollor, Tiranë, 1994, f. 123-124.

Raportet venë në dukje në fjalimet e ulemave theksin që këta të fundit i kushtonin harmonisë “midis muhamedanëve dhe të krishterëve për ruajtjen e lirisë posa të fituar”, sepse, në të dy raportet theksohet, ky element, kjo siç duket ishte edhe prej kushteve kryesore për mbarëvajtjen e organizimeve të mëtutjeshme të lëvizjes kombëtare, kjo gjë ishte e qartë edhe për ylematë të cilët u bënë pjesë e këtyre organizimeve.

Pa dashur të futemi në thellime të mëtejshme të raporteve që po i prezantojmë, ne mendojmë që këto raporte, ashtu siç janë përpiluar nga diplomatët e kohës dhe ashtu siç kanë ardhur deri te ne, flasin më shumë. Prandaj edhe ne prezantimin e tyre po e paraqesim pa asnjë ndërhyrje nga ana jonë.

“Misioni i Hoxhë Ismail Hakiut në Manastir, anëtar i Komitetit të Fshehtë të Stambollit.

Synim për themelimin e komiteteve të fshehta.

Manastir 7 dhjetor 1908. Nr. 77, Posfai.

I nderuari Baron,

Hoxhë Ismail Haki Beu, shqiptar me prejardhje nga Manastiri, i njohur si kortizan i xhonturqeve, ka arritur këtu para disa ditëve prej një udhëtimi që kishte bërë me tre shokë, që kishin misionin e njajhtë në Vila-jetin e Kosovës për një qëndrim të shkurtër këtu, si ai për të cilin ishte qenë dërguar Haxhi Vildani nga Manastiri në Shkodër (relacioni, dt., 23 Nëntor 1908).

Ai mbajti para shumë mijra ndigjuesave në pjesë të madhe muhamedan në Xhaminë e madhe një fjalim të gjatë, i cili ka bërë një përshtypje të thellë. Thelbi i këtij ka qenë ftesa për harmoni midis muhamedaneve dhe të krishterëve për ruajtjen e lirisë posa të fituese.

Kritika të ashpra kundër sistemit të vjetër, sidomos kundër sundimit të përparshëm arbitrar të Sulltanit kanë zgjuar një jehonë në zemrat e të gjithëve.

Siç kam marrë vesh në mënyrë tepër konfidenciale Ismail Hakiu ishte një antar i shquar i Komitetit të fshehtë të shqiptarëve të Istambullit, qendra e të cilit mbas të gjitha gjasave duket se është në Istambull dhe ai është ngarkuar po me atë detyrë sekrete si ajo e mikut të tij të Presidentit të Klubit të këtushëm “Bashkimi” Rexhep Hoxhës, të cilin unë e kam patur nderin ta permend në relacionin tim të devotshëm datë 30 nëntor 1908 Nr. 75 dhe e cila synon të themelojnë në Provincën Komitete të fshehta shqiptare.

I dërguar prej xhonturqëve që të marrin pjesë masa që shqiptarët të mbështetën gjithkrah në Komitetin e xhonturqëve, ai këtë e bëri me bindje të plotë ashtu siç e bëjnë pothuajse të gjithë udhëheqësit shqiptar, vetëm të sigurojnë zhvillimin e idesë nacionale shqiptare. Gjithashtu edhe për të zhvilluar ndërgjegjen kombëtare të bashkatdhetarëve të tij, e cila shpesh herë as që tejkalon kufinin e fisit dhe me këtë rast të shfrytëzojnë fuqimisht ndihmën e partisë politike udhëheqëse. Regjimi i ri, në ekzistencën e të cilit konstatohet shpesh herë se kanë pak besim, duhet të shërbej si mjet për t'i arritur qëllimit. Një interes të veçantë meriton plani organizativ i Komitetit të fshehtë, për të cilin unë këtu poshtë marrë leje të flasë:

1. *Në të gjitha viset e Shqipërisë do të dërgohen ho-xhallarë për të bërë propagandë nacionale shqiptare.*
2. *Në radhët e dytë duhet të punojnë për sigurimin e Kushtetutës, ky duhet të jetë qëllimi kryesor i dukshëm nga jashtë, por ne të vërtetë ky është vetëm një pretekst.*
3. *Në çdo lokalitet me të madh të Shqipërisë do të zgjidhen në formë sekrete pese persona, të cilët do të bëjnë propagandë kombëtare.*
4. *Këta pesë persona detyrohen duke dhënë besën se do të punojnë për çeshtjën kombëtare shqiptare dhe he për he xhonturqit do t'i përkrahin dhe kjo e fundit për arsye që të mos dyshohet prej Xhemitit (Komitetit të Xhonturqëve) dhe të mos luftohen prej tij.*
5. *Në çdo lokalitet do të mblidhen të holla, të cilat pasanikët do t'i dhurojnë vullnetarisht dhe këto do të shërbejnë ne radhë të parë për forcimin e komiteteve.*
6. *Shqiptarët nuk do të kundërshtojnë në asnjë vend nderimin e rrugëve meqë këto do t'i shërbejnë Shqipërisë për të mirën e sajë.*
7. *Kur komitetet e degëve të jenë të organizuar, ata do të punojnë ndër fshatra.*
8. *Kur shfaqet e nevojshme ka për t'u dërguar nga vetë qendra një Komision (nën çfarëdo preteksti) dhe pikërisht për të evituar çdo dyshim nga ana e*

xhonturqëve dhe pa pandehur askush aktivitetin e komitetit.

9. *Çdo degë e komitetit në fillim ka të drejtë të përdorin shumat e mbledhura për qëllimet saja, si për shembull për dërgimin e hoxhallarëve për qëllime propagande ndër fshatra.*
10. *Më vonë (Komiteti Qendror) i panjohur ka për ta caktuar një lokalitet ku do të mblidhen të hollat që nuk janë shpenzuar prej degëve të komiteteve dhe do të krijohet një arkë qendrore.*
11. *Autor që do të tradhtoj ka për t'u dënuar nga Komiteti me vdekje.*
12. *Hoxhallarët e dërguar ndër fshatra do të zgjedhin me kujdes personat e përshtatshëm duke u njohur mandateve të tyre emrat dhe pastaj dega e komitetit ka për të dërguar një person të përshtatshëm dhe do të krijoj një degë të re të komitetit.*

Për të ardhmen e afërte mund të supozohet pothuaj me siguri, se patriotët shqiptarë do të punojnë në mes tyre drejtë mbështetjes se plotë të regjimit të ri dhe do ta përkrahin atë. Sidoqoftë përderisa të jetë forcuar mjaftësishtë kauza nacionale ata do të ecin në një rrugë të përbashkët me xhonturqit. Poashtu, parashikohet se pas forcimit, ata do të detyrohen të ndahen prej xhonturqëve, është vetëm çështje kohe, është problem i shpejtësisë së përparimit të tyre kur kontraktat që do të shfaqen në mes të aspiratave të tyre kombëtare dhe të idesë së Shtetit Otoman do të bëjnë dis-harominë dhe se kur do të realizohet pranimi i një

*programi me radikal i përgatitur nga ky komitet i fshehtë”.*⁹

Raporti tjetër lidhet kryesisht me personalitetin e Hoxhë Vildan Dibrës, një prijës fetarë mysliman me kontribut të theksueshëm në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, por jo i vlerësuar aq sa duhet nga historiografia jonë. Në raport thuhet:

“Delegatët e Klubit të Stambollit, Hoxhë Vildan Efendiu, kolonel Ali Riza dhe avokat Abdyl bej Ypi.

31 dhejtor 1908. Karl.

Delegatët e Klubit të Stambollit nuk kanë qenë të inspiruar prej Komitetit xhonturk. Delegatët ishin ndërkohë në Shkodër, ku më vizitoi ky i fundit, me të cilin kam qenë i miqësuar qysh në Manastir. Nga deklaratat e tija rezulton se inisiativa për udhëtimin e përmendur kishte dalë prej vetë Klubit të shqiptareve të Stambollit dhe, pikërisht të shtyre nga motive nacionale dhe je me kërkesën e qeverisë ose të xhemijetit, por para nisjes kishin hyrë në kontakt me rrethet zyrtare, duke i venë vetës së qëllim propagandimin në favor të Kushtetutës dhe kishin marrë aprovimin e vezirit të madh dhe Këshillit të Ministrave. Komiteti xhonturk nuk zuri besë, pse nuk ishte arritur një urdhëresë e plotë me të dhe kështu i caktoi me vonë delegacionit shqiptarë një njëri të besuar, personin e Sylejman Efendiut, i cili duke filluar prej Manastirit

⁹ Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien (më tej: HHSt.A.P.A.A), në Arkivi i Institutit të Historisë - Tiranë, (më tej: AIHT), AIHT, Vj. 18-7-751. Raport i Posfajt nga Manastiri dërguar në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vienë, më 7 dhjetor 1908.

do të kontrolloj veprimet e delegacionit. Pra, ai nuk është anëtar e Komisionit, por i ndjek ata të gjithë kohën hap pas hapi. Pjesëtarët e Kongresit të alfabetit në Manastir, ishin në fillim të mendimit se Vildan Efendiu me shokë vini për t'i bindur që t'i pranon për alfabet shqiptarë shkronjat turqisht, por nga fjalimet e mbajtura prej tyre në Manastir, u duk menjëherë se ishte e kundërta. Hoxha theksoj atje dhe në vendet e tjera se shqiptarët duhet të sqarohen mbi propagandën e përhapur nga disa fanatik turk se Kurani e ndaluaka që shqipja të shkruhet ndryshe veç se me shkronja arabe. Prandaj, një gjuhë mund ta shkruajmë si ta duam si t'i përshtatemi më mirë asaj. Shkronjat rrjedhin prej dorës së njeriut dhe nuk rrjedhin prej Zotit. Nuk mund të thuhet se arabishtja qenka e vetmja gjuhë që e ka pëlqyer Zoti, sepse ekzistojnë shumë libra fetare dhe në gjuhën turqishte. Prandaj, nuk ekziston as edhe një pengim që shqipja të shkruhet me shkronja latine.

Delegatet kishin pastaj për detyrë të zgjoni ndjenjat kombëtare, të formonin klube shqiptare të zgjonin dëshirën për leximin e shkrimeve shqipe etj., detyrë që ata e kryenin vetëm me nuanca të ndryshme dhe sipas gjendjes së lëvizjes kombëtare nëpër krahinat e veçanta. Ata folën edhe mbi paqen e nevojshme ndërmjet secilës fe. Mbi përshtypjet e tyre në secilin qytet u informova se në Dibër mbas një përshëndetje relativisht të ftoftë, në fillim iu caktua atyre si direktiva, se mund të flisnin mbi çdo gjë që dëshironin, vetëm jo përmbi

gjuhën shqipe dhe sulltanin. Pak nga pak ata mund të fitoni besimin dhe krijojnë mirëkuptim. Kështu që ata qëndruan atje afër 10 ditë, mbajtën konferenca të ndryshme dhe munden që të themelonin një klub shqiptarë. Në Elbasan ata bënë një pajtim ndërmjet dy partive të atjeshme, kështu që shpresa për themelimin e shkollës do të jetë më e plotë. Më pak sukses ata patën edhe në Tiranë, për shkak të kundërshtimeve që ekzistonin në mes të parisë bejlerë dhe populllore dhe për faktin se ata u përshëndetën dhe bujtën te të parët, duke ngjallur kështu një mosbesim tek këta të fundit. Me entuziazëm ata folën për Krujën, ku gjetën më tepër mirëkuptim se kudo tjetër. Me keq ata u pritën në Shkodër, që e cilësuan si më prapanikun në gjithë Shqipërinë. Si gjë interesante është kundërshtimi latent ndërmjet Kulbit Shqiptarë në Stamboll dhe Komitetit xhonturk, po del në dritë gjithnjë e më shumë. Kolonel Riza Beu nuk ishte i vëllau Xhemal Pashë Matit siç kam pohuar në një raport, por është një shqiptar nga Ohëri”¹⁰.

¹⁰ *HHS.A.P.A.A në AIHT*, Vj. 18- 2- 245. Raport i Kral dërguar në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, më 31 dhjetor 1908.

Përfundim

Nga raporti i prezantuar dhe literatura e gjertanishme e shfletuar, mund të përfundojmë se ulemaja (me ndonjë përjashtim) kishte kontribut të çmuar në këtë ngjarje me rendësi kombëtare të vlerësuar nga historiografia shqiptare.

Raporti në fjalë përshkruan edhe autoritetin e tyre në Komitetin e Stambollit, ku përdoret termi “anëtar i shquar”, d.m.th., se këta kishin qenë njerëzit e zgjedhur të Komitetit Shqiptar të Stambollit për t’i dërguar në trevat shqiptare.

Janë me dhjetëra raporte austrohungareze që e potencojnë rolin konstruktiv të Hoxhë Hakiut dhe kolegëve të tij në këtë ngjarje.

Hoxhë Haki Manastirliu, Hoxhë Vildan Dibra emrat e të cilëve janë apostrofuar më së shumti në këto dokumente, së bashku me Hafiz Ali Korçen, Hoxhë Vokën e Tetovës, Hoxhë Vokën e Dibrës, Hafiz Ibrahim Dalliu, e shumë të tjerë bënë pjesë te ata prijës fetarë që e përkrahnin shkrimin shqip me shkronja latine, domethënë ishin në vijën e rilindësve etj.

Në dy raportet theksohet roli konstruktiv i ulemave tanë në unifikimin e popullatës shqiptare pa dallime fetare. Kjo, ndoshta është edhe një tregues se ulemaja, veçan për ata të cilët bëmë fjalë, ishin të respektueshëm dhe të pranueshëm të populli ku vepruam, edhe tek ata të përkatësive të tjera fetare.

Fjalët e thëna nga Hoxhë Vildan Efendiu të cilat potencohen edhe në raport se *“një gjuhë mund ta shkruajmë si ta duam si t’i përshtatemi më mirë asaj. Shkronjat rrjedhin prej dorës së njeriut dhe nuk rrjedhin prej Zotit. Nuk mund të thuhet se arabishtja qenka e vetmja gjuhë që e ka pëlqyer*

*Zoti, sepse ekzistojnë shumë libra fetare dhe në gjuhën turqishte. Prandaj, nuk ekziston as edhe një pengim që shqipja të shkruhet me shkronja latine*¹¹ - mendojmë se janë më tepër se përkrahje për këtë nismë; këto fjalë paraqesin njëkohësisht edhe fetvanë e ulemave tanë të kohës për shkronjat me të cilat sot shkruhet gjuha jonë shqipe.

¹¹ *HHSht.A.PA.A në AIHT*, Vj. 18- 2- 245.

Prim.dr.med.sc. Ali F. ILJAZI

BIMËT NGA KËNDVËSHTRIMI KURANOR DHE AI SHKENCOR

Allahu fuqiplotë, të Cilit i takojnë falënderimi dhe lavdërimi në Kuranin famëmadh urdhëron e thotë:

“(Zoti im) I Cili për ju e bëri tokën si djep, për të mirën tuaj hapi rrugë nëpër të, lëshoi shiun prej së larti, e kjo mundësoi që të mbijnë bimë të llojeve të ndryshme.” (Ta Ha, 53)

“... E ti e sheh tokën e tharë - të vdekur, e kur Ne ia lëshojmë asaj ujin ajo gjallërohet, shtohet dhe nga të gjitha llojet rritë bimë të këndshme.” (El - Haxh, 5)

“... Dhe nga qielli Ne kemi lëshuar shi e kemi bërë të mbijnë në të nga të gjitha llojet më të dobishme.” (Lukman, 10)

“E tokën e kemi shtruar dhe në të kemi vuar kodra dhe kemi bërë që në të të mbijnë bimë të caktuara të të gjitha llojeve.” (El - Hixhr, 19)

“Ai është që lëshoi nga lartë shiun e me të nxori bimën e çdo sendi dhe prej bimës gjelbërim dhe prej tij (prej gjelbërimit) kokrra të dendura në kallinj ...” (El - En'amë, 99)

“A nuk e sheh se All-llahu lëshon nga qielli ujë, e Ne nxjerrim me të fruta, ngjyra e të cilëve është e ndryshme ...” (Fatir, 27)

“I pastër nga të metat është Ai që krijoi të gjitha llojet (çifet) nga çka mban toka, nga vetë ata dhe nga çka ata nuk dinë.” (Jasin, 36)

“Ne, nga qielli lëshuam shiun e dobishëm dhe me të bëmë që të kultivohen kopshte e drithëra që korren.” (Kaf, 9)

“Edhe drithi me kashtën e tij edhe bimët aromatike (ose ushqyese).” (Er - Rrahman, 12)

“Dhe prej reve të shtrydhura kemi lëshuar shi të madh. Që me të të rrisim drithëra e bimë. Edhe kopshte të dendura palë mbi palë.” (En - Nebe'ë, 14-16)

“Njeriu le të shikoje ushqimin e vet. Ne lëshuam shi të mjaftueshëm. Pastaj e çamë tokën sipas nevojës së bimës.” (Abese, 24-26)

Siç shihet nga versetet kuranore të cituara më sipër, bimët përmenden në shumë vende. Kjo tregon rëndësinë që kanë ato për jetën e njeriut. Banorët e këtij planeti, që helenët e vjetër i quajtën botane - bimë, vërejnë çka po ndodh rreth tyre dhe reagojnë me një shkallë të lartë dhe të rafinuar, e cila tejkalon edhe atë që mendojmë ne. Hulumtimet shkencore, të cilat filluan në vitet e gjashtëdhjeta, sot u kurorëzuan me zbulime që arritën kulmin në lëmin e fiziologjisë së bimëve. Zbulimet e sotme shkencore vërtetuan vizionin e poetëve dhe

të filozofëve se bimët janë krijesa të gjalla të cilat komunikojnë, kanë personalitetin, shpirtin dhe qëllimin e tyre. Por, antropocentrizmi ynë kronik patologjik është shkaktar që ne bimët, përkatësisht lulet i shohim si pjesë të mobilieve tona e jo si miq që mund të na bëjnë më të bukur jetën tonë fizike dhe më të begatshme jetën tonë shpirtërore. Mbi bazë të eksperimenteve, biokimistët amerikanë të Universitetit të Arizonës në SHBA kanë zbuluar se të gjitha qelizat e gjalla kanë “vetëdije”, madje edhe bakteret dhe ameba.

Allahu i madhërishëm që para 14 shekujsh ka shpallur versetin kuranor: ***“Dhe kur arriti tek ai (zjarr) nga ana e djathtë e luginës së atij vendi të bekuar me pemë u thirr: "O Musa, s'ka dyshim se Unë jam All-llahu, Zoti i botëve!" (El - Kasas, 30)***

I dërguari i Allahut xh.sh. - Musai, a.s., nga pema dëgjoi fjalët e Allahut fuqiplotë. Profesor Andreas Siversi, nga Universiteti i Bonit, duke bërë eksperimente me një bimë kopshti, nxori përfundimin se edhe bimët kanë impulse elektrike nervore, të cilat e informojnë organizmin mbi atë se ç'po ndodh në botën e jashtme, dhe ato nuk janë privilegj vetëm të botës shtazore.

Që në fillim të këtij shekulli biologët, në mesin e të cilëve edhe Hajnc Ueltens (Heinz Welten), kanë hetuar se bimët kanë rrugë nervore, fije plazmatike që shtrihen prej një qelize në qelizën tjetër dhe përgjatë të cilave kalojnë impulsset elektrike që janë zbuluar tani vonë. P.sh. bima e eksperimentuar e kopshtit ka në majat e rrënjës organe të vërteta që rregullojnë baraspeshën, të njohura me emrin statocite. Këto qeliza janë të ndieshme në ndryshimet që ndodhin në fushën e forcës, sipas së cilës bima drejtohet pjesërisht gjatë rritjes së vet.

Statocitet transmetojnë impulse elektrike, të cilat në formë të rrymave nervore lëvizin deri tek pikat e rritjes në rrënjë dhe bisk dhe aty e orientojnë rritjen në një drejtim të ri.

Bimët nuk kanë “diktate” nga një qendër nervore. Të gjitha qelizat jetojnë në “lidhje të pëlqyeshme qelizore” dhe mund të vendosin në masë të caktuar. Potencialin motorik në qelizat nervore e jep joni i kalciumit.

Ekziston edhe një dallim thelbësor në krahasim me sistemin nervor të njeriut: shpejtësia e impulsit. Impulsi i bimëve transmetohet me shpejtësi 3 centimetra në sekondë, ndërsa i njeriut 100 metra në sekondë. Por, tek e fundit, bima as që ka nevojë të vendosë apo të veprojë shpejt. Përrjashtim bën mimoza, e cila me shpejtësi të rrufeshme “tërhiqet në vend të sigurt”, që të mos e hajë lopa. Ajo i lëshon gjethet dhe kërcellin e vet aq shpejt, kështu që aty ku pak më parë ishte bima e lëngshme e gjelbër, përnjëherë vërehet vetëm një degëz e përhimë. A thua mimoza lëshon gjethë dhe kërcellin sepse e ka trembur lopa që kullot në afërsi, apo ajo fshehet nga lopa në mënyrë të vetëdijshme? Duhet të përkujtojmë se reproduktimi në botën bimore bëhet në dy mënyra: seksuale dhe asexuale.

Reproduktimi seksual i bimës bëhet me bashkimin e elementeve mashkullore dhe femërore, për çka në disa versete aludon para 14 shekujsh Kurani faëmadh: “*(Zoti im) I Cili për ju e bëri tokën si djep, për të mirën tuaj hapi rrugë nëpër të, lëshoi shiun prej së lart, e kjo mundësoi që të mbijnë bimë të llojeve të ndryshme.*” (Ta Ha, 53)

Elementi çift është përkthim adekuat i fjalës "zevxh" (shumësi ezvaxh), e cila ka kuptimin “e një gjëje që është marrë nga tjetri dhe formon çift”. Po kjo fjalë ka kuptimin e

bashkëshortëve, por edhe të këpucëve. Këtë fenomen shkencë e vërtetoi në këtë shekull. Po ashtu në versetin 99 të kaptinës El-En'amë, Kurani famëlartë tregoi procesin e fotosintezës: **“... Prej bimës gjelbërim dhe prej tij (prej gjelbërimit) kokrra të dendura në kallinj ...”** (El - En'amë, 99)

Në tetor të vitit 1970, në laboratorin për klimë artificiale në Moskë, ndodhi një fenomen tejet interesant. Kur e kishin zhytur rrënjën e një njomze në ujë të valuar, bima përnjëherë kishte klithur. “Zërin trishtues të bimës e kishte regjistruar një aparat elektronik me ndieshmëri të lartë, treguesi i të cilit kërcente shumë. Dukej qartë se bima luftonte për të jetuar”. Rrëfime të ngjashme, gati të pabesueshme vijnë edhe nga SHBA-të, ku botanistët, fizikantët dhe psikologët merren me jetën shpirtërore të bimëve. Më i njohuri ishte Kliv Baksteri (Cleve Backster), i cili për hulumtimin dhe studimin e bimëve shfrytëzoi detektorin e gënjeshtreve. Midis tjerash, aparati shënon tek njerëzit ndryshime në frymëmarrje dhe në shtypjen e gjakut, tek të cilët krijohet një gjendje e shqetësuar. Sipas fjalëve të Baksterit, një gjendje e tillë ekziston edhe tek bimët. Këtë e dëshmon edhe eksperimenti në vijim:

Në një dhomë ishin vendosur dy bimë. Gjashtë persona hyjnë në dhomë, njëri prej tyre shkuli një bimë me rrënjë, e hodhi në dysheme dhe e shkeli. Bima, pra, ishte shkatërruar. Kush ishte “vrasësi” nuk e dinte as Baksteri. Pastaj, ai e lidhi bimën tjetër me detektorin e gënjeshtreve dhe i lëshoi gjashtë personat të hyjnë në dhomë. Pesë herë nuk ndodhi asgjë, por kur “vrasësi” hyri në dhomë u ngrit fuqishëm gjilpëra (treguesi) në detektor. Një kohë të gjatë bimët janë konsideruar të verbra, ngase në to nuk kanë mund të zbulohen sytë, por ato kanë sy në një numër më të madh sesa kemi ne. Ato kanë mi-

liona sy. Sytë e tyre janë proteinet mikrogypor që ndodhen në brendi të qelizave të të gjitha qenieve të gjalla, por edhe në qelizat e bimëve. Me ndihmën e tyre mund të kapen dhe të ruhen edhe fotografitë tridimensionale.

Me anë të këtyre pigmenteve të të parit bimët nuk mund të shohin njëlloj si njerëzit, por për bimët është me rëndësi jetike të dallojnë vetëm dritën nga errësira. Bimët, për shembull, me anë të këtyre pigmenteve, të cilat u dhuroi Allahu xh.sh., mësojnë t'i hapin lulet, kur është koha e mëngjesit, t'i mbyllin ato kur është mbrëmje. Me rëndësi të veçantë është që Kurani famëmadh na mëson për dobinë e madhe që ka njeriu nga bimët: ***“A nuk e shikuan ata tokën se sa shumë lloje bimësh të dobishme bëmë të mbijnë në të?”*** (Esh - Shuaraë, 7)

Ky verset bën aluzion edhe në bimët mjekuese, pra në fitoterapinë, në të cilën sot përdoren gjithnjë e më shumë kura shërimi me bimë.

Hulumtuesit amerikanë para disa vjetësh kanë vërtetuar se bimët janë të afta dhe komunikojnë me njëra-tjetrën. Nëse lëndohet, bima menjëherë tajit substancën mbrojtëse - fenolin, me të cilën substancë mbyll plagët dhe pengon pezmatimin. Në thellësi të një pylli në Nigeri u zbulua një bimë e re, deri tani e panjohur në analet e botanikës. Ky rast i veçantë ka një rëndësi tejet të madhe shkencore si një zbulim mahnitës.

Në këtë kohë të katastrofës ekologjike dhe industrializmit të pashmangshëm, zbulimi i një lloji të ri bimor apo shtazor tregon se natyra, përkundër të gjitha dëmeve që i shkaktohen, mund të na befasojë përsëri për të mirë. Ky zbulim jo vetëm që është risi, por është edhe i veçantë. Bima e Nigerisë nuk është e zakonshme. Ajo ka disa tipare të ngjashme me ato të fëmijës. Ka organ të vërtetë seksual, nga i cili pas “shtatzënisë

nëntëmujore” lind fryti. Që çudia të jetë edhe më e madhe, organin seksual e mbulon një gjeth, sikurse dora e Afuditës në “Pranverën” e Bottichelit. Këtë bimë e zbuloi italiani Loris Regioli në një pyll 400 km larg bregdetit të Nigerisë. Bima është e lartë 4 metra dhe e mbuluar me gjethë të holla, të cilat dalin drejtpërdrejt nga trungu. Gjatë studimit të tij 18 mujor, Regioli vërejti se për dallim nga bimët e tjera të njohura, lulet e të cilave çelin nga sythi, kjo bimë nuk ka fare sytha.

Lulet “lindin” në rrugë seksuale. Regioli përcaktoi se kjo bimë i ka 35 lule, të cilat vyshken 15 ditë pas lindjes. Ato thahen, nxihen, organi fekondues deformohet, mbyllet dhe humbet, për të dalë përsëri në pranverë. Kur fekondohen lulet, sqaron Regioli, në vezore zhvillohen frytat me një mbështjellës të hollë ngjyrë hiri. Në brendi të frytave gjenden nga 12 fara. Sikurse foshnja që kalon nëntë muaj në trupin e nënës, ashtu edhe fryti piqet nëntë muaj, pastaj bie. Regioli filloi të studionte ambientin përreth në një diametër prej 500km dhe gjeti edhe dy bimë të ngjashme. Kjo do të thotë se, bima jo vetëm që është e panjohur, por është e rrallë. Më vonë zbuloi se për shumicën e kafshëve të atij pylli frytet e kësaj bime paraqesin “delikatesë” të vërtetë, prandaj farat e kësaj bime arrijnë të mbijnë shumë rrallë.

Shtrohet pyetja: Si është e mundur që në një rajon prej 500 km të ekzistojnë vetëm tri bimë të këtij lloji dhe pse gjenden pikërisht aty ku janë e jo diku tjetër?

Siç shihet, nga kjo pyetje dhe nga shumë të tjera, Allahu i madhërishëm na bind se ka aq shumë fshehtësi, të cilat pothuajse nuk do të zbulohen kurrë dhe se i takojnë misterit, i cili duhet të pranohet ashtu siç është.

Të rikujtojmë fjalët e Kuranit famëmadh:

“... I lartë është All-llahu, më i miri Krijues!” (El - Mu'minunë, 14)

Shkencëtarët, poashtu, zbuluan bimën mishngrënëse atraktive të quajtur “mizëgjuajtësja venerike” (*Dionea muscipula*), me madhësi 20 cm. Kjo bimë i ka rrënjët të zhvilluara pak dhe është banuese e moçaleve të varfra me azot. Kjo bimë kultivohet lehtë edhe në vazo me lagështi të bollshme. Miza shkakton ngacmim të dukshëm elektromekanik në pjesën gjuajtëse, kur i prek qimet senzitive të bimës në fjalë. Kjo bimë ndien gjithmonë uri, ndërsa gjahun e saj e kthen në përjetim vizuel, që lë mbresa të pashlyeshme. Dispestimi i mizës zgjat dy ditë, ndërsa i krimbit dhjetë ditë.

Ja edhe një mrekulli tjetër e Krijuesit, i Cili tregon argumente të panumërta në çdo kohë dhe në çdo vend, siç bën aluzion verseti i Kuranit fisnik në vijim: **“Këta janë shembuj që Ne ua sjellim njerëzve, po këta nuk i kupton kush pos dijetarëve.”** (El - Ankebutë, 43)

Shumë nga ne kemi parë këtë eksperiment në laboratorin biologjik të shkollës me epruveta pejzore të vendosura në një enë përplot ujë. Atëherë kemi parë se si ngritej uji në epruvetat pejzore nëpërmjet presionit osmotik. Me ndihmën e këtij eksperimenti na tregonin mënyrën si ushqehen bimët, mirëpo harronin të na thonin shkakun përse bimët japin fryte të ndryshme edhe pse ushqehen njësoj, ujiten me ujë të njëjtë dhe rriten në tokë të njëjtë; harruan të na thonë se Allahu i madhërishëm u ka dhënë bimëve diçka mbi veçorinë e llojit të tyre - veçorinë e zgjedhjes. Për këtë arsye çdo bimë, me diturinë e saj që ia dhuruan Zoti xh.sh., zgjedh nga toka substancat që i përshtaten llojit dhe frytit të saj, që i përshtaten shijes së ëmbël apo të thartë, erës tërheqëse që e karakterizon

atë, etj. Afër saj rritet kungulli i egër, i cili zgjedh substancat që e bëjnë shumë të hidhur dhe i japin një ngjyrë të veçantë, kurse përbri tyre rritet speci, i cili zgjedh ato substanca që e bëjnë djegës, me një shije poashtu të veçantë dhe karakteristike. Të gjitha këto ujiten me ujë të njëjtë, mirëpo jeta (gjallëria) të cilën Allahu ua dha bimëve i bën ato që të zgjedhin nga toka elementet dhe substancat më të përshtatshme për zhvillimin e secilës. Ja se ç' thotë Allahu xh.sh. në Kuran lidhur me këtë: ***“E në tokë, copa sipërfaqesh, të ngjitura njëra me tjetrën, kopshte të hardhisë, të mbjella (të llojlojshme) dhe hurma (bimë këto) që janë të degëzuara në shumë trupa dhe jo të degëzuara (nga një filiz) e të gjitha ujiten nga një ujë, dhe Ne shijen në ngrënie të frutave të tyre e kemi dalluar njërën prej tjetrës. Edhe kjo dëshmon me argumente për njerëzit e mençur.”*** (Er - Rra'd, 4)

Bimët, pra, e madhërojnë Zotin xh.sh. Lidhur me këtë po e tregojmë ngjarjen e njohur kur Muhammedit, a.s., ia sollën një mimber (vendligjërimi) në vend të trungut të vjetër të hurmasë, që të ligjërojë hipur mbi të. Ai trung i hurmasë filloi të qante dhe të dëneste me zë nga mallëngjimi dhe mërzitja që u nda nga njeriu më i dashur. Kjo argumenton se bima ka ndjenja edhe pse ne nuk e kuptojmë gjuhën e tyre. Kështu edhe rasti kur hurma ia puthi dorën e bekuar të Pejgamberit, a.s., ishte vetëm njëra nga mrekullitë e shumta që e karakterizonin Muhammedin, a.s.

Të ndalemi dhe të meditojmë pak lidhur me rastin e Muhammedit, a.s. A thua me të vërtetë bimët reagojnë në rrethin ku jetojnë? A mund të reagojnë edhe në muzikë?

Lidhur me këto pyetje, disa hulumtime të bëra në SHBA në fillim të viteve shtatëdhjeta kanë vërtetuar se kjo është e

mundshme. Shumica e njerëzve në pohimet e tilla kanë qeshur. Janë bërë edhe eksperimente të ndryshme, si p.sh. me petunitë, që u janë nënshtruar muzikës rok dhe muzikës së lehtë. Bimët që i janë nënshtruar muzikës rok janë përpjekur të ikin pas dy javësh pasi që kishin dëgjuar vazhdimisht atë muzikë. Ato janë rritur duke ikur nga radioja, nga e cila është emetuar muzika rok dhe janë vërejtur çrregullime të dukshme në rritjen e tyre, kurse pas dy javësh vetë janë vyshkur krejtësisht. Në anën tjetër, bimët që i ishin nënshtruar dëgjimit të muzikës së lehtë jo vetëm se ishin rritur më shpejtë, por edhe ishin kthyer drejt radios, sikur të donin ta përkëdhelnin atë.

Ky dhe eksperimente të tjera treguan se nën ndikimin e tingujve të zëshëm dhe të paharmonizuar bimët vyshken dhe vdesin, ndërsa nën tonet e lehta dhe melodike lulëzojnë dhe përparojnë.

Sado që ky rezultat është dukur i pabesueshëm, ai është i pranueshëm nga pikëpamja e njohurive më të reja shkencore. Kështu, D. Kreçmen (Kretchman), profesor i hortikulturës në Ohajo, thotë: “Unë mendoj se valë të caktuara akustike i ngacmojnë bimët, prandaj ato i mbajnë poret e tyre të hapura më shumë dhe për një kohë më të gjatë, gjë që tek ato shpejtohet shkëmbimi i materieve e me këtë favorizohet rritja e tyre.” Mbi bazë të kësaj do të mund të pyesnim: Mos vallë bimët që shkatërrohen kur dëgjojnë muzikë rok kryejnë një lloj vetëvrasjeje duke mbyllur plotësisht poret e veta?

Inxhinieri i shquar Marsel Vogël, i cili punonte në kompjuterët e laboratorit IBM, ka bërë një sërë eksperimentesh lidhur me komunikimin me bimët. Zonja Vivian Vejl i këputi dy gjethe të së njëjtës bimë. Të parës i kushtoi kujdes të ve-

çantë gjatë ditës, ndërsa gjethin tjetër e injoroi plotësisht. Gjethi i parë e ruajti gjelbërimin, ishte vital, plot energji dhe i freskët, ndërsa gjethi që e injoroi dhe për të cilin nuk u kujdes zonja Vejl, u vyshk. Ky eksperiment i thjeshtë, por bindës, tregon qartë se bimët dhe njerëzit vendosin lidhje të fuqishme dhe efikase, e cila lidhje vepron mbi protoplazmën, si të bimëve, ashtu edhe të njerëzve. Kjo lidhshmëri karakterizohet me fushën elektromagnetike, me ndryshimin e impulseve elektrike dhe të potencialeve aksionale në sipërfaqet e membranave qelizore të bimëve dhe të njerëzve, me hapjen dhe mbylljen e pompës së kalium-natriumit dhe me veprime të mëtejme biokimike në citoplazmë, që është model i njohur fiziologjik për zhvillimin dhe komunikimin mes qelizave. Çdo herë kur bimëve eksperimentale të Vogëlit u afroheshin persona që kishin qëndrim armiqësor, që mbanin qëndrim negativ ndaj ambientit, tipa depresivë dhe pesimistë, bimët përjetonin stres dhe krijohej një gjendje kaotike e hormoneve të rritjes së tyre - auksimi dhe të gjitha funksionet vitale të saj zvogëloheshin (indeksi respirativ, fotosinteza). Shkencëtari në fjalë kuptoi se kontaktin më të mirë me bimët e realizojnë fëmijët, njerëzit emocionalë, njerëzit plot jetë, si dhe njerëzit që janë të pastër shpirtërisht.

Pra, kushti kryesor për komunikim me bimët është gjendja shpirtërore e personit, ngritja e tij shpirtërore. Sa i përket qëndrimit të besimtarit ndaj botës bimore i kemi parasysh gjithmonë këshillat e arta të Muhammedit, a.s.:

“Nuk ka mysliman që mbjell diçka, ose që mbjell ndonjë fidan, prej të cilit të hajë zogu, njeriu a shtaza, e atij të mos i shkruhen sevabe sikur të kishte dhënë sadaka.” (Buhariu, Muslimi)

“Ruajuni nga tri mallkimet që do të shkaktojnë mbi atë që i bën mallkimin edhe të Allahut, edhe të njerëzve: kryerja e nevojës në burime të ujit, në rrugë dhe nën hije.” (Ebu Davudi, Ibn Maxhxheh, Hakimi dhe Bejhekiu)

Sikur njerëzit, planetët, tërë kozmosi, shtazët, ashtu edhe bimët e madhërojnë Allahun e madhërishëm, siç bëjnë aluzion versetet e Kuranit në vijim:

“Lartmadhëri të merituar i shprehin Atij shtatë qiejt e toka dhe çka ka në to, e nuk ka asnjë send që nuk e madhëron (nuk i bën tesbihë), duke i shprehur falënderim Atij, por ju nuk e kuptoni atë madhërim të tyre (pse nuk është në gjuhën tuaj). Ai është i butë dhe falshumë.” (El - Israë, 44)

“Edhe bimët edhe druajt i përulën Allahut.” (Er - Rrahman, 6)

Literatura:

1. Kur’ani. Përkthim me komentim në gjuhën shqipe nga Sherif Ahmeti.
2. Botanika e përgjithshme (ribotim), Tiranë, 2015.
3. Bimët - Wikipedia.
4. Ali Iljazi: Kur’ani famëmadh nga këndvështrimi shkencor, Gjakovë, 2004.
5. Dr. Xhervis Klinton: Fshtësitë e thesarit të gjelbër të natyrës (përkthim), Gjakovë, 2001.
6. Michael T. Murray, N.D., Joseph E. Pizzorno, N.D.: Encyclopedia of Natural Medicine, USA, 1998.
7. James F. Balch, M.D., Mark Stengler, N.D.: Bottom Lines Prescription for Natural Cures, USA, 2004.

Dr. Sedat ISLAMI

RESPEKTIMI I PRINDËRVE SIPAS ISLAMIT

HYRJE

Pozita e prindërve në fe dallon nga pozita e njerëzve të tjerë. Trajtimi që kërkohet për prindërit është ndryshe nga trajtimi i njerëzve të tjerë. Prindërit dhe respektimi i tyre gëzojnë një pozitë të lartë, pozitë e cila në fe ka ardhur paralel me adhurimin për Zotin. Respektimi për prindërit dhe adhurimi për All-llahun janë të ndërlidhur me njëri tjetrin dhe, siç do të shpjegojmë më vonë, njëri nuk pranohet pa tjetrin. Kjo ka bërë që respektimi për prindërit të jetë, krahas tjerash, edhe një pasqyrë ku reflekton madhështia e Islamit dhe e etikës së tij. Si të këtillë, dijetarët myslimanë me kohë e kanë futur në kuadër të mjeteve me të cilat kanë thirrur dhe thërrasin në fe. Kjo, sepse morali dhe etika jetësojnë teoritë në praktikë dhe lehtësojnë pranimin e tyre nga ana e njerëzve.

Megjithëkëtë, një grup besimtarësh të paformuar, me veprimet dhe sjelljet e tyre arrogante ndaj prindërve, kanë filluar ta zbehin këtë etikë dhe moral të lartë islam. E keqja është se ata po e bëjnë këtë në emër të fesë, ndryshe arrogantë ndaj prindërve ka patur gjithmonë. Kjo më ka shtyrë që t'i rrekem kësaj teme,¹ për të vërtetuar me tekste fetare dhe fakte e dëshmi nga gjeneratat e para se sa të gabuara janë këto sjellje dhe se ato në asnjë rrethanë nuk përfaqësojnë Islamin dhe etikën e tij.

Këto tekste, fakte dhe dëshmi i kam shtjelluar brenda tre pjesëve të këtij punimi:

1. Në pjesën e parë u jam referuar ajeteve kuranore, duke hulumtuar për domethëniet e tyre në libra bazë me qëllim që të dëshmoj se koncepti bazë dhe i praktikuar ndër gjenerata të myslimanët është ai për respektimin e prindërve. Kam shpjeguar rregullat dhe etikën me prindërit besimtarë dhe me ata jobesimtarë.
2. Në pjesën e dytë u jam referuar haditheve, të cilat kanë zbërthyer kuptime të ajeteve dhe kanë ofruar modelin e kërkuar të zbatimit të tyre.
3. Ndërsa në pjesën e tretë i jam referuar historisë, gjegjësisht kohës së gjeneratave të para, për të dëshmuar edhe me praktikën e tyre se është respektimi i prindërve ai që përkon me Islamin dhe assesi arroganca.
4. Në fund fare, kam bërë një përmbledhje të rezultateve, që mendoj se janë edhe porositë dhe këshillat e këtij punimi.

¹ Ky punim është pjesa e parë e një hulumtimi fetar me titull '*Mbikëqyrja fetare ose Ihtisabi ndaj prindërve – Rregullat dhe etika*'.

1. Kurani për respektimin e prindërve

1.1. Porosia hyjnore për mirësjellje me prindërit

Në Kuan gjejmë disa citate të cilat na obligojnë të jemi të sjellshëm me prindërit tanë. Kështu, në kaptinën En-Nisa, ajeti 36, All-llahu na urdhëron:

وَاعْبُدُوا اللَّهَ وَلَا تُشْرِكُوا بِهِ شَيْئًا وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا

*“Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); silluni mirë me prindërit,...” (En-Nisa: 36)*²

Në kaptinën El-En’amë, ajeti 151, All-llahu na urdhëron:

وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا

“(Thuaju: “Ejani t’ju lexoj çfarë ju ka urdhëruar Allahu:...) që të silleni mirë me prindërit;...” (El-En’amë: 151)

Po kështu edhe në kaptinat Llukman, 14;³ El-Isra, 23;⁴ El-Ahkaf, 15,⁵ etj.

Çfarë nënkupton mirësjellja me prindërit?

² Përkthimin e ajeteve e kemi huazuar nga përkthimi i merhumit Hasan ef. Nahit.

³ *“Ne e kemi urdhëruar njeriun që t’i nderojë prindërit e vet. Nëna e ka mbartur atë, duke duruar mundim pas mundimi, e ndarja e tij (nga gjiri) është brenda dy vitesh. Ne i thamë atij: “Bëhu falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu! Tek Unë do të ktheheni të gjithë”.*”

⁴ *“Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuroni askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit....”*

⁵ *“Njeriun e kemi porositur të jetë i sjellshëm ndaj prindërve të vet...”*

Nëse i kthehemi komentimit të ajeteve të cituara sipër, do të gjejmë domethënie madhështore të respektimit të prindërve.

1. Xhessasi, fillimisht, shpjegon se bëhet fjalë për mirësjellje të obliguar nga All-llahu.⁶ Në këtë aludon edhe Fahrudin Rrazi.⁷
2. Hasan Basriu mendon se bamirësia ndaj prindërve nënkupton të shpenzosh për ta atë që e posedon dhe të përfillësh urdhrat e tyre për aq kohë sa urdhrat nuk paraqesin mëkat ndaj Allahut.⁸
3. Imam Kurtubiu, në komentim të këtij ajeti, respektivisht *mirësjelljes* me prindërit, shpjegon imazhe më të shumta të formave se si manifestohet në praktikë. Thotë se mirësjellja nënkupton *‘bamirësinë ndaj tyre, ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre, përfilljen e urdhrave të tyre, lirim nga robëria (nëse janë në të), dhe heqjen dorë nga pushteti ndaj tyre.’*⁹
4. Begaviu shpjegon se krahas bamirësisë hyjnë edhe dhembshuria dhe ana emocionale.¹⁰ Ngjashëm kanë shpjeguar

⁶ Shih: El-Xhessas, Ahmed bin Ali. (1405 h.) *Ahkamu-l-Kur'an*. Verifikimi shkencor: Muhammed Sadik El-Kamhavi. Bejrut: Daru Ihjai-t-turath el-arabijj. 3/155.

⁷ Shih: Fahrudin Rrazi, Ebu Abdullah Muhammed bin Umer. (1420 h.). *Me-fatihu-l-gajb*. Ed. 3. Bejrut: Dar Ihja et-turath el-arabijj. 10/76.

⁸ Shih: El-Xhessas. (1405 h.) *Ahkamu-l-Kur'an*. Op. cit. 5/20.

⁹ El-Kurtubi, Ebu Abdullah Muhammed bin Ahmed. (1964). *El-xhamiu li-ah-kami-l-Kur'an*. Verifikimi shkencor: Ahmed Berduni dhe Ibrahim Atfish. Kajro: Dar el-kutub el-misrijjeh. 7/132.

¹⁰ Shih: El-Begavi, Ebu Muhammed El-Husejn bin Mes'ud. (1420 h.). *Mealim et-Tenzil fi tefsiri-l-Kuran*. Verifikues shkencor: AbduRezzak El-Mehdi. Bejrut: Dar Ihjai-t-turath el-arabijj. 1/615.

edhe Imamët Xhelaluddin Mehal-liu dhe Xhelaluddin Sujuti.¹¹

5. AbduRrahman bin Nasir Es-Sa'di në shpjegimin e tij përmbledh të drejta morale dhe materiale. Thotë: *‘Silluni mirë ndaj prindërve me fjalë të mira, me ligjërime të butë, me vepër të bukur duke përfillur urdhrat e tyre dhe shmangur ndalesave të tyre, duke shpenzuar për ta, duke respektuar ata që kanë lidhje me ta, qoftë nga lidhja e drejtpërdrejtë (farefisi), qoftë nga lidhja jo e drejtpërdrejtë (miqësia e shoqëria).’*¹²

Siç mund të shihet, respektimi i prindërve nuk përkufizohet në një fushë ose aspekt obligimesh. Fajruzabadi mendon se mirësjellja me prindërit nënkupton pafundësi në respektim të tyre.¹³

Pra, të mos kufizohesh vetëm në një ose dy forma, porse ta shndërrosh respektimin e tyre në art, në jetë, në gjithçka të bukur. Në Kuran, duke na u ofruar limite dhe kufij që nuk guxojmë t'i shkelim kur është fjala për respektimin e prindërve, na ofrohen në fakt hapësira gjigante dhe mundësi të rralla të jetësimit të shembujve më të lartë dhe më brilantë të res-

¹¹ Shih edhe: El-Mehali, Xhelaluddin dhe Es-Sujuti, Xhelaluddin. (p.v.b.) *Tefsiru-l-Xhelalejni*. Kajro: Daru-l-hadith. F. 107.

¹² Es-Sa'di, AbduRrahman bin Nasir. (2000). *Tejsiru-l-Kerimi-rr-Rrahman fi tefsiri Kelami-l-Mennan*. Verifikues shkencor: AbduRrahman bin Mual-la El-Luvejhik. Bejrut: Muessesetu-rr-rrisale. F. 177.

¹³ Shih: El-Fejruzabadi, Mexhuddin Ebu Tahir Muhammed bin Ja'kub. (1996). *Besairu dhevi-t-temjiz fi letaifi-l-Kitabi-l-aziz*. Verifikues shkencor: Muhammed Ali Nexh-xhar. Ed. 3. Kajro: El-mexhlis el-a'la li-sh-shuun el-islamijeh. 2/213.

pektimit të tyre. Ja çfarë më konkretisht dua të them: All-llahu thotë:

وَقَضَىٰ رَبُّكَ أَلَّا تَعْبُدُوا إِلَّا إِيَّاهُ وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا إِمَّا يَبْلُغَنَّ
عِنْدَكَ الْكِبَرَ أَحَدُهُمَا أَوْ كِلَاهُمَا فَلَا تَقُلْ لَهُمَا أَفٍّ وَلَا تَنْهَرُهُمَا
وَقُلْ لَهُمَا قَوْلًا كَرِيمًا * وَاخْفِضْ لَهُمَا جَنَاحَ الذُّلِّ مِنَ الرَّحْمَةِ
وَقُلْ رَبِّ ارْحَمْهُمَا كَمَا رَبَّيَانِي صَغِيرًا

“Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuronit askënd tjetër përveç Atij dhe që të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as “uh!”, mos i kundërshtoj, por drejtoju atyre me fjalë respekti. 24. Lësho para tyre krahët e përlules prej mëshirës dhe thuaj: “O Zoti im, mëshiroji ata ashtu siç më kanë rritur kur unë isha i vogël!”.” (El-Isra: 23-24)

Në ajet limit që nuk guxon të shkelet është thënia: ‘of’,¹⁴ që nënkupton se çdo gjë më e madhe se kjo thënie është mëkat. Hasani, i biri i Aliut (*radij All-llahu anhumā*) transmetohet të ketë thënë: Po të kishte diç nga kundërshtimi i prindërve që është dhe më i vogël se thënia ‘uh’, All-llahu do ta ndalonte.¹⁵

Tash, paramendo se çfarë shembujsh përrallorë mund të ketë në shoqëri nëse ka rregulla dhe etikë sikur kjo që prindërve as ‘uh’ nuk lejohet t’u thuhet e lëre më t’i thyhet fjala

¹⁴ Es-Sa’di. (2000). *Tejsiru-l-Kerimi-rr-Rahman*. Op. cit. F. 456.

¹⁵ Këtë thënie e ka regjistruar në tefsirin e tij Shevkani. Shih: Esh-Sheukani, Muhammed bin Ali. (1414 h.) *Fet’hu-l-Kadir*. Bejrut: Dar Ibn Kethir. 3/262.

apo, Allahu mos e dhëntë, të sillet keq me ta e të maltretohen fizikisht e psikikisht.

Së këndejmi, mund të themi se respektimi i prindërve përfshin atë që është shpirtërore, emocionale, etike dhe materiale. Shpirtërore, sepse është punë besimi respektimi i tyre; emocionale, sepse duhet patur kujdes që të mos lëndohen emocionalisht, siç do të shpjegojmë më poshtë; etike, sepse duhen përzgjedhur fjalë se si flet dhe si u drejtohesh atyre; materiale, sepse duhet shpenzuar për prindërit.

1.2. Respektimi për prindërit në pozitë me adhurimin për Allahun

Një tjetër imazh i respektimit ose pozitës së prindërve në Islam është edhe krahasimi që tërhiqet ndërmjet kësaj pozite dhe adhurimit për Allahun, si p.sh. në ajetin:

وَاعْبُدُوا اللَّهَ وَلَا تُشْرِكُوا بِهِ شَيْئًا وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا

“Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); silluni mirë me prindërit,...” (En-Nisa: 36)

Ibni Kethiri në komentim të këtij ajeti (dhe të ajetit 151 nga kaptina El-En’amë) thotë se jo rrallë Allahu i Madhëruar sjell paralel adhurimin për Të me respektimin për prindërit, si fjala vjen në ajetet:

أَنِ اشْكُرْ لِي وَلِوَالِدَيْكَ

“...Ne i thamë atij: “Bëhu falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu!...” (Llukman: 14)

وَقَضَىٰ رَبُّكَ أَلَّا تَعْبُدُوا إِلَّا إِيَّاهُ وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا

“Zoti yt ka urdhëruar që të mos adhuronit askënd tjetër përveç Atij dhe që të silleni mirë me prindërit....” (El-Isra: 23)¹⁶

Ibni Abbasi (*radijAll-llahu anhumu*), duke iu referuar ajetit të 14-të nga kaptina Lukman, thotë se kush falënderon All-llahun, ndërsa nuk falënderon prindërit, nuk i pranohet, sepse këto gjëra janë të lidhura ndërmjet vete. Kjo ngase në Kuran, në tri kaptina, kanë ardhur paralel tri palë gjërash, që nuk pranohen nëse ndahen nga njëra tjetra:

- respektimi i All-llahut dhe respektimi i të Dërguarit (*sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem*) (Et-Tegabun: 12),
- falja e namazit dhe dhënia e zekatit (El-Bekare: 43) dhe
- kjo për falënderimin e All-llahut dhe falënderimin e prindërve (Lukman: 14).¹⁷

Si ta kuptojmë këtë?

Respektimi i prindërve është, siç po shohim, urdhër i All-llahut, dhe nëse nuk respektohet fjala ose urdhri i All-llahut, atëherë as Allahu nuk është respektuar. Nuk ka formalitet me Allahun. Këtë e kuptojmë edhe më mirë nëse i referohemi një ajeti, ku çështja na shpjegohet si parim e jo si rast. Në kaptinën En-Nisa, ajeti 80, Allahu thotë:

¹⁶ Shih: Ibn Kethir, Ebu-l-Fida' Ismail bin Umer. (1999). *Tefsiru-l-Kurani-l-Adhim*. Verifues shkencor: Sami bin Muhammed Selameh. Rijad: Dar Tajjibeh li-n-neshri ve-t-teuzië. 2/298; 3/361.

¹⁷ Shih: Es-Sefarijini, Muhammed bin Ahmed Salim. (1993.) *Gidhau-l-elbab fi sherhi mendhumeti-l-adab*. Ed. 2. Egjipt: Muessesetu Kurtube. 1/392.

مَنْ يُطِيعِ الرَّسُولَ فَقَدْ أَطَاعَ اللَّهَ

“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut....”

Pra, t’i bindesh të Dërguarit që proklamon fjalën e Allahut, është, në fakt, bindje ndaj Allahut. Këtë na e shpjegon edhe Muhammedi (*sal-laAll-llahu alejhi ve sellem*) në hadithin e tij: *“Kush më respekton mua, e ka respektuar Allahun, dhe kush më kundërshton mua, e ka kundërshtuar Allahun!...”*¹⁸

1.3. Motive të respektimit

1. Përfillja e urdhrit të Zotit

Për besimtarin para çdo gjëje tjetër është çuarja në vend e një urdhri hyjnor. Allahu ka urdhëruar respektimin e prindërve, kështu që për të mjafton dhe ky urdhër për t’i respektuar ata.

2. Prindërit janë shkaku i ekzistimit tonë

Ibni Kethiri, në komentim të ajetit 36 nga kaptina En-Nisa, ajet që e cituam sipër, thotë se prindërit duhen respektuar, ngase ata janë shkak i ardhjes në këtë botë. Ngjashëm thotë edhe Fahrudin Rrazi.¹⁹

3. Mirësjellja e tyre me ne na obligon që të jemi të mirësjellshëm me ta

Këtë e mësuam nga ajetet 23 dhe 24 nga kaptina El-Isra. Megjithatë, në Kuran, na sillen ndërmend edhe imazhe të

¹⁸ Transmetim Unanim.

¹⁹ Shih: Fahrudin Rrazi. (1420 h.). *Mefatihu-l-gajb*. Ed. 3. Op. cit. 13/178.

tjera nga sakrifica e prindërve për ne, veçmas nënës.
Thotë Allahu:

وَوَصَّيْنَا الْإِنْسَانَ بِوَالِدَيْهِ إِحْسَانًا حَمَلَتْهُ أُمُّهُ كُرْهًا وَوَضَعَتْهُ كُرْهًا
وَحَمْلُهُ وَفِصَالُهُ ثَلَاثُونَ شَهْرًا

“Njeriun e kemi porositur të jetë i sjellshëm ndaj prindërve të vet. Nëna e mbart atë me mund dhe me mund e lind. Ai mbartet dhe ushqehet me gjë për tridhjetë muaj...” (El-Ahkaf: 15)

4. Si motive të tjera të fuqishme do të veçonim:

A. Urdhrin e All-llahut drejtuar njerëzimit mbarë

Respektimi dhe mirësjellja me prindërit është urdhër që Allahu ia shpalli njerëzimit në vazhdimësi. Allahu thotë:

وَإِذْ أَخَذْنَا مِيثَاقَ بَنِي إِسْرَآئِيلَ لَا تَعْبُدُونَ إِلَّا اللَّهَ وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا

“Kujtoni kur Ne morëm besën tuaj, o bijtë e Izraelit, se do të adhuronit vetëm Allahun, do të silleni mirë me prindërit...” (El-Bekare: 83)

Këto ligje janë baza të fesë që nuk ndryshojnë kurrë dhe të cilat Allahu ia ngarkoi çdo populli.²⁰

B. Shëmbëlltyrat e profetëve (alejhimusselam)

Profetët janë njerëzit më të zgjedhur të Allahut. Ata përfaqësojnë më së miri vlerat dhe virtytet. Kurani na sjell disa shembuj nga jeta dhe veprimtaria e profetëve. Ja disa shembuj:

²⁰ Es-Sa'di. (2000). *Tejsiru-l-Kerimi-rr-Rrahman*. Op. cit. F. 57.

- a. Nuhu (*alejhisselam*), i cili lutej për prindërit:

رَبِّ اغْفِرْ لِي وَلِوَالِدَيَّ وَلِمَنْ دَخَلَ بَيْتِي مُؤْمِنًا وَلِلْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ
“O Zoti im, falmë mua dhe prindërit e mi, si dhe çdo besimtar që kërkon strehim në shtëpinë time!...” (Nuh: 28)

- b. Ibrahim (i *alejhisselam*) me prindin e tij, i cili jo vetëm që nuk besonte, por insistonte në të keqen dhe e mbronte atë. Megjithëse Ibrahim (i *alejhisselam*) nuk pajtoi kurrë me qëndrimet e tij, prapë ishte i sjellshëm me të. Ajetet në vijim na sjellin imazhe nga morali i lartë i Ibrahim (i *alejhisselam*) me të atij pabesimtar:

وَأَذْكُرْ فِي الْكِتَابِ إِبْرَاهِيمَ إِنَّهُ كَانَ صِدِّيقًا نَبِيًّا ﴿٤١﴾ إِذْ قَالَ لِأَبِيهِ يَا أَبَتِ لِمَ تَعْبُدُ مَا لَا يَسْمَعُ وَلَا يُبْصِرُ وَلَا يُغْنِي عَنْكَ شَيْئًا ﴿٤٢﴾ يَا أَبَتِ إِنِّي قَدْ جَاءَنِي مِنَ الْعِلْمِ مَا لَمْ يَأْتِكَ فَاتَّبِعْنِي أَهْدِكَ صِرَاطًا سَوِيًّا ﴿٤٣﴾ يَا أَبَتِ لَا تَعْبُدِ الشَّيْطَانَ إِنَّ الشَّيْطَانَ كَانَ لِلرَّحْمَنِ عَصِيًّا ﴿٤٤﴾ يَا أَبَتِ إِنِّي أَخَافُ أَنْ يَمَسَّكَ عَذَابٌ مِّنَ الرَّحْمَنِ فَتَكُونَ لِلشَّيْطَانِ وَلِيًّا ﴿٤٥﴾ قَالَ أَزَاغِبُ أَنْتَ عَنِّ آلِهَتِي يَا إِبْرَاهِيمُ لَئِنْ لَّمْ تَنْتَهِ لَأَرْجُمَنَّكَ وَاهْجُرْنِي مَلِيًّا ﴿٤٦﴾ قَالَ سَلَامٌ عَلَيْكَ سَأَسْتَغْفِرُ لَكَ رَبِّي إِنَّهُ كَانَ بِي حَفِيًّا

“Trego në Libër për Ibrahimin! Ai ishte njeri i së vërtetës dhe profet. Ai i tha të atit: “O babai im, përse adhuron atë që as nuk dëgjon, as nuk sheh e as që

mund të të sjellë ndonjë dobi? O babai im, mua më ka ardhur prej diturisë, çfarë s'të ka ardhur ty; andaj ndiqmë mua dhe unë do të të udhëzoj në rrugën e drejtë! O babai im, mos adhuro djallin, sepse ai është gjithmonë i pabindur ndaj të Gjithëmëshirshmit. O babai im, unë kam frikë se mos të vjen ndonjë dënim nga i Gjithëmëshirshmi e kështu të bëhesh i afërm i djallit!” Ai u përgjigj: “O Ibrahim! Si guxon t'i hedhësh poshtë zotat e mi?! Nëse nuk heq dorë, unë do të të mbys me gurë; andaj, largohu prej meje për një kohë të gjatë!” Ibrahim tha: “Shpëtimi qoftë mbi ty! Do t'i lutem Zotit tim që të të falë. Me të vërtetë, Ai është i mirë me mua.” (Merjem: 41-47)

Në një kaptinë tjetër, kaptinë Ibrahim, përmendet lutja që në fakt është ligjësuar si lutje e përgjithshme deri në mbarim të botës:

رَبَّنَا اغْفِرْ لِي وَلِوَالِدَيَّ وَلِلْمُؤْمِنِينَ يَوْمَ يَقُومُ الْحِسَابُ

“O Zoti ynë, më fal mua, prindërit e mi dhe besimtarët në Ditë kur do të jepet llogari!” (Ibrahim: 41)

- c. Ismaili (alejhisselam) e respektoi të atin aq shumë saqë pranoi dhe të therej për kurban:

يَا أَبَتِ افْعَلْ مَا تُؤْمُرُ سَتَجِدُنِي إِنْ شَاءَ اللَّهُ مِنَ الصَّابِرِينَ

“...O ati im, vepro ashtu siç je urdhëruar! Dashtë Allahu unë do të jem i durueshëm!” (Es-Saffat: 102)

d. Sulejmani (*alejhisselam*)

رَبِّ أَوْزَعْنِي أَنْ أَشْكُرَ نِعْمَتَكَ الَّتِي أَنْعَمْتَ عَلَيَّ وَعَلَى وَالِدَيَّ

“...O Zoti im, më frymëzo që të jem mirënjohës për mirësitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi...”

(*En-Neml: 19*)

e. Jahja (*alejhisselam*) ishte i mirësjellshëm me të dy prindërit e tij:

وَبَرًّا بِوَالِدَيْهِ وَلَمْ يَكُنْ جَبَّارًا عَصِيًّا

“Dhe i sjellshëm ndaj prindërve të vet, nuk ishte i ashpër dhe i padëgjueshëm.” (*Merjem: 14*)

f. Isai (*alejhisselam*) ishte i sjellshëm me nënën e tij, Merjemen.

وَبَرًّا بِوَالِدَتِي وَلَمْ يَجْعَلْنِي جَبَّارًا شَقِيًّا

“Dhe që të jem i mirë ndaj nënës sime dhe nuk më ka bërë të ashpër dhe të padëgjueshëm.” (*Merjem: 32*)

2. Suneti për respektimin e prindërve

2.1. Respektimi i prindërve, pozita dhe mirësitë

1. Kënaqësia e Allahut në kënaqësinë e prindërve

I Dërguari i Allahut (sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem) ka thënë: *“Kënaqësia e Zotit është në kënaqësinë e prindit (babit) dhe hidhërimi i Zotit është në hidhërimin e prindit.”*²¹

²¹ Transmetojnë Tirmidhiu në Sunen dhe Buhariu në Edebu-l-Mufred ndërsa Albani e vlerëson autentik. Shih: *Sahihu-l-Edebi-l-Mufred*, nr. 2.

Ky hadith, ndonëse tekstualisht përmend babanë, ai përfshinë dhe nënën, madje edhe më parë se vetë babanë.²²

Ky hadith sjell atë paralelen që e mësuam nga Ibni Abbasi (*radijAll-llahu anhumu*), se falënderimi ndaj Zotit nuk vlen nëse nuk falënderon edhe prindin. Munaviu dhe Mubarekfuri e thonë tekstualisht se ky hadith na tregon se kush e respektonte prindin, ai e ka respektuar Allahun dhe se kush e kundërshtonte atë, ai e ka kundërshtuar Allahun.²³

2. Mirësjellja e prindërve nuk kompensohet me asgjë

Prindërit kanë pozitë shumë të lartë. Njeriu, pavarësisht angazhimit në përmbushjen e kërkesave dhe nevojave të prindërve, asnjëherë nuk mund ta kompensojë atë që prindërit kanë bërë për të. Ibn Umeri (*radijAll-llahu anhumu*) kishte parë një jemenas që bartte nënën e tij në shpinë gjatë tavafit. Njeriu iu drejtua Ibni Umerit:

O biri i Umerit, a mendon se kam kompensuar mundin e nënës sime?

Ibn Umeri iu përgjigj: Jo, madje as edhe një dhimbje të vetme gjatë kohës kur të lindi ty.²⁴

²² Shih: el-Karij El-Herevij, Ali bin Sultan Muhammed. (2002). *Mirkatu-l-mefatih sherhu Mishkati-l-mesabih*. Bejrut: Daru-l-fikr. 7/3089. Shihe dhe: El-Mudhhiri, El-Husejn bin Mahmud bin El-Hasen. (2012). *El-Mefatih fi sherhi el-Mesabih*. Kuvajt: Dar en-Nevadir. 5/209.

²³ Shih: El-Munavi, Zejnuddin Muhammed. (1988). *Et-tejsiru bi sherhi El-Xhami'i-s-Sagir*. Ed. 3. Rijad: Mektebetu El-Imam Esh-Shafii. 2/34.; El-Mubarekfuri, Muhammed AbduRahman bin AbduRahim. (pv.b.) *Tuhfetu-l-ahvedhi bi sherhi Xhami'i-t-Tirmidhijj*. Bejrut: Dar el-kutub el-ilmijjeh. 6/22.

²⁴ Transmeton Buhariu në Edebu-l-Mufred ndërsa Albani e vlerëson autentik. Shih: *Sahihu-l-Edebi-l-Mufred*, op. cit. nr. ۱۳.

Në fakt, dijetarët, referuar një hadithi autentik, kanë thënë se ka raste kur njeriu kompenson mundin e prindit. Kjo bëhet kur fëmija i dhuron lirinë prindit. Liria konsiderohet mirësi dhe dhunti e madhe e Allahut dhe gjëja më mirë që dikush mund t'i japë dikujt.²⁵ Fjala është për hadithin e Ebu Hurejres: “*Fëmija nuk mund ta kompensojë prindin me përjashtim nëse e gjen të robëruar, e blen dhe e liron atë.*”²⁶

3. Respektimi i prindërve prej veprave më të mira

Ibn Mes'udi (*radijAll-llahu anhu*) transmeton:

“E kam pyetur Profetin:

Cila vepër është më e dashur tek Allahu?

Tha: *Namazi në kohën e vet.*

Pastaj cila?- pyeta.

Tha: *Mirësjellja me prindërit.*

Pastaj cila?

Tha: *Xhihadi në Rrugën e Allahut.*”²⁷

Respektimi i prindërve është krahasuar me vepra që kanë shpërblim të madh, si xhihadi, madje edhe më prioritare, veçmas nëse bëhet fjalë për xhihad vullnetar. Një njeri, siç shënojnë Buhariu dhe Muslimi, kishte ardhur tek i Dërguari i Allahut (*sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem*) për të kërkuar leje për xhihad.

I Dërguari i Allahut e kishte pyetur: *A i ke prindërit gjallë?*

²⁵ Shih: Hattabi, Hamd bin Muhammed. (1932). *Mealim es-Sunen*. Halep: El-matbaatu el-ilmijjetu. 4/150.

²⁶ Hadithin e transmetojnë Ebu Davudi dhe Ibn Maxheh. Albani e konsideron autentik.

²⁷ Transmetim unanim.

Po- ia kishte kthyer.

Kthehu dhe bëje xhihadin duke respektuar ata!- e kishte porositur i Dërguari i Allahut (*sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem*).

Ibn Bettali në koment të hadithit përmend të kenë thënë Omeri dhe Othmani (*radijAll-llahu anhum*a) se nëse njeriu merr rrugën e Xhihazit vullnetar, ndërsa prindërit kërkojnë prej tij të mos shkojë, atëherë duhet të mos shkojë.²⁸

Hasan Basriu shkon edhe më tutje dhe konsideron se edhe po t'i jepte nëna leje që të shkonte në xhihad, ndërsa ai e vëren se ajo ka dëshirë që ai të qëndrojë pranë saj, nuk shkon.²⁹

4. Jeta e lumtur dhe e gjatë

Respektimi i prindërve është vepër e cila të dhuron lumturi dhe jetëgjatësi. I Dërguari i Allahut (*sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem*) ka thënë: “*Asgjë nuk e largon caktimin e Zotit përveç duasë, sikur që nuk e zgjat jetën asgjë tjetër përveç mirësjelljes.*”³⁰

Për shtimin e jetës disa dijetarë kanë thënë se për qëllim është shtim konkret, pra zgjatja e viteve të jetës, derisa të tjerë mendojnë se për qëllim është begatia dhe mirësitë në jetë.³¹

²⁸ Shih: Ibn Bettal, Ali bin Halef. (2003). *Sherhu Sahihi-l-Buhari*. Ed. 2. Verikimi shkencor: Ebu Temim Jasir bin Ibrahim. Rijad: Mektebetu-rr-Rrushd. 5/159.

²⁹ Ibid.

³⁰ Hadithin e transmeton Timridhiu ndërsa Albani thotë se është hasen.

³¹ Shih: El-Mubarekfuri. (pv.b.) *Tuhfetu-l-ahvedhi*. Op. cit. 6/289.; El-Karij. (2002). *Mirkatu-l-mefatih*. Op. cit. 4/1528; El-Munavi. (1988). *Et-tejsiru*. Op. cit. 1/283.

5. Largim të pikëllimit dhe rrugëdalje nga problemet

Kushdo që ka lexuar hadithin e tre vetave që nata i zuri në rrugë dhe u strehuan në shpellë për ta bërë gjumin,³² e kupton se sa e rëndësishme është mirësjellja me prindërit. Ata ngelën të ngjuar në shpellë dhe vendosën që ta lusnin Allahun me veprat e mira që kanë bërë. Të tre përzgjedhën nga një vepër. Njëri përzgjedhi mirësjelljen me prindër. Lutjet u pranuan, duke dëshmuar indirekt se edhe ato vepra ishin pranuar dhe se ishin vepra me shpërblim.

6. Hyrja në Xhenet

Imam Ahmedi dhe Ibn Maxheh shënojnë se Muavije Sulemiu kishte kërkuar leje nga i Dërguari i Allahut për të marrë pjesë në xhihad me të. Ai e urdhëroi që të kthehej tek nëna dhe të sillej mirë me të. Meqë insistonte, ai (*sal-laAllahu alejhi ve sel-lem*) i tha: “Mjerë për ty, mos iu ndaj këmbës së saj, sepse aty është Xheneti!”³³

Sehaviu ka thënë se modestia me nënat është shkak për të hyrë në Xhenet, në mënyrë figurative, ka ardhur sikur diç që është në pronësi të nënës, e cila qëndron e ulur mbi të. Ti nuk mund të marrësh asgjë prej saj pa pëlqimin e saj.³⁴

³² Transmetim unanim. Pjesën e hadithit do ta përmendim më poshtë.

³³ Albani e konsideron hadith autentik.

³⁴ Shih: Es-Sindi, Muhammed bin Abdul Hadi. (p.v.b) *Kifajetu-l-haxheh fi sherhi Suneni Ibni Maxheh*. Bejrut: Dar el-Xhil. 2/180.

2.3. Imazhe të respektimit

1. Të folurit me fjalë të mira e të buta

Ibn Omeri i kishte thënë Tajsale bin Mejjasit: ...A ke frikë Xhehenemin dhe a ke dëshirë të hysh në Xhenet?

Po- ia kishte kthyer.

Po prindërit i ke gjallë?- e pyeti.

E kam vetëm nënën- ia ktheu.

Tha Ibn Omeri: Pasha Allahun, nëse i drejtohesh me fjalë të buta dhe e ushqen do të hysh në Xhenet përderisa nuk ke bërë mëkate të mëdha.³⁵

2. Dhënia përparësi nënës në respekt

Respekti i nënës vihet para respektit për babanë, edhe pse kjo në asnjë rrethanë nuk interpretohet si mungesë respekti për këtë të fundit. Argument për këtë është hadithi i Ebu Hurejres, i shënuar nga Buhariu e Muslimi:

Erdhi një njeri tek i Dërguari i All-llahut (*sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem*) dhe tha: O i Dërguari i Allahut: Kush nga njerëzit meriton më së shumti shoqërimin tim të mirë?

Tha: *Nëna*.

Pastaj kush?- pyeti njeri.

Tha: *Nëna*.

Pastaj kush?- pyeti.

Tha: *Nëna*.

Pastaj kush?- pyeti.

Tha: *Babai*.

³⁵ Hadithi është autentik. Shih: Sahihu Edebi-l-Mufred, nr. 8.

Arsyeja, siç shpjegon Imam Neveviu, se përse i është dhënë përparësi nënës qëndron në lodhjet e saj në bartjen, lindjen dhe përkujdesjen për të.³⁶

3. T'ua kthesh gëzimin siç ua ke shkaktuar mërzinë

Nëse njeriu u shkaktonte një mërzi prindërve, atëherë duhet të bëjë diç që t'ua largojë atë dhe t'ua kthejë gëzimin. Ebu Davudi, Ibn Maxheh dhe Nesaiu transmetojnë se një njeri kishte ardhur për t'u besatuar për hixhretin, ndërsa i kishte lënë prindërit duke qarë. I Dërguari i Allahut (*sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem*) i tha: “*Kthehu tek ata dhe kthejua buzëqeshjen ashtu sikur që i bërë të qajnë.*”³⁷

Në hadith flitet për xhihadin vullnetar³⁸ ose për hixhretin jo të obliguar,³⁹ vepra këto që nuk janë të këqija, por, megjithatë, hidhërimi i prindërve, duke i lënë vetëm, është konsideruar më mëkat se sa mospjesëmarrja në to. Tani, paramendo se si do të trajtohej vepra që parimisht ose në thelb është e keqe në raport me prindërit?

4. Shpenzimi për ta

Në shpjegim të hadithit “*Ti dhe pasuria jote jeni të ba-bait tënd*”⁴⁰, dijetarë myslimanë kanë përmendur se fëmija jo

³⁶ Shih: En-Nevevi, Jahja bin Sheref. (1392 h.) *El-minhaxh sherhu Sahihi Muslim bin El-Haxh-xhaxh*. Bejrut: Dar ihja et-turath el-arabij. 16/102.

³⁷ Albani thotë se hadithi është autentik.

³⁸ Shih: Hattabi. (1932). *Mealim es-Sunen*. Op. cit. 2/245.

³⁹ Shih: El-Vel-levi, Muhammed bin Ali. (2003) *Dhehiretu-l-ukba fi sherhi el-muxhteba*. Mekke: Dar Brum li-n-neshri ve-t-teuzië. 32/235.

⁴⁰ Transmetojnë Ahmedi dhe Ibn Maxheh. Albani thotë se hadithi është autentik.

vetëm që është i obliguar të furnizojë prindërit në rast se ata qëndrojnë keq materialisht, porse prindit i lejohet që, nëse fëmija refuzon ndërsa ai ka nevojë, të marrë nga pasuria e tij pa lejen paraprake të fëmijës.⁴¹

5. Durimi në respektimin e tyre

Në Sunet gjejmë porosi që në raport me prindërit të durojmë, qoftë edhe nëse dëmtohem fizikisht e materialisht. Imam Ahmedi transmeton porosinë që i Dërguari i Allahut (*sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem*) i kishte dhënë Muadh bin Xhebelit (*radijAll-llahu anhu*), në të cilën, përveç tjerash, i kishte thënë: “...dhe mos i kundërshtoj prindërit, edhe nëse të urdhërojnë ta braktisë familjen dhe pasurinë tënde...”⁴²

Siç shpjegojnë dijetarët, hadithi ka ardhur në formë metaforike, duke dashur të na bëjë me dije se prindërit, edhe nëse të urdhërojnë për diç shumë me rëndësi dhe që ka vlerë e peshe tek ti, atëherë jepe për ata dhe respektoji.⁴³

6. Respektimi i tyre pas vdekjes

Respektimi për prindërit nuk ndalet me vdekjen e tyre. Ai vazhdon edhe pas vdekjes, dhe kjo në format në vijim:

- Lutja dhe kërkimfalja për ta.

Ka thënë i Dërguari i Allahut (*sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem*): “Pas vdekjes të vdekurit ndodh t’i rriten gradat. Pyet:

⁴¹ Shih: El-Karij, Ali bin Sultan Muhammed. (1985). *Sherhu Musnedi Ebi Hafife*. Verifikimi shkencor: Halil Muhjiddin El-Mejs. F. 216.

⁴² Albani në Sahihu-t-Tergib e vlerëson si hadith hasenun li gajrihi.

⁴³ Shih: El-Karij. (2002). *Mirkatu-l-mefatih*. Op. cit. 1/133.

*O Zoti im, prej nga kjo? I thuhet: Fëmija yt ka kërkuar falje për ty.*⁴⁴

- Dhënia lëmoshë për shpirtin e tyre

Të Dërguarin e Allahut (*sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem*) e pyeti një njeri nëse pranohej si vepër e mirë dhënia e lëmoshës për nënën e tij të vdekur, edhe pse ajo nuk kishte porositur? Ai i tha: Po.⁴⁵

- Respektimi i miqve dhe i dashamirëve të tyre që janë gjallë

Ka thënë i Dërguari i Allahut (*sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem*): “*Bamirësia më e madhe është që fëmija të mbajë lidhjet me dashamirët e babait të tij.*”⁴⁶

Këtu hyn edhe nëna, respektivisht të afërmit e saj, me theks të veçantë tezja.⁴⁷

2.3. Trajtimi i prindërve jobesimtarë

1. Nuk lejohet imponimi i fesë

Nuk i lejohet një myslimani që t’ua imponojë fenë prindërve të tij. Ajo që duhet të bëjë është që të lutet për udhëzimin e tyre. Dëshminë më të qartë e kemi nga Ebu Hurejre

⁴⁴ Hadithin e transmeton Buhariu në Edebu-l-Mufred ndërsa Albani e konsideron hasen.

⁴⁵ Hadithin e transmeton Buhariu në Edebu-l-Mufred ndërsa Albani e konsideron autentik.

⁴⁶ Hadithin e transmeton Muslimi.

⁴⁷ Tirmidhiu transmeton nga Ibn Umeri [*radijAll-llahu anhum*] se tek i Dërguari i All-llahut kishte ardhur një njeri që i ankohej se kishte bërë mëkat. Ai i tha ta respektonte nënën sepse ashtu e shlyente mëkatin. Ai i kishte thënë se nuk ka nënë. Atëherë respektojë tezen- i kishte thënë.

(*radijAll-llahu anhu*), i cili shkoi tek i Dërguari i Allahut (*sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem*) t'i ankohej për nënën e tij se megjithëqë ai dëshironte ta pranonte Islamin, ajo refuzonte.

Ai i tha: “Lute Allahun për të!”

Ebu Hurejre u lut dhe nëna e tij, siç vazhdon hadithi, e pranoi Islamin.⁴⁸

2. Mbajtja e lidhjeve në bazë të asaj që përcakton afërsia familjare

Bazë për mbajtjen e lidhjeve me prindërit është aspekti biologjik. Edhe nga Kurani mësuam se prindërit duhen respektuar, edhe nëse nuk janë të së njëjtës fe me ne. Këtë e kuptojmë më mirë edhe nga thirrja e parë publike e të dërguarit të Allahut (*sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem*). Siç transmeton Ebu Hurejre, kur Allahu shpalli ajetin:

وَأَنْذِرْ عَشِيرَتَكَ الْأَقْرَبِينَ

“Paralajmëroje farefisin tënd më të afërm!” (Esh-Shuara: 214),

Profeti (*sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem*) u ngrit dhe thirri:

“O bijtë e Ka’b bin Luejit! Shpëtojeni veten nga zjarri!

O bijtë e Abdi Menafit! Shpëtojeni veten nga zjarri!

O bijtë e Hashimit! Shpëtojeni veten nga zjarri!

O bijtë e Abdul Muttalibit! Shpëtojeni veten nga zjarri!

⁴⁸ Transmeton Buhariu në Edebu-l0mufred, ndërsa Albani e konsideron hasen.

*Oj Fatime, e bija e Muhammedit! Shpëtoje veten nga zjarri sepse unë nuk mund të bëj asgjë për ty tek Allahu, me përjashtim që ne kemi lidhje familjare, të cilën (në këtë botë) do ta mbaj.*⁴⁹

Në *Mirkatu-l-mefatih* shpjegohet se lidhja që do të vazhdojë është lidhja në bazë të afërsisë me gjërat që parasheh kjo afërsi, si: bamirësia, largimi i padrejtësisë, dhunës, etj.⁵⁰

Nëse kjo ka të bëjë me të afërmit, në përgjithësi, atëherë prindërit, që janë shkaktarët biologjikë të ardhjes së njeriut në këtë botë, meritojnë më shumë se të tjerët respekt dhe mirësjellje.

3. Mirësjellja

Profeti (*sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem*) ka porositur që të respektohen prindërit, pavarësisht se çfarë feje kanë. Një rast konkret e kemi me Esmën, e cila rrëfen të ketë kërkuar leje nga Profeti (*sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem*) për nënën e saj, e cila, ndonëse ishte ende jomyslimane, kishte shfaqur dëshirë të ishte në lidhje me vajzën e saj, pra Esmën. Ai i kishte thënë: “*Po, mbaji lidhjet me nënën tënde!*”⁵¹

4. Përkujtimi edhe pas vdekjes

Nëse prindërit vdesin si jobesimtarë, atëherë myslimanit nuk i takon të kërkojë falje për ta, për shkak se lutja është e padobishme. Është rregull i Zotit që:

⁴⁹ Transmeton Muslimi.

⁵⁰ Shih: El-Karij. (2002). *Mirkatu-l-mefatih*. Op. cit. 8/3372.

⁵¹ Hadithin e shënon Buhariu.

- Ata që vdesin si jobesimtarë, nuk hyjnë në Xhenet,⁵² dhe
- Ndalohet kërkimfalja për ata që kanë vdekur si jobesimtarë, pavarësisht se kush janë. Muslimi transmeton se me një rast, i Dërguari i Allahut (*sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem*) kishte vizituar varrin e nënës së tij, ku edhe kishte qarë. Kishte thënë: “Kërkova leje të kërkoja falje për nënën, por nuk m’u dha. Kërkova leje ta vizitoja varrin e saj dhe m’u dha leja.”⁵³

Pra, lejohet që të përkujtohen prindërit, raportet me ta, por nuk lejohet të kërkohet falje për ta, sepse pas vdekjes së jobesimtarëve, lutjet më nuk u bëjnë dobi.

2.4. Mosdëgjueshmëria ndaj prindërve, manifestimi dhe pesha e mëkatit

1. Mëkat prej mëkateve më të mëdha

Kundërshtimi i prindërve është prej mëkateve më të mëdha. Ebu Bekrete (*radijAll-llahu anhu*) transmeton:

Kemi qenë tek i Dërguari i llahut (*sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem*), kur tha: *A t’ju rrëfej për mëkatet më të mëdha?*- dhe e përsëriti tri herë.

Thamë: Po, gjithsesi, o i Dërguari i Allahut!

Tha: T’i përshkruash shok All-llahut, t’i kundërshtosh prindërit dhe të shpifësh...⁵⁴

Imam Neveviu në shpjegim të këtij hadithi thotë të jenë pajtuar dijetarët rreth urdhrit për mirësjelljen me prindërit

⁵² Shih ajetin: En-Nisa: 48.

⁵³ Këtë qëndrim e mbështet edhe ajeti 113 nga kaptina Et-Teube.

⁵⁴ Transmetim unanim.

dhe asaj se kundërshtimi i tyre është prej mëkateve të mëdha.⁵⁵

2. Mallkimi i prindërve mëkat i madh

Si imazh i manifestimit të kundërshtimit të prindërve është edhe përdorimi i fjalorit të pistë në raport me ta. I Dërguari i Allahut (*sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem*) ka thënë: “...Allahu e ka mallkuar atë që mallkon prindërit e tij!...”⁵⁶

3. Sharja e prindërve

Mëkat i madh është dhe sharja e prindërve apo bërija shkaktar për sharjen e tyre. I Dërguari i llahut (*sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem*) ka thënë: “Sharja e prindërve është prej mëkateve të mëdha.

E si i shan njeriu prindërit?- e pyetën.

Tha: *Ia shan dikujt, e i shajnë babanë dhe nënën.*”⁵⁷

4. Mëkat me dënim të përshpejtuar

Kundërshtimi i prindërve është prej mëkateve që kanë dënim të përshpejtuar. Ebu Bekrete (*radijAll-llahu anhu*) transmeton se i Dërguari i All-llahut (*sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem*) ka thënë: “Nuk ka mëkate që meritojnë t’u përshpejtohet dënimi në këtë botë, krahas dënimit që u ruhet për

⁵⁵Shih: En-Nevevi. (1392 h.) *El-minhaxh sherhu Sahihi Muslim*. Op. cit. 16/104.

⁵⁶ Transmeton Muslimi.

⁵⁷ Hadithi është autentik. Shih: *Sahihu Edebi-l-Mufred*, op. cit. Nr. 27.

botën tjetër, sikur padrejtësia dhe shkëputja e lidhjeve familjare.”⁵⁸

5. Privimi nga mëshira e Allahut

Kundërshtari i prindërve në Ditën e Llogarisë do të ngelë i privuar nga mëshira e Allahut. I Dërguari i Allahut (*sal-la-All-llahu alejhi ve sel-lem*) ka thënë: “*Allahu i Madhëruar nuk do t’i shikojë tre veta në Ditën e Llogarisë: kundërshtarin e prindërve, gruan që imiton meshkujt dhe dejjuthin (atë që pranon të keqen në shtëpi)...*”⁵⁹

2.5. Kufiri i respektit për prindërit

1. Nuk ka respekt në mëkat

Ashtu sikur në Kuran, edhe në Sunet është përshkruar kufiri ku mbaron respekti për prindërit. Ky kufi ka të bëjë me ndalesat e Allahut. Nëse prindërit e urdhërojnë fëmijën për diç të gabuar, atëherë nuk është mëkat për këtë të fundit që të mos e çojë në vend fjalën e tyre, ngase: “*Nuk ka respekt për krijesën nëse të urdhëron t’i bësh mëkat Krijuesit.*”⁶⁰

Nëse prindërit të urdhërojnë t’i bësh mëkat Allahut, atëherë, referuar këtij hadithi, nuk respektohet fjala e tyre.⁶¹

⁵⁸ Hadithi është autentik. Shih: *Sahihu Edebi-l-Mufred*, op. cit. Nr. 29.

⁵⁹ Hadithin e shënon Nesaiu ndërsa Albani e konsideron autentik.

⁶⁰ Hadith autentik. Shih: *Sahihu-l-xhami*, 7520.

⁶¹ Shih: El-Karij. (2002). *Mirkatu-l-mefatih*. Op. cit. 1/132.

3. Shembuj nga gjeneratat e para për respektimin e prindërve

3.1. Koncepti i të parëve për respektimin e prindërve

1. Natyrshmëri edhe hiç po të mos urdhëronte feja

Te gjeneratat e para respektimi për prindërit ishte diç që, para së gjithash, e përcakton natyra e pastër njerëzore, sikur që konsideron për shturje nga kjo natyrshmëri kundërshtimit dhe arrogancën ndaj tyre. Ebu Lejth Samarkandi ka thënë: *‘Edhe po të mos e përmendte Allahu në Kuran ndalesën e kundërshtimit të prindërve dhe të mos na porosiste fare për mirësjellje me ta, vetvetiu, nga logjika, do të kuptohej se shërbimi ndaj tyre është obligim.*⁶²

2. Vepër që shlyen edhe mëkatet e mëdha

Ibn Abbasi (*radijAll-llahu anhumu*) thoshte se nuk ka vepër që djeg mëkatet më shumë sesa mirësjellja me prindërit. Një njeri i kishte ardhur dhe i kishte thënë se ka bërë mëkat të madh. Ibni Abbasi i kishte thënë ta respektonte nënën. Pasi që i kishte vdekur nëna, Ibni Abbasi i tha të pendohej.

Atau thotë: E pyeta Ibni Abbasin se përse ia përmendi nënën dhe respektimin e saj ndërsa fjala ishte për një mëkat të madh?

Tha: *‘Unë nuk di ndonjë vepër që të afron tek Allahu më shumë se mirësjellja me prindërit.*⁶³

⁶² Es-Semerkandi, Ebu El-Lejth Nasr bin Muhammed. (2000) *Tenbihi-l-gafiline bi ehadithi Sejjidi-l-Enbijai ve-l-Murseline*. Verifikues shkencor: Jusuf Ali Bedjevi. Damask-Bejrut: Dar Ibn Kethir. Nr: 143, f. 124.

⁶³ Shih: *Sahihu Edebi-l-Mufred*. Op. cit. Nr. 4, f. 34.

3. Vepër për jetë të lumtur

Tek të parët tanë respektimi për prindërit ishte vepër që e konsideronin edhe mjet të arritjes së lumturisë, sikur që braktisjen e respektit e shihnin si simptomë të jetës së vështirë, depresionit, ngushtimit të shpirtit. Është transmetuar se njëri nga Sahabet ka thënë: *‘Fëmijës do t’i bëhet jeta e vështirë nëse e braktis lutjen për dy prindërit e tij.*⁶⁴

4. Durimi

Duke qenë se të parët e shihnin respektimin e prindërve si vepër të madhe dhe me shpërblim të madh, atëherë ata tregoheshin të vëmendshëm dhe shumë durimtarë që ta jetësonin me format më të mira të mundshme. Ibni Abbasi thoshte: *‘Me prindërit bëhu sikur robi fajtor dhe i përvuilur para zotërisë së tij të ashpër dhe të vrazhdë.*⁶⁵

5. Përkushtimi maksimal për të mos lënduar ndjenjat e tyre

Të parët ishin të kujdesshëm që të mos bënin as edhe veprimin më të vogël që do të mund të shqetësonte prindërit ose të lëndonte ndjenjat e tyre. Ibni Abbasi thoshte në koment të ajetit: *“...dhe që të silleni mirë me prindërit...”* (*El-Isra: 23-24*): *‘Mos e shkund rrobën që të pluhurosen ata.*⁶⁶

⁶⁴ Es-Semerkandi. (2000) *Tenbihi-l-gafiline*. Op. cit. Nr. 148, f. 129.

⁶⁵ Shih: Hakki, Ismail. (p.v.b.) *Ruhu-l-Bejan*. Bejrut: Dar el-fikr. 5/147.

⁶⁶ Ibn El-Xheuzi, Xhemaluddin Ebu-l-Ferexh AbduRrahman bin Ali. (1993) *El-birr-rru ve-s-siletu*. Verifikimi shkencor: Adil Abdul Mevxhud dhe Ali Muavvad. Bejrut: Muessesetu-kutubi-th-thekafijeh. F. 43.

Ata nuk bënin ndonjë veprim nga i cili prindi do të ndihej i prekur ose i nënvlerësuar. Ebu Hurejre, siç qëndron në Edebu-l-mufred,⁶⁷ i kishte parë dy veta duke ecur.

Çfarë jeni ndërmjet vete?- i pyeti.

Baba e bir- ia kthyen.

Ebu Hurejre iu drejtua të birit: Mos e thirr babanë në emër, mos ec para tij dhe mos u ul para tij.

6. Favorizonin respektin për prindërit ndaj adhurimeve vullnetare

Duke qenë se respektimi për prindërit është obligim, siç cituam Imam Neveviun,⁶⁸ atëherë të parët ishin kureshtarë që këtij obligimi t'i jepnin përparësi ndaj punëve të tjera, veçmas nëse ato ishin vullnetare madje edhe nëse bëhej fjalë për adhurime. Imam Ahmedi citon Muhammed bin Munkedirin të ketë thënë: Vëllai im e kaloi natën duke falur namaz ndërsa unë e kalova duke prekur këmbën e nënës (e relaksoja). Po të më kërkonte t'ia ndërroja natën, nuk do ta bëja.⁶⁹

⁶⁷ Shih: *Sahihu-Edebi-l-Mufred*, op. cit. Nr. 32, f. 46.

⁶⁸ Shih: En-Nevevi. (1392 h.) *El-minhaxh sherhu Sahihi Muslim*. Op. cit. 16/104.

⁶⁹ Ibn Hanbel, Ahmed bin Muhammed. (1999) *Ez-Zuhdu*. Bejrut: Dar el-kutub el-ilmijeh. F. 72. Shih edhe: Ibn El-Xheuzi, Xhmaluddin Ebu-l-Ferexh AbduRrahman bin Ali. (1986) *Et-Tebisiretu*. Bejrut: Dar el-kutub el-ilmijeh. F. 191; Ibn El-Xheuzi, Xhmaluddin Ebu-l-Ferexh AbduRrahman bin Ali. (1986) *Sifetu-s-safve*. Kajro: Dar el-hadith. 1/379.

7. Derë Xheneti

Të parët prindin e konsideron si urë që të çon në Xhenet. Apo, më konkretisht, e konsideronin derë nëpërmjet së cilës hyhet në Xhenet. Kur Ijas bin Muaviut i vdiq nëna, qau.

Përse qanë?- e pyetën.

Tha: I kam pasur dy dyer të Xhenetit të hapura, njëra tash (që më vdiq nëna) m'u mbyll.⁷⁰

3.2. Shembuj nga të parët për respektimin e prindërve

1. Dy burrat më respektues të prindërve nga ky umet

Shembuj nga gjeneratat e para për respektimin e prindërve ka shumë. Do të doja të veçoj vetëm disa sa për ilustrim. Aisheja (*radijAll-llahu anha*) flet për dy burra të mëdhenj të këtij umeti, të cilët i klasifikon si njerëzit më respektues për prindërit në radhët e këtij umeti. Fjala është për Othmanin dhe Harithe bin Nu'manin (*radijAll-llahu anhumu*). Thotë Aisheja: 'Kanë qenë dy burra nga radhët e shokëve të Dërguarit të Allahut (*sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem*), që kanë qenë më respektuesit për nënat e tyre nga ky umet. Ata janë Othman bin Affani dhe Harithe bin Nu'mani. Othmani thoshte: Që kur kam pranuar Islamin, nuk kam mundur ta shikoj nënën në sy (nga respekti dhe turpi). Ndërsa Harithe ia çmorriste kokën nënës dhe e ushqente me dorën e tij. Po e urdhëroi diçka, kurrë nuk e pyeste se çfarë i kishte thënë, edhe nëse nuk e kishte kuptuar ose kapur atë që kishte thënë. Kur

⁷⁰ Ibn Mendhur El-Ensari, Muhammed bin Mukrim bin Ali. (1984) *Muhtesar Tarihi Dimeshk li Ibn Asakir*. Verifikues shkencor: grup hulumtuesish. Damask: Dar el-fikr li-t-tibaah. 14/129.

dilte ajo, e pyeste dike që ishte i pranishëm se çfarë kishte thënë nëna.⁷¹

2. Ibn Mes'udi, protagonist i 'shpellës' nga ky umet

Në hadithet profetike kemi mësuar për heronj të ndryshëm në fushën fetare: heronj adhurimi, heronj morali e nderi, heronj betejash, etj. Më lart përmendëm hadithin e tre vetave që ishin ngujuar në shpellë dhe kishin arritur të dilnin prej saj vetëm atëherë kur ishin lutur me nga një vepër të mirë. Njëri prej tyre kishte përmendur respektimin e prindërve. Duke qenë se atje vetëm aluduum në të, këtu do të përmendim si tekst pjesën që na duhet: *"...Njëri prej tyre tha: "O Zoti im, unë i kam pasur prindërit pleq të thinjur dhe asnjëherë nuk u kam dhënë të hanë e as të pinë fëmijëve të mi e as mallit tim (shërbëtorëve) para tyre. Një ditë më argëtoi kërkimi i kullosës më të mirë për kopenë time e nuk u erdha me kohë, prandaj ata kishin fjetur. Unë e mola qumështin në enë dhe ua solla por i gjeta duke fjetur. Më erdhi keq t'i trazoja, por nuk doja që t'i ushqeja familjen dhe shërbëtorët para tyre, prandaj kam pritur me enë në dorë dhe kam shikuar kur do të zgjohen e kjo pritje ka zgjatur deri në agim. Fëmijët e mi aty te këmbët e mia klithnin të uritur, por unë u dhashë qumësht vetëm pasi janë zgjuar prindërit dhe e kanë pirë qumështin të cilin ua kisha sjellë. O Zoti im! Nëse këtë e kam bërë vetëm për Ty e për askënd tjetër, atëherë na e largo neve këtë shkëmb nga hyrja e kësaj shpelle, në të cilën gjendemi!"...*"⁷²

⁷¹ Ibn El-Xheuzi. (1993) *El-birr-rru ve-s-siletu*. Op. cit. F. 84.

⁷² Transmetim unanim.

Shembuj të këtillë kemi edhe në umetin tonë. Abdullah bin Mes'udit (*radijAll-llahu anhu*) një natë i kishte kërkuar nëna ujë. U çua t'ia sillt, por kur erdhi e gjeti fjetur. Qëndroi me gotë në dorë te koka e saj deri në mëngjes, ndërsa nga frika e shqetësimit nuk e zgjoi nga gjumi, nga frika se do ta shqetësonte. Po kështu nuk u largua nga frika se do të zgjohet e nuk do ta gjente ujin.⁷³

3. Ebu Hurejre me nënën e tij

Ebu Hurejre (*radijAll-llahu anhu*) ishte i dalluar për dashurinë e madhe që kishte për nënën. Nuk dilte nga shtëpia pa iu drejtuar: Paqja, mëshira dhe begatitë e Allahut qofshin mbi ty, oj nëna ime!

Edhe mbi ty qofshin paqja, mëshira dhe begatitë e Allahut, o biri im! - ia kthente.

Pastaj Ebu Hurejre shtonte: Allahu të mëshiroftë sikur që ke bërë me mua kur kam qenë i vogël!

Nëna ia kthente: Allahu të mëshiroftë siç po sillesh mirë me mua tani që jam plakur!⁷⁴

4. Ebu Hanife me nënën e tij

Ebu Hanife ishte i njohur për respektin e madh që kishte për të ëmën. Kjo mund të vërehet më së miri edhe në rastin e burgosjes së tij për shkak të refuzimit që të merrte postin e

⁷³ Shih: Ahmed, Ali Abdul Hamid. (2010) *Et-tahsilu-l-ilmijj ve alakatuhu bi-l-kijemi-t-terbevijjeti*. Bejrut: Mektebetu Hasen el-asrijjetu. F. 216.

⁷⁴ Albani në *Daiifu-l-Edebi-l-Mufred*, nr. 2, konsideron se ka varg transmetuesish të dobët.

gjykatësit. Kur u lirua, kishte thënë: *‘Mërzia e nënës sime më ka ardhur më rëndë se goditjet (e kamxhikut).’*⁷⁵

5. Imam Shafiu me nënën e tij

Imam Shafiu ishte i lidhur me të ëmën shumë. Kjo pasi që babai i kishte vdekur që moti, duke qenë Imami ende fëmijë, kështu që respekti për të ëmën ishte i dyfishuar. Ai thoshte: *‘Po ta përgojoja dikë, do ta përgojoja time mëmë, sepse ajo më së shumti meriton të mirat e mia.’*⁷⁶

Përfundim

Në përfundim të këtij punimi do të doja të veçoja disa nga rezultatet kryesore të tij:

1. Respektimi i prindërve është detyrim fetar.
2. Respektimi i prindërve nuk përkufizohet në një fushë ose aspekt obligimesh. Ai përfshin atë që është shpirtërore, emocionale, etike dhe materiale.
3. Respektimi dhe mirësjellja me prindërit është urdhër që Allahu ia shpalli njerëzimit në vazhdimësi.
4. Profetët ishin respektues të prindërve dhe rrjedhimisht mbetën shembull dhe model për ne.
5. Respekti për prindërit nuk bie as atëherë kur ata nuk janë fare besimtarë/myslimanë. Limit është vetëm ajo që parashihet respekti. Më qartë, nëse prindërit na urdhërojnë për

⁷⁵ El-Hatib El-Bagdadi, Ebu Bekir Ahmed bin Ali. (2002) *Tarihu Bagdad*. Verifikues shkencor: Besh-shar Avad Ma’ruf. Bejrut: Daru-l-garb el-islamiyy. 15/444.

⁷⁶ El-Kasim, Abdul Muhsin bin Muhammed. (1427 h.) *Hutuvat ile-s-seadeh*. Ed. 4. Botues: P.v.b.: p.sh.b. F. 116.

- gjëra që feja na i ndalon, atëherë nuk i respektojmë për përfilljen e urdhrit në fjalë, ndërsa respekti vazhdon.
6. Mirësjellja e prindërve është vepër që nuk kompensohet me asgjë, me përjashtim nëse fëmija e gjen prindin të zënë rob dhe e liron.
 7. Respektimi i prindërve vlerësohet mbi veprat vullnetare.
 8. Respektimi i prindërve sjell lumturinë.
 9. Dhënia përparësi nënës në respekt.
 10. Respektimi për prindërit nuk ndalet me vdekjen e tyre. Ai vazhdon edhe pas vdekjes, dhe kjo në format në vijim:
 - Lutja dhe kërkimfalja për ta,
 - Dhënia lëmoshë për shpirtin e tyre, dhe
 - Respektimi i miqve dhe i dashamirëve të tyre që janë gjallë
 11. Kundërshtimi i prindërve është prej mëkateve më të mëdha dhe mëkateve që kanë dënim të përshpejtuar
 12. Te gjeneratat e para respektimi për prindërit ishte diç që, para së gjithash, e përcakton natyra e pastër njerëzore, sikur që konsideron për shthurje nga kjo natyrshmëri kundërshtimin dhe arrogancën ndaj tyre.

Zoti im, na fal ne, fali prindërit tanë dhe të gjithë besimtarët!

KONTRIBUT

Faik MIFTARI

IMAMËT DHE MYEZINËT E XHAMISË SË "GAZI MEHMED PASHËS" (BAJRAKLISË) NË PRIZREN (1917-2017)

Hyrje

Ka plot gjysmë shekulli që shtëpinë e kam pranë xhamisë së Bajraklisë. Qysh nga fëmijëria e hershme e vizitoj xhaminë, pasi që nga mosha 7 vjeçare babai im, rahmet i pastë shpirti, më merrte për dore dhe, së bashku me të, falja ndonjë namaz të drekës, ikindisë apo akshamit e pothuajse rregullisht namazin xhumasë. Tani, bëhen plot 47 vjet që jam edhe xhematli i xhamisë së Bajraklisë duke marrë pjesë qoftë në namazet ditore, javore, mujore dhe vjetore. Kështu që kam pasur rast që gjatë periudhës së kaluar të takoj, të shoqërohem, të mësoj, të ndjek derset, të falem pas shumë imamëve,

jo vetëm të Prizrenit, por edhe të Kosovës e besa edhe të ish-Jugosllavisë.

Duke marrë parasysh thënien e imamit të shquar boshnjak mulla Mustafa Basheskisë: "Çdo gjë që shënohet mbetet, çdo gjë që mbahet mend harrohet", vendosa t'i shkruaj këta rreshta me të vetmin qëllim që të jap kontributin tim modest konform thënies së cituar më lart, që të shkruaj rreth imamëve dhe myezinëve që kanë shërbyer në xhaminë e Bajraklisë në Prizren, gjatë periudhës së kaluar njëqindvjeçare, dhe kjo prej vitit 1917 e gjer në ditët e sotshme të vitit 2017. Kemi për detyrë, secili atë njohuri që posedon, të shkruajmë që të mbetet e shënuar në letër dhe e publikuar në gazeta, revista, libra apo në media dhe portale elektronike që të mbetet përherë dhe të mos harrohen, për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm që do të vijnë, që të jenë të njohur me të kaluarën tonë të pasur, jo vetëm kulturore e kombëtare, por edhe fetare. Sidomos, kemi obligim të trajtojmë periudhën pas vitit 1912, vit në të cilin u largua Perandoria Osmane nga trojet shqiptare, që këtë njëqindvjeçar të kaluar të hulumtojmë dhe të shkruajmë sa më shumë që mundemi, për këtë periudhë kohore të kaluar të trojeve shqiptare në ish-Jugosllavinë e Kralit dhe ish-Jugosllavinë e Titos, si dy periudha gjatë së cilës populli shqiptar përballoi sakrificat dhe vështirësitë e ndryshme duke arritur të ruajë jo vetëm përkatësinë kombëtare por edhe atë fetare myslimane.

Gjithashtu, edhe periudha pesëshekullore të kaluar gjatë Perandorisë Osmane, duhet trajtuar e hulumtuar, pasi që janë me qindra mijëra dokumente arkivore të ruajtura në arkivat e Turqisë, në veçanti ato të Stambollit, të cilat presin të dalin

në dritë për opinionin e gjerë publik shqiptar në Ballkan për të mësuar dhe njohur me shumë elemente të rëndësishme. Gjatë asaj kohe, shqiptarët në trojet e tyre etnike në kuadër të Perandorisë Osmane kanë dhënë një kontribut të çmuar në fushat e ndryshme: politike, ushtarake, fetare, kulturore, administrative, arsimore, letrare, humanitare, tregtare, zejtare, bujqësore, etj.

Kjo punë duhet kryer me një planifikim afatgjatë, jo vetëm në kuadër të institucioneve shtetërore, por edhe të Bashkësisë Islame të Kosovës, që të dërgohen të rinjtë entuziastë hulumtues, që me vullnet do t'i qasen kësaj pune, në specializim për të mësuar gjuhën osmane në Stamboll dhe Ankara, pas së cilës do t'i rreken punës shumëvjeçare të hulumtimit të arkivave të periudhës osmane që kanë të bëjnë me të kaluarën politike, fetare, kulturore të shqiptarëve gjatë periudhës së kaluar të Perandorisë Osmane, jo vetëm në Kosovë por edhe në Shqipëri, Maqedoni, Preshevë e Ulqin.

Periudhën e kaluar njëshekullore, nga viti 1912 e gjer në ditët e sotshme e kemi më lehtë të hulumtojmë dhe të analizojmë, por duhet pasur vetëm vullnet dhe punë sistematike në hulumtimin e periudhës së kaluar njëshekullore, me theks të veçantë të asaj fetare, pasi e kemi më lehtë të hulumtojmë dokumentet arkivore, të cilat janë në gjuhët dhe alfabetet, të cilat sado kudo i njohim dhe mund të përdorim me më pak vështirësi se të periudhës së kaluar pesëshekullore të periudhës osmane. Edhe ky shkrim mëton në vazhden e hulumtimit të kësaj periudhe të kaluar njëqindvjeçare, që në rastin konkret ka të bëjë me përshkrimin dhe hulumtimin e imamëve dhe myezinëve që kanë shërbyer në xhaminë e “Gazi Me-

hmed Pashës”-(Bajrakisë) në Prizren gjatë periudhës kohore 1917-2017.

Historia e xhamisë së Gazi Mehmed Pashës (Bajrakisë) në Prizren

Xhamia e Bajrakisë është xhamia qendrore e Prizrenit. Ndërtimi i saj ka filluar në vitin 1571 dhe ka përfunduar në vitin 1574 nga Gazi Mehmed Pasha, një pasha (gjeneral) i famshëm osman, i cili ka marrë pjesë në shumë beteja, dhe ka lanë shumë vakëfe (fondacione). Mehmet bej Dukagjinza-de (më vonë merr titullin pasha dhe njihet si Gazi Mehmet Pasha), i cili shërbeu një kohë në pozitën e sanxhakbeut të Shkodrës, në vitin 1571 ka lënë një shumë të madhe parash, me të cilat ndërtoi kompleksin fetaro-arsimor në qendër të Prizrenit në mahallën e Bajrakisë. Kompleksi i tij përbëhet prej xhamisë, mejtebit, ders-hanes, medresesë, hamamit, bibliotekës dhe tyrbes. Të gjitha këto objekte edhe sot e kësaj dite janë të ruajtura, por tani disa janë me destinacione të tjera, përveç xhamisë së Gazi Mehmet Pashës, e cila në popull njihet më shumë si xhamia e Bajrakisë.

Për ndërtimin e kompleksit fetaro-arsimor, Gazi Mehmet Pasha ka lënë vakëf (fondacion) shumë prej 340.000 akçe të destinuara për ndërtimin e medresesë dhe xhamisë. Gazi Mehmet Pasha ishte me prejardhje shqiptare, ka qenë djali i Ahmet bej Dukagjinit, i cili gjatë vitit 1514-1515 ishte në pozitën e Vezirit të Madh të Oborrit të Perandorisë Osmane. Ahmet bej Dukagjini ishte nip i familjes së njohur mesjetare shqiptare feudale, të Dukagjinëve, posedues tokash të mëdha në fushën e Dukagjinit. Mehmet Pasha e ngriti në oborr të

xhamisë së Bajraklisë tyrben me dëshirë që aty të varrosej, por ajo ka mbetur bosh, pasi që ai ka rënë shehid-dëshmor në një fushëbetejë në Hungari në vitin 1596 dhe atje është varrosur.

Në tyrben e ndërtuar tani është vendosur biblioteka me dorëshkrime të vjetra orientale, në të cilin gjenden rreth 200 dorëshkrime nga koha e Perandorisë Osmane në gjuhën arabe, perse dhe osmane (turke). Aty gjendet edhe një raritet me vlerë jashtëzakonisht të madhe, dorëshkrimi i vjetër i Kuranit nga viti 1312. Medreseja e Gazi Mehmet Pashës ka qenë medreseja më e vjetër, jo vetëm në Prizren por edhe në Kosovë, e cila ka punuar gjer në vitin 1947, kur pushteti i atëhershëm komunist e mbylli. Në popull është e njohur me emrin xhamia e Bajraklisë, pasi që prej ditëve të para të punës së saj, është ngritur flamuri në maje të minares për nder të ditëve festive dhe festave të Bajramit, traditë e cila vazhdon edhe në ditët e sotshme. Mbi derën hyrëse të xhamisë qëndron mbishkrimi në gjuhën osmane, ku përveç tjerash shkruan se: **“kjo xhami është ngritur në vitin 981 hixhri, nga ana e Gazi Mehmed Pashës, i cili nuk e ka ngritur këtë xhami për shyhret, por për hir të Allahut, që t’i shërbejë qytetit të Prizrenit”**. Në vitin 1993-1994 nën udhëheqjen e imamatit të tanishëm aktual të xhamisë së Bajraklisë mulla Reshat ef. Mexhiti dhe në koordinim të plotë me Këshillin e Bashkësisë Islame të Prizrenit si dhe ndihmës së pakursyer të xhematit të Prizrenit është kryer restaurimi i tërësishëm i xhamisë së Bajraklisë dhe mund të themi lirisht se sot kompleksi i xhamisë së Gazi Mehmet Pashës në kuadër të cilit hyjnë medreseja (tani muzeu i Lidhjes së Prizrenit), ders-hanja (tani shtëpia e

Lidhjes së Prizrenit), biblioteka, mejtepi (tani ndërtesa e Këshillit të Bashkësisë Islame të Prizrenit), paraqet me të vërtetë “par exellens” të xhamisë më të rregulluar dhe më të mirëmbajtur jo vetëm në Prizren, por edhe në Kosovë dhe mund të krahasohet si i tillë vetëm me kompleksin e xhamisë së Gazi Husrevbeut në Sarajevë.

Kur jemi tek kompleksi i xhamisë, nuk mund të mos përmendim edhe 8 çezmat (krojet), të cilat gjenden në oborr të xhamisë dhe nga të cilët rrjedh uji pandërprerë natë e ditë.

Imamët e xhamisë së Bajraklisë në Prizren

1. Hafëz Qamil ef. Imami (1917-1945)
2. Hafëz Sylejman ef. Shehapi (1945-1947)
3. Hafëz Ismailhaki ef. Ustaibo (1947-1959)
4. Hafëz Safet ef. Basha (1959-1965)
5. Hafëz Aziz ef. Hoxhallari (1965-1977)
6. Hafëz Adnan ef. Rexhepi (1977-1980)
7. Mulla Reshat ef. Mexhiti (1987-në detyrë)

Hafëz Qamil ef. Imami - lindi në Prizren në vitin 1879, rrjedh prej një familje të njohur qytetare dhe me traditë të lartë fetare, e cila ka dhënë imamë, hoxhallarë e hafëzllarë. Babai i tij ka qenë hafëz Mehmed ef. Imami, vëllau i tij, hafëz Abdyli etj. Hifzin e kreu tek i ati, hafëz Mehmed efendiu. Pas hifzit kreu edhe medresenë e Gazi Mehmed pashës në Prizren. Për herë të parë praktikën e kreu gjatë muajit të bekuar Ramazan, dhe për 27 net e bëri Kuranin hatme. Një natë i kishte thënë xhematit në xhami: “Nëse jeni në gjendje të

qëndroni, kam mundësi që për tri netë ta përfundoj Kuranin në tërësi!” Vërtet, ashtu siç u premtoi, për tri netë në teravi nga dhjetë xhuza i këndoi dhe Kuranin e përfundoi!

Pas kësaj ngjarjeje të veçantë, u caktua imam në xhaminë kryesore të Prizrenit, në xhaminë e Mehmed Pashës (Bajraklisë) në vitin 1915, ku e kaloi tërë jetën në shërbim për të vërtetën, gjer në vitin 1945. Një vit, para se të ndërronte jetë, u sëmur dhe pas kësaj e la në amanet që, në vend të tij, të caktohet hafiz Ismailhaku në pozitën e imamit në xhaminë e Bajraklisë.

Hafëz Qamili ishte një hafëz me shumë vlera, çmohej e nderohej si hafëz i rrallë, i fortë dhe me zë shumë të bukur, kishte nxjerrë hafëzë që u bënë të njohur sikur ishin hafëz Maksut Spahiu, hafëz Sami Sylbije, hafëz Ismailhaki Ustai-bo, hafëz Reshad Opoja, hafëz Safet Basha, hafëz Asije Ashqiu etj.

Gjatë kohës sa ishte imam në xhaminë e Bajraklisë, paralelisht përveçqë ua mësonte hifzin talebeve, jepte mësim edhe në medresenë e Gazi Mehmed Pashës, ashtu që në detyrën e imamit të xhamisë i ndihmonte vëllai i tij hafëz Abdyli, i cili ishte edhe imam ofiqar për mahallën e Bajraklisë. Ashtu që zakonisht hafëz Qamil efendiu i falte namazet e sabahut, akshamit dhe jasisë, ndërsa vëllai i tij hafëz Abdyl efendiu namazin e drekës dhe të ikindisë. Hafëz Qamil ef. Imami ndërroi jetë në vitin 1945 dhe u varros në varrezat Kuriçeshme të Prizrenit. Shpirti i tij rahmet pastë!

Hafëz Sylejman ef. Shehapi - ishte me prejardhje nga Tetova, ka shërbye në xhaminë e Bajraklisë 3 vjet, 1945-1947, besimtarët myslimanë të Prizrenit kanë treguar respekt të madh ndaj tij. Hafëz Sylejman ef. Shehapi lindi në vitin 1892 në Tetovë. Hifzin e kreu tek hfz. Xhemil efendiu. Studimet i vazhdoi në Stamboll të Turqisë, ku pasi diplomoi një kohë punoi në Stamboll. Në vendlindje u kthye në vitin 1921 dhe u emërua imam në xhaminë e Çarshisë së Epërme, e gjithashtu ishte edhe myderriz në medresenë e Çarshisë së Epërme në Tetovë, ku shërbeu deri në vitin 1944. Ka qenë edhe myfti i Tetovës prej vitit 1940 deri në vitin 1942. Një kohë ka ushtruar edhe detyrën e gjykatësit në Gjykatën e Tetovës.

Nga Tetova u detyrua të largohej pasi erdhën në pushtet komunistët sllavo-maqedonë. U vendos në Prizren në fund të vitit 1944. Në Prizren e vendosën në një dhomë në medresenë e Mehmed Pashës dhe e emëruan edhe si myderriz (profesor) në medresenë e Mehmed Pashës dhe imam në xhaminë e Bajraklisë. Ka qenë hafiz, alim (dijetar) i madh dhe atdhetar i flaktë. Për vetëm 3 vjet që ka shërbyer me devotshmëri, ka lënë gjurmë të pashlyeshme në Prizren, që akoma kujtohen. Aq respekt të madh kishte për të në Prizren, sa për Ramazan qytetarët e Prizrenit garonin se cili do ta përgatiste iftarin dhe syfyryn për hafizin, myderrizin e nderuar të medresesë si dhe imamin e Bajraklisë, meqë banonte në një dhomë i vetmuar në medrese. Për ligjëratat e tij që mbante flitej me javë dhe muaj, jo vetëm në Prizren por edhe më gjerë. Edhe babai im shpesh gjatë kujtimeve të tij më ka rrëfyer për këtë personalitet me nam që kishte lënë mbresa të veçanta, për të cilin më

thoshte se nuk kishte alim si ai në atë kohë gjatë së cilës jetoi dhe veproi për vetëm 3 vjet në Prizren.

Me një vendim të pushtetit komunist vendor, hafëz Sylejman ef. Shehapiu e detyruan të largohej nga Prizreni. Hafëz Jakub ef. Muqeziu në vitin 1948 e mori me vete, dhe e strehoi hfz. Sylejman efendiun në Sarajevë. Atje hafizi i nderuar gjeti strehim dhe mbështetje nga boshnjakët nëpërmjet lidhjeve që pati hafëz Jakub efendi. Por, hafizin e nderuar edhe atje nuk e lënë rahat, nuk zgjati shumë, një ditë prej ditëve, një futbollist serb prizrenas, i cili luante në atë kohë për klubin futbollistik "Metohia" të Prizrenit, gjatë shkuarjes në Sarajevë për të zhvilluar një ndeshje futbollistike miqësore, rastësisht e takoi hfz. Sylejman efendiun në rrugë, e njohu dhe menjëherë shkoi në zyret e OZN-ës (shërbimi sekret jugosllav) në Sarajevë dhe e denoncoi hafëzin si njeri që ishte kundër sistemit dhe rendit qeverisës komunist. Nuk shkoi shumë kohë pas kësaj dhe hafëzi u burgos dhe u deportua në Gjykatën Hetimore në Shkup. Për shkak të torturave të ushtruara ndaj tij, ndërroi jetë në burg. Ende nuk dihet varri i tij, sikur nuk dihet as dita kur ka ndërruar jetë.

Hafëz Ismailhaki ef. Ustaibo - lindi në vitin 1921 në Prizren. Hifzin e kreu në vitin 1937 së bashku me hfz. Nysret efendin dhe hfz. Sylejman efendin tek muhafizi i shquar i kohës hfz. Qamil ef. Imami. Para hifzit kreu shkollën fillore, kurse medresenë e Gazi Mehmet Pashës në Prizren e përfundoi në vitin 1940. Rrjedh nga një familje e njohur prizrenase me traditë fetare e qytetare. Hfz. Ismailhaki Ustaibo ka punuar si imam në xhaminë e Emin Pashës, të Sinan Pashës

si edhe në xhaminë e Gazi Mehmed Pashës (Bajraklisë) në Prizren në të cilin shërbeu nga viti 1947 gjer në vitin 1959. Nga viti 1948 ishte zgjedhur edhe kryetar i Këshillit të Vakëfit të Prizrenit. Në vitin 1950 u emërua edhe në detyrën e Myftiut të Prizrenit. Hafiz Ismailhaki ef. Ustaibo prej 1 janarit të vitit 1960 u emërua drejtor i medresesë “Alauddin”, gjatë udhëheqjes së tij e ngriti medresenë nga një rang i ulët që ishte në një rang më të lartë gjegjësisht të mesëm, me se e barazoi me gjimnazin e atëhershëm në Prishtinë.

Më 14 tetor 1963 me dekret u zgjodh kryetar i Kryesisë së Bashkësisë Islame në RSS me seli në Prishtinë. Këtë detyrë e kreu deri në çastet e fundit të jetës së tij. Për plot 20 vjet, sa ishte në detyrë ka dhënë një kontribut të çmuar për jetën fetare islame në Prizren në veçanti dhe për Kosovën në përgjithësi. Në vitin 1979 u zgjodh për kryetar të Kuvendit Suprem të Bashkësisë Islame në ish-Jugosllavi. Hafëz Ismailhaki Ustaibo dallohej me zërin e tij të bukur gjatë këndimit të Kuranit. Ka qenë lexuesi më i mirë i Kuranit në gjeneratën e tij.

Gjatë viteve të 70-ta të shek. XX, hfz. Ismailhaku ishte përfaqësues i ish-Jugosllavisë në garat botërore në leximin e Kuranit, edhe u shpërblye nga nikoqiri me një Kuran me kopertinë të praruar dhe iu organizua një pritje në audiencë të mbreti i Malajzisë..

Ndërroi jetë më 26 prill 1983 në Prishtinë në moshën 62 vjeçare, pas një sëmundjeje të rëndë. Xhamia e Bajraklisë ishte mbushur përplot me xhemat e hoxhallarë, të ardhur jo vetëm nga Kosova, por edhe nga Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Bosna e Hercegovina. Namazin e xhenazes ia fali Rei-

sululemaja i atëhershëm i Jugosllavisë Naim ef. Haxhiabdiqi, kurse është varrosur në varrezat e qytetit Kuriçeshme.

Hafëz Safet ef. Basha- lindi në vitin 1920 në Prizren. Shkollën fillore katërvjeçare e kreu në Prizren, vazhdoi shkollimin tek hfz. Sylejman efendiu edhe për katër vite të tjera. Këtu mori njohuri nga lëmi të ndryshme fetare e laike. Në vitin 1932, në moshën 12-vjeçare filloi mësimin e hifzit të Kuranit tek muhafizi Qamil efendiu, i cili ishte imam në xhaminë e Bajraklisë. Për dy vjet e mësoi Kuranin përmendsh dhe mori titullin e nderuar hafëz i Kuranit në moshën 14-vjeçare. Në vitin 1934 u regjistrua në medresenë e Gazi Mehmet Pashës, ku u dallua për zgjuarsinë e tij dhe sjelljen shembullore dhe medresenë e kreu me sukses. Qysh si nxënësi filloi të punonte si myezin në xhaminë e Sozi Çelebiut. Në vitin 1943 u emërua imam në xhaminë e Mahmud Pashës (Hoçamahallës) në Prizren. Në vitet 1945-1947 shërbeu si imam në xhaminë e Iljaz Kukës.

Pas kryerjes së shërbimit ushtarak, në vitin 1950 u emërua arkëtar i Këshillit të Bashkësisë Islamë në Prizren. Nga viti 1954 deri në vitin 1959 e kreu detyrën e imamit në xhaminë e Terzi Mehmed Beut (Terzi Mahallës). Hafëz Safet Basha në vitin 1959, pas shkuarjes së Myftiut të gjeratëhershëm hfz. Ismailhakiut në detyrë të re në Prishtinë, u zgjodh Myfti i Prizrenit, njëherit edhe mori detyrën e imamit në xhaminë e Mehmed Pashës (Bajraklisë).

Në dhjetor të vitit 1982, pas një pune aktive gati 40-vjeçare u pensionua. Hafëz Safet Basha, Myftiu i fUndit i Prizrenit, më datë 05.01.1987 ndërroi jetë. Lajmi për vdekjen e tij u prit me pikëllim të madh nga besimtarët e Prizrenit.

Xhenazen e të ndjerit e përcolli një numër i madh i xhematit, nga shtëpia deri në xhaminë e Bajraklisë. Në mesin e të pranishmëve ishte edhe delegacioni i Kryesisë së Bashkësisë Islame, i prirë nga kryetari Jetish ef. Bajrami, anëtarë të kryesisë së Shoqatës së Ylemave, Myftiu i Prishtinës, përfaqësues të medresesë “Alauddin”, pastaj anëtarë të Këshillave të Bashkësisë Islame nga qytete të ndryshme si Prishtina, Gjakova, Dragashi, Rahoveci etj. Namazin e xhenazes së hfz. Safet ef. Bashës e fali kryetari i Kryesisë së Bashkësisë Islame Jetish ef. Bajrami. Nga xhamia e Bajraklisë, pas namazit, xhenazja e të ndjerit u nis drejt varrezave të qytetit të Kuriçeshmes, e shoqëruar nga një numër i madh i xhematit.

Hafëz Abdylaziz ef. Hoxhallari - lindi në vitin 1922 në Prizren. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse hifzin e kreu tek muhafizi i tij Beqir ef. Kajserliu në mejtebin e xhamisë së Emin Pashës, ku ishte imam hfz Beqiri. Vazhdoi mësimet në medresenë e Mehmed Pashës te myderrizi i shquar Hasan ef. Nahi, por, u detyrua t’i ndërpriste mësimet, si dhe shumë nxënës tjerë, sepse regjimi komunist, në vitin 1947, e mbylli medresenë. Shërbeu si imam në xhami të ndryshme të qytetit të Prizrenit, si në xhaminë e Jenimahallës, Emin Pashës, Gazi Mehmed Pashës (Bajraklisë) në të cilin shërbeu me plot sukses prej vitit 1965 e gjer në vitin 1977, pas së cilës kaloi në xhaminë e Terxhuman Skenderit (Dragomanit), ku edhe u pensionua në vitin 1987.

Hfz. Aziz ef. Hoxhallari (në popull ka qenë i njohur me emrin hafëz Azizi) ka dhënë një kontribut të madh në edukimin e brezave të rinj deri në pleqëri të thellë. Ka mësuar

shumë talebe, jo vetëm në xhami, por edhe nëpër shtëpi. Krahas shërbimit në xhami, gjatë gjithë kohës, sa ka pasur mundësi, është marrë me punët e bujqësisë në arat e tij për të mbijetuar me familjen e tij. Ka qenë shumë modest, gjatë gjithë jetës ka qenë i kënaqur me rriskun që ia ka caktuar Zoti.

Ndërroi jetë më 5 shkurt 2011, në moshën 89-vjeçare. U varros në varrezat Kuriçeshme të Prizrenit po atë ditë, pas namazit të drekës.

Hafëz Adnan ef. Rexhepi - lindi në vitin 1925 në Bresanë të Opojës. Ishte i biri i myderrizit të shquar të Opojës, haxhi Rexhep ef. Ismailit, i cili për plot 40 vjet ka mirëmbajtur medresenë e Opojës në Bresanë, në të cilën kanë mësuar shumë talebe, të cilët, në veçanti gjatë periudhës komuniste, kanë dhënë një kontribut të çmuar në mbajtjen gjallë të jetës fetare në trevën e Opojës dhe më gjerë në Kosovë. Edhe tre vëllezërit e tjerë të hfz. Adnanit me dekada kanë shërbyer si imam në rrethe të ndryshme.

Hfz. Adnani shkollën fillore e kreu në fshatin e tij të lindjes, krahas shkollës fillore ai do të ndjekë edhe mësimet në medresenë e Opojës në Bresanë te myderrizi, babai i tij, haxhi Rexhep efendiu. Në medrese do të dallohej për aftësi të veçanta, zgjuarsi dhe aftësi për të mbajtur mend, kjo i ndihmoi shumë që të mësonte hifzin. Në medresenë e Bresanës, hfz. Adnani do të mësojë tetë vjet dhe do të marrë diplomën në vitin 1946 nga babai i tij, myderrizi i njohur haxhi Rexhep efendiu. Nga viti 1960 e deri në vitin 1968 shërbeu si imam në fshatin e tij të lindjes në Bresanë, kurse më vonë u shpërngul në Prizren, ku shërbeu si imam në tri xhamitë e qytetit

të Prizrenit, në xhaminë e Sozisë, të Mehmed Pashës (Bajraklisë) nga viti 1977 gjer në vitin 1980, pas së cilës kaloi me detyrë në xhaminë e Mahmut Pashës (Hoçamahallës).

Detyrën e imamit e vazhdoi me vullnet e devotshmëri të plotë derisa e mbërtheu sëmundja, e cila e detyroi të ndahej nga detyra aktive e imamit, që e deshi aq shumë dhe së cilës ia kushtoi një pjesë të madhe të jetës së tij. Më 2 korrik 2001 hafëz Adnan ef. Ismaili ndërroi jetë. Me kalimin në Ahiret të hfz. Adnan ef. Ismailit, Opoja dhe Prizreni mbetën pa një alim, hoxhë dhe hafëz të nderuar.

Në periudhën kohore 1980-1986 xhamia e Bajraklisë për shkaqe objektive nuk ka pasur imam të rregullt, por imam të përkohshëm, në vitet 1981, 1982 dhe 1983 nga 6 muaj shërbeu si imam mulla Mazllum ef. Mazllumi, për disa vite me radhë ka falur namazin e sabahut dhe jacisë hafëz Jakub ef. Muqeziu, pastaj një kohë ka shërbyer edhe mulla Vahid ef. Salihu e tjerë.

Mulla Reshat ef. Mexhiti – lindi në vitin 1959 në fshatin Kuklibeg të komunës së Dragashit. Edhe babai i tij mulla Hajriu ka shërbyer si imam. Pas përfundimit të shkollës fillore, kreu medresen "Alauddin" në Prishtinë në vitin 1979. Më pas, vajti në Kajro dhe në Universitetin "Al-Azhar" kreu fakultetin, dega e tefsirit. Pas kryerjes së fakultetit u emërua imam në xhaminë e Bajraklisë në vitin 1987, në të cilën detyrë gjendet ende edhe sot e kësaj dite. Krahës punës si imam në xhaminë e Bajraklisë, jep mësim edhe në Medresenë "Alauddin", paralelja e ndarë fizike në Prizren.

Reshat ef. ka merita të mëdha pasi me një vullnet të madh ka organizuar dhe udhëhequr mbarëvajtjen e punimeve gjatë restaurimit apo renovimit detal të xhamisë dhe oborrit të saj gjatë viteve 1993-1994 dhe lirisht mund të them se ka qenë më meritori për këtë.

Myezinët e xhamisë së Bajraklisë në Prizren

1. Ismail ef. Telaku (1917-1927)
2. Rexhep ef. Rogaça (1927-1947)
3. Abdyrahim ef. Limani (1947-1950)
4. Rexhep ef. Rogaça (1950-1963)
5. Xhelal ef. Hoxhaj (1963-2007)
6. Xhengiz ef. Igxhiu (2007-2011)
7. Muhamed Haki ef. Bojniku (2011-...)

Ismail ef. Telaku- lindi në vitin 1899 në Prizren. Rrjedh prej një familjeje prizrenase me traditë fetare, pasi që të dy vëllezërit i kishte hafëz, hfz. Abdullah ef. Telaku i shquar si dhe hfz. Beqir ef. Telaku. Mësimet e para i mori në familje nga vëllezërit e tij ashtu që si ri në moshën 18-vjeçare u bë myezin në xhaminë e Bajraklisë nga viti 1917, dhe shërbeu gjer në vitin 1927 kur dhe ia lëshoi vendin Rexhep ef. Rogaçës, i cili ishte në gjendje të vështirë ekonomike. Kishte me të vërtetë një zë të bukur melankolik dhe mbahej në mend nga qytetarët e vjetër të Prizrenit. Në vitin 1956 së bashku me familjen dhe vëllanë u shpërngul në Turqi, në vazhden e shpërnguljeve të mëdha shqiptare nga represioni i atëherëshëm serb. Ndërroi jetë në vitin 1980 dhe u varros në varrezat e Bakërkujit në Stamboll.

